

FETVAJA E HAMASË

Shkroi: shejhulislam
AHMED IBN ABDULHALIM IBN MEXHDUDIN IBN TEJMIJE



Fetva rrëth akides së sëlëfit
për emrat dhe cilësitë e Allahut

Përktheu:
Florian Leli



Fetva ja

e

Hamasë

Autor

Ahmed ibn Abdulhalim ibn Tejmiye

Përkthet:

Florian Leli

Botimi elektronik i parë 2014

© Të gjitha të drejtat e librit janë të rezervuara për përkthyesin. Nuk lejohet shumëfishimi apo botimi i librit për qëllime përfitimi me çdo mjet apo formë pa leje me shkrim të përkthyesit.

Në këtë libër, me shprehje të tilla si “fjala e Allahut” apo “Allahu ka thënë” kihen për qëllim ajetet në gjuhën arabe ashtu siç janë zbritur në Kuranin e ndritur. Ndërsa përkthimi i ajeteve në gjuhën shqipe është një mund njerëzor i mangët dhe i papërkryer.

Ajetet e përkthyer në gjuhën shqipe, nuk janë fjale të Allahut në realitet, por një përcjellje e kuptimeve të fjalës së Allahut me përafërsi, sepse ajetet kuranore Allahu i ka folur vetëm në arabisht.

Parathënie

Hamdi qoftë për më të lartin, sunduesin e qiejve dhe të tokës, zotin e Arshit të madh. Dëshmoj se ai është një dhe i vetëm, zotëri i gjithpushtetshëm, krijues i madhërishëm, zot i lavdishëm.

U lartësoftë emri i tij, u bëftë vullneti i tij, urdhëri i tij kur dëshiron diçka të bëhet është bëhu dhe ajo bëhet.

Dëshmoj se askush tjetër përveç tij nuk meriton të adhurohet. I pari pa fillesë, i fundit pa mbaresë, i larti mbi çdo gjë, i afërti me çdo gjë. I pa shok në emrat e tij, i pangjashëm në cilësitë e tij, a mos vallë njeh dikënd tjetër si ai?!

Nuk e kapin shikimet por ai i kap shikimet. Asnjë gjethe nuk bie pa dijen e tij, asgjë nuk i fshihet shikimit të tij, asgjë s'i shpëton dëgjimit të tij, asgjë s'i ngjason atij dhe ai është dëgjuesi shikuesi.

E di atë që ka qënë dhe atë që do të jetë dhe atë që nuk ka qënë, nëse do të ishte si do të ishte. E di atë që fshehin zemrat, atë që e bluan mendja dhe as thërmija më e vogël nuk i shpëton diturisë së tij.

E krijoi Arshin e tij me fuqi, pa pasur për të nevojë. Arshi nuk e mban atë por ai me fuqinë e Allahut qëndron dhe me vullnetin e Allahut ekziston. U lartësua mbi të pa shëmbëllim, ashtu siç deshi pa përshkrim, sepse ai është vepruesi i asaj që dëshiron, askush prej asaj që vepron nuk e pengon.

Dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i tij. Te zoti i tij u ngjit dhe urdhrat e tij i dëgjoi pa perde. E shpalosi të vërtetën, e qartësoi të paqartën, e sqaroi të dyshimtën, e rrëzoi të kotën derisa ajo u zhduk e përçmuar.

Dëshmoj se ishte i sinqertë me umetin, në vend e çoi amanetin, i la në bardhësinë e besimit, në natyrshmërinë e islamit, pas të cilës nuk ka asgjë përveç devijimit.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij të nderuar. O Allah! Paqe dhe bekim çdo edhe mbi shokët e tij, ruajtësit e akides, përhapësit e besimit, kandilët e dritës dhe të udhëzimit.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta dhe këdo që me rrugën e tyre udhëzohet, me dritën e tyre ndriçohet, me fenë e tyre pajtohet dhe aty ku ata kanë ndaluar ndalohet, sepse ajo që dikur nuk ka qënë fe sot nuk mund të jetë e tillë.

Në vijim, me lejen dhe udhëzimin e zotit tim, po paraqes përpara jush këtë punim, të një kolosi në fe dhe në mendim. Dijetar dhe mendimtar i rrallë, ripërtëritës i sunetit, nga figurat e ndritura në faqet e historisë islame, me të cilin krenohet çdo besimtar dhe zemërohet çdo inatqar.

Ky libër, është një orvatje për të ftuar në anijen e sunetit, atë që akoma nuk ka hipur. Le të zbresë nga varka e kulturës greke me të cilën ka humbur navigimin. Le të hipë, akoma sa nuk është vonë, në anijen e udhëzimit. Sepse ashtu siç ka thënë edhe Maliku: “Suneti është si anija e Nuhut. Kush hip në të shpëton, e kush mbetet pas, mbytet”.

Shkak i përkthimit të saj ishin “thanë dhe u tha”, “i gjuajtëm dhe na ranë”, të cilat kanë mbushur faqet e internetit anembanë. Sikur flamurtarët e *ilmul-kelamit* të heshnin, do ta kursenin kohën për përkthimin e të tjera librave. Por dyshimet e panumërta dhe akuzat e shumta, nuk na lanë shteg dhe rrugëdalje tjetër.

Kjo vepër, me lejen e të madhërishmit, është një punim i thjeshtë, që mund t’i shtohet bibliotekës së muslimanit, në mesin e librave të tjerë të përkthyer nga nxënës dhe studentë, mbase më të shumtë se unë në dije dhe më të përgatitur.

Jam mundur që lexuesit të thjeshtë t’i sqaroj disa terma, për ta futur në vija për çështjet e trajtuara. Nuk pretendoj se i kam sqaruar çdo gjë, përkundrazi kjo fetva ka nevojë për më shumë zgjerime, të cilat mund të na lehtësohen në të tjera botime. Gjithashtu kam dhënë një rezume të shkurtër për hadithet e profetit dhe thëniet e dijetarëve të selefit. Nuk kam ardhur me gjykime dhe njohuri të reja. Hadithet dhe etheret e përmendura janë të njohura në mesin e dijetarëve, ashtu siç është i njohur qëndrimi i tyre ndaj tyre.

Jam mjaftuar me kthimin e hadithit dhe etherit te librat kryesorë, megjithëse mund të jetë transmetuar në më shumë libra. Shpeshherë mund të jem zgjeruar në përmendjen e disa senedeve dhe burimin e tyre, nisur nga rëndësia e tyre. Kjo për arsyen e thjeshtë se pasuesi i sunetit dhe rrugës së selefit, ka nevojë të dijë dhe të përvetësojë disa burime dhe fjalë të akides së tij, që ti bëjë ballë dyshimeve dhe panikut që përhapin esharitë dhe maturiditë në mesin e tyre.

I bëj me dije lexuesit se vepra e paraqitur, është një vepër e një dijetari të njohur në botën islame. Mendimi dhe fjala e tij ka peshën dhe rëndësinë e saj. Por nuk është kusht që çdo gërmë apo fjalë që Ibn Tejmija ta ketë shkruar, të pajtohem me të verbërisht dhe të jetë edhe mendimi jonë rrjedhimisht.

Gjithashtu tërheq vërejtjen se kjo vepër nuk është për nivelin e fillestarit. Atë mund ta lexojë ai që fillimisht i ka përvetësuar bazat e akides dhe i ka njohur rregullat kryesore të besimit. Libri nuk është punuar që të jetë vegël në dorën e debatxhiut dhe as

argument për pendën e kalemxhiut. Ai është një gur në murin e lartë të dijes. Grada e debatit ka nevojë për më shumë djersë dhe më tepër libra dhe nuk arrihet me një apo dy punime, me tre apo katër trajtime.

E lus Allahun ta bëjë na japë dobi prej këtij libri dhe të na i hapë dyert e mëshirës së tij dhe portat e njohjes dhe të diturisë. Amin.

Mekë më 1. 2. 1435 h.

E shkroi: Florian Leli.

Jetëshkrim i shkurtër i shejhulislam Ibn Tejmijes

Emri, origjina dhe familja e tij dhe fillimet e herëshme.

Ai është Ahmed ibn Abdulhalim ibn Abduselam ibn Abdullah ibn Hidr ibn Muhamed ibn Hidr ibn Ali ibn Abdullah ibn Tejmije. Kun'ja e tij është Ebu Abas, ndërsa thirret me epitelin Takijudin.

U lind në vitin 661 h. në një familje me origjinë kurde nga Harani. Babai dhe xhaxhallarët e tij emigruan në Damask në vitin 667h. për shkak të gjëndjes së vështirë që ishte krijuar në krahinën e Haranit, pas pushtimit të saj prej tatarëve.

Familja e tij ishte një djep i dijes dhe i kulturës islame. Babai i tij Abdulhalim ibn Abduselami (627-682h) ishte një fakih hambeli dhe hatib i njohur. Ibn Kethiri e ka cilësuar atë si: “Muftiu rreth çështjeve të fraksioneve islame dhe njohësi i thellë i tyre. Posedonte shumë virtyte të larta dhe vlera të shumta”.¹

Ndërsa Ibn Shakir Ketbiu e ka përshkruar me fjalët e tij: “Ishte imam në tefsir. Shquhej për njohjen e medhhebit (hambeli), për njohjen e mospajtimeve, në akide, në gjuhë dhe në gramatikë arabe. Kishte njohuri të thella për aritmetikën, algjebren dhe gjeometrinë dhe në shumë lëmi të tjera. Në anën tjetër ai ishte njeri me moral të lartë dhe i dashur”²

Ndërsa gjyshi i tij Abduselami (590-652h), që thirrej edhe si Ebu Berekat Mexhdudin ibn Tejmije, është aq i njohur sa nuk ka nevojë për fjalë të shumta. Fakih hambeli dhe usulist i njohur. Hartuesi i librit të famshëm “El munteka min ehadithil ahbar” të cilin e ka shpjeguar Sheukani në librin e njohur “Nejlul eutar”. Vetë Shukani në parathënien e librit të tij e lavdëron imam Mexhdudin ibn Tejmijen me lëvdata të larta, madje duke e quajtur edhe muxhtehid absolut, gradë që nuk para përdoret kollaj në mesin e fukahave.

Prej veprave të tij “El ahkamul kubra” një enciklopedi në disa vëllime rreth dispozitave fetare.

Dhehebiu shprehet për të: “Ishte imam i plotë, i pashok në kohën e tij. Ishte kokë në fikh dhe në usul dhe shumë i fortë në dijen e hadithit dhe interpretimin e tij.

¹ El bidaje uen nihaje, (3/303).

² Ujunut tarih, 22/339.

Gjithashtu kishte dije të thellë rreth tefsirit dhe kiraeteve të Kuranit”.¹

Të njohur në mesin e shujhëve kanë qënë edhe tre vëllezër të shejhul-islam ibn Ibn Tejmijes, të cilët ishin:

1) Vëllai i tij nga nëna e tij, Bedrudin Muhamed ibn Halid Haraniu (650-717h). Fakih dhe mësues i fikhut.

2) Zejnudin Abdurrahman ibn Abdulhalimi. (663-747h). Zahid, asket dhe tregtar. Qëndroi me Shejhul-islam në burg në Aleksandri dhe në Damask për ti shërbyer.

3) Sherefudin Abdullah ibn Abdulhalimi (666-727h). Ishte dijetar me dije të thellë. Udhëtoi me shejhul-islam Ibn Tejmijen në Egjipt dhe u shqua për debatet me kundërshtarët e tij.

Që në fëmijëri Ibn Tejmije u dallua për memorie të fortë, mprehtësi dhe zgjuarsiri. Mësimet e para i morri nga vetë babai i tij. Më pas mësoi dhe e morri dije nga dijetarë të njohur hanbeli dhe shafi, si puna e:

1- Sherefudin Makdesi (622-694h) Shejhu dhe muftiu i shafive në kohën e tij dhe hatib i njohur i Damaskut.

2- Muhamed ibn Abdulkavi ibn Bedrani. Fakih dhe gramaticien i njohur, prej të cilit Ibn Tejmije përvetësoi shkencat e gjuhës arabe.

3- Takijudin Vasitiu (602-692h), prej dijetarëve hambeli në lagjen Salihije.

4- Muhamed ibn Ismail Amidiu. Nga dijetarët e Egjiptit.

5- Menxha ibn Uthman Menxha Tenuhiu (631-695h). Prej tij Ibn Tejmija morri dhe studioi fikhun.

6- Abdurrahim ibn Muhamed Alethiu (612-685).

7- Halla e Ibn Tejmijes, Situdar bint Abduselami. Ka transmetuar prej saj hadithe.

Që në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçare, zuri postin e mësuesit dhe muftiut në medhhebin hanbeli. Në vitin 683h zëvendësoi babain e tij në postin e mësuesit në shkollën “Darulhadith” duke mbajtur leksione të rregullta në të.

Ibn Kethiri, duke përshkruar leksionin e parë të Ibn Tejmijes në këtë shkollë shprehet: “Në këtë leksion prezantoi Kadikudati i shafive Behaudin ibn Zeki, shejhu shafi Taxhudin Gazeviu, shejh Zejnudin ibn Murahili dhe Zejnudin ibn Menxha nga hambelitë. Ishte një leksion i paparë. Shejh Taxhedin Fezari e ka shkruar me dorën e tij

¹ Marfetul el kurra el kibar, (2/654)

për shkak dobive të shumta ...”.¹

Xhihadi dhe veprimtaria fetare.

Hulumtuesi i jetës dhe veprimtarisë së shejhul-islam Ibn Tejmijes, ka për të gjetur te personaliteti i tij një kolos të mendimit, jo vetëm në aspektin teorik por edhe në atë praktik.

Ibn Tejmije ishte një person i palodhur në thirrjen islame dhe i angazhuar në të gjitha drejtimet. Shumë i përgatitur nga ana profesionale, ai u shndërrua shumë shpejt në një dijetar që synohej nga të gjithë. I dashur me njerëzit dhe duke jetuar në mesin e tyre, shumë shpejt i fitoi zemrat e tyre dhe emri i tij u bë i njohur te përkrahësit dhe te kundërshtarët e tij.

Veprimtaria e tij fetare duket qartë në librat voluminozë që la pas. Diapazoni i gjërë dhe njohuritë e thella në fushat dhe lëmitë e ndryshme të diturisë kuptohen lehtë në shkrimet dhe përpilimet e tij.

Me mendimin e tij të lirë dhe të hapur, Ibn Tejmije na paraqitet në veprat e tij si një kritik fetar i fraksioneve të ndryshme islame dhe joislame. Kritik i historisë islame dhe evolimit të fraksioneve historike, siç vërehet qartë në veprën e tij “Minhaxhul itidal” ku kritikon bazat dhe parimet mbi të cilat rafiditë bazuan medhhebin e tyre.

Njohës i disa gjuhëve të huaja dhe i literaturës greke dhe persiane. Njohës i sekteve të ndryshme çifute dhe të krishtere. Kjo i dha një shtysë më shumë për të shkruar dhe hartuar vepra rreth krishtëritizmit dhe feve të tjera. Vepra e tij voluminoze “El xheuabus sahih”, kritikon mendimin dhe besimin e krishterë, bazuar në fakte dhe citate të marra nga vetë literatura e tyre. Fatkeqësisht kjo vepër nuk ka arritur në kohën tonë e plotë.

Mësues i palodhur. Me meritë e fitoi titullin “shejhul-islam” që do të thotë “dijetari i islamit”. Titull me të cilin vazhdon të thirret si te përkrahësit e tij, ashtu edhe te kundërshtarët e tij.

Nëse produkt i veprimtarisë së tij do të ishin vetëm nxënësit e tij të ngushtë atëhere do të ishte e mjaftueshme për të dëshmuar vlerën dhe rëndësinë e tij. Nga dora e tij lindi dhe u formua një plejadë e artë dijetarësh. Prej tyre:

- 1) Ibn Kajimi vd. 751 h.
- 2) Dhehebiu, vd. 748h.
- 3) Ibn Kethiri vd. 774h.

¹ El bidaje uen nihajeh, (13/303).

- 4) Ibn Abdulhadi, vd. 744h.
- 5) Umer ibn Ali Bezari, vd. 749h.
- 6) Jusuf ibn Abdurrahman Muzemiti, vd. 742h.
- 7) Kadiu Ibn Kadilxhebel, vd. 771h.
- 8) Ibn Fad Umeriu, vd. 749h.
- 9) Muhamed ibn Menxha, vd. 724h.
- 10) Jusuf ibn Mahmud Betiu, vd. 726h.
- 11) Muhamed ibn Muflih Hanbeliu. Autori i librit “El furu”, vd. 763.

E shumë të tjerë. Secili prej këtyre dijetarëve është një faqe më vete në dije dhe ka nevojë për jetëshkrim të veçantë.

Por Ibn Tejmije nuk u ndal në kufinj të veprimtarisë akademike dhe shkencore. Jeta e tij ishte një mishërim i muxhahidit dhe aktivistit të paepur.

Në vitin 693h ndodhi ngjarja e të krishterit Asaf ibn Hixhit, atëhere kur ofendoi profetin. Atëhere Ibn Tejmije me shejh Zejnudin Farikiun u ngritën dhe shkuan te emiri i Damaskut. Në këtë ngjarje ndodhën precedente dhe sprova për këta dy dijetarë, derisa ky i krishter u ekzekutua.

Në vitin 699h sëbashku me xhematin e tij ndërmori një aksion për thyerjen e bareve dhe vendeve ku serviroshin pije alkolike dhe zbatuan disa ndëshkime ndaj disa pronarëve të bareve.

Prej tyre qëndrimi që Ibn Tejmije mbajti ndaj sulltan Nasirit gjatë mbledhjes që sulltani mbajti me dijetarët në Egjipt. Veziri i sulltanit kërkoi mendimin e dijetarëve për heqjen e veshjeve të posaçme për çifutët dhe të krishterët në këmbim të pagesës. Dijetarët heshtën. Askush nuk e ngriti zërin përveç Ibn Tejmijes, i cili foli ashpër, derisa sulltani e refuzoi kërkesën e të krishterëve.

Në ditën e xhuma 17 sheval 697h. shejhu mbajti një tubim të madh për nxitjen e njerëzve për xhihad, duke sqaruar gradën dhe vlerën e xhihazit dhe muxhahidëve.

Në vitin 699h. mbajti qëndrimin e tij të njohur ndaj Kazanit, komandantit të ushtrisë tatare, e cila kishte rrethuar Damaskun. Ibn Tejmija ishte personazhi kryesor në negociatat që u mbajtën me Kazanin, deri sa ushtria tatare e ngriti rrethimin e Damaskut dhe u kthye.

Në vitin 700h. mbërritën lajme se ushtria tatare po marshonte drejt Damaskut për pushtimin e tij. Njerëzit të tmerruar u përgatitën për emigrim në Egjipt. Këtu del në pah personaliteti i fortë i Ibn Tejmijes, në qetësimin e njerëzve dhe urdhërimin e tyre për durim dhe qëndrim dhe ndalimin e braktisjes së Damaskut, që të mos bjerë në dorë të

armikut.

Ai ishte një prej delegatëve që shkuan te sultani i Egjiptit dhe e urdhëruan për përgatitjen e ushtrisë për xhihad derisa sulltani u bind dhe filluan përgatitjet për daljen e ushtrisë islame.

Ibn Kethiri në përshkrimin e këtyre ngjarjeve thotë: *“Në fillim të muajit sefer erdhën lajme se ushtria tatarë po marshon drejt Shamit dhe se në plan kanë edhe ekspansionin e Egjiptit. Njerëzit u shqetësuan dhe u dobësuan më shumë se më parë dhe humbën logjikën, aq sa zunë të largohen në drejtim të Egjiptit, Shobekut apo në disa kala të tjera të sigurta.*

Çmimi i udhtimit për në Egjipt me gomar, arriti 500 dirhem, ndërsa udhëtimi me deve 1000 dirhem. U shitën mallrat dhe paisjet dhe rrobat e shtrenjta me çmimet më të lira.

Shejh Takijudin ibn Tejmije në datën 2 sefer, mbajti mësimin e tij në xhami, ku i nxiti njerëzit për daljen në luftë. U përmendi ajetet dhe hadithet rreth xhihadit dhe i ndaloi prej largimit. I nxiti për shpenzimin e pasurive për mbrojtjen e muslimanëve dhe të vendeve të tyre dhe pasurive të tyre dhe se pasuria që shpenzohet për emigrim nëse do të shpenzohej për xhihad do të ishte më mirë.

E obligoi xhihadin kundër tatarëve kategorikisht dhe këto fjalë i përsëriti në shumë kuvende të tjera.

Pastaj u lëshua urdhër që askush të mos largohej (nga Damasku) përveçse me urdhër dhe leje nga sulltani. Pastaj njerëzit ndaluan prej emigrimit dhe u qetësuan ...

... Ibn Tejmije më pas shkoi te zëvendësi i sulltanit në Sham dhe i urdhëroi që të qëndronin dhe të tregoheshin të fortë dhe e kaloi natën tek ata. Pastaj e zgjodhën si delegat për te sulltani që ta nxiste për të ardhur. Kështu u nis për në Kajro dhe e arriti sulltanin pasi kishte hyrë në qytet dhe ushtarët ishin shpërndarë. Mirëpo Ibn Tejmije u takua me sulltanin dhe e nxiti që të përgatiste ushtrinë për në Sham dhe u tha: Nëse i ktheni shpinën Shamit dhe nuk e mbron, atëhere ne do të zgjedhim një sulltan të pavarur që ta fortifikojë dhe ta mbrojë atë dhe përfitimet e shtetit do t'i takojnë atij në kohë paqeje. Vazhdoi t'u bënte presion derisa ushtria u dërgua për në Sham”.¹

Në vitin 702h. morri pjesë në betejën e njohur të Shakhabit, në të cilën sulltan Kalauni dhe muslimanët thyen ushtrinë tatarë. Në këtë betejë Ibn Tejmije dhe xhemati i tij luajtën një rol të rëndësishëm.

Në këtë betejë Ibn Tejmije betohej për Allahun përpara komandantëve të ushtrisë dhe përpara njerëzve se këtë herë ata do të ishin fitimtarë. Komandantët i

¹ El bidaje uen nihaje (14/14).

thoshin: Thuaj me lejen e Allahut. Atëhere ai thoshte: Me lejen e Allahut si vërtetim dhe jo si dyshim, siç e përmend Ibn Kethiri në “El bidaje uen nihaje”.

Në vitin 704h. u nis me xhematin e tij për një ekspeditë ushtarake në malësinë e Xherdit dhe Kesravanijes kundër rafidive dhe u kërkuan pendim një pjese të madhe prej tyre dhe i detyruan që të praktikojnë obligimet islame.

Në vitin 705h Ibn Tejmije niset sëbashku me një pjesë të ushtrisë me në krye zëvendësin e sulltanit kundër druzëve dhe rafidive dhe Allahu ju dhuroi sukses dhe triumf ndaj tyre.

Në vitin 712h. doli me sulltan Kalaunin për një fushatë xhihadi në rrugë të Allahut, pasi u lirua nga burgu dhe shpëtoi prej fitnes së njohur që i ndodhi në Egjipt.

E shumë beteja dhe veprimtari të tjera të cilat dijetarët i kanë përcjellur me detaje në librat e historisë, sidomos nxënësi i tij Ibn Kethiri i cili i ka përmendur këto ngjarje me hollësi në librin e tij të njohur “El bidaje uen nihaje”.

Sprova dhe vdekja e tij.

Çdo njeri që arrin në gradën e Ibn Tejmijes patjetër do të urrehet dhe armiqësohet prej njerëzve të shumtë. Ai u sprovua me burg disa herë në jetën e tij për shkak të trillimeve të shpirtligëve dhe për shkak të mendimeve të tij, të cilat në disa raste, ishin në kundërshtim me modelin e ngurtë të dijes, i cili mbizotronte në mendjet e disa njerëve me influencë në atë kohë.

Sprovat dhe burgosjet që provoi ishin të shumta dhe kanë nevojë për trajtim të gjërë. Prej tyre sprova e fetvasë së Hamasë, e cila po i paraqitet lexuesit shqiptar në këtë botim.

Sprova dhe burgosja e fundit ndodhi në vitin 726h. për shkak të një fetvaje të herëshme të shejhut ku e ndalonte udhëtimin për në varret e evlijave. Kundërshtarët e shejhut, ja paraqitën këtë fetva mëkëmbësit të sulltanit në Damask, të deformuar dhe të ndryshuar, kinse Ibn Tejmije cënonte vlerat e vetë profetit ﷺ dhe të profetëve të tjerë.

Në datën 6 shaban 726h. u arrestua me urdhër të mëkëmbësit të sulltanit dhe u burgos në kalanë e Damaskut. Me të në burg hyri edhe vëllai i tij Zejnudini që t’i qëndronte pranë dhe t’i shërbente.

Pak nga pak u privua nga shumë gjëra. Fillimisht u privua nga vizita e nxënësve të tij. Pastaj u dha urdhër që të nxirreshin të gjitha mjetet e shkrimit nga qelia e tij, në mënyrë që të mos shkruante libra. Pjesën e mbetur të jetës e kaloi në adhurim dhe me lexim Kurani. Njëzet ditë para vdekjes e goditi një sëmundje nga e cila gjeti vdekjen. I mbylli sytë në datën 20 dhulkade 728h. në moshën 67 vjeçare. Allahu e mëshiroftë me

mëshirë të madhe.

Fjalët e dijetarëve për Ibn Tejmijen.

Për të mbledhur lëvdatat e dijetarëve për Ibn Tejmijen do të duheshin vepra dhe vëllime. Prandaj nuk dëshiroj të zgjatem shumë, për të mos e lodhur lexuesin. Mjafton të sjellë një dëshmi nga nxënësi dhe i apasionuari pas tij imam Shemsedin Dhehebiu. Kjo për dy arsye. E para nisur nga fakti se Dhehebiu dëshmon diçka të cilën e ka parë dhe dëgjuar, pas vdekjes së shejhut _Allahu e mëshiroftë_.

Së dyti sepse Dhehebiu e ka kritikuar profesorin e tij në disa pika gjatë jetës së tij. Ai që e njeh relatën mes nxënësit dhe mësuesit, e kupton me bindje se këshilla e Dhehebiut ka tjetër prizëm dhe synime. Nuk mund t'i kyçim gojët e dashakeqësve dhe as t'i thyejmë kalemët e të padrejtëve. Nëse këshilla ka qënë gjatë jetës, atëhere lëvdatat kanë qënë pas vdekjes. Shumica e lëvdatave të Dhehebiut për shejhun e tij, janë në trajtën e kohës së shkuar, për ditët që kanë kaluar. Si në librin që Dhehebiu ka shkruajtur për shujhët e tij “Muxhemul shujh” ashtu edhe në libra dhe transmetime të tjera,

Dhehebiu ka folur për shejhun e tij si askush tjetër, ashtu siç e kishte këshilluar për këto pika gjatë jetës. Sepse dashuria dhe drejtësia për një person, nuk duhet të na shtyjë për pranimin e të pavërtetës. Ashtu si edhe gabimi në disa pika, nuk ja heq askujt meritat që i takojnë.

Nëse kjo sqarohet, atëhere do sqarohet edhe pretendimi i pavlerë se Dhehebiu është kthyer dhe e ka braktisur shejhun!! Ndërkohë që lëvdatat e tij kanë qënë pas vdekjes. Apo mos vallë këshillën drejtuar shejhut të tij, ja kishte dërguar në varr!! Për të mos u zgjatur, -se nuk ja vlen të merremi më tepër-, po paraqesim për lexuesin një shëmbull të fjalëve të Dhehebiut për shejhun e tij.

Thotë: “ ... derisa arriti të bëhej një nga dijetarët e mëdhenj akoma kur mësuesit e tij ishin gjallë. Veprat e tij në këtë kohë e kalojnë numrin e katër mijë kurrasesh¹. E ka komentuar Kuranin për dy vjet rresht në ditët e xhuma vetëm nga memoria e tij. Shkëlqente nga zgjuarsia.

Transmetimi i tij i hadithit ka qënë i shumtë, ndërsa dijetarët nga e morri hadithin e kalonin numrin e 200 shejhave.

Njohja e tij e tefsirit ishte kulm i njohjes. Ndërsa për memorizimin e hadithit dhe transmetuesit e tij dhe njohjen e të saktit dhe të pasaktit ishte i paarritshëm.

Në citimin e fikhut dhe të mendimeve të sahabëve dhe tabinëve, pa folur për katër medhhebet, nuk krahasohej me askënd.

¹ Kurrasi është një tip fletoreje e mesme e cila përdorej për të shkruar në kohën e tyre.

Ndërsa për njohjen e fraksioneve dhe feve dhe në njohjen e akides dhe *ilmul-kelamit*, unë nuk njoh askënd të jetë i barabartë me të

Ishte një mrekulli e vërtetë për sa i takon zgjuarsisë dhe perceptimit. Kokë në njohjen e Kuranit, sunetit dhe mospajtimet e njerëzve. Det në transmetime. Më i rralli i kohës së tij

Lexoi dhe mësoi dhe u shqua në hadith, fikh aq sa ishte i aftë për mbajtje leksionesh dhe për fetva që në moshën 17 vjeçare. U shqua në lëminë e tefsirit, usulit dhe në të gjitha lëmitë e islamit, në baza dhe në detaje, të hollësishmet dhe sipërfaqsoret, pa folur për njohjen e shkencës së kiraeteve.

Nëse flet në tefsir ai është flamurtari i kësaj dije. Nëse përmenden fukahatë atëhere ai është muxhtehidi absolut. Nëse sillen hafizat (e hadithit) ai fliste dhe ata heshtnin, ai vazhdonte të fliste e ata e qepnin, pastaj e mbyllte fjalën kur kishte akoma ç'të thoshte ndërsa ata kishin falimentuar.

Nëse përmendeshin kelamistët ai ishte më i rralli në mesin e tyre dhe tek ai mbaron dija e tyre. Sikur filozofët t'i vinin me Ibn Sinën në krye kishte për t'i thyer dhe do t'i dërrmonte. Do t'ua çirrte fytyrën e vërtetë dhe do t'i demaskonte pëllitjet e tyre.

Kishte dije të thellë në gjuhën arabe në morfologji dhe në gramatikë. Ishte një kolos më i madh sesa ta përshkruaj atë fjala ime apo të dëshmojë për të lapsi im ...

Sikur të më kërkohej të betohesha për Allah mes Ruknit (të Qabes) dhe mes mekamt (të Ibrahimit) kisha për t'u betuar për Allah se sytë e mi nuk kanë parë ndonjë si puna e tij. Jo pasha Allahun, as ai vetë nuk ka parë në dije si puna e vetes së tij”.¹

¹ El ukudu ed durrijuh, fq: 22-25.

Paraqitje e shkurtër e fetvasë së Hamasë.

Në realitet, kjo fetva nuk është një libër i mirëfilltë. Ajo është përgjigje e një pyetje drejtuar shejhut nga banorët e Hamasë në vitin 698h. Hamaja është një qytet sirian në mesin e Sirisë, më konkretisht mes Himsit dhe Halebit.

Le ta lëmë vetë Ibn Tejmijen të na rrëfejë për rrethanat e përpilimit të kësaj fetvaje: “Unë jam pyetur para shumë kohësh, nga fundi i viteve 690-të, për ajetet dhe hadithet e transmetuara rreth cilësive të Allahut, për një pyetje të ardhur nga Hamaja. E orientova pyetësin te tjetërkush, por ai këmbënguli duke përmendur që ata duan përgjigje vetëm prej teje.

Atëhere e shkruajta këtë përgjigje mes drekës dhe ikindisë. Aty përmenda medhhebin e selefit dhe të imamëve dhe bazimin e tij në Kuran dhe sunet, i cili përputhet me natyrën që Allahu ﷻ i ka krijuar njerëzit. Qartësova edhe disa argumente logjike të kuptueshme. Sqarova detyrimin e shmangies prej xhehmive mohues dhe skajit tjetër që janë përngjasuesit shëmbëllyes ...”.¹

Nuk ka dyshim që kjo fetva është e shejhul Islamit dhe askush nuk e ka mohuar autorësinë e tij. Ajo është ruajtur në kopje të ndryshme dhe disa pjesë të saj i kanë përmendur edhe nxënësit e Ibn Tejmijes. Prej tyre Ibn Abdulhadi në librin e tij “El ukudud durrijuh”. Disa pjesë të saj i ka cituar edhe Shihabudin Halebiu, një eshari që ka shkruar një replikë ndaj fetvasë së Hamasë.

Vlera e kësaj fetvaje kthehet te lehtësia e saj, sepse ajo është një fetva që i drejtohet publikut të gjërë dhe muslimanëve që nuk janë thelluar aq shumë në çështjet e *ilmul-kelamit*, por që nga ana tjetër janë ndikuar negativisht nga kelamistët e ndryshëm të cilët i kishin dhënë publikut një përfytyrim të deformuar të akides së selefit të këtij umeti.

Duket qartë që kjo fetva nuk i drejtohet një publiku të painfluencuar nga *ilmul-kelami*, prandaj Ibn Tejmija futet në shumë çështje të *ilmul-kelamit* por ose në mënyrë sipërfaqësore, ose në një nivel të mesëm, të kuptueshëm për publikun dhe muslimanët e këtij niveli, të cilët në realitet përbënin shumicën e shoqërisë islame në atë kohë.

Këtu qëndron edhe sekreti i sprovimit të Ibn Tejmijes për shkak të kësaj fetvaje, më shumë se sprovimi i tij për shkak të disa librave të tjerë, të cilat mund të ishin shumë herë më të thellë në mendim, më të ashpër në kritikë dhe më të fortë në kundërpërgjigje ndaj kelamistëve, sesa kjo fetva e shkurtër. Libra të tillë qëndronin larg nivelit të

¹ Këto fjalën janë cituar nga parathënia e librit “Nakdud tasis”, vëll. 1, fq. 4-6.

publikut të gjërë të asaj kohe dhe prej tyre nuk mund të përfitonte dokushdo por vetëm ndonjë nxënës dije apo dijetar. Prandaj ndikimi i tyre në publik nuk ishte i drejtpërdrejtë dhe as i menjëhershëm.

Ndërsa kjo fetva bëri bujë me të madhe në auditorin e asaj kohe dhe u përhap shumë shpejt në mjaft zona të Shamit, madje edhe në Irak dhe Egjipt. Ajo hyri shpejt në zemrat e shumë njerëzve për shkak të lehtësisë dhe qartësisë së saj.

Kjo bujë e madhe, në një ambient të influencuar përgjithësisht nga esharitë, ishte një humbje e madhe për kelamistët eshari. Prandaj edhe kundërgoditja e tyre u drejtua pikërisht ndaj kësaj fetvaje. Madje edhe në sprovat e mëvonëshme të Ibn Tejmijes, rihapej nga fillimi çështja e fetvasë së Hamasë.

Në fillim të kësaj parathënie, Ibn Tejmije sqaron bazat kryesore dhe arsyet që e shtyjnë një musliman për pranimin e akides ashtu siç ka ardhur nga brezat e parë, pa pasur nevojën e bazimit të metodat e kelamistëve për disa arsye të thjeshta:

1) Sqarimin e çështjeve kryesore të akides e ka marrë përsipër vetë i dërguari i Allahut ﷺ, i cili ka qënë i dërguar te njerëzit pikërisht për këtë qëllim. Sepse detyra kryesore e profetëve është udhëzimi i njerëzve te zoti i tyre. E përderisa njohja e zotit është pika kulminore e imanit, atëhere është absurde që i dërguari i Allahut ﷺ t'i lejë muslimanët të çorientuar dhe me dyshime në këtë çështje.

2) I dërguari i Allahut ﷺ ka qënë i përkryer si në oratorinë e tij, ashtu edhe në dijen e tij, ashtu edhe në dëshirën për të udhëzuar umetin e tij. Sepse ai ka qënë më i madhi profet që Allahu ﷻ ka dërguar për njerëzimin. E nëse dituria, oratoria dhe dëshira e udhëzimit mbledhen te një person atëhere edhe përcjellja e dijes prej tij do të jetë në formën më të përkryer. E kur dituria, oratoria dhe sinqeriteti janë në kulmin e përsosjes, atëhere edhe dija e përfituar prej këtij njeriu do të jetë në kulmin e qartësisë dhe të përsosjes.

3) Nëse sqarohet kjo atëhere sahabët që kanë transmetuar dijen nga mësuesi i tyre i përkruar, na kanë transmetuar të tjera njohuri nga ato që janë përhapur në mesin e kelamistëve të mëvonshëm. Edhe nxënësit e sahabëve; tabinët, na kanë përcjellur të tjera njohuri dhe botkuptime që dallojnë nga njohuritë e kelamistëve.

4) Dija e kelamit, burimin e ka te kulturat pagane joislame, si kultura pagane greke, kultura perse dhe ajo indiane. Madje në zanafillat e saj ka qënë e infiltruar nga faktori çifut dhe e ndikuar indirekt prej tij. Atëhere ajo nuk mund të shërbejë si bazë për njohjen e temave të akides.

5) *Ilmul-kelami* ka lindur në një periudhë relativisht të vonë. Fillesat e tij kanë qënë diku aty nga fundi i shekullit të dytë. Ndërsa përhapja e tij me përmasa të gjëra kthehet në fillimet e shekullit të tretë. Pra akidja islame nuk ka nevojë për *ilmul-kelamin*

që të kuptohet, sepse brezi i sahabëve dhe tabinëve kishte kaluar dhe askush prej tyre nuk e njihte *ilmul-kelamin*.

6) Kelamistët në qëndër të vëmendjes kanë vendosur logjikën. Mirëpo kriteret dhe bazat e tyre logjike janë shumë të luhatura. Mospajtimet e tyre në çështjet logjike kanë marrë dhenë. Në çdo temë që studiojnë, më shumë ngrenë dilema sesa sqarojnë probleme. Prandaj shumica e kelamistëve kanë pasur luhatje të mëdha dhe oshilacione në dijen të tyre. Madje vetë kelamistët e mëdhenj e kanë pranuar që *ilmul-kelami* nuk na jep një dije kategorike të formës së prerë por thjesht disa krahasime të logjikës analitike, maksimumi i të cilave mund të ngjiten në rangun e dijes së pranueshme.

E shumë baza të tjera logjike dhe rregulla besimi të kuptueshme dhe të perceptueshme për masat e gjëra të muslimanëve. Megjithëse ai shprehet se është i vetëdijshëm që kelamistët kanë shumë dyshime në këto pika, mirëpo në këtë fetva të shkurtër ai po përpaket të sqarojë vetëm disa baza të përgjithëshme. Kjo ishte pjesa e parë e kësaj fetvaje.

Në pjesën e dytë Ibn Tejmije na paraqet shumë fjalë dhe thënie të selefit të umetit. Si i kanë trajtuar ata çështjet e cilësive. Çfarë kanë pohuar prej cilësive dhe çfarë kanë mohuar. Si ka qënë reagimi i tyre me grupet e ndryshme kelamiste, si xhehmitë, mutezilët apo rrymat e tjera.

Këtu Ibn Tejmije citon shumë fjalë të ndryshme nga imamë të njohur të fesë, imameti i të cilëve është i pranuar nga të gjithë. Ai gjithashtu na bën me dije që për hatër të moszgjatjes së kësaj fetvaje, është i detyruar të mjaftohet me një pjesë shumë të vogël të këtyre thënieve dhe transmetimeve.

Në pjesën e tretë, Ibn Tejmije citon shumë citate prej dijetarëve sufi të ndryshëm dhe prej disa personaliteteve esharinj të brezave të tyre të hershëm (shekulli i katërt), apo prej brezave të mesëm (shekulli i pestë). Kjo për ti treguar lexuesit se mendimet që qarkullojnë në duart e sufive dhe esharive në këtë kohë, njëherë e njëkohë kanë qënë klasifikuar si mendime të xhehmive dhe të mutezilive. Esharitë dhe sufritë e kohës së Ibn Tejmijes kanë qënë shumë herë më ndryshe në trajtimin e këtyre çështjeve sesa imamët e tyre në vetë medhhebin e tyre.

Në fundin e kësaj pjese Ibn Tejmije tërheq vërejtjen se nuk është kusht që ai të pajtohet me të gjitha thëniet e esharive që ka cituar, por ai thjesht dëshiron t'u tregojë njerëzve për evolucionin e madh që ka ndodhur në medhhebin eshari me kalimin e dekadave.

Në pjesën e katërt, Ibn Tejmije rikthehet edhe njëherë në disa rregulla logjike dhe gjuhësore për kuptimin e përmbajtjes kuptimore të ajeteve të cilësive. Ai përpaket të largojë dyshimet që kanë disa njerëz rreth mospërputhjes së ajeteve me njëri-tjetrin, për

ta mbyllur këtë fetva të shkurtër me një klasifikim të përmbledhur të grupeve dhe rrymave të ndryshme në çështjen e cilësive.

Duket edhe nga tematika e përmbledhur e kësaj fetvaje se ndikimi i saj në ambjentin islam ishte më i fortë se librat e ndërlikuar që kundërshtojn *ilmul-kelamin*. Goditja e kelamistëve në pikën më të fortë të tyre; logjikën, rrëzimi tezave të esharive të mëvonshëm nga vetë librat e esharive të hershëm, shkëputja e lidhjes së akides esharie në çështjen e cilësive nga Kurani dhe suneti dhe thëniet e selefit, lidhja e *ilmul-kelamit* me një burim pagan joislam, të gjitha këto çuan në një reagim të fortë dhe të menjëhershëm të kelamistëve.

Ata hartuan një replikë të shpejtë kundër kësaj fetvaje dhe e ngritën çështjen te organet gjyqësore të asaj kohe, të cilat për hir të realitetit, ishin të ndikuara prej faktorit eshari dhe rrethit sufist të kohës. Megjithatë akuza e formuluar ishte e pabazë dhe deformim i qëllimshëm i fjalëve dhe nënkuptimeve të Ibn Tejmijes. Në të kishte trillime të pabaza dhe të paqëna. E megjithatë nuk e patën të lehtë të gjenin kadi që të merrte përsipër akuzën e tyre. Derisa pas shumë ndërhyrjesh dhe këmbënguljesh, kadiu hanefi Xhelaledin Hanefiu pranoi ta merrte në shqyrtim këtë çështje.

Atëhere ai shkoi në shkollën e “Darulhadith” ku jepte mësim Ibn Tejmija dhe kërkoi takim me të, por nuk u takua dot. Pastaj kërkoi që t’i paraqitej në gjykatë por Ibn Tejmija nuk u paraqit, por i dërgoi një shkresë ku i shkruante: “Çështjet e akides nuk janë kompetencë e ofiqit tënd, sepse sulltani të ka vendosur që të gjykojë mes njerëzve. Ndërsa ndalimi nga e keqja nuk është kompetencë e kadiut”.

Kur kjo shkresë i arriti kadiut hanefi, njerëzit e nxitën më shumë kundër shejhut dhe i dhanë zemër më tepër, prandaj morri vendim që të thirrej në tregje për pavlefshmërinë e akides së Ibn Tejmijes.

Atëhere kur këto lajme i ranë në vesh mëkëmbësit të Damaskut; Sejfedin Xhakanit, urdhëroi që të anullohej vendimi i kadiut hanefi dhe i doli në mbrojtje shejhut, madje nxorri urdhër për arrestimin e disa prej shkaktarëve të kësaj rrëmuje, të ciltë nxituan të fshiheshin.

Ditën e xhuma, shejhu mbajti mësimin e përjavshëm në tefsir dhe pas mësimit u ulën me gjithë kadiun shafi Imamedinin dhe një grup dijetarësh për të shqyrtuar fetvanë e Hamasë. Pasi u lexua e gjithë fetvaja dhe pas disa sqarimeve që shejhul islami u bëri pikave të paqarta, apo pyetjeve të të pranishmëve dhe pas një debati të gjatë, kadiu shafi u prononcua se kushdo që do të flasë kundër shejhut, ai do të ndëshkohet.

Kështu morri fund kjo sprovë që u krijua për shkak të kësaj fetvaje, ku shejhu doli triumfuator.

Reagimet e tjera ishin nëpërmjet kundërpërgjigjeve në kuvendet e dijes dhe

nëpërmjet shkrimeve të ndryshme. Replika e vetme¹ që është shkruar kundër fetvasë së Hamasë, ka qënë replika e Shihabudin ibn Xhehbel Halebiut, nga fukahatë shafitë. I njohur si fakih dhe i shquar në fikhun shafi, por jo për çështjet e *ilmul-kelamit*, prandaj edhe replika e tij nuk ishte e nivelit të pritur.

Libri në fjalë është i vogël në përmasa, madje pak më i shkurtër se vetë fevaja e Hamasë të Ibn Tejmijes. Fjalët që ai citon prej Ibn Tejmijes në këtë libër mund të zenë 50% të librit. Pra fjalët e Shihabudin Xhehbelit zënë jo më shumë se gjysmën e librit, që është pak për një replikë me dije, sidomos kur edhe përmbajtja e fjalëve të vetë Ibn Xhehbelit, më shumë humbet në lllumin e akuzave të Ibn Tejmijes si person, sesa merret me shqyrtimin e çështjeve me bazë fetare.

Unë e kam lexuar replikën e tij, në “Tabakatush shafiye” të Subkiut dhe për hir të së vërtetës niveli i saj është nën nivelin e dijetarëve eshari të kalibrit të lartë dhe me shumë gabime. Autori gabon shumë shpesh gabime të pafalshme dhe nuk i kundërpërgjigjet Ibn Tejmijes me të njëjtën monedhë, por më shumë bazohet në lojra fjalësh dhe jo në transmetime të besueshme prej dijetarëve të hershëm.

Prej gabimeve të tij ishte edhe fjala e Ibn Tejmijes të cilën e kujtoi si fjalën e imam Ahmedit kur thotë:

“Sikur të ndalonte dhe të mjaftohej me atë që transmetohet nga imam Ahmed ibn Hanbeli, i cili ka thënë: Imam Ahmed ka thënë: "Allahu përshkruhet vetëm me atë që ka përshkruar veten e tij, ai dhe i dërguari i tij. Nuk tejkalohet as Kurani dhe as hadithi".

Medhhebi i selefit është përshkrimi i Allahut ﷻ me atë që e ka përshkruar veten e tij dhe e ka përshkruar me të i dërguari ﷺ, pa tahrif (deformim) apo tatil dhe pa tekjif apo temthil.

Përshkrimet që Allahu ﷻ i ka bërë vetes së tij janë reale dhe jo gjëgjëza apo enigma. Kuptimi i këtyre përshkrimeve kuptohet ashtu siç kuptohet qëllimi i folësit nga fjala e tij, sidomos kur folësi është krijesa më e ditur rreth asaj që thotë, krijesa më oratore në sqarimin e dijes, krijesa më oratore në qartësi, në njohje, në paraqitjen e argumentit dhe në udhëzim.

E megjithatë asgjë nuk është njësoj si Allahu ﷻ, dhe as si vetja e tij të pastër e cila përmendet me emrat dhe cilësitë e tij. Ashtu siç jemi të bindur se Allahu ﷻ ka një qenie reale dhe veprime reale, po ashtu jemi të bindur se ai ka cilësi reale. Por asgjë nuk i ngjason atij as në qenie, as në cilësi dhe as në veprat e tij.

Ai është i pastër nga çdo gjë që nënkupton mangësi ose krijim, sepse Allahut ﷻ i takon përsosmëria absolute. Ekzistimi i tij pas mosekzistimit është i pamundur sepse

¹ Ose të paktën kjo është e vetmja që është përmendur dhe na ka arritur.

vetë mosekzistenca e tij është e pamundur. Ekzistenca momentale që të quhet ekzistencë momentale duhet që ta ketë paraprirë atë mosekzistenca. Ekzistenca momentale e Allahut është e pamundur sepse Allahu ﷻ ekziston vetvetiu në formë të përherëshme, ndërsa ekzistenca momentale ka nevojë për një krijues.”.

Thotë Ibn Xhehbeli: “Kjo është fraza e imanit të tij e përse nuk mjaftohet me të. Imami i tij me këto fjalë është shprehur pak e saktë. Ai, argumentet e kelamistëve kundër asaj që ky sharlatan (Ibn Tejmije) pretendon, i paraqet në formën më të bukur dhe në domethënien më të qartë ...”.

Fjala e imam Ahmedit mbaron te fjala “dhe as hadithi”. E gjithë fjala në vazhdim që përmendi se është e imam Ahmedit, në realitet është fjalë e Ibn Tejmijes. Madje këto fjalë dhe ide që Ibn Tejmije shpalos këtu, janë pika kyçe e çështjes dhe një përmbledhje e shkurtër e mendimit të Ibn Tejmijes rreth cilësive.

Duke e supozuar si fjalë të imam Ahmedit, zuri ta lavdëronte dhe ta ngrinte shumë lart, madje shkoi deri aty, sa pretendoi se ajo është fjala e vetë kelamistëve!! E sikur ta dinte se ajo ishte fjala e Ibn Tejmijes kishte për ta ulur aq poshtë sa asnjë fjalë tjetër.

Pjesa e mbetur e librit është e këtij lloji, jo në lartësinë e duhur të një dijetari të *ilmul-kelamit*. Ndoshta sepse Shihabudin ibn Xhehbeli _Allahu e mëshiroftë_, ka qënë prej fukahave të preokupuar me dispozitat e fikhut. Prandaj do të ishte më me interes një replikë nga vetë esharitë e njohur të kohës së Ibn Tejmijes. Mirëpo ne nuk na ka arritur ndonjë replikë e tillë në kohën e sotme.

Dhe Allahu është më i ditur. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dërguarin e tij Muhamedin, mbi shokët e tij, familjen e tij dhe ata që pasojnë udhëzimin e tyre deri në ditën e gjykimit.

Me emrin e Allahut të mëshirëshmit mëshiruesit.

Shejhul-islami dijetari Takijudin Ahmed ibn Abdulhalim ibn Abduselam ibn Tejmiye ne vitin 689 h, u pyet:

Cili është mendimi i zotërive fukaha, imamëve të fese rreth ajeteve të cilësive, si ajeti **﴿I meshiresmi mbi Arsh u lartesua﴾** dhe ajeti **﴿pastaj u lartesua mbi arsh﴾** dhe **﴿pastaj u lartesua mbi qiell kur ai ishte tym﴾**? Apo për ajetet dhe hadithet e tjera rreth cilësive, si hadithi: *"Zemrat e njerëzve janë mes dy gishtave prej gishtave të mëshiruesit"* dhe hadithi: *"Xhebari e vendos kembën e tij në zjarr"* dhe të tjera hadithe si këto. Çfarë kanë thënë dijetarët rreth tyre? Zgjerohuni në përgjigje, Allahu ju shperbleftë .

U përgjigj :

Lavdërimi i takon Allahut Zotit të botrave .

Mendimi jonë rreth tyre është ajo që kanë thënë Allahu ﷻ dhe i derguari i tij ﷺ, muhaxhirët dhe ensarët e parë, dhe ndjekësit e tyre me mirësi, dhe ajo me të cilën janë shprehur imamet e udhezimit pas tyre, për të cilët muslimanet janë pajtuar rreth udhezimit dhe dijes së tyre . Kjo është detyra e çdo krijese në këtë çështje apo në çdo çështje tjetër, sepse Allahu ﷻ e ka derguar Muhamedin ﷺ me udhezimin dhe fenë e vërtetë për t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë, me lejen e zotit të tyre, për në rrugën e të fuqishmit dhe të lavdëruarit. Allahu ﷻ deshmoi se e ka dërguar Muhamedin ﷺ për të thirrur për tek ai me lejen e tij, si pishtar ndriçues, prandaj e urdheroi të thotë: **﴿Thuaj: Kjo është rruga ime! Thërras për tek Allahu me dije, unë, dhe kush më ndjek mua﴾** Jusuf, 107.

Ai është pishtari ndriçues me të cilin Allahu ﷻ i nxorri njerëzit nga errësira në dritë dhe i zbriti atij librin e të vërtetës, që të gjykojë mes njerëzve rreth kundërshtimeve të tyre dhe i urdheroi njerëzit t'i kthejnë mosmarrveshjet në fe, tek libri dhe urtësia që u ka dërguar. Ai thërret për tek Allahu ﷻ dhe në rrugën e tij, me lejen e tij dhe me dije. Allahu ﷻ na ka njoftuar se ia ka plotësuar fenë, atij, dhe umetit të tij, duke përmbushur kështu ndaj tyre mirësinë e tij. Pas gjithë kësaj është e pamundur fetarisht dhe logjikisht që ta këtë lënë temën e besimit rreth Allahut ﷻ të turbullt dhe të pashpjeguar dhe të mos ketë sqaruar se çfarë është e domosdoshme prej emrave më të bukur dhe cilësive të larta dhe çfare është e mundur dhe çfarë është e pamundur; sepse kjo njohuri është baza e fesë dhe themeli i udhezimit dhe konsiderohet njohuria më e dobishme dhe më e

obligueshme që zemra ka fituar dhe shpirti ka përvetësuar dhe mendja ka kuptuar. Si ka mundesi atëhere që ky liber, ky profet ﷺ, dhe krijesat më të mira të Allahut pas profeteve ﷺ të mos e kenë besuar dhe shpjeguar me përsosmëri këtë çështje?!

Profeti ﷺ i mësoi umetit çdo gjë, deri edhe edukatën e kryerjes së nevojës, aq sa tha: *"Ju kam lënë ju në një argument të qartë, nata e tij është si dita e tij. Vetëm një i shkatërruar devijon prej tij, pas meje"*.¹

Në hadithin sahih thuhet: *"Allahu kurrë nuk ka dërguar ndonjë profet që të mos ketë qënë i ngarkuar për udhëzimin e umetit të tij, për më të mirën që ka ditur për ta dhe t'i ndalojë prej më të keqes që ka ditur për ta"*.²

Ebu Dherri ؓ ka thënë : *"I dërguari i Allahut vdiq dhe nuk kishte asnjë zog që rrihte flatrat në qiell veçse na u kish permendur rreth tij ndonjë njohuri"*.³

Umer ibn Hatabi ؓ ka thënë: *"I dërguari i Allahut ﷺ u ngrit karshi nesh dhe përmendi zanafillën e krijimit, derisa banorët e xhenetit u futën në banesat e tyre dhe banorët e zjarrit në vendet e tyre. E mbajti mend kush e mbajti dhe e harroi kush e harroi"*.⁴ E transmeton Buhariu.

Është e pamundur t'u mësojë çdo gjë dhe çdo imtësi që u bën dobi ne fe, e pastaj të mos u mësojë se çfare duhet të thonë me gjuhët e tyre dhe të besojnë me zemrat e tyre reth të adhuruarit të tyre, zotit të botrave; njohja e të cilit është kulmi i njohurive dhe adhurimi i tij është me i larti pikësynim dhe arritja tek ai është përfundimi i synimeve. Ajo është ajka e thirrjes profetike dhe ajka e dërgesës hyjnore. Si mund të dyshojë ai që në zemër ka një grimcë iman dhe urtësi, se sqarimi i kesaj çështje nuk ka ardhur prej të dërguarit ﷺ në formën më të plotë?! E nëse ka ardhur prej tij në formën më të plotë, atëhere është e pamundur që më të mirët e umetit dhe brezat e tij më të mirë, ta kenë neglizhuar këtë çështje, duke shtuar në të apo pakësuar prej saj .

Gjithashtu është e pamundur që brezat më të mirë _brezi i profetit, ata që vijnë pas tyre dhe ata që vijnë pas tyre_ të mos e kenë njohur këtë çështje apo të mos kenë folur rreth saj me të vërtetën e qartë, sepse kështu i bie që ose kanë qënë të paditur dhe

¹ **Hadith sahih.** E transmetojnë Ibn Maxheh në sunenin e tij (43), imam Ahmedi në musnedin e tij (17142), Taberaniu në "El kebir" (619) dhe Ibn Ebi Asim në "Es sunneh" nr: 47-49. Shejh Shuajb Arnauti e ka konsideruar sahih bazuar në rivajetet e ndryshme.

² **Hadith sahih.** E transmetojnë Muslimi (33/46), Nesaiu (4191), Ibn Maxheh (3956) dhe të tjerë nga Abdullah ibn Amr ibn Asi.

³ **Hadith hasen.** E transmeton Ahmedi në musnedin e tij (21361) nga Ebu Dherri ؓ thotë: *"I dërguari i Allahut ﷺ u nda prej nesh, po nuk kishte ndonjë zog që rrihte krahët në qiell, veçse na e kishte përmendur rreth tij ndonjë njohuri"*. E transmeton edhe Taberaniu në "El kebir" (1647) me një teks të përngjashëm.

⁴ **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu (3192). Ndërsa Muslimi e transmeton prej hadithit të Hudhejfes (52/23), thotë: *"I dërguari i Allahut u ngrit karshi nesh dhe nuk la gjë pa përmendur deri në ndodhjen e kiametit. Kush e mbajti mend e mbajti e kush e harroi e harroi"*.

nuk kanë folur të vërtetën ose kanë besuar të pavërtetën dhe kanë folur gënjeshtër . Të dyja këto supozime janë të pamundura.

Sa i përket mundësisë së parë; kushdo që në zemër ka sadopak jetë dhe kërkim të dijes dhe zell për adhurim, e konsideron kerkimin rreth kësaj çështjeje, pyetjen apo njohjen e të vërtetës rreth saj, si objektivin më madhor _kam për qëllim sqarimin e asaj që duhet besuar për njohjen e Allahut dhe cilësive të tij_. Gjëja që shpirti i udhëzuar dëshiron me tepër është pikërisht njohja e kësaj çështjeje. Kjo gjë është diçka instiktive.

Me ekzistimin e një arsyeje kaq të fortë, si mund të përfytyrohet kundërshtimi i saj prej parisë së muslimaneve, në të gjitha kohrat?! Kjo nuk ndodh as me krijesën më të trashë dhe më të pabindur ndaj Allahut ﷻ, as me krijesën më të hutuar pas dynjase dhe më të shkujdesur prej përkujtimit të Allahut ﷻ. Si atëhere mund të ndodhë prej tyre?!

Mundësia tjetër është që ata kanë besuar të kotën dhe janë shprehur me të. Një musliman me logjikë të shëndoshë, që e njeh pozitën e tyre, nuk e thotë një gjë të tillë.

Pa folur që deklaratimet e tyre në këtë çështje, janë aq të shumta sa që nuk mund të shkruhen në këtë përgjigje dhe as në shumëfishin e saj. Kushdo që i gjurmon dhe i kërkon transmetimet e tyre, e di shumë mirë këtë.

Po ashtu është e pamundur që të mëvonëshmit të jenë më të ditur se të mëherëshmit, siç mund të pretendojnë disa injorantë të cilët nuk i kanë dhënë selefit vendin e merituar, madje as Allahun ﷻ, as te derguarin ﷺ dhe as besimtarët nuk i kanë njohur, të cilët pretendojnë se: "Rruga e selefit është me e sigurtë, por rruga e halefit është me e ditur dhe me e persosur".

Bidatçite, të cilët preferojnë metodën e halefit më shumë se metodën e selefit, si filozofët dhe ata që ndjekin rrugën e tyre; kujtuan se rruga e selefit është thjesht besimi përceptas në fjalët e Kuranit dhe të hadithit, por pa i kuptuar ato. Sipas tyre selefi nuk e kalojnë nivelin e analfabeteve, për të cilët Allahu ﷻ thote: **«Prej tyre ka analfabetë që nuk e njohin shkrimin»** El bekare 78. Ndersa rruga e halefit, sipas tyre, është nxjerrja e domethëniesve të frazave të shpalljes, duke i devijuar ato nga realiteti i tyre, me lloj-lloj alegorish dhe me lloj-lloj kuptimesh gjuhësore të largëta. Ky supozim i kotë, i çoi deri tek kjo shprehje, përmbajtja e të cilës nënkupton hedhjen pas krahëve të islamit. Pikësëpari ata gënijnë për rrugën e selefit dhe humben, pikësëdyti, kur saktësuan rrugën e halefit. Kështu mbledhën sëbashku paditurinë në shpifjen ndaj selefit dhe paditurinë dhe humbjen në saktësimin e rruges së halefit.

Shkak ishte besimi se frazat e shpalljes hyjnore, në realitet, nuk dëshmojnë për ndonjë cilësi, bazuar në mëdyshje të kota, në të cilat u bene bashkëpjesëmarres me vellezerit e tyre pabesimtare. Atëhere kur mohuan cilesitë, duhej patjeter që frazat të përmbanin një kuptim. Kështu mbetën të luhatur mes pranimi të fjalëve, por me lenien e kuptimit të tyre, të cilën e quajnë “metoda e selefit”, dhe mes shpjegimit të fjalëve me

kuptime të tjera shumë të largëta, të cilën e quajnë “metoda e halefit”. Kështu, kjo e kotë ishte produkt i gërshetimit të logjikës së shtrembër me mohimin e tekseve të shpalljes. Për mohimin e cilësive ata u bazuan në argumente logjike, të cilat i supozuan si të qarta, por që në realitet nuk janë hiç më shumë sesa dyshime. Në anën tjetër fjalet e tekseve të shpalljes i transformuan.

Përderisa çështja e tyre u ndertua mbi këto dy premisa¹ të rreme dhe mosbesuese, atëhere konkluzioni ishte: “Akuzimi me injorancë dhe moslogjikim i të pareve të umetit dhe besimi se ata nuk ishin më shumë sesa njerëz të devotshëm analfabetë, prej masave të gjëra, të cilët nuk janë thelluar në njohjen e Allahut ﷻ dhe nuk kanë qënë koshientë për hollesitë e dijes hyjnore. Në anën tjetër halefi i nderuar ka zënë vendin e parë në të gjitha këto gjëra.

Nëse njeriu mediton rreth kësaj shprehje, ka për ta gjetur në kulmin e padijes dhe të humbjes. Si mund të jenë të mëvonëshmit më të ditur; sidomos nëse me ta kihen për qellim disa kelamistë të lëkundur në fe, mes të cilëve dhe njohjes së zotit ka një perde të trashë. Aq sa njohësi i realitetit të tyre na tregon për katandisjen e tyre kur thotë:

*Betohem! Ne çdo shkollë kam kaluar
me sy ato pamje i kam vështruar
por mbi mjekra pashë vetem duar
të hutuara, nga vitet e jetes të penduar²*

Dëshmuar kundër veteve të tyre në vetë librat e tyre, me disa vargje të cilat i

¹ Termi i përdorur nga Ibn Tejmije (mukaddimeh – مقدمة), përdoret gjerësisht në usul dhe në dijen e logjikës dhe përkon me termin shqip premisë. Premisa është secila nga dy pjesët e para të një silogjizmi, nga të cilat del një përfundim. Ose është diçka që është thënë më parë, nga e cila nxirret një pohim i njohur ose mbi të cilën mbështetet një përfundim. Pra një tezë paraprake e supozuar si e vërtetë, mbi të cilën mund të ndërtohet një konkluzion.

Përderisa dy premiset ku kelamistët bazuan konkluzionin e tyre, ishin të pasakta atëhere edhe konkluzioni ishte i rremë. Premisa e parë ishte besimi se Allahu ﷻ nuk mund të përshkruhet me këto cilësi. Premisa e dytë ishte se tekset kuranore nuk përmbajnë domethënie kuptimore që dëshmojnë për këto cilësi.

Po t'u shtojmë këtyre dy premisave, një premisë të tretë se selefi i umetit nuk i kanë mohuar domethëniet kuptimore të ajeteve të cilësive, atëhere konkluzioni logjik i kësaj çështje është se selefi i kanë besuar tekset kuranore pa ua ditur përmbajtjen kuptimore, ndërsa halefi e ka ditur përmbajtjen kuptimore të tyre, prandaj halefi në këtë pikë është më i ditur se selefi i umetit.

Dy premiset e para janë të rreme, ndërsa e treta është e vërtetë, siç do sqarohet në vijim, prandaj dhe ky konkluzion ishte i rremë.

² Këto vargje i përmend Shehrestani në parathënien e librit të tij “Nihajetul ikdam”, pa e përmendur autorin e vjershës. Disa kanë menduar se ato janë hartuar prej vetë Shehrestanit. Ndërsa Tash Kubri Zadeh në rishikimin që i ka bërë këtij libri, përmend se këto vargje janë të Ibn Sinës.

përmendin ose në formë krijimi ose në formë citimi, si fjala e një prej parisë së tyre¹:

*Caku i udhëtimit të mendjes është ndërlikim
shumica e lodhjes së njerezve është harxhim
Shpirtërat në trupat tanë janë në mërgim
synimi dynjasë sonë është sprovë dhe dënim
Gjithë jetën nuk perfituam nga ky kërkim
veç mblodhëm thuhet dhe tha pambarim².*

*Kam hulumtuar rrugët e kelamistëve dhe metodat e filozofëve, por nuk i pashë të shërojnë sëmundje dhe as të shuajnë etje. Tani u binda që rruga më e mirë është rruga e Kuranit. Lexoj duke pohuar **«I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua»** Taha, 5, **«tek ai ngjitet fjala e mirë»** Fatir 10, dhe lexoj rreth mohimit **«Asgjë nuk është si ai»** Es shura 11, **«nuk e perfshijnë atë me dije»** Taha 110. Kush do e provojë përvojën time do ta kuptojë fjalën time³.*

Një tjetër dijetar i tyre shprehet: “U zhyta në detin e thellë aq sa braktisa pasuesit e islamit dhe dijet e tyre dhe depërtova në atë prej së cilës më ndaluan. Por tash, nëse zoti im nuk më kaplon me mëshirën e tij, mjerë atëhere për filanin. Ja ku po vdes në akiden e nënës time”.⁴

Një tjetër thotë: “Njerëzit më të luhatur në agonitë e vdekjes janë kelamistët”.⁵

Në anën tjetër, këta kelamistë që kundërshtojnë selefin, nëse arrijnë ndonjë njohuri, ajo nuk është njohuri e sigurtë dhe as njohje e kulluar e Allahut ﷻ, me të cilën kanë ardhur hadithet apo transmetimet.

Si mund të jenë këta të privuar, të mangët, të hutuar dhe kokëkrisur, më të ditur se Allahu ﷻ për emrat dhe cilësitë e tij?! Si mund të jenë më preçizë rreth qënies së Allahut ﷻ dhe ajeteve të tij, sesa vetë muhaxhirët dhe ensarët dhe pasuesit e tyre me

¹ Ka për qëllim Fehrudin Raziun _Allahu e mëshiroftë_. Ibn Tejmije përmend që këto vargje Raziu i ka cituar në librin e tij “Aksamul ledhat”, i cili nuk është botuar. Autori i tyre është pikërisht Raziu.

² Këto vargje gjithashtu i përmend Subkiu në “Tabekatu esh-shafijeh” (5/40), Ibn Halkani në librin “Uefajatul ajan” (4/250) dhe Lisanudin ibn Hatibi në “El ihatah” (2/222).

³ E gjithë kjo fjalë e cituar është e Fehrudin Raziut, Allahu e mëshiroftë. Këtë fjalë e përmend prej tij Dhehebiu në “Sijeru alami en-nubela” në biografinë e Raziut dhe Kadi Shuhbe në “Tabakatu esh-shafijeh” po në biografinë e tij.

⁴ Këto fjalë janë të Ebu Meali Xhujejnit, Allahu e mëshiroftë. I citon prej tij Subkiu në “Tabakatu esh-shafijeh” (3/260), Dhehebiu në “Es sijer” (18/471) dhe Ibn Imad Hanbeliu në “Esh shedherat” (3/361).

⁵ Ibn Tejmije përmend në librin e tij “Nakdul mentik” se këto fjalë janë të Ebu Hamid Gazaliut, Allahu e mëshiroftë.

mirësi?! Ata të cilët ishin trashëgimtarë të profetëve dhe zëvendësues të tyre. Ishin pishtarë të dritës dhe të udhëzimit. Ata të cilët e qartësuan Kuranin dhe vetëm atë praktikuan. Për ta foli Kurani dhe vetëm me Kuran folën. Ata të cilëve Allahu ﷻ u dhuroi dije dhe urtësi, aq sa u shquan në mesin e pasuesve të profetëve, pa foluar për umetet e tjera, të cilëve nuk u është zbritur ndonjë libër. Ata të cilët u thelluan në realitetin e njohurive dhe në fshehtësinë e realitetit. Edhe sikur urtësia e të gjithë njerëzve të tjerë të mblidhej, kishte për t'u turpëruar ai që kërkon të bëjë krahasim.

Si mund të jenë brezat më të mirë të umetit, më të pakët në dije dhe urtësi sesa këta që janë më të vegjël në krahasim me ta?! Sidomos kur bëhet fjalë për njohjen e Allahut ﷻ dhe për dispozitat e emrave dhe të ajeteve të tij.

Si mund të jenë këlyshët e filozofëve, pasuesit e grekëve dhe të indianëve, trashëgimtarët e mexhusëve dhe të politeistëve, çifutët dhe të krishterët e humbur, sabinët¹ dhe sorollapi i tyre; si mund të jenë më të ditur rreth Allahut ﷻ, sesa trashëguesit e profetëve dhe pasuesit e Kuranit dhe imanit?!

E shkruajta këtë parathënie, sepse ai që e kupton atë ka për ta gjetur udhën e udhëzimit, në këtë çështje apo në çdo çështje tjetër. Do ta kuptojë se humbja dhe kokëkrisja, sundoi mbi të mëvonëshmit, pikërisht atëhere kur e hodhën pas krahëve Kuranin dhe i kthyen shpinën udhëzimit dhe argumentave të qarta, me të cilat u dërgua Muhamedi ﷺ. Ata nuk u përpoqën të zbulonin rrugën e sahabëve ؓ dhe të tabinëve, por e kërkuan njohjen e Allahut ﷻ tek ata që nuk e njohin Allahun ﷻ, me dëshminë e vetë atyre, apo me dëshminë e umetit kundër tyre, apo me shumë dëshmi të tjera.

Këtu nuk kam për qëllim një individ të caktuar, por po përshkruaj kategorinë e këtyre njerëzve.

Nëse kjo bëhet e qartë, atëhere libri i Allahut ﷻ nga fillimi e gjer në fund, suneti i të dërguarit ﷺ nga fillimi e gjer në fund dhe të gjitha shprehjet e sahabëve ؓ, të tabinëve dhe të pjesës së mbetur të umetit, përmbajnë dëshmi të pakontestueshme ose të forta² që dëshmojnë se Allahu është i larti më i lartë, sipër çdo gjëje, i lartësuar mbi çdo gjë, sipër Arshit, sipër qiellit. Prej tyre fjala e Allahut ﷻ: **«Tek ai ngjitet fjala e mirë dhe puna e mirë të cilën e ngre»** Fatir, 1.

«Unë do të t'i marrë ndjenjat dhe do të të ngrejë tek unë» Ali Imran, 55.

«A mos vallë u siguroat prej atij që është në qiell se nuk do t'jua çajë tokën dhe ajo do të lëkundet! Apo u siguroat prej atij që është në qiell se nuk do t'ju dërgojnë ndonjë rrebesh gurësh» El mulk, 16-17.

¹ Pasuesit e mandazimit.

² Argumenti “dhahir” në usul-fikh është argumenti i qartë, nga i cili anon dëgjuesi me siguri dhe e kundërta e tij është shumë e dobët.

«Por Allahu e ka ngritur për tek ai» En nisa, 158.

«Melaiket dhe shpirti ngjiten për tek ai» El mearixh, 4.

«I frikësohen zotit të tyre sipër tyre» En nahl, 50.

«pastaj u lartësua mbi Arsh» në gjashtë ajete të ndryshme.

«I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua» Taha, 5.

«O Haman! Më ndërto një kullë! Se mbase i arrij udhët, udhët e qiellit dhe ngjitem te ilahu i Musës. Me të vërtetë unë mendoj se ai është gënjeshtar» Gafir, 36-37.

«zbritje prej të urtit të lavëruarit» Fusilet, 42.

«Është zbritur prej zotit tënd me të vërtetën» El enam, 114.

E të tjera ajete si këto, të cilat janë aq shumë, saqë kërkojnë shumë mund për t'u mbledhur një nga një.

Apo si hadithet sahihe dhe hasene të panumërta. Prej tyre historia e ngjitjes (miraxhi) së profetit ﷺ te zoti, zbritja e melekëve nga Allahu ﷻ dhe ngjitja e tyre tek ai.

Apo si fjala e Allahut ﷻ për melekët që zevendësojnë njëri-tjetrin gjatë ditës dhe natës: *“Ngjiten ata që kanë buajtur me ju për te zoti i tyre dhe i pyet, edhe pse është më i ditur rreth tyre”*.¹

Në hadithin sahih rreth harixhive thuhet: *“A nuk më besoni mua, ndërkohë që unë jam besniku i atij që është në qiell? Më vjen lajmi i qiellit ditë e natë”*.²

Në hadithin e rukjes, të cilin e transmeton Ebu Daudi dhe të tjerë, thuhet: *“Zoti ynë Allah, që je në qiell! U shenjtëroftë emri yt! Urdhëri yt është në qiell dhe në tokë. Ashtu siç është mëshira jote në qiell, shpërndaje mëshirën tënde edhe në tokë! Na i fal ne shkarjet dhe gabimet tona! Ti je zoti i të mirëve. Zbrit një mëshirë prej mëshirës tënde dhe një shërim prej shërimit tënd për këtë sëmundje”*. I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *“Nëse dikush prej jush ankohet, ose ndonjë vëlla i tij ankohet, atëhere le të thotë: O zoti ynë Allah, që je në qiell ...”*³ e deri në fund të hadithit.

¹ **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu 555 dhe Muslimi 632.

² **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu 4351 dhe Muslimi 1064.

³ **Hadith i dobët.** E transmetojnë Ebu Daudi në sunenin e tij 3892, Nesaiu në “Amelul jeumi uel lejleh” 1038, Hakimi në mustedrekun e tij (1/344), Ibn Hibani në “El mexhruhin” (1/308), Ibn Adiji në “El kamil” (3/1054) dhe Uthman Darimiu në “Er redd ala Bishr al Merisi”.

Hakmi ka thënë: “Me të gjithë transmetuesit e këtij hadithi janë argumentuar dy shejhat (Buhariu dhe Muslimi) përveç Zijade ibn Muhamedit. Ai është një shejh egjiptian që transmeton pak hadithe”.

Ibn Hibani ka thënë: “Zijade ibn Muhamedi është shumë munker në hadith. Transmeton transmetime munkere prej dijetarëve të njohur. E ka merituar të braktiset.”.

Në hadithin e uealëve thuhet: *"Arshi është sipër kësaj dhe Allahu është sipër Arshit dhe ai e di gjëndjen në të cilën jeni"*.¹ E transmetojnë Ahmedi, Ebu Daudi dhe të tjerë.

Në hadithin sahih të robëreshës, përmendet se profeti ju drejtua asaj: *"Ku është Allahu? I tha: Në qiell. I tha: Kush jam unë? I tha: Ti je i dërguari i Allahut. Tha: Liroje atë, sepse ajo është besimtare"*.²

Apo si fjala e profetit ﷺ në hadithin sahih: *"Kur Allahu i krijoi krijesat, shkroi në një libër, i cili është i vendosur tek ai sipër Arshit: Mëshira ime ja ka kaluar zemërimit tim"*.³

Apo si fjala e tij në hadithin e marrjes së shpirtit: *"Derisa të ngjitet me të në qiellin mbi të cilin është Allahu"*.⁴

Apo si vargjet e Abdullah ibn Reuahas ؓ të cilat ia recitoi profetit ﷺ dhe ai i aprovoi:

Dëshmova se premtimi i Allahut është hak

E zjarri është strehimi i pabesimtarëve

Dhe sipër ujrave Arshi lundron

*E sipër Arshit është zoti aleminëve*⁵

Transmetimi i hadithit munker nga një dijetar i njohur është shumë më i dobët se transmetimi i hadithit munker nga një i panjohur. Kjo për shkak se dijetari i njohur ka me dhjetra nxënës që e kanë mësuar hadithin e tij dhe pastaj të gjithë këta nxënës nuk e transmetojnë atë, por prej tij e transmeton dikush që nuk është nxënës i tij dhe është munker në hadith. Kjo rrethanë dëshmon se dyshimi për këtë hadith duhet të jetë akoma më i madh, madje mund të jetë shkak edhe për akuzimin e transmetuesit. Për këtë shkak Ibn Hibani e ka braktisur hadithin e tij.

Dhehbiu ka thënë: "Këto fjalë janë munkere. Askush tjetër përveç Zijades nuk i ka transmetuar".

Nesaiu e ka transmetuar këtë hadith nga rivajeti i Talk ibn Habibit nga një banor i Shamit nga babai i tij. Ky personi nga Shami dhe babai i tij janë të panjohur. Prandaj dhe ky hadith është i dobët.

¹ **Hadith i dobët.** E transmetojnë Ebu Daudi 4723, Tirmidhiu 3320, Ibn Maxheh 193, Ahmedi (1/207), Hakimi (2/412), Bejhakiu në "El esmau ues sifati" 847, Ibn Huzejme në "Et teuhid" (10/144) dhe shumë të tjerë. Hakimi ka thënë: "Sahih sipas kushteve të Muslimit mirëpo ata (Buhariu dhe Muslimi) nuk e kanë vendosur (në sahihet e tyre)". Tirmidhiu ka thënë: "Hadithi hasen garib". Megjithatë hadithi është i dobët për shkak se Abdullah ibn Umejri është i panjohur dhe Jahja ibn Alai konsiderohet i braktisur".

² **Hadith sahih.** E transmetojnë Muslimi 537, Ebu Daudi, Nesaiu, Ahmedi dhe shumë e shumë të tjerë.

³ **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu 3194 dhe Muslimi 2715.

⁴ **Hadith sahih.** E transmetojnë Ahmedi në musnedin e tij 8754, Nesaiu në "Es sunen el kubra", Ibn Maxheh në sunenin e tij, Ibn Xherir Taberiu në tefsirin e tij, Ibn Huzejme në "Et teuhid" dhe të tjerë. Dhehebiu ka thënë: "Sipas kushtit të Buhariut dhe Muslimit". Shejh Shuajb Arnauti ka thënë: "Senedi i tij është sahih".

⁵ **Hadith i dobët.** E transmeton Darimiu në "Er redd alel xhehmijeh" me sened të dobët dhe të shkëputur (Munkati). E përmend edhe Ibn Abdulberri në "El istiab" dhe thotë: "Historia e tij dhe e gruas së tij, atëhere kur ai shkoi me robëreshën e tij është e njohur. Atë e kemi transmetuar me rivajete sahihe".

Apo vjersha e Umeje ibn Ebi Salt Thekafiut, vjershat e të cilit kur i janë recituar profetit ﷺ, i ka pëlqyer dhe ka thënë: **"Besoi poezia e tij por mohoi zemra e tij".¹**

Madhërojeni Allahun se myzhdet i takojnë

Zoti jonë në qiell është madhëruar

Me ndërtimin e lartë para njerëzve

Dhe sipër qiellit e shtriu fronin

Gjerësisht dhe nuk i fle shikimi i syrit

E poshtë tij shikon melekët të krijuar

Apo si fjala e profetit ﷺ në hadithin e transmetuar në "El musned": **"Allahu ﷻ është i turpshëm dhe bujar. Turpërohet prej robit të tij t'ia kthejë duart bosh atëhere kur i ngre duart drejt qiellit".²**

Dhe fjala e tij në hadithin: **"I zgjat duart e tij drejt qiellit duke thënë: O zot! O zot!".³**

E shumë argumente të tjerë, të cilat askush përveç Allahut nuk mund t'i përmbledhë të gjitha. Ato janë nga argumentet më mutevatire si në tekstin e tyre ashtu edhe në përmbajtjen e tyre kuptimore. Ato na krijojnë bindje të plotë dhe dije apriori⁴ se i dërguari i Allahut ﷺ u ka thënë të thirrurve në fenë e tij, që Allahu ﷻ është mbi Arsh dhe sipër qiellit. Kjo është edhe natyra në të cilën Allahu ﷻ i ka krijuar të gjithë popujt, arabët apo joarabët, në xhahilijet apo në islam, me përjashtim të atyre, të cilët shejtanët i kanë nxjerrur nga kjo natyrshmëri.

Rreth kësaj çështje, nga selefi, transmetohen qindra thënie, madje mijra. Mirëpo as në Kuran, as në sunet, as nga ndonjë prej selefit; si sahabët dhe pasuesit e tyre me mirësi, as prej imamëve të cilët jetuan në periudhën e bidateve dhe mosmarrveshjeve, nuk përcillet qoftë edhe një thënie e vetme që kundërshton këto argumente të padiskutueshme dhe të forta.

Askush prej tyre nuk është shprehur: Allahu nuk është në qiell. Ai nuk është mbi Arsh. Ai është kudo me qënien e tij. Të gjitha vëndet në lidhje me të janë njësoj. Ai nuk është as brenda botës dhe as jashtë saj. As nuk është i përzier me krijesat dhe as nuk është i ndarë. Nuk lejohet të bëhet me shenjë treguese ndaj Allahut me gisht. Apo të tilla shprehje si këto.

¹ **Hadith i dobët.** E transmeton Ibn Abdulberri në "Et temhid" dhe Ibn Asakir në "Tehdhibu et tarih".

² **Hadith sahih.** E transmeton Ebu Daudi 1488 dhe Tirmidhiu 3556.

³ **Hadith sahih.** E transmeton Muslimi.

⁴ Dija apriori është dija e cila nuk ka nevojë për argument sepse dihet vetvetiu, si dija që dielli lind nga lindja dhe 1+1=2.

Përkundrazi është saktësuar në hadithin sahih nga Xhabir ibn Abdullahi ؓ se profeti ﷺ, kur mbajti hytben madhështore në ditën e Arafatit, në tubimin më të madh që ishte mbledhur ndonjëherë rreth profetit ﷺ, zuri të thoshte: ***“A nuk e kam përcjellur? I thanë: Po! Atëhere e ngrite gishtin drejt qiellit dhe e përkulte drejt tyre dhe thoshte: O Allah dëshmo!”***.¹

Nëse e vërteta, përputhet me fjalën e mohuesve të cilësive të permendura në Kuran dhe sunet, si fjalët e permendura më sipër apo të tjera, dhe nuk përputhet me argumentet e padiskutueshme dhe të forta të Kuranit dhe sunetit, si ka mundësi atëhere që Allahu ﷻ dhe profeti ﷺ dhe më të mirët e këtij umeti, të flasin vazhdimisht me fjalë, të cilat janë të padiskutueshme dhe të qarta, por në kundërshtim me të vërtetën (realitetin) e cila është detyrë të besohet, e pas gjithë kësaj, nuk shfaqin qoftë edhe një fjalë të vetme për të vërtetën që duhet besuar dhe nuk shprehin për të as argumente të padiskutueshme dhe as të qarta?! Derisa na erdhën pinjollët e persve dhe të romakëve, apo çiliminjtë e çifutve dhe të krishterëve dhe të filozofëve dhe i sqaruan umetit islam akiden e saktë, të cilën duhet ta besojë çdo besimtar i ndërgjegjshëm dhe i devotshëm.

Nëse e vërteta që duhet besuar është pikërisht kjo që këta kelamistë ekstremë pretendojnë; të cilët u mbështetën për kuptimin e të vërtetës vetëm në logjikën e tyre dhe në refuzimin e argumentave të padiskutueshme dhe të qarta të Kuranit dhe sunetit bazuar në krahasime logjike; atëhere sipas këtij supozimi i bie që lënia e njerëzve pa Kuran dhe pa sunet do të ishte më udhëzuese dhe më e dobishme për ta. Madje kështu i bie që ekzistenca e Kuranit dhe e sunetit qënkam dëmprurëse për akiden.

Realiteti që këta njerëz pretendojnë është që ju o robër, njohjen e Allahut ﷻ dhe njohjen e cilësive që meritojnë të pohohen apo të mohohen, mos e kërkonin as te Kurani dhe as te suneti. Mos e synoni atë prej rrugës së selefrit! Përkundrazi! Logjikoni vetë dhe ato cilësi që shikoni se i përshtaten Allahut ﷻ, përshkruajeni me to, pohohen apo nuk pohohen në Kuran dhe sunet. Ndërsa cilësitë që i shikoni të papërshtatshme, sipas logjikës tuaj, mos e përshkruani me to.

Më pas kelamistët në këtë pikë ndahen në dy fraksione. Shumica e tyre thonë: Atë që nuk e pohon logjika juaj mohojeni. Ndërsa disa të tjerë thonë: Ndaluni rreth saj.

Ndërsa atë që e mohon krahasimi i logjikës suaj, për të cilin jeni luhatur dhe kundërshtuar më shumë se çdo mospajtim tjetër në tokë, atë mohojeni. Madje kur të ndodhin divergjenca, referohuni te ky (mohim logjik) sepse kjo është e vërteta me të cilën Allahu ﷻ ju ka ngarkuar. Ndërsa atë që përmendet në Kuran dhe sunet, e cila bie ndesh me krahasimin tuaj logjik dhe e pohon atë që nuk e kanë logjikuar mendjet tuaja, sipas metodës së shumicës, atëhere dijeni se Allahu ﷻ po ju sprovon dhe nuk i ka zbritur ato për t'i ndjekur apo për t'u udhëzuar me to, përkundrazi i ka zbritur që të

¹ **Hadith sahih.** E transmeton Muslimi 1218.

mundoheni t'i nxirrni kuptimet e tyre nga kuptimet e panjohura, nga fjalët e papërhapura dhe nga botkuptimet e rralla, ose përndryshe heshtni për to duke e kthyer dijen e tyre te Allahu ﷻ, me kusht që ta mohoni kuptimin që ato mbartin për cilësinë.¹

¹ Këto fjalë në përmbajtjen e tyre kanë retorikë. Në to Ibn Tejmije shpalos disa baza të argumentimit në akide dhe i kundërpërgjigjet metodologjisë kelamiste.

Cilësitë e Allahut mund të shqyrtohen në dy aspekte: pohimi dhe mohimi. Përsa i përket pohimit, kelamistët janë në një mendje se cilësitë që mendja i pohon duhet të pohohen. Ndërsa cilësitë që mendja i mohon duhet të mohohen. Ky është rregull bazë në mesin e tyre megjithë divergjencat e shumta se çfarë pohohet dhe çfarë mohohet.

Por disa cilësi logjika nuk i pohon prerazi por edhe nuk i mohon. Këtu kelamistët ndahen në dy fraksione. Fraksioni i parë mendon se këto cilësi duhet të mohohen përderisa logjika nuk dëshmon për to.

Ndërsa fraksioni i dytë mendon se për cilësi të tilla mbahet mbahet qëndrim i rezervur dhe as nuk i pohojmë dhe as nuk i mohojmë.

Fraksionit të parë Ibn Tejmije i përgjigjet me pikat e mëposhtme:

1- Nuk ka ndonjë ndarje dalluese të qartë për cilësitë që logjika nuk mund t'i pohojë. Psh. esharitë e mëvonshëm mendojnë se cilësi si dora dhe syri, logjika nuk i pohon, ndërkohë që cilësi si dëgjimi dhe shikimi logjika i pohon. Mutezilitë mendojnë që logjika nuk mund të pohojë cilësi si dëgjimi dhe shikimi, mirëpo logjika e pohon një cilësi si dija. Disa rryma filozofike dhe xehemitë mendojnë që logjika nuk e pohon një cilësi si dija, mirëpo e pohon qënien dhe ekzistencën e Allahut. Disa rryma filozofike ekstreme pretendojnë që logjika nuk e pohon edhe vetë ekzistencën përveçse me kushtin e ekzistencës të pakufizuar, pra ekzistencë imagjinare në mendësi dhe jo në njëmendësi.

Pra atë që dikush prej tyre mendon se logjika e pranon, dikush tjetër pretendon se nuk e pranon dhe si e tillë ose duhet refuzuar ose duhet të ndalemi. Divergjencat e tyre në këtë çështje janë aq shumë saqë kanë mbushur dheun anembanë. Si rrjedhim, logjika me të tilla luhatje nuk mund të jetë referencë e pavarur për pohimin dhe mohimin e cilësive.

2- Logjika e pavarur nuk mund të jetë referenca me të cilën Allahu i ka ngarkuar krijesat, sidomos aty ku bie në kundërshtim me argumentet kuranore kategorike dhe të qarta. Nëse Kurani në pamje të jashtme dëshmon për një cilësi, ndërkohë që logjika nuk e pohon atë cilësi, atëhere argumenti kuranor qënka në kundërshtim me të vërtetën.

Për të shpëtuar nga kjo akuzë e rrezikshme, kelamistët janë munduar që t'i japin njëfarë shpjegimi këtij problemi. Ata kanë ndjekur për këtë disa metoda:

a) Gërmimi dhe gjurmimi i kuptimeve të papërhapura dhe të panjohura të fjalëve që shprehin cilësi. Si p.sh. kuptimi i fjalës "istiva" me sundimin dhe mbizotrimin.

b) Besimi se Kurani ka domethënie të fshehta dhe se ai në pamje të jashtme duket sikur është në kontradiktë me realitetin sepse Allahu ﷻ ka dashur t'i sprovtojë robërit e tij me kuptimet e jashtme të ajeteve. Pra imani lidhet me fshehtësinë e ajetit dhe jo me kuptimin e tij parësor. Kuptimi parësor është sprovë që Allahu ﷻ e ka hedhur mes njerëzve. Prandaj disa prej esharive të mëvonshëm kanë arritur deri aty sa kanë pohuar se besimi i kuptimeve aparente të ajeteve është prej degëve të kufrit.

c) Fraksioni i dytë kanë thënë: Këto ajete janë zbritur që të kuptohen si fjalë të zbrazura nga kuptimet. Prandaj ne e mohojmë kuptimin e tyre aparent dhe e kthejmë dijen e tyre te Allahu ﷻ.

Këto tre metoda lidhen me ajetet që bëjnë fjalë për cilësitë që logjika, sipas kelamistëve, nuk i pranon. Ndërsa ajetet që logjika, sipas tyre, i pranon, ato duhet të kuptohen dhe të pranohen në kuptimin e tyre parësor.

Ibn Tejmije u kundërvihet kelamistëve duke i sulmuar ashpër në këtë pikë. Si mundet që logjika të bëhet bazë dhe Kurani degë që vërtitet rreth saj. Sa herë që personit ia shkrep mendja që iks cilësi nuk i shkon Allahut, i qaset librit të Allahut me deformime gjuhësore apo pretendon se filan ajet është sprovë. E gjithë

Ky është realiteti sipas mendimit të këtyre kelamistëve.

Kuptimin e kësaj fjale e kanë shprehur qartë një grup kelamistësh¹. Ato janë rrjedhojë e pashmangëshme për të gjithë ata. Përmbajtja e tyre nënkupton që nuk mund të udhëzohemi me Kuran rreth njohjes së Allahut ﷻ. Ndërsa i dërguari ﷺ nuk është ngarkur për mësimin dhe njoftimin e njerëzve për cilësitë e dërguesit të tij. Nënkupton që njerëzit, kur të ndodhin mospajtime, nuk duhet të referohen as te Allahu ﷻ dhe as te i dërguari ﷺ, por duhet t'i referohen asaj që ekzistonte në periudhën e xhahilijetit. Duhet t'i referohen asaj te e cila kthehen për gjykim ata që nuk besojnë profetët, si brahmanët², filozofët politeistë, mexhusëve dhe disa sabinë.

Ky referim i tyre, e përshtjellon më shumë çështjen dhe nuk i jep fund mospajtimeve, sepse çdo fraksion ka tagutët e tij, tek të cilët dëshirojnë të gjykohen edhe pse janë urdhëruar të mos u besojnë atyre.

Gjëndja e këtyre kelamistëve përngjason shumë me fjalën e Allahut ﷻ: **«A nuk i shikon ata që pretendojnë se kanë besuar atë që të është zbritur ty dhe atë që është zbritur para teje. Dëshirojnë të gjykohen te taguti, ndërkohë që janë urdhëruar të bëjnë kufër me të, mirëpo shejtani dëshiron t'i humbasë me humbje të largët. E kur u thuhet atyre: Ejani te ajo që ka zbritur Allahu dhe te i dërguari, ke për t'i parë munafikët të zbrapsen prej teje me zbrapsje. E si do të jetë puna e tyre kur t'i godasë ndonjë musibet (fatkeqësi) për shkak të asaj që përfituan me vetë duart e tyre, e pastaj të vinë te ty dhe të betohen për Allah, se kanë synuar vetëm mirësi dhe pajtim»** En nisa, 60-62.

Kur kelamistët ftohen për kthimin te ajo që Allahu ﷻ ka zbritur dhe te i dërguari ﷺ _ftimi te i dërguari pas vdekjes përmbushet me ftimin te suneti i tij_, refuzojnë duke u justifikuar: Me këtë rrugë që kemi ndjekur, kemi synuar të mirën, si në vepra ashtu edhe në dije, për të përputhur mes argumenteve logjike dhe argumenteve të transmetuara.

Në shumicën e dyshimeve, të cilat i supozojnë si argumente, ata kanë imituar ndonjë tagut prej tagutëve të politeistëve dhe të sabinëve, apo nga pasardhësit e tyre, të

kjo vetëm e vetëm se logjika e tij nuk e ka pranuar një cilësi të tillë. Kështu Kurani bëhet lodër në dorën e logjikës kelamiste. Apo më mirë të themi u bëhet ferrë në këmbë dhe halë në fyt. Prandaj shumica e kelamistëve pas mohimit të ndonjë cilësie merren gjithmonë me shqyrtimin e ajeteve "të dyshimta" të cilat mund të jenë me dhjetra. I shikon ata të bëhen copë fare vetëm e vetëm për të dalë nga situata. Më e bukura është se në shumicën e rasteve atë shpjegim që ia jep njëri, e mohon ai tjetri megjithëse janë në të njëjtin medhheb. Si mund të jetë kjo metodologjia e saktë për pranimin e emrave dhe cilësive të Allahut kur kjo është gjëndja e tyre?!

¹ Shumë muezili dhe xhehmi e pohojnë këtë pikë. Sipas tyre kumtesa hyjnore përmban dy kuptime; një kuptim që i drejtohet masave të gjëra dhe kuptimi tjetër është kuptimi që u drejtohet të diturve dhe filozofëve. Pra në realitet kumtesa hyjnore nuk përmban kuptime reale por thjesht zbret në nivelin e logjikës së masave të gjëra dhe u drejtohet atyre me atë që ata kuptojnë dhe jo me atë që është e vërtetë.

² Me këtë titull thirren priftërinjtë e hinduizmit.

cilëve u urdhëruan të mos u besojnë, si puna e filanit dhe fistekut. Apo i kanë marrë këto dyshime nga ata që u përngjasojnë atyre në ide. Allahu ﷻ thotë: **«Jo pasha zotin tënd! Ata nuk besojnë derisa të të bëjnë ty gjykatës për atë që ka ndodhur mes tyre dhe pastaj të mos gjejnë në vetet e tyre asnjë siklet prej gjykimit tënd dhe ta pranojnë me nënshtrim»** En nisa, 65.

Dhe thotë: **«Njerëzit ishin një umet i vetëm dhe Allahu dërgoi profetët si përgëzues dhe qortues dhe u zbriti atyre librin me të vërtetën, për të gjykuar mes njerëzve në kundërshtimet rreth tij. Nuk u kundërshtuan rreth tij askush tjetër përveç atyre që iu dha libri dhe pasi u erdhën qartësimet»** El bekare, 213.

Rrjedhojë e fjalës së tyre është se Kurani nuk është as udhëzues për njerëzit, as sqarim, as shërim për gjokset, as dritë dhe as referencë në debat. Ne e dimë me bindje të plotë se për atë që këta kelamistë ekstremë e besojnë si të vërtetë që duhet besuar, nuk ka dëshmuar as Kurani dhe as suneti, as me argumente kategorike dhe as me argumente të fortë.

Maksimumi që mund të arrijë më i shkathti i tyre është nxjerrja e këtij konkluzioni prej ajetit **«Askush nuk është i barabartë me të»** El ihlas 4, dhe prej ajetit **«A mos vallë di për të ndonjë të përngjashëm?!»** Merjem 65.

Çdo njeri me logjikë të shëndoshë nuk ka dyshme se ai që përpiket t'i mbushë mendjen se ajeti **«A di për të ndonjë të përngjashëm»**, dëshmon që Allahu ﷻ nuk është mbi Arsh dhe as sipër qiejve, ai është shumë larg të vërtetës. Ose po thotë gjëgjëza, ose po i bie tërthor për të dredhuar, por kurrësi nuk po u flet me gjuhë arabe të qartë.

Rrjedhim i kësaj fjale, është që lënia e njerëzve pa shpallje hyjnore, është më e dobishme për akiden e tyre, sepse referenca si para dërgesës profetike ashtu edhe pas saj, na qënka e njëjtë. Madje shpallja hyjnore i paska shtirë njerëzit në qorrsoakak dhe në humbje më të madhe.

Subhanallah! Përse i dërguari i Allahut ﷻ dhe askush prej selefit ﷺ nuk thanë, qoftë edhe një herë të vetme: Këto ajete dhe hadithe, mos i besoni për ato që shprehen, por besoni konkluzionet e analogjisë tuaj. Besoni kështu dhe ashtu, sepse kjo është e vërteta. Besoni atë që kundërshton kuptimin parësor të argumentit dhe mos e besoni kuptimin parësor. Shqyrtojini këto ajete dhe hadithe dhe ato që përputhen me analogjinë e logjikës suaj besojeni, e në të kundërt ose heshtni ose mohojeni.

I dërguari i Allahut ﷻ na ka njoftuar se umeti i tij do të përçahet në shtatëdhjetë e tre fraksione. E pasi na njoftoi me atë që do të ndodhë tha: ***"Unë po lë mes jush diçka, me të cilën po të kapeni, nuk do të humbisni pas meje; librin e Allahut dhe sunetin***

tim".¹

Transmetohet se ai ka thënë për veçorinë e grupit të shpëtuar: *"Ata janë ata që janë në atë që jam unë sot dhe sahabët e mi"*.

Përse nuk tha: Kush kapet pas kuptimeve aparente të Kuranit, në çështjet e akides, ai është i humbur. Udhëzimi fshihet te analogjitë e logjikës suaj dhe te ajo që do t'ju sqarojnë kelamistët për këtë çështje, pas tre brezave. Megjithëse këto çështje patën mbirë që në fundin e brezit të tabinëve.

Mohimi i cilësive, burimin e ka te nxënësit e çifutëve dhe të mushrikëve dhe devijimet e sabinëve. I pari që u bë i njohur me përhapjen e mohimit se Allahu ﷻ është mbi Arsh realisht dhe se kuptimi i "istiva-së" është mbizotrimi, ishte Xhad ibn Dirhemi². Prej Xhadit këto mendime i morri Ibn Safuani³ dhe i përhapu aq shumë, sa mendimet e xhehmive iu atribuan atij. Thuhet se Xhadi i morri këto mendime nga Xhehm Eban ibn Semani. Ebani i morri nga Taluti, djali i motrës së Lebid ibn Esamit. Taluti i morri prej magjistarit çifut Lebid ibn Esamit, i cili i bëri magji profetit ﷺ.

Përmendet se Xhad ibn Dirhemi ishte nga Harani. Në kohën e tij, në Haran, ishin përhapur shumë sabinët dhe filozofët, të cilët ishin mbetje të fesë së nemrudit dhe kenanëve. Madje disa të mëvonshëm kanë hartuar një libër rreth magjive të tyre.⁴

Nemrudi ka qënë mbret i sabinëve keldani, të cilët ishin politeistë. Ashtu siç ishte kisra mbret i persëve dhe mexhusëve, apo faraoni mbret i Egjiptit, apo nexhashiu mbret i të krishterëve abisinas. Pra ky është emër i përgjithshëm dhe jo i përveçëm.⁵

Shumica e sabinëve _përveç një pakice të tyre_ ishin politeistë. Dijetarët e tyre

¹ **Hadith sahih.** E transmeton Tirmidhiu 3788 dhe Maliku në "El muata". Shejh Albani e ka përmendur në librin e tij "Sahihul xhami" nr: 2458, dhe e ka saktësuar.

² Xhad ibn Dirhemi, me origjinë prej Horasanit. Ishte i pari që përhapu idetë e mohimit të cilësive. Pretendoj që Allahu ﷻ nuk e ka marrë Ibrahimin për mik dhe nuk i ka folur Musait me fjalë. E vrau atë Halid Kisriu në Kufë, në ditën e bajramit, në vitin 124h.

³ Xhehm ibn Safuani, Ebu Muhriz Rasibiu, me origjinë nga Samerkandi. Themeluesi i sekti xhehmi. Ishte kelamisti më i shquar që përhapu idetë e tatilit (mohimit të cilësive). Prandaj edhe kushdo që i përfaqson idetë e tij, i atrubohet xhehmive. Kështu muezilitë dhe filozofët e ndryshëm islam, quhen "xhehmi" me kuptimin e gjërë të fjalës, sepse ata janë prej mohuesve të cilësive.

⁴ Ka për qëllim Fahrudin Raziun dhe librin që e ka shkruar rreth planeve dhe yjeve, me titull "Es sirrul mektum fi muhatebatil nuxhum". Raziu në këtë libër shtjellon dhe shqyrton besimin e shumë popujve politeiste dhe ndikimin e tyre në umetin islam. Për hir të realitetit, ky libër është përpiluar për t'ju kundërpërgjigjur humbjes së këtyre feve dhe fraksioneve dhe Raziu nuk i ka pasë besuar këto gjëra. Ai thjesht citon dhe u referohet fjalëve të tyre dhe replikon me ta herë pas here. Kjo gjë duket qartë në shumë fragmente të librit dhe falenderimi i takon Allahut.

⁵ Fjala "nemrud" është titull i mbretit në Haranin e lashtë. Nemrudi nuk është emër i një personi të veçantë, siç mund të kujtojë ndokush, por titull dhe emër i përgjithshëm për çdo mbret të Haranit. Transmetimet që dëshmojnë se Ibrahim i ﷺ është takuar me nemrudin, nuk kanë për qëllim mbretin me emrin "Nemrud" por mbretin që në shtetin e Haranit thirrej me titullin "nemrud".

ishin filozofë. Megjithëse sabiu mund të jetë besimtar që beson Allahun ﷻ dhe botën tjetër dhe jo politeist, siç thotë Allahu ﷻ: **«Ata që besuan dhe ata që ishin çifutë dhe të krishterë dhe sabinë, kush besoi Allahun dhe botën tjetër dhe veproi mirësi, atyre u takon shpërblimi i tyre te zoti i tyre dhe nuk ka frikë për ta dhe as nuk dëshpërohen»** El bekare, 62.

Dhe thotë: **«Ata të cilët kanë besuar dhe ata që kanë qënë çifutë dhe sabinë dhe të krishterë, kush besoi Allahun dhe botën tjetër dhe veproi mirësi, për ta nuk ka frikë dhe aspak nuk dëshpërohen»** El maideh 69.

Por shumica e tyre ishin qafirë ose politeistë, ashtu siç e patën deformuar çifutët dhe të krishterët fenë dhe devijuan, duke u shndërruar në qafirë dhe mushrikë. Sabinët qafirë dhe mushrikë, në atë epokë, adhuronin planetet dhe ndërtonin për to tempuj.

Drejtimi mohues në mesin e tyre, besonte se zoti përshkruhet vetëm me cilësi negative ose me cilësi marrëdhëniore¹ ose të përbëra nga këto të dy lloje. Sabinët janë populli tek të cilët ishte dërguar Ibrahim Halili عليه السلام.

Khadi i morri këto mendime pikërisht nga sabinët dhe filozofët. Edhe Ebu Nasr Farabiu² kur hyri në Haran, e morri prej filozofëve sabinë të gjithë filozofinë e tyre.

Ndërsa Xhehmiu, këto mendime i morri nga sumenitë³, siç e përmend imam Ahmed i dhe të tjerë, të cilët ishin filozofë të Indisë. Ata mohonin çdo burim tjetër përveç burimeve empirike. Kështu burimet bazë të Xhehmiut kthehen te çifutët, sabinët, politeistët, apo te filozofët e humbur prej sabinëve dhe politeistëve.

Atëhere kur literatura greke u përkthye në arabisht, diku aty nga shekulli i dytë, belaja u shtua më shumë, si shtesë mbi humbjet që shejtani u hodhi fillimisht të devijuarve dhe dyshimet që u pati hedhur më parë sorollapit të tyre.

¹ Cilësitë negative në realitet nuk janë cilësi sepse ato nuk ekzistojnë por thjesht mohohen prej Allahut. P.sh. mohimi i gjumit, i lodhjes etj. Shumë prej xhehmive dhe filozofëve e përshkruajnë Allahun vetëm me këto cilësi. P.sh. ata nuk e pohojnë cilësinë e dijes, por mohojnë që Allahu të jetë i paditur.

Edhe cilësitë marrëdhëniore (الصفات الإضافية) gjithashtu nuk janë cilësi kuptimore shtesë, por nocione që kanë lidhje relative. Si p.sh. nocioni i të qenit prind në lidhjen babë-bir. Ky nocion në vetëvetë nuk është një cilësi kuptimore shtesë, pra që i shtohet qënies.

Prej nocioneve marrëdhëniore që filozofët pohojnë për Allahun është edhe cilësimi i Allahut si “shtytësi i parë” (العلّة الأولى), pra shkaktari i ekzistencës së materies. Ky përshkrim në realitet nuk është një pohim cilësor sepse shkaku është vetëm një lidhje relative mes shkaktarit dhe të shkaktuarit.

² Ebu Nasr Farabiu, filozof i njohur. Thirrej si mësuesi i dytë, sepse mësuesi i parë thirrej Aristoteli. Lindi diku nga viti 257h dhe vdiq në vitin 339. Filozofinë e mësoi në Aleksandri, ndërsa mësimet e para në filozofi i morri nga Ebu Bishri, një filozof i krishterë. Dhehbiu thotë për të: “Hartoi libra të njohur. Kush e kërkon udhëzimin në to ka për të humbur dhe do të çoroditet. Nga librat e tij ka mësuar Ibn Sina. E lusim Allahun të na dhurojë udhëzimin”. Es sijer (15/416)

³ Sumenitë janë një rrymë filozofike empirike. Empiricizmi, në dallim nga racionalizmi, dyshon në aftësitë e arsyes për të dhënë dituri rreth botës, duke preferuar të bazojë çdo njohuri që kemi në shqisat. Ata ishin filozofë materialistë që bazoheshin vetëm në të perceptuarën me shqisat.

Ndërsa nga shekulli i tretë u përhapën këto ide të cilat dijetarët e hershëm i cilësonin si ide xhehmie. Shkak u bë Bishër ibn Gijath Merisiu¹ dhe bashkohësit e tij. Fjalët e imamëve si Maliku, Sufjan ibn Ujejne, Ibn Mubareku, Ebu Jusufi, Shafiu, Ahmedi, Is'haku, Fudejl ibn Ijadi, Bishër Hafiu dhe të tjerë, janë të shumta rreth përbuzjes dhe humbjes së tyre.

Këto “tavile” që qarkullojnë sot në dorën e njerëzve², si shumica e “tavile-ve” të Ebu Bekr ibn Forekut në librin me titull “Et tavilat”, të cilat i ka cituar edhe Ebu Abdullah Muhamd ibn Umer Raziu në librin me titull “Tasisut takdis”, të cilat gjenden me shumicë në fjalët e të tjerëve si puna e Ebu Ali Xhubaiut, Abdulxhebar ibn Ahmed Hamedanit, Ebu Husejn Basriut, Ebu Uefa ibn Akilit, Ebu Hamid Gazaliut etj; këto “tavile” janë pikërisht “tavilet” e Bishër Merisit të cilat i ka përmendur në librin e tij. Edhe pse në fjalët e disa prej tyre ke për të gjetur refuzim të tavilit dhe hedhjen poshtë të tij, apo ke për të hasur fjalë të goditura në disa çështje të tjera. Mirëpo unë kam për qëllim që “tavilet” e tyre janë pikërisht “tavilet” e Bishër Merisit.

Për këtë, dëshmon replika që ka shkruar Uthaman ibn Said Darimiu, një prej imamëve të njohur në kohën e Buhariut. Ai përpiloi një libër me titull “Replika e Uthaman ibn Saidit kundër gjënjeshtarit kokëfortë për atë që trilloi ndaj Allahut në teuhid”.

Ai citon të njëjtat “tavile” prej Bishër Merisit, madje me një kontest që dëshmon se Merisi ishte më i ditur rreth bazave, transmetimeve dhe argumenteve logjike sesa këta të mëvonëshmit, të cilët kanë marrë prej tij dhe prej tjetërkujt.

Uthman ibn Saidi i bën një replikë të fortë, me fjalë të cilat nëse një njeri me logjikë të mprehtë i lexon, ka për t’u bindur për realitetin e selefit dhe do t’i qartësohet forca e argumentit dhe e metodës së tyre dhe dobësia e argumentit të kundërshtarëve të tyre.

Nëse qartësohet që imamët e udhëzimit janë pajtuar në një mendje për përçmimin e metodës merisiane dhe se shumica e tyre i kanë konsideruar ata qafirë të humbur; dhe nëse qartësohet që idetë e përhapura në mesin e të mëvonshmëve janë njësoj si medhhebi i Merisit; atëhere do t’i qartësohet udhëzimi atij që Allahu ﷻ dëshiron ta udhëzojë, dhe forca e fuqia janë vetëm prej Allahut ﷻ.

Kjo fetva nuk na lejon të zgjerohemi më shumë në këtë pikë. Unë thjesht po

¹ Bishër ibn Gijath Merisiu, (138-218). Prej fukahave hanefi dhe kadiu i kalifit Mamun. Fikhun e morri prej Ebu Jusufit. Transmeton prej Hamad ibn Selemes dhe Sufjan Theriut. Por me kalimin e kohës hyri në çështjet e ilmul-kelamit dhe u shndërua në një nga protagonistët kryesorë në fitnen e krijimit të Kuranit. Doli haptaz në mbështetje të xhehmive në çështjet e cilësive dhe të imanit, duke pasur edhe përkrahjen e kalifit Mamun, aq sa dijetarët e hadithit e shpallën qafir dhe bidatçi të humbur.

² Ka për qëllim me fjalën “njerëz” esharitë dhe maturiditë për të cilët është shkruar edhe kjo fetva.

përpiqem të tregoj bazat e këtyre çështjeve dhe i logjikëshmi ecën në këtë rrugë dhe mediton.

Fjalët e selefit rreth kësaj çështjeje janë përmendur në shumë libra. Këtu mund të përmendim vetëm disa prej tyre. Prej tyre:

"Kitabus sunen" i Lalekait, "El ibaneh" i Ibn Batas, "Es sunneh" i Ebu Dherr Hereviut, "El usul" i Ebu Umer Talamenkut, fjalët e Ebu Umer ibn Abdulberrit, "El esmau ues sifati" i Bejhakiut.

Para këtyre librave janë hartuar libra si "Es sunneh" prej secilit nga Taberani, Ebu Shejkh Asfahani, Ebu Abdullah ibn Menah dhe Ebu Ahmed Asali, të dy këta të fundit nga Asfahani.

E para tyre libra si "Es sunneh" i Halalit, "Et teuhid" i Ibn Huzejmes dhe fjalët e Ebu Abas ibn Surejhit.

Apo si "Er-reddu alal xhehmijeh". Me këtë titull kanë shkruar libër një grup dijetarësh, si Buhariu dhe shejhu i tij Abdullah ibn Muhamed ibn Abdullah Xhafiu.

E më herët libra si "Es sunneh" i Abdullah ibn Ahmedit, "Es sunneh" i Ebu Bekr ibn Ethremit, "Es sunneh" i Hanbelit dhe Merveziut dhe Ebu Daud Sixhistanit dhe Ibn Ebi Shejbes dhe "Es sunneh" i Ebu Bekr ibn Ebi Asimit.

Apo si "Halku efalil ibad" i Buhariut. "Erred alal xhehmije" i Uthman ibn Said Darimiut dhe i disa të tjerëve. Apo si fjalët e Ebu Abas Abdulaziz Mekuit, autori i librit "El hajdetu fir reddi alal xhehmije" dhe fjalët e Naim ibn Hamad Huzaiut dhe fjalët e shumë të tjerëve.

Apo si fjalët e imam Ahmed ibn Hambelit, Is'hak ibn Rahavejhit, Jahja ibn Saidit, Jahja ibn Jahja Nejsaburit dhe si puna e tyre.

E akomë më herët fjalët e Abdullah ibn Mubarekut dhe bashkohësve të tij dhe shumë e shumë të tjerë.

Ne posedojmë shumë argumente të transmetuara dhe logjike, mirëpo vendi nuk na lejon të zgjerohemi më tepër.

Jam i ndërgjegjshëm se kelamistët mohues kanë përhapur shumë dyshime, të cilat nuk mund ti përmendim në këtë fetva. Kush hulumton në këtë fetva dhe synon qartësimin e këtyre dyshimeve, atëhere le të bëjë krahasim vetë.

Nëse ideja e **tatilit** dhe **tavilit** e ka burimin te nxënësit e politeistëve, të sabinëve dhe të çifutëve, si atëhere i qetësohet shpirti besimtarit dhe të logjikshmit, në pasimin e rrugës së këtyre të humburve, me të cilët Allahu është zemëruar?! Si mund ta braktisë rrugën e atyre të cilëve Allahu u ka dhuruar mirësi, si profetët, të sinqertët, shehidët dhe njerëzit e mirë?!

Kapitull

Gjykimi përmbledhës për të gjitha këto çështje është se: Allahu ﷻ përshkruhet me çfarë e ka përshkruar veten, ai dhe i dërguari i tij ﷺ dhe e kanë përshkruar të parët e hershëm, pa u tejkualuar Kurani dhe as hadithi.

Imam Ahmed ka thënë: *"Allahu përshkruhet vetëm me atë që ka përshkruar veten e tij, ai dhe i dërguari i tij. Nuk tejkalohej as Kurani dhe as hadithi".*

Medhhebi i selefit është përshkrimi i Allahut ﷻ me atë që e ka përshkruar veten e tij dhe e ka përshkruar me të i dërguari ﷺ, pa **tahrif** (deformim) apo **tatil** dhe pa **tekjif** apo **temthil**.¹

Përshkrimet që Allahu ﷻ i ka bërë vetes së tij janë reale dhe jo gjëgjëza apo enigma. Kuptimi i këtyre përshkrimeve kuptohet ashtu siç kuptohet qëllimi i folësit nga fjala e tij, sidomos kur folësi është krijesa më e ditur rreth asaj që thotë, krijesa më oratore në sqarimin e dijes, krijesa më oratore në qartësi, në njohje, në paraqitjen e argumentit dhe në udhëzim.

E megjithatë asgjë nuk është njësoj si Allahu ﷻ, dhe as si vetja e tij e patëmeta e cila përmendet me emrat dhe cilësitë e tij. Ashtu siç jemi të bindur se Allahu ﷻ ka një qenie reale dhe veprime reale, po ashtu jemi të bindur se ai ka cilësi reale. Por asgjë nuk i ngjason atij as në qenie, as në cilësi dhe as në veprat e tij.

Ai është i pastër nga çdo gjë që nënkupton mangësi ose krijim, sepse Allahut ﷻ i takon përsosmëria absolute. Ekzistimi i tij pas mosekzistimit është i pamundur sepse vetë mosekzistenca e tij është e pamundur. Ekzistenca momentale që të quhet ekzistencë momentale duhet që ta ketë paraprirë atë mosekzistenca. Ekzistenca momentale e Allahut është e pamundur sepse Allahu ﷻ ekziston vetvetiu në formë të përherëshme,

¹ Këto terma qarkullojnë shpesh në terminologjinë e dijetarëve të hadithit, prandaj kanë nevojë për një sqarim më të gjërë.

Tahrifi në aspektin gjuhësor nënkupton deformimin dhe animin e diçkaje. Në terminologjinë akaidore kihet për qëllim tavili që kelamistët i bëjnë shumë prej cilësive, sepse në realitet komentimet gjuhësore që ata i kanë pretenduar, nuk janë më shumë sesa deformime kuptimore të tyre.

Tatili në aspektin gjuhësor është zbrazja e diçkaje. Në terminologjinë akaidore me fjalën tatil nënkuptohet mohimi i cilësisë, sepse mohuesi i cilësisë e zhvesh qënien e Allahut prej cilësisë që ai ka mohuar, apo e zhvesh fjalën që dëshmon për cilësinë prej përmbajtjes kuptimore të saj.

Tekjifi është dhënia formë e diçkaje. Këtu kihet për qëllim përshkrimi i formës së cilësive të Allahut me forma të njohura apo të panjohura.

Temthili është shembëllimi i cilësive të Allahut me cilësitë e krijesave. Këtu hyjnë të gjithë rrymat panteiste.

ndërsa ekzistenca momentale ka nevojë për një krijues.

Medhhebi i selefit është mes **tatilit** dhe **temthilit**. Nuk i ngjasojnë cilësitë e Allahut ﷻ me cilësitë e krijesave, ashtu siç nuk e ngjasojnë qënien e tij me qëniet e krijesave. Në anën tjetër nuk i mohojnë përshkrimet me të cilat e ka përshkruar veten e tij, apo e ka përshkruar atë i dërguari ﷺ. Nuk i mohojnë kuptimet e emrave të bukur dhe cilësive të larta. Nuk i deformojnë kuptimet e fjalëve nga konteksti i tyre dhe nuk deformojnë emrat e Allahut dhe ajetet e tij.

Si fraksioni i tatilit ashtu edhe fraksioni i **temthilit** kanë rënë në **tatil** dhe në **temthil** sëbashku.

Pasuesit e tatilit kanë kuptuar prej emrave dhe cilësive të Allahut ﷻ atë që i shkon përshtatet krijesës. Pastaj u përpoqën të mohonin këto kuptime. Kështu bashkuan mes **temthilit** dhe **tatilit**. Fillimisht bënë **temthil** (përngjasim) dhe pastaj **tatil** (mohuan kuptimet).

Përngjasimi që ata i bënë kuptimeve të emrave dhe cilësive të Allahut me kuptimet e emrave dhe cilësive të krijesave, nënkupton privimin e Allahut prej emrave dhe cilësive që i shkojnë për shtat atij.

Nëse dikush thotë: Nëse Allahu ﷻ do të ishte sipër Arshit, nga kjo rrjedh se ose do jetë ose më i madh se Arshi, ose më i vogël, ose i barabartë. Të tre këto mundësi janë të pamundura. Apo thotë fjalë të këtij lloji. Në realitet ky person, ka kuptuar prej hipjes së Allahut ﷻ mbi Arsh vetëm atë që kuptohet prej hipjes së çdo trupi mbi një trup tjetër. Ky konkluzion është rrjedhojë vetëm prej këtij konceptimi.

Ndërsa nëse flasim për një "istiva-hipje" që i shkon për shtat vetëm Allahut ﷻ dhe i takon vetëm atij, atëhere nuk rrjedhin këto rrjedhoja të kota të cilat duhen mohuar, ashtu siç rrjedhin te trupat e tjerë.

Pretendimi që ai ngre është njësoj si fjala e përngjasuesit: Nëse bota ka krijues atëhere ky krijues ose do të jetë substancë ose do të jetë veti¹, sepse logjika dëshmon që

¹ Ibn Tejmiye këtu përdor fjalën (Xheuher-جوهر) dhe fjalën (arad-عرض) janë dy terma që përdoren për dy nocione të njohura në mesin e kelamistëve. Kelamistët dhe filozofët islamë e konsiderojnë materien të formuar nga **xheuheri** që është ana e padukshme e materies ose substanca e saj dhe nga **aradi** që është vetia e materies.

P.sh. uji përbëhet nga subsatanca e tij dhe nga vetitë që ai ka. Vetitë janë si puna e lëngshmërisë, rrjedhshmërisë dhe transparencës. Ngjyra, lëvizja, temperatura dhe vetitë e ndryshme të lëndës, në terminologjinë e *ilmu-kelamit* quhen **arade**.

Këtu duhet të tërheqim vëmendjen e lexuesit se shumica e kelamistëve, sidomos esharitë, bëjnë dallim mes termave (dhat-qënie) dhe (sifat-cilësi) dhe mes termave si (xheuher-substancë) dhe (arad-veti). Allahu ﷻ përshkruhet me dy nocionet e para, por jo me dy nocionet e dyta sepse ata janë të veçantë për materien e krijuar dhe Allahu nuk është materie.

të gjitha gjërat ekzistuese janë të tilla. Apo si fjala e përngjasuesit: Nëse është i lartësuar mbi Arsh atëhere ky lartësim është njësoj si hipja e njeriut mbi fron apo mbi anije, sepse

Gjithashtu kelamistët përmendin një dallim mes nocionit të (sifeh-cilësi) i cili mund të jetë i përhershëm, sipas tyre, dhe mes nocionit (arad-veti) i cili është momental dhe nuk ekziston në dy kohë të ndryshme. Sipas shumicës së tyre një veti (arad) e lëndës nuk ekziston në dy momente, por ajo ripërtërihet moment pas momenti. Pra ngjyra, shija, lëvizja e lëndës dhe të tjera veti si këto, ripërtërihen moment pas momenti; sepse Allahu ﷻ në çdo moment e rikrijon të njëjtën veti në substancën ose në lëndën (xheuher-in) e saj. Vetia mund të duket e njëjtë në çdo moment si lloj mirëpo në realitet ajo është e ndryshme.

Le të marrim një top të kuq për ilustrim. Ngjyra e kuqe e topit ripërtërihet në çdo moment. Ngjyra e kuqe që ka qënë përpara këtij momenti është tjetër nga ngjyra e kuqe në momentit të tanishëm. Ashtu si ngjyra e kuqe në këtë moment është tjetër nga ngjyra e kuqe që do të vijë në momentin pasrendës. Ky është mendimi i shumicës së kelamistëve.

Ndërsa cilësitë, sipas tyre, janë të përhershme dhe nuk ripërtërihen. Prandaj Allahu ﷻ cilësohet me cilësi dhe jo me veti momentale që lidhen me çastin dhe momentin.

Nëse kuptohet kjo, do të kuptohet se ku e kanë marrë kelamistët mohimin e cilësive të varura nga dëshira, si puna e të folurit në një çast apo moment të caktuar. Ata kelamistë që e pohojnë cilësinë e të folurit, e pohojnë atë si një cilësi të amëshuar, të papërkufizuar në kohë, si në lloj ashtu edhe në veprime. Sepse veprimi i kësaj cilësie në një moment të caktuar nënkupton që ajo është një veti momentale dhe vetia momentale është karakteristike e substancave dhe substancat janë materie, kështu që rrjedh që Allahu ﷻ është materie dhe pohimi që Allahu është materia është kufër.

Ky është një nga dallimet kryesore mes selefizmit dhe esharizmit, sepse selefistët i pohojnë cilësitë të cilat si kategori janë të amësuara ndërsa si veprime janë momentale, të cilat Allahu i vepron kur dëshiron në një moment të caktuar, të renditura, pra të paraprirë nga veprime të tjera.

Vendi nuk na lejon t'u kundërpërgjigjemi njëpërnjë të gjitha mendimeve të kelamistëve në këtë pikë, sidomos kur dihet që ata kanë shumë mospajtime në detaje midis tyre.

Ajo ku desha të dal, është kuptimi i fjalës së Ibn Tejmijes në këtë fetva. Nëse kuptohet nocioni i **xheuherit** dhe **aradit** dhe dallimi mes tij dhe cilësisë dhe qënies sipas kelamistëve, atëhere edhe fjala e Ibn Tejmijes mund të kuptohet shumë lehtë.

Ai dëshiron t'u thotë kelamistëve: Ashtu siç ju fillimisht pretenduat se "istivaja" nënkupton një hipje të një trupi fizik mbi një trup fizik dhe pastaj e mohuat këtë pohim sepse ai është një pohim i pavërtetë, po kështu edhe përngjasuesit, mund t'ju thonë: Bota ka krijues dhe krijuesi është substancë dhe veti momentale sepse në botën reale gjërat ekzistojnë të tilla.

Në këtë rast përgjigja e esharive ndaj tyre, shkurtimisht, është se nuk është e thënë që krijuesi të jetë substancë dhe veti, por ai është qenie e amëshuar e cilësuar me cilësi të amësuara. Argument për këtë janë argumentet e njohura logjike, të cilat mund të cekën gjerësisht gjetkë. Ndërsa gabimi i përngjasuesve konsiston në faktin se ata gjeneralizuan gjykimin mes materies së dukëshme dhe krijuesit kështuqë premisa e tyre ishte e gabuar, atëhere edhe konkluzioni i ndërtuar mbi këtë premisë ishte i gabuar.

Ibn Tejmije dëshiron t'u thotë esharive: Edhe ne ju kundërpërgjigjemi ashtu siç ju kundërpërgjigjet përngjasuesve. Përderisa premisa (المقدمة) e juaj ishte e gabuar (teza që istivaja në aparencë nënkupton hipjen e trupit fizik mbi një trup fizik tjetër) atëhere edhe konkluzioni i juaj ishte i gabuar. Logjikë me logjikë dhe bërja dallim në raste të ngjashme dëshmon për divergjencë logjike.

Shtjellimi i çështjes mund të jetë më i gjatë, por po mjaftohemi me kaq në këtë libër të shkurtër i cili nuk na le vend për zgjatje të tepërta.

Shënim: Përkthimi i termave xheuher si substancë apo elementë dhe i aradi-it si veti momentale është më i saktë si nga ana gjuhësore ashtu edhe nga përmbajtja kuptimore se përkthimi i disa studiuesve si aksidentale etj. Për këtë term mund të përdoret edhe termi veti e rastit.

ne nuk e konceptojmë dot "istivanë" përveçse në këtë formë.

Të dy ata kanë përngjasuar dhe të dy ata kanë mohuar realitetin e përshkrimit që Allahu ﷻ i ka bërë vetes së tij. Por fraksioni i parë, dallon nga i dyti, në mohimin e çdo kuptimi real të "istivasë". Ndërsa fraksioni i dytë dallon nga i pari me pohimin e një istivaje e cila i përshtatet krijesave.

Fjala e prerë i takon umetit të mesëm, se Allahu ﷻ është i lartësuar mbi Arsh ashtu siç i takon vetëm atij, ashtu siç cilësohet se është i ditur për çdo gjë, i fuqishëm për çdo gjë, dëgjues dhe shikues, etj. Nuk lejohet që dija dhe fuqia të përshkruhen si veti të përngjashme me vetitë e krijesave, si dija dhe fuqia e krijesave. Po kështu është edhe hipja e Allahut ﷻ mbi Arsh. Nuk i atribuohen hipjes së tij veçoritë e hipjes së krijesës mbi një krijesë tjetër dhe rrjedhojat e saj.

Ji i sigurtë që logjika e shëndoshë dhe transmetimet e sakta, nuk bien në kundërshtim me rrugën e selefit. Nuk kemi mundësi t'u përgjigjemi të gjitha dyshimeve që bien ndesh me të vërtetën. Kushdo që në zemër ka ndonjë dyshim dhe me të vërtetë dëshiron ta largojë atë, atëhere kjo është e lehtë dhe e kollajshme.

Pasuesit e **tavilit** që kundërshtojnë Kuranin, sunetin dhe selefin e umetit në këtë çështje janë shumë të çoroditur. Ata që mohojnë të parët e Allahut ﷻ prej krijesave, pretendojnë se logjika gjykon për pamundësinë e saj, dhe ai nuk ka rrugëdalje tjetër përveç "tavilit". Edhe ai që pretendon se është pamundur që Allahu ﷻ të cilësohet me dije, me fuqi apo me të folur të pakrijuar thonë: Logjika gjykon për pamundësinë e kësaj, prandaj u detyrova të bëj "tavi". Madje edhe ai që mohon ringjalljen me trupa dhe ngrënien dhe pirjen reale në xhenet, pretendon se logjika gjykon për pamundësinë e saj, prandaj është detyruar të bëjë "tavi".¹

Po kështu edhe ai që mohon se Allahu ﷻ është sipër Arshit, pretendon se logjika gjykon për pamundësinë e kësaj, prandaj është detyruar të bëjë "tavi".

Për kotësinë e thënies së tyre mjafton të dihet se ata nuk kanë ndonjë kriter stabil rreth asaj që logjika e pamundëson. Përkundrazi, atë që dikush pretendon se logjika e lejon dhe e obligon, ai tjetri pretendon se logjika e refuzon.

Cila na qënka kjo logjikë që mund të barazohet me Kuranin dhe sunetin?! Allahu ﷻ qoftë i kënaqur me imam Maliku atëhere kur tha: ***"A çdo herë kur na vjen një person më shumë polemizues, kemi për ta lënë atë me të cilën Xhibrili i ka ardhur"***

¹ Esharitet nuk i mohojnë këto çështje, përkundrazi i pohojnë ato përgjithësisht. Ibn Tejmija dëshiron t'u thotë: Përse kelimistët ekstrem prej mutezilive dhe xhehmive, kur pretendojnë "tavin" bazuar në logjikë ju u kundërvihen duke u thënë se "tavi" i argumenteve kuranore në këto pika, nuk lejohet sepse argumentet kuranore në këtë pikë janë të qarta. Përse atëhere e impononi umetin të bëjë "tavi" ndaj argumenteve të cilat logjika juaj nuk i pranon. A nuk është ky një dystandartizim?!!

Muhamedit, për hatër të polemikës së tyre?!".¹

Secili prej tyre është i refuzuar me të njëjtën mënyrë siç është refuzuar tjetri, nga disa aspekte:

Së pari: Sqarimi se logjika nuk gjykon që kjo është e pamundur.

Së dyti: Sqarimi se transmetimeve të përcjellura nuk mund t'u bëhet **tavil**.

Së treti: Të gjitha këto çështje janë të njohura me dije të sigurtë se profeti ﷺ i ka predikuar ato, ashtu siç ka predikuar për pesë namazet dhe për agjërimin e ramazanit. Tavili i cili refuzon këto cilësi është i ngjashëm me tavilin e kurmutive² dhe të batinive³, i cili i deformon kuptimet e haxhit, namazit, agjërimit dhe obligimet e tjera që i ka predikuar profeti ﷺ.

Së katërti: Sqarimi se logjika e shëndoshë është në përputhje me tekset e transmetuara të shpalljes. Edhe pse mund të ndodhë që tekset e shpalljes të përmbajnë detaje të cilat logjika është e paaftë që ti kuptojë plotësisht, megjithëse mund ti konceptojë ato përgjithësisht.

E shumë e shumë aspekte të tjera. Vetë kolosët e mëdhenj prej kelamistëve, e pranojnë se logjika është e paaftë të arrijë bindje të plotë në temat e ilahijateve. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë duhet që njohja e këtyre çështjeve të merret prej nubuvateve⁴

¹ **Ether sahih.** E transmeton Hatib Bagdadiu në "Sherefu as'habil hadith" me një tekst të përafërt. Lalekai në "Sherh usulil itikad" 1/144, nr 293, 294, nga Maliku. Hereviu në "Dhemmul kelam", Merveziu në "tadhimu kadril salah" (2/670), Ebu Nuejmi në "Hiljetul eulija" (6/324), Bejhakui në "El med'hel iles sunenil kubra", Ibn Abdulberri në "Xhamiul ilm" nr: 238, etj. Të gjitha këto transmetime nga rruga e Is'hak ibn Isa Tibaut. Shejh Albani në "Muhtesarul ulu" thotë: "Senedi i tij është sahih".

² Kurmutitë janë një sekt i humbur të cilët u shfaqën në fundit e shekullit të tretë. I pari i tyre Hamdan Kurmuti ishte një heretik i ndikuar nga rrymat filozofike materialiste dhe nuk besonte në shpalljen hyjnore si profetësi. Ai mohoi dhe i ndaloi njerëzit prej adhurimeve dhe ndalesave fetare, përveç asaj që atij i vinte për shtat. Shteti i tyre shtrihej në lindje të gadishullit arabik, konkretisht në Bahrejn dhe në rrethinat e tij. Krimet e tyre kundër muslimanëve dhe haxhive në Qabe janë të njohura, ashtu si edhe rrëmbimi i gurit të zi prej Qabes.

³ Batinitë janë ato sekte të cilat nuk i përmbahen argumentave të sheriatit në lidhje me adhurimet dhe ndalesat fetare. Batini mund të jetë kushdo që i keqinterpretonte disa adhurime dhe ndalesa fetare të njohura në fe, me interpretime të largëta. Batinitë janë në grada të ndryshme në lidhje me këto deformime kuptimore të fesë. Një pjesë e tyre arrin deri aty sa mohen edhe ringjalljen dhe xhenetin me zjarrin duke pretenduar se ato janë thjesht shprehje simbolike dhe jo reale.

Nga sektet batinije në Shqipëri mund të përmenden bektashitë, ose për të qënë më të drejtë aty ku është katandisur ky tarikat në kohën tonë. Sepse fillimet e tij kanë qënë si një tarikat suni dhe muxhahid, ndërsa përfundimi i tij si një sekt ekstrem batini.

⁴ Me termin "ilahijat" kelamistët kanë për qëllim çështjet e akides që lidhen me Allahun dhe mund të shqyrtohen me logjikë. Ndërsa me termin "nubuvat" kanë për qëllim ato çështje të akides të cilat logjika as nuk i mohen dhe as nuk i pohon dhe si të tilla mund të njihen vetëm prej fjalëve profetike. Si puna e haudit të profetit, peshores në ditën e gjykimit, etj.

teksualisht.

Të gjithë besimtarët janë të bindur se Allahu ﷻ e ka dërguar Muhamedin ﷺ me udhëzimin dhe me fenë e vërtetë që ta bëjë atë dominuese mbi çdo fe; dhe Allahu ﷻ është më i miri dëshmuar. Ata janë të bindur se profeti ﷺ i ka sqaruar njerëzit për çështjet e besimit të Allahut dhe botës tjetër, të cilat ua ka përcjellur. Besimi i Allahut dhe i botës tjetër përfshin edhe besimin për krijimin fillestar dhe për ringjalljen. Ai është besimi i krijesit dhe i ringjalljes, ashtu siç i ka përmendur Allahu ﷻ sëbashku: **﴿Disa prej njerëzve thonë se ne kemi besuar Allahun dhe botën tjetër, por ata nuk janë besimtarë﴾** El bekare, 8.

Dhe thotë: **﴿Krijimi dhe ringjallja juaj është njësoj si për një person të vetëm﴾** Lukman, 28.

Dhe thotë: **﴿Ai është i cili e fillon krijimin dhe pastaj e ripërsërit atë. Ai është shumë më i lehtë për të﴾** Er rum, 27.

Allahu ﷻ i ka shtjelluar me gojën e profetit ﷺ çështjet e imanit dhe të botës tjetër, duke i udhëzuar robtë e tij dhe duke u qartësuar atyre qëllimin e tij.

Besimtarët janë të bindur se i dërguari i Allahut ﷻ është më i ditur se çdokush tjetër për këto çështje. Ai është më i sigurtë se kushdo tjetër me umetin. Ai është më i aftë se kushdo tjetër për sqarimin me oratori. Madje ai është më i dituri prej krijesave rreth kësaj dhe më i sigurti me umetin dhe më oratori.

Te ai është mbledhur përsosmëria e dijes, e aftësisë dhe e qëllimit të mirë. Dihet se nëse te folësi dhe vepruesi bashkohen së bashku përsosmëria e dijes, e aftësisë dhe e dëshirës, atëhere edhe fjalët dhe veprat e tij do të jenë të përsosura.

Mangësia ndodh atëhere kur ka mangësi në dije, ose për shkak të paaftësisë për sqarimin e dijes, ose për shkak të mospasjes dëshirë për sqarimin e saj. Profeti ﷺ është absoluti në përsosurinë e dijes, absoluti në qëllimin e përcjelljes së qartë, absoluti në aftësinë e sqarimit të qartë.

Nëse ekziston aftësia e plotë dhe vullneti i fortë atëhere edhe ajo që kihet për qëllim medoemos duhet të realizohet.

Kështu arrijmë në konkluzion se sqarimi që profeti ﷺ u ka bërë çështjeve të imanit dhe botës tjetër, ka arritur përsosmërinë e qartësisë. Ajo që ka dashur të sqarojë përputhet me dijen e tij dhe dija e tij është më e përsosura dije. Kushdo që ka iluzione se dikush tjetër është më i ditur se profeti ﷺ, apo më i qartë në shprehje se ai, apo më i përkushtuar për udhëzimin e krijesave se ai, atëhere ai është qafir dhe nuk mund të

Ibn Tejmije dëshiron t'u thotë atyre: Nëse logjika sipas jush nuk arrin në konkluzione precize dhe të pamohueshme në çështjet e cilësive, atëhere këto çështje duhet të hyjnë te temat e nubuvateve, pra te çështjet që njihen vetëm nëpërmjet kumtesës profetike.

konsiderohet si besimtar.

Sahabët, pasuesit e tyre (tabinët) me mirësi dhe ata që kanë ndjekur rrugën e tyre në këtë çështje, ata janë në rrugë të drejtë. Ndërsa të devijuarit prej rrugës së tyre janë tre rryma; pasuesit e iluzionit, pasuesit e tavilit dhe pasuesit e injorimit.

Pasuesit e iluzionit janë filozofët dhe ata që kanë ndjekur rrugën e tyre prej kelamistëve, sufistave dhe fukahave. Ata thonë: Ajo që Allahu ﷻ ka përmendur për çështjet e imanit rreth Allahut ﷻ dhe botës tjetër është vetëm një iluzion, që masat e gjëra të kenë dobi. Ai nuk po sqaron realitetin dhe as po udhëzon krijesat dhe as nuk ka për qëllim të qartësojë realitetin. Këta njerëz ndahen në dy pjesë.

Një pjesë thonë: I dërguari ﷺ nuk e ka ditur realitetin ashtu siç duhet dhe pretendojnë se disa filozofë teologë e kanë arritur realitetin. Apo disa të vetëshpallur evlija e kanë ditur realitetin. Ata pretendojnë se disa filozofë dhe evlija janë më të ditur rreth Allahut ﷻ dhe botës tjetër se profetët. Ky është mendimi i pabesimtarëve ekstrem prej filozofëve, batinive, si batinitë e shiave ashtu edhe batinitë e sufistave.

Ndërsa një pjesë tjetër thonë: I dërguari ﷺ e ka ditur realitetin, por nuk e ka sqaruar, madje është prononcuar me të kundërtën, sepse dobia e krijesave arrihet me këto besime që nuk përputhen me realitetin. Thonë: I dërguari ﷺ e ka për detyrë t'i thërrasë njerëzit në besimin e trupëzimit, edhe pse është i pavërtetë. E ka për detyrë t'i thërrasë njerëzit në besimin e ringjalljes së trupave edhe pse është i pavërtetë. Duhet t'i njoftojë ata se banorët e xhenetit hanë dhe pinë, megjithëse kjo nuk është e vërtetë. Thonë: Thirrja e krijesave (në islam) është e pamundur me një tjetër mënyrë. Kjo mënyrë me të vërtetë përmban gënjeshtëri, por ajo gënjeshtëri është për hir të dobisë së njerëzve. Ky është mendimi i tyre në lidhje me besimin e Allahut ﷻ dhe të botës tjetër.

Ndërsa veprat¹ disa prej tyre i pranojnë, ndërsa disa të tjerë sillen me to në të njëjtën mënyrë dhe pretendojnë se me to urdhërohen një grup njerëzish dhe jo e gjithë njerëzia. Me to ngarkohen masat e gjëra por jo personat specifikë. Kjo është metoda e batinive pabesimtarë si puna e ismailive² dhe lloji i tyre.

¹ Ka për qëllim me veprat adhurimet, ndalesat dhe urdhëresat me të cilat ka ardhur sheriati.

² Ismailitë janë sekt ekstrem shit. Ata janë ndarë nga shiat musevi (si shiat ithnaasherie në Iran) atëhere kur imami i tyre i gjashtë Xhafer Sadiku vdiq dhe Ismaili i cili ishte djali i Xhafer Sadikut kishte vdekur përpara të jatit. Mirëpo djali i Ismailit, Muhamedi, ishte i gjallë. Ismailitët pretenduan se imameti duhej t'i kalonte pikërisht Muhamed ibn Ismailit sepse rregulli i pranuar në mesin e tyre e detyronte kalimin e imametit të fëmija më i madh. Ndërsa musavitë pretenduan se imameti i takonte djalit më të vogël të Xhafer Sadikut, që ishte Musa Qazimi.

Ismailitët patën ngritur shumë shtete në histori. Shteti më i famshëm i tyre ishte Shteti Ubejdi në Tunizi dhe pastaj në Egjipt, ose siç njihet ndryshe edhe si Shteti Fatimi. Besimet e tyre në lidhje me çështjet e akides dhe detyrimeve shariatike ishin ekstreme, pa folur që imami, sipas tyre, ishte një ligjvënës në tokë i cili gjykonte me inspirim nga Allahu, prandaj çdo verdikt që ai jepte ishte i pagabueshëm dhe me natyrë hyjnore. Ata besonin se sheriati Muhamedian është si puna e lëvozhgës ndërsa njohuritë e tyre si puna e

Pasuesit e tavilit, thonë: Profeti ﷺ, me frazat e përcjelluara rreth cilësive, nuk ka pasur qëllim që njerëzit të besojnë diçka të kotë. Ai ka pasur për qëllim disa kuptime, por nuk ua ka shfaqur atyre këto kuptime dhe as nuk i ka orinetuar për to. Ai ka dashur që ata vetë të hulumtojnë, për ta njohur të vërtetën me logjikën e tyre dhe pastaj të mundohen t'u japin tjetër kuptim domethëniesve të tyre.

Qëllimi i profetit ﷺ prej kësaj është: Sprovimi, ngarkimi, mundimi i mendjeve dhe i logjikave të tyre për tjetërsimin e domethëniesve të fjalëve, që ta njohin të vërtetën pasi të lodhen. Ky është mendimi i kelamisëtvë, i xhehmive, i mutezilive dhe i atyre që janë ndikuar prej tyre.

Ata të cilëve kemi dëshiruar t'u kundërpërgjigjemi në këtë fetva janë pikërisht këta persona. Kjo për shkak se distancimi i njerëzve prej llojit të parë është i mirënjohur. Ndërsa këta persona shfaqen si mbrojtës të sunetit në shumë çështje. Mirëpo realiteti dëshmon se as për islamin nuk triumfuan dhe as filozofët nuk i dërrmuan.

Filozofët i vunë me shpatulla për muri në tekset e ringjalljes, me të njëjtat pretendime që kelamistët i ngritën për tekset e cilësive. Kelamistët u thanë filozofëve: Ne e dimë me siguri të plotë se i dërguari ﷺ ka predikuar ringjalljen e trupave. Gjithashtu jemi të bindur për pasaktësinë e dyshimeve që mohojnë ringjalljen me trup.

Ehli-suneti iu përgjigjen kelamistëve: Edhe ne e dimë me bindje të plotë se i dërguari ﷺ ka predikuar pohimin e cilësive. Tekset që flasin për cilësitë në librat hyjnore janë më të shumta dhe më të mëdha se tekset rreth ringjalljes.

Ehli-suneti u thanë atyre: Dihet mirë që mushrikët arabë dhe mushrikët e tjerë e mohonin ringjalljen. Atë e patën mohuar edhe para të dërguarit ﷺ, madje debatuan me profetin ﷺ për mohimin e saj. Kjo në dallim me cilësitë. Arabët nuk i mohonin ato. Nga kjo mësohet se pohimi i logjikës për cilësitë është më i fortë sesa pohimi i saj për ringjalljen dhe se dyshimi i mohimit të ringjalljes është më i fortë se dyshimi i mohimit të cilësive. Si mund të pretendohet atëhere se tekset e cilësive nuk duhet të kuptohen ashtu siç janë, ndërsa tekset e ringjalljes duhet të kuptohen ashtu siç kanë ardhur?!

Është e mirënjohur se i dërguari ﷺ i ka nënçmuar *ehli-kitabët* për shkak të deformimeve dhe transformimeve. Dihet gjithashtu se Teurati është i mbushur me përmendjen e cilësive. Nëse kjo do të ishte prej asaj që është transformuar dhe deformuar, do ishte më parësore që të demaskohej. Ndërkohë profeti ﷺ kur i

bërthamës së frutit. Sot ismailitë gjenden në Arabinë Saudite, në krahinën e Xhizanit, në Sham ku sekti më i njohur prej tyre janë druzët, në Indi dhe në Taxhakistan dhe krahinat rreth tij. Numri i tyre nuk është shumë i madh si dikur.

përmendnin para tij cilësitë, qeshte prej çudisë dhe aprovimit.¹

Ai nuk i qortoi aspak ata me qortimet që mohuesit e cilësive u drejtohen pohuesve. As me trupëzim dhe as me përngjasim apo me diç të ngjashme. Përkundrazi i kritikoi për fjalën e tyre: **«dora e Allahut është e shtrënguar»** El maide, 181. I kritikoi për fjalën e tyre: **«Allahu është i varfër ndërsa ne jemi të pasur»** Ali Imran, 181. I kritikoi për pretendimin se zoti u çlodh pas krijimit të qiejve dhe të tokës, dhe u përgjigj: **«Ne i krijuam qiejt dhe tokën dhe çdo gjë mes tyre në gjashtë ditë dhe nuk na kaploi asnjë lodhje»** Kaf, 38.

Teurati është plot me cilësi që përputhen me cilësitë e përmendura në Kuran dhe hadith. Megjithëse ai nuk përmban tekste të qarta për ringjalljen ashtu siç gjenden në Kuran. Nëse lejohet t'u bëhet **tavil** cilësive për të cilat janë pajtuar të dy librat, atëhere tavili i ringjalljes i përmendur vetëm në njërin prej tyre është më parësor. Nëse pasaktësia e kësaj të dytës, njihet me siguri të plotë në fenë e profetit ﷺ, atëhere pasaktësia e të parës është akoma më parësore.

Grupi i tretë janë pasuesit e injorimit. Ata janë të shumtë në mesin e fukahave dhe të pretenduesve të sunetit dhe pasuesve të selefit. Ata thonë: Profeti ﷺ nuk i ka ditur domethëniet e ajeteve të cilësive që Allahu ﷻ i ka zbritur. As Xhibrili ﷺ dhe as të parët e hershëm nuk i kanë ditur domethëniet e tyre.

Të njëjtën gjë e thonë edhe për hadithet e cilësive, se kuptimin e tyre e di vetëm Allahu ﷻ, megjithëse profeti ﷺ është i pari që i ka thënë ato. Sipas fjalës së tyre i bie që profeti ﷺ të ketë folur me fjalë të cilat nuk i kupton.

Ata kujtojnë se po ndjekin fjalën e Allahut ﷻ: **«interpretimin (tavilin) e tyre e di vetëm Allahu»** Ali Imran, 7. Shumica e selefit kanë ndaluar të fjala e Allahut: **«interpretimin (tavilin) e tyre e di vetëm Allahu»**.

Por këta njerëz nuk ditën të bëjnë dallim mes “domethënies” dhe “komentimit” të fjalës, dhe mes “tavilit” të cilin e di vetëm Allahu. Ata kujtuan se tavili i përmendur në fjalën e Allahut është njësoj si tavili i përmendur në terminologjinë e të mëvonëshmeve. Prandaj gabuan në këtë pikë sepse **tavili** vjen me tre kuptime:

Kuptimi i parë: Tavili si term i përdorur gjerësisht te brezat e mëvonshëm është: **Mosmarria parasysh e kuptimit parësor të fjalës por të atij dytësor, bazuar**

¹ Ka për qëllim hadithin se një rabin çifut vajti te profeti ﷺ dhe i tha: *“O Muhamed! Ne lexojmë se Allahu ﷻ do i vendosë qiejtë në një gisht dhe tokat në një gisht dhe pemët në një gisht dhe ujin me tokën në një gisht dhe pjesën tjetër të krijesave në një gisht. Pastaj thotë: Unë jam sunduesi. Atëhere profeti qeshi derisa iu dalluan dhëmballët si aprovim për fjalët e rabinut. Pastaj i dërguari i Allahut lexoi: «Nuk e vlerësuan Allahun ashtu siç e meriton. E gjithë toka do jetë në mbërthimin e tij në ditën e ringjalljes ndërsa qiejt do të jenë të palosur në të djathtën e tij. I pastër dhe i lartë është ai prej asaj që po i bëjnë shok»”*. E transmetojnë Buhariu (4811, 7414, 7415, 7451, 7513) dhe Muslimi (50/19, 21, 22), në dy sahihet e tyre me rrugë transmetimi të ndryshme.

në një dëshmi shoqëruese të fjalës.

Sipas këtij termi, kuptimi parësor i fjalës nuk konsiderohet tavil. Ata kujtuan se Allahu ﷻ ka pasur për qëllim me tavilin, pikërisht këtë nocion terminologjik dhe se ajetet kuranore kanë tavile që kundërshtojnë domethënien kuptimore të tyre, dhe këtë tavil e di vetëm Allahu ﷻ dhe askush tjetër.

Shumica e tyre thonë: Këto shprehje trajtohen në kuptimin parësor sepse pamja e tyre e jashtëme është e synuar. Mirëpo ata thonë: Këto shprehje kanë tavile të cilat i di vetëm Allahu. Në këtë kontradiktë kanë rënë shumë prej atyre që i atribuohen sunetit prej pasuesve të katër imamëve dhe të tjerëve.

Kuptimi i dytë: Tavili është komentimi i fjalës, përputhet apo nuk përputhet me kuptimin parësor. Ky kuptim i tavilit haset shpesh në përdorimin e dijetarëve të tefsirit dhe të dijetarëve të tjerë. Këtë tavil e njohin dijetarët e fortë në dije. Ky kuptim përputhet me ndalesën në **﴿interpretimin (tavilin) e tyre e di vetëm Allahu dhe të palëkundurit në dije﴾**. Këtu kanë ndaluar shumë selefë¹. Kjo transmetohet prej Ibn Abasit, Muxhahidit, Muhamed ibn Xhafer ibn Zubejrit, Muhamed ibn Is'hakut, Ibn Kutejbës dhe prej shumë të tjerëve.

Të dyja mendimet janë të sakta, nëse secili shikohet nga një këndvështrim i ndryshëm. Këtë e kemi shpjeguar me hollësi në libra të tjerë. Madje prej Ibn Abasit ﷺ janë transmetuar të dyja mendimet sepse të dyja ato janë të vërteta.

Kuptimi i tretë: Tavili është realizimi i realitetit të cili përfundon fjala edhe nëse përputhet me kuptimin parësor. Tavili i ajeteve kuranore të cilat flasin rreth ushqimeve, pijeve, veshjeve, mardhënieve në xhenet dhe ndodhjen e kjetimit etj, tavili i tyre është realizimi i vetë këtyre gjërave reale dhe jo përfytyrimi i tyre në mendje dhe as shprehja e tyre me gojë. Ky është kuptimi i "tavilit" i përdorur në Kuran, si p.sh. në fjalën e Allahut ﷻ rreth Jusufit ﷺ: **﴿O babai im! Ky është tavili (realizimi) i ëndrrës time të mëparëshme. Zoti im e bëri atë të vërtetë﴾** Jusuf, 100.

Dhe thotë: **﴿A mos po presin vetëm përmbushjen (tavilin) e tij? Atë ditë kur të ndodhë përmbushja (tavili) e tij, ata që dikur e patën harruar atë do të thonë: Patën ardhur të dërguarit e zotit tonë me të vërtetën﴾** El araf, 53.

Dhe thotë: **﴿Nëse kundërshtoheni për diçka atëhere kthejeni atë te Allahu dhe te i dërguari nëse besoni Allahun dhe botën tjetër. Ky përfundim (tavil) është më i mirë dhe më i bukur﴾** En nisa, 59.

Këtë lloj tavili askush përveç Allahut ﷻ nuk e di. Tavili i cilësive është realiteti i tyre në botën reale (në njëmendësi), të cilin askush përveç Allahut ﷻ nuk mund ta dijë.

¹ Ka për qëllim ndalimin gjatë recitimit të Kuranit. Pra recituesi ndalon te kjo fjalë dhe pastaj vazhdon leximin e pjesës së mbetur të ajetit pa e lidhur me të parën.

Ai është si-ja e paditur për të cilën selefi, si puna e Malikut dhe të tjerëve, kanë thënë: **"Istivaja është e ditur ndërsa si-ja e panjohur"**. Istivaja është e ditur sepse kuptimi dhe tefsiri i saj janë të ditura dhe mund të përkthehen në gjuhë të tjera.¹ Ndërsa forma e istivasë është pikërisht tavili të cilin askush përveç Allahut nuk e di.

Transmetohet nga Ibn Abasi ﷺ, siç e përmend Abdurrezaku dhe të tjerë në tefsiret e tyre, se ai ka thënë: **"Komentimi i Kuranit është në katër forma. Një komentim arabët e kuptojnë nga gjuha e tyre. Për një komentim tjetër askujt nuk i pranohet justifikimi me padije. Një komentim e dinë dijetarët. Ndërsa një komentim e**

¹ Prej çudive më të mëdha që kam hasur me esharitë dhe maturiditë shqiptarë, është se ata pretendojnë **tefvidin** dhe në të njëjtën kohë i përkthejnë tekset që flasin për cilësitë që i mohojnë, me fjalën analoge të tyre në shqip.

Nga njëra anë pretendojnë që tefvidi nënkupton që tekset kuranore të disa cilësive, si dora, syri etj, nuk dëshmojnë për kuptimin aparent të tyre porse kanë një përmbajtje kuptimore tjetër, të cilën ne nuk e dimë dhe se këto fjalë janë "teukifije", pra të shpallura nga Allahu si fjalë, por pa kuptimet përkatëse.

Nga ana tjetër i përkthejnë këto tekste në shqip si "dorë", "sy", etj, duke u dhënë atyre kuptime. Çdo i njeri me arsye të shëndoshë e di që përkthimi nga një gjuhë në një gjuhë tjetër është përkthim kuptimor. Nëse humbet elementi kuptimor nuk ka kuptim përkthimi. Prandaj gërmat e shkëputura në fillim të disa sureve, nuk përkthehem, por transkriptohen ashtu siç janë, si psh: Elif, lam, mim. Ta ha, etj. Sepse ato nuk kanë përmbajtje kuptimore gjuhësore të njohur, kështu që nuk mund të përkthehen. Prandaj vetëm transkriptohen.

Nëse esharitë shqipëtarë do i përmbaheshin "tefvidit" duhet që fjalët e cilësive që i mohojnë, të mos i përkthejnë, por ti transkriptojnë, sepse në të kundërt ata e kanë hedhur poshtë medhhebin e tyre.

Nga ana tjetër, disa eshari dhe maturidi shqipëtarë anojnë nga medhhebi i **tavilit**, ndërkohë që edhe këta i përkthejnë tekset e cilësive që u bëjnë tavil në gjuhën shqipe, jo me kuptimet e largëta dytësore, por me kuptimet parësore. Psh, fjalën "jed" e përkthejnë dorë dhe fjalën "ajn" sy, dhe fjalën "istiva" lartësim.

Ndërkohë që çdo i logjikshëm, e di që përkthimi duhet të bazohet në kuptimin që kihet për qëllim nga folësi, qoftë ai edhe kuptim i largët. Që të sqarohet kjo çështje po japim një shëmbull të thjeshtë: Folja arabe "teueffa" në gjuhën arabe nënkupton vdekjen dhe marrjen e shpirtit. Ky është kuptimi primar dhe aparent i kësaj fjale. Si në ajetin: **(Ata të cilët melekët ua marrin shpirtat si zullumqarë)** En nahl 28. Në ajet është përdorur folja "teueffa".

Por kjo folje është përdorur me kuptim dytësor që ka nevojë për tavil në ajetin e sures Ali Imran: **(Kur Allahu tha: O Isa i biri i Merjemes! Unë do t'i marrë ndjenjat ty dhe do të të ngjis tek unë)**. Nëse do e përkthenim ajetin "Unë do ta marrë shpirtin" atëherë i bie që Isai ka vdekur dhe nuk do të zbresë rishtazi në këtë dynja. Por atëherë kur kuptimi parësor (sipas termave dhe kushteve të vetë kelamisteve) nuk ishte për qëllim, bazuar në argumenta të tjerë, atëherë duhet që ajeti patjetër të përkthehet me kuptimin dytësorë (tavilin), sepse përkthimi varet drejtpërdrejt me kuptimin.

Prandaj esharitë shqiptarë që pasojnë **tefvidin**, ajetin që selefistët e përkthejnë: **﴿Çfarë të pengoi t'i bëje sexhde atij që e krijova me dy duart e mia﴾**, duhet ta përkthejnë: (Çfarë të pengoi t'i bëje sexhde atij që e krijova me dy jedet e mia) dhe të thonë nuk e dimë çfarë ka për qëllim me fjalën jed. Ndërsa esharitë shqiptarë që pasojnë "tavilin" duhet ta përkthejnë: (Çfarë të pengoi t'i bëje sexhde atij që e krijova me fuqinë time). Përndryshe ata kanë hedhur poshtë dhe kanë anashkaluar edhe vetë medhhebin e tyre, të cilin një shumicë e tyre, dhe jo të gjithë, nuk e njohin dhe nuk ja kanë haberin, por thjesht imitojnë pa u thelluar. Dhe falenderimi i takon Allahut zotit të botrave.

di vetëm Allahu, e kush e pretendon njohjen e tij ai është gjënjeshitar".¹

Apo siç thotë Allahu ﷻ: **﴿Askush nuk e di se çfarë është fshehur (rezervuar) për ta prej kënaqësive të syrit, si shpërblim për atë që punonin﴾** Es sexhde, 17.

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *"Allahu thotë: Kam përgatitur për robtë e mi të devotëshëm atë që as syri s'ka parë, as veshi s'ka dëgjuar dhe as që i ka shkuar ndokujt në mendje".²*

Këtu hyn edhe dija e momentit të kiametit apo dijet e ngjashme më të. Ato janë prej tavilit të cilin vetëm Allahu ﷻ e di. Megjithëse ne i kuptojmë domethëniet e asaj me të cilën jemi ligjëruar dhe kuptojmë prej ligjëratës aq sa është kërkuar prej nesh të kuptojmë, siç thotë Allahu ﷻ: **﴿Përse nuk e meditojnë Kuranin, apo zemrat kanë drye?﴾** Muhamed 24. Dhe thotë: **﴿A nuk e meditojnë fjalën﴾** El muminun, 67. Allahu ﷻ na ka urdhëruar të meditojmë të gjithë Kuranin dhe jo vetëm një pjesë të tij.

Abdurrahman Silmiu thotë: *"Na kanë treguar ata që na mësonin leximin e Kuranit si Uthman ibn Afani, Abdullah ibn Mesudi dhe të tjerë se ata kur i mësonin prej profetit ﷺ dhjetë ajete, nuk kalonin te të tjerat derisa të mësonin çfarë përmbanin si dije dhe vepra. Thonin: Kështu e mësuam të gjithë Kuranin dhe të gjithë dijen dhe punën".³*

Muxhahidi ka thënë: *"Ia kam lexuar të gjithë Kuranin Ibn Abasit nga fillimi e gjer në fund. Qëndroja te çdo ajet për ta pyetur rreth tij".⁴*

¹ **Ether hasen.** Etherin e Ibn Abasit ؓ e transmeton Taberiu në tefsirin e tij (1/76), nga transmetimi i Sufjan Theuriut nga Ibn Zinadi nga Ibn Abasi ؓ. Taberiu përmend edhe një transmetim të Kelbiut të atriubuar profetit ﷺ, për të cilin imam Taberiu thotë: Ky sened ka nevojë për rishikim. Sepse Kelbiu është gjënjeshitar. Më e saktë është që ky ether është prej fjalës së Ibn Abasit ؓ dhe nuk është hadith profetik.

Atë e përmend edhe Ibn Rezaku në tefsirin e tij por pa përmendur zinxhirin e transmetuesve nga Sufjan Theuriu te Ibn Abasi. Në transmetimin e Taberiu gjendet Muemel ibn Ismail Kureshiu. Ibn Haxheri ka thënë për të: "Saduk por gabon. Shumë dijetarë e kanë kritikuar për memorien e tij".

² **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu (3244, 4779) dhe Muslimi (51/2).

³ **Ether hasen.** E transmeton imam Ahmedi në musnedin e tij 23482. Ibn Ebi Shejbe në musanafin e tij me të njëjtin sened si të Ahmedit, 29929. E transmeton edhe Ibn Sadi në "Et tabakat" (6/172) nga transmetimi i Hamad ibn Zejdi, Taberiu në tefsirin e tij (1/36) nga transmetimi i Xherir ibn Abdulhamidit, Tahaviu në "Sherh meshakilil athar" (1451) nga transmetimi i Sufjanit. Darakutni në "El ilel" prej Jahja ibn Kethirit, Bejhakui në sunenin e tij dhe Hakimi në mustedrekun e tij nga transmetimi i Shurejikut. Të gjithë këta nga Ata ibn Saib nga Ebu Abdurrahman Silmiu.

Hakimi thotë: "Hadith i saktë sipas kushteve të tyre por ata nuk e kanë nxjerrur". Me të është pajtuar edhe Dhehebiu. Shuajb Arnauti në korigjimin e musnedit të Ahmedit thotë: "Senedi i tij është hasen për shkak të Atasë". Ataut në fund të jetës i është përzier hadithi.

⁴ **Ether sahih.** E transmeton Ibn Ebi Shejbe në "El musanef" 30287, thotë: Na ka treguar Fadl ibn Dukejni, nga Shibli (ibn Imad Mekiu), nga (Abdullah) Ibn Ebi Nexhihu, nga Muxhahidi thotë: *"Ia lexova Mus'hafin Ibn Abasit nga fillimi e gjer në fund tre herë, qëndroja te çdo ajet"*. Ky sened është sahih. Transmetuesit e tij janë të gjithë transmetues të Buhariut. Ibn Ebi Nexhihu nganjëherë edhe mund të bëjë tedlis.

Shabiu ka thënë: ***"Sa herë që dikush shpik një bidat, sqarimi i tij gjëndet në librin e Allahut"***.¹

Mesruku ka thënë: ***"Dija e çdo gjëje për të cilën sahabët e Muhamedit janë pyetur ka qënë në Kuran, mirëpo dija jonë nuk e ka arritur"***.²

Kjo është temë e gjërë, e cila është shpjeguar me hollësi në vende të tjerë. Këtu synojmë vetëm sqarimin e bazave të mendimeve të gabuara, të cilat kanë përfunduar në devijim, në çështjet e njohurive dhe të besimit me të cilat është dërguar i dërguari ﷺ. Ai që e konsideron profetin ﷺ dhe Xhibrilin ﷺ si të paditur për domethëniet e Kuranit që i është zbritur, ai nuk e ka konsideruar Kuranin udhëzues dhe sqarues për njerëzit.

Pastaj ata i mohojnë metodat logjike në këtë çështje tërësisht. Ata nuk i atributojnë të dërguarit ﷺ dhe umetit të tij, as njohuri logjike dhe as njohuri

E transmeton Taberaniu në "El kebir" 11097, thotë: "Na ka treguar Ebu Jezid Karatisi, na ka treguar Esed ibn Musa, nga ka treguar Abdurrahman ibn Muhamed Muharibiu, nga Muhamed ibn Is'haku, nga Eban ibn Salih, nga Muxhahidi, thotë: ***"Ja kam lexuar Mus'hafin ibn Abasit nga fillimi e deri në fund. E ndaloja të çdo ajet dhe e pyesja për të ..."***

E transmeton edhe Taberiu (108) në tefsirin e tij, nga Ebu Kurejbi, na ka treguar Muharibiu dhe Junus ibn Bekiri, na ka treguar Muhamed ibn Is'haku, nga Eban ibn Salih, nga Muxhahidi.

Këto dy transmetime janë hasen, sepse Muhamed ibn Is'haku është saduk por mudelis, dhe këtu ka transmetuar me fjalën "nga". Transmetimi nga Muhamed ibn Is'haku nuk mund të ngjitet më shumë se në gradën e hasenit, duke pasur parasysh që nuk është hadith profetik dhe prandaj nuk e shtrëngojmë shumë të çështja e tedlisit. Muhamed ibn Ibrahim është autori i librit të sires së njohur, të cilin e ka përmbledhur Ibn Hishami dhe është quajtur "Sirja e Ibn Hishamit".

Ky ether ka edhe një dëshmi kuptimore që e transmeton Taberiu (107) në tefsirin e tij thotë: Na ka treguar Ebu Kurejbi (Muhamed ibn Alau), nga ka treguar Talk ibn Ganami, nga Uthman (ibn Esved) Mekiu, nga Ibn Ebi Mulejka (Abdullah ibn Ubejdilah), thotë: ***"E kam parë Muxhahidin të pyeste Ibn Abasin për tefsirin e Kuranit dhe në dorë mbante dërrasa. Ibn Abasi i thoshte: Shkruaj. Thotë: Derisa sa e pyeti për të gjithë tefsirin"***. Të gjithë ransmetuesit e tij janë transmetues të Buhariut dhe të besueshëm, por senedi mes Talkut dhe Uthmanit është i shkëputur sepse ai nuk e ka arritur Uthmanin.

¹ **Ether sahih.** E transmeton Halali në "Es sunneh" (914), thotë: Hambeli thotë: Na ka treguar Sulejman ibn Harbi, na ka treguar Hamad ibn Zejdi, nga Daud (ibn Ebi Hindi), nga Shabiu, thotë: ***"Sa herë që në islam shpiket ndonjë bidat, në librin e Allahut ekziston diçka që e përgënjeshton atë"***. Ky ether nga Shabiu është sahih. Senedi i Halalit është transmetuar imam pas imami. (shiko "kitab es-sunneh" me rishikimin e Zahranit).

Transmetohet edhe si shprehje e tabinit të njohur Hasan ibn Atije Muharibiu. E transmeton Darimiu në sunenin e tij (99), thotë: Na ka treguar Ebu Mugireh, na ka treguar Euzaiu nga Hasan (ibn Atije): ***"Sa herë që disa njerëz shpikin një bidat, Allahu u largon prej sunetit diçka të njëjtë, pastaj nuk ua rikthen këtë sunet deri në ditën e gjykimit"***. Senedi i tij është sahih.

² **Ether sahih.** E transmeton Ebu Hajtheme Zuhejr ibn Harb Nesi, në librin e tij "El ilm" (50), thotë: Na ka treguar Veki (ibn Xherahu) nga Amesha, nga Ebu Duha, nga Mesruku, thotë: ***"Sa herë që pyesnim sahabët e profetit për ndonjë gjë, dija e saj ka qënë në Kuran, porse dija jonë nuk e ka arritur"***. Senedi i tij është sahih. E transmeton edhe Hatib Bagdadiu në "El fakih uel mutefekih", vëll. 1, fq. 197, nga Mesruku thotë: ***"Nuk janë pyetur sahabët e të dërguarit të Allahut për ndonjë gjë, veçse dija e saj ka qënë në Kuran, mirëpo ne nuk e kemi arritur atë"***.

transmetimesh hyjnore¹, duke u pajtuar kështu me pabesimtarët në shumë pika. Ata gabuan atëhere kur i atribuan padijen profetit ﷺ dhe selefit të këtij umeti, ashtu siç gabuan edhe pasuesit e deformimeve dhe tavileve të kota dhe të devijuarit e tjerë.

Këtu po përmendim fjalët e selefit pikë e presje dhe citimet e atyre që i kanë transmetuar mendimet e tyre, aq sa na lejon kjo fetva dhe aq sa të njihet medhhebi i tyre.

Transmeton Ebu Bekr Bejhakiu në "El esma ues sifat" me sened të saktë prej Euzaiut, thotë: **"Kur tabinët ishin akoma të shumtë, thonim: Allahu ﷻ është sipër Arshit të tij dhe besonim me cilësitë që kanë ardhur në sunet".**²

Euzaiu është një prej katër fukahave të shquar në kohën e tabitabinëve, të cilët janë; Maliku imami i Hixhazit, Euzaiu imami i Shamit, Lejthi imami i Egjiptit, Theuriu imami i Irakut. Euzaiu përcolli mirënjohjen e shprehjes, në kohën e tabinëve, rreth besimit se Allahu është sipër Arshit dhe besimit të cilësive semije. Euzaiu e tha këtë fjalë pas shfaqjes së medhhebit të Xhehmiut, i cili e mohoi qënien e Allahut ﷻ sipër Arshit dhe i mohoi cilësitë e tij, në mënyrë që njerëzit ta dinin që medhhebi i të parëve ishte në kundërshtim me atë të Xhehmiut.

Ebu Bekr Halali transmeton se Euzaiu ka thënë: Mekhuli dhe Zuhriu janë pyetur

¹ Fjala e përdorur "semijat" nënkupton dijen që arrihet vetëm nëpërmjet shpalljes hyjnore, të cilën logjika as nuk e mohon dhe as nuk e pohon, prandaj ajo njihet vetëm prej shpalljes. Si puna e ndodhive që do të ndodhin në ditën e gjykimit. Logjika nuk dëshmon dot për to por edhe nuk i mohon. Për to dëshmojnë vetëm tekset e ndryshme hyjnore (Kurani dhe suneti).

² **Ether hasen.** E transmeton Bejhakiu nga profesori i tij Hakimi, nga Muhamed ibn Ali Xheuhieriu, nga Ibrahim ibn Hejthemi, nga Muhamed ibn Kethir Misisi, nga Euzaiu. Problemi i këtij etheri qëndron te Muhamed ibn Kethir Misisi. Ai është prej dijetarëve të Jemenit, konkretisht nga Sanaja. Nxënës i njohur i imam Euzaut. Hadithin e tij e kanë nxjerrur në sunenet e tyre Tirmidhiu, Ebu Daudi dhe Nesaiu. Jahja ibn Maini një herë ka thënë për të: Ka qënë saduk dhe një herë: Thikah (i besueshëm). Hasen ibn Rabi ka thënë: Muhamed ibn Kethiri sot është njeriu më i besueshëm. Hafidhi Salih ibn Muhamedi ka thënë: Saduk që gabon. Ibn Hibani e ka përmendur në librin e tij "Eth thikat" mirëpo thotë: "gabon dhe transmeton fjalë garibe". Ndërsa Buhariu ka thënë për të "shumë lejjin". Ndërsa disa të tjerë e kanë dobësuar, prej tyre imam Ahmedi.

Sido që të jetë grada e tij nuk zbret nga "saduk" por që gabon. Ndërsa rreth mendimit të imam Ahmedit për të ka disa vrejtime të cilat vendi nuk na lejon ti përmendim. Bazuar në këtë që thamë shumë dijetarë ose e kanë saktësuar ose e kanë konsideruar hasen këtë ether. Prej tyre Dhehebiu, Ibn Kajimi, Ibn Haxheri dhe të tjerë.

Dhehebiu pasi e transmeton këtë ether me senedin e tij deri te Muhamed ibn Kethiri në "Tedhkiretul hufadh" thotë: "Senedi i tij është sahih". (Tedhkiretur hufadh 1/136). Ndërsa në librin e tij "El arsh" shton: "Senedi i tij është me imamë të besueshëm (thikat)".

Ibn Haxheri në "Fethul bari" thotë: "E ka transmetuar Bejhakiu me sened xhejid". Xhejid në terminologjinë e hadithit përdoret për hadithin që është më i fortë se haseni, ose mes hasenit dhe sahihut. Allahu është më i ditur.

për shpjegimin e haditheve dhe thanë: ***“Kalojini ato ashtu siç kanë ardhur”***.¹

Gjithashtu transmeton prej Velid ibn Muslimit, thotë: ***“Kam pyetur Malik ibn Enesin, Sufjan Theuriun, Lejth ibn Sadin dhe Euzaun për hadithet e transmetuara rreth cilësive. Më thanë: Kalojini ato ashtu siç kanë ardhur”***.

Në një transmetim tjetër thuhet: ***“Kalojini ashtu siç kanë ardhur pa “si”***.²

Fjala e tyre: ***“Kalojini ashtu siç kanë ardhur”***, është kundërpërgjigje ndaj pretenduesve të **tatilit**, ndërsa fjala: ***“pa -si-”*** është kundërpërgjigje ndaj përngjasuesve.

Zuhriu dhe Mekhuli kanë qënë tabinët më të njohur në kohën e tyre. Ndërsa katër të tjerët, janë imamët e botës islame në epokën e tabitabinëve. Në epokën e tyre kanë jetuar edhe Hamad ibn Zejdi, Hamad ibn Selemeja dhe të tjerë.

Ebu Kasim Ezxhiu transmeton me sened të tij prej Mutarif ibn Abdullahut thotë: Kam dëgjuar Malik ibn Enesin të thoshte, kur përmendeshin refuzuesit e haditheve të cilësive: ***“Omer ibn Abdulazizi ka thënë: I dërguari i Allahut ﷺ dhe udhëheqësit pas tij kanë vendosur disa sunete. Pranimi i tyre është vërtetim i librit të Allahut dhe plotësim i bindjes së Allahut dhe kapje e fortë me fenë e Allahut ﷻ. Asnjë krijese nuk i takon t'i ndryshojë ato dhe as të hulumtojë aty ku kundërshtohet me to. Kush udhëzohet me to, ai është i udhëzuar. Kush ngadhënjën me to ai është ngadhënjës. Kush i kundërshton ato dhe ndjek tjetër rrugë nga ajo e besimtarëve, Allahu ﷻ do t'i japë atë që ka dashur dhe do ta zhysë në xhehenem dhe ai është përfundimi i keq”***.³

¹ **Ether sahih.** E transmeton imami i Andalusit Ibn Abdulberri në “Xhamiul bejanil ilm” (1801), thotë: Na ka treguar Abdulvarith (ibn Sufjani), na ka treguar Kasim (Ibn Esbegu), na ka treguar Ahmed ibn Zuhejri (Ebu Bekr ibn Ebi Hajthame), na ka treguar Abdulvehab ibn Nexhde, na ka treguar Bakije (ibn Velidi), nga Euzaun thotë: ***“Mekhuli dhe Zuhriu thoshin: Transmetojini këto hadithe ashtu siç kanë ardhur dhe mos debaton rreth tyre”***. Ky sened është sahih, mirëpo Bakije është mudelis.

E transmeton edhe Hatabiu nga e njëjta rrugë e Ibn Abdulberrit, thotë: Na ka treguar Zaferani, na ka treguar Ibn Ebi Hajthameh, na ka treguar Abdulvehab ibn Nexhde Heutiu, na ka treguar Bakije nga Euzaun, thotë: ***“Mekhuli dhe Zuhriu thoshin: Kalojini hadithet ashtu siç kanë ardhur”***. Mealimus sunen, 4/331. Problemi i këtij rivajeti është po ashtu tedlisi i Bakijes.

Dëgjimin e Bakijes nga Euzaun e transmeton Ibn Asakiri në librin “Tarihu Dimashk”, thotë: Më ka treguar Ebu Muhamed Ekfani, na ka treguar Ebu Muhamed Ketani, na ka treguar Abdurrahman ibn Uthmani, na ka treguar Abdurrahman ibn Abdullah, na ka treguar Ebu Zurah Abdurrahman ibn Amri, na ka treguar Jezid ibn Abdirabihi, na ka treguar Bakije, na ka treguar Euzaun, thotë: ***“Zuhriu dhe Mekhuli thoshin: Kalojini këtë hadithe ashtu siç kanë ardhur”***. Tarihu Dimashk, biografia e Mekhulit.

² **Ether sahih.** E transmetojnë Ebu Bekr Halali në "Es suneh" 313, Axhuri në "Esh sheriah" 720, Darakutni në "Es sifāt" 67, Ibn Bata në "El ibaneh" 183. Ibn Mendeh në "Et teuhid" 894. Lalekai 930, Sabuni në "Akidetush selef" 90, Bejhakiu në "El esmau ues sifāt" nr: 955, me sened sahih, Ibn Abdulberri në "Et temhid", etj.

Dhehbiu e përmend në disa libra. Në librin "El arbain" thotë: "Është saktësuar prej Velidit ...".

³ **Ether sahih.** E transmetojnë Halali në "Es sunneh" 1329, nga imam Ahmed ibn Abdurrahman ibn Mehdi, nga Maliku dhe senedi i tij është sahih plot me imamë të besueshëm, Axhuri në "Esh sheriah" 307 nga Xhafer Firjabiu, nga Hasen Hulvani, nga Ibn Mutarif, nga Maliku dhe senedi i tij është sahih, Ibn

Transmeton Halali me sened të mbushur me imamë të besueshëm, nga Sufjan ibn Ujejne thotë: U pyet Rabia ibn Abdurrahmani për ajetin **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾**, si u lartësua? Tha: *"Istivaja nuk është e panjohur ndërsa si-ja është e pakapëshme me logjikë. Prej Allahut është mesazhi, mbi të dërguarin është përcjellja e qartë, ndërsa ne duhet të besojmë"*.¹

Këto fjalë transmetohen në rrugë të ndryshme edhe prej Malik ibn Enesit, i cili ka qënë nxënës i Rabia ibn Abdurrahmanit.

Prej këtyre rrugëve është ajo që transmeton Ebu Shejh Asfahaniu dhe Ebu Bekr Bejhakui nga Jahja ibn Jahja, thotë: Ishim te Malik ibn Enesi, kur erdhi një burrë dhe i tha: O Ebu Abdullah! **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾**, si u lartësua? Atëhere Maliku uli kokën aq sa djersa i mbuloi kokën, pastaj tha: *"Istivaja nuk është e panjohur ndërsa si-ja është e pakapshme me logjikë. Besimi i saj është detyrë, ndërsa pyetja rreth saj është bidat. Unë besoj se ti je bidatçi"*. Pastaj urdhëroi që të nxirrej.²

Fjala e Rabisë dhe Malikut: *"Istivaja nuk është e panjohur ndërsa si-ja është e pakapshme me logjikë. Besimi i saj është detyrë"* përputhet plotësisht me fjalën e të tjerëve: *"Kalojini ato ashtu siç kanë ardhur pa -si-"*. Ata kanë mohuar njohjen e formës por jo kuptimin real të cilësisë.

Nëse këta dijetarë do të besonin fjalën e zhveshur nga domethënia, dhe pa i kuptuar kuptimet e saj ashtu siç i takon Allahut ﷻ, atëhere nuk do të thoshin: *"Istivaja nuk është e panjohur ndërsa si-ja është e pakapshme me logjikë"*, dhe nuk do të thoshin: *"Kalojini ato ashtu siç kanë ardhur pa formëzim"*. Sepse nëse do të ishte kështu³, atëhere istivaja në këtë rast nuk do të ishte e njohur, përkundrazi do të ishte e panjohur njësoj si shkronjat e fjalorit. Gjithashtu nuk do të nevojitej mohimi i njohjes së si-së, përderisa nga fjala nuk kuptohet asnjë kuptim. Mohimi i njohjes së formës, i

Bata në "El ibaneh" 352-353, nga Maliku me të njëjtin sened si të Axhurit dhe me dy transmetime të tjera, Ibn Abdulberri në "Xhamiul ilm" 2326 nga transmetimi i Abdurrahman ibn Mehdit nga Maliku, Ebu Nuejm Asfahaniu në "El hiljeh" (6/324), po nga rruga e Firjabit, nga Hulvanu, nga Mutarifi thotë: E kam dëgjuar Malik ibn Enesin kur përmendej Ebu Hanifeja dhe të devijuarit në fe, thoshte: *"Umer ibn Abdulazizi ka thënë ..."* deri në fund, si rivajeti i përmendur nga Ibn Tejmije dhe senedi i tij është sahih. Fjalën e Omer ibn Abdulazizit e transmeton edhe Lalekai në "Sherhus sunneh" me senedin e tij, jo nga Maliku por nga shejhu i Malikut, imam Zuhriu. Po ashtu edhe Hatib Bagdadiu e transmeton nga Zuhriu në "El fakih uel mutefekih".

¹ **Ether sahih**. E transmetonë Ibn Bata në "El ibaneh" 121, Lalekai në "Sherhul usul" 665, nga transmetimi i Sufjan ibn Ujejnes, Bejhakui në "El esma ues sifat", 868 nga një rrugë tjetër, por në vend të pjesës së dytë thotë: *"Unë dhe ju kemi për detyrë ta besojmë të gjithë këtë"*. Albani e ka konsideruar sahih në "Muhtesarul ulu".

² **Ether sahih** dhe shumë i njohur nga Maliku.

³ Nëse do të ishte ashtu siç pretendojnë pasuesit e tefvidit se imamët e selefit kanë besuar vetëm fjalët si fjalë por të e zhveshura nga domethëniet dhe përmbajtja kuptimore e tyre.

nevojitet atij që i pohon cilësitë.¹

Gjithashtu ata që mohojnë cilësitë haberije apo të gjithë cilësitë, nuk kanë nevojë të thonë: Pa formë. Ai që thotë: Allahu ﷻ nuk është mbi Arsh, nuk ka nevojë të thotë: Pa formë. Nëse mohimi i cilësive dhe i kuptimeve reale të tyre do të ishte medhhebi i selefit, atëhere nuk do të thonin: Pa formë.

Po kështu edhe fjala e tyre: Kalojini ato ashtu siç kanë ardhur, nënkupton që domethëniet e tyre të mbesin ashtu siç janë, sepse ato kanë ardhur si fjalë kuptimplote. Nëse domethënia e tyre do të ishte e mohuar, atëhere duhet të shprehemi: Kalojeni shqiptimin e tyre, por duke besuar që kuptimi i tyre nuk është për qëllim. Apo duhej të thuhej: Kalojini shqiptimet e tyre por duke besuar se Allahu realisht nuk përshkruhet me ato që ato dëshmojnë. Në këtë rast, nuk i ke kaluar ato ashtu siç kanë ardhur dhe në këtë rast nuk thuhet “pa formë”; sepse mohimi i formës prej inekzitetit është i pakuptim.

Ethremi në "Es suneh" dhe Ebu Abdullah ibn Bata në "El ibaneh" dhe Ebu Amr Talamenku dhe të tjerë, transmetojnë me sened sahih, prej Abdulaziz ibn Abdullah ibn Ebi Seleme Maxheshonit², i cili ka qënë një prej tre imamëve të Medines bashkë me Malikun dhe Ibn Ebi Dhibin, se ai kur u pyet për atë që xhehmitë e kanë mohuar tha:

¹ Kjo pikë që përmend Ibn Tejmije është një pikë shumë e rëndësishme. Disa eshara argumentohen me këto transmetime se dijetarët e selefit nuk i kanë besuar kuptimet që i përmbajnë hadithet që flasin për cilësitë haberije (dora, syri, fytyra etj).

Ky pretendim është i kotë, sepse nëse ata nuk do i besonin kuptimet e tyre, nuk do të kishin nevojë të mohonin formën. Mosnjohja e formës dëshmon që ata i pohonin këto cilësi. Për atë gjë që nuk ka kuptim, nuk mund të pyetet si është forma e saj; sepse në momentin që e mohon kuptimin, është absurde të flasësh për formën. Njësoj si të thuash: Allahu nuk ka dorë por pa formë. Allahu nuk ka sy por pa formë. Nëse mohohet dora dhe syri, atëhere mohimi i formës është një absurditet.

Pyetja për formën dhe mënyrën me parafjalën “si”, bëhet atëhere kur gjëja ekziston dhe ka kuptim. Atëhere kur dijetarët e selefit i pohuan cilësitë haberije dhe i pranuan ashtu siç kanë ardhur, u friksuan prej përngjasimit të kuptimeve dhe realitetit të saj të krijesat. U friksuan se mos njerëzit kuptojnë prej dorës, atë që kuptohet prej duarve të krijesave. Ndërkohë që argumentet e cilësive janë thjesht kuptime gjuhësore dhe nuk dëshmojnë për përngjashmëri në njëmendësi (botën reale), sepse cilësitë e Allahut janë krejt ndryshe nga cilësitë e krijesave, si në formë ashtu edhe në përmbajtje. Sado që njeriu të mundohet të konceptojë dhe të përfytyrojë këto cilësi, ai nuk do t’ia arrijë, sepse kjo është përtej fuqisë së tij mendore.

Atëhere kur dijetarët e hershëm i pohuan cilësitë haberije, u detyruan të sqaronin se nuk pyetet për to se si janë në realitet, sepse kjo shpie në përngjasim dhe humbje.

Nëse ata do e mohonin përmbajtjen kuptimore dhe gjuhësore të tyre, kishin për të thënë: Këto hadithe mos i merrni ashtu siç kanë ardhur, dhe nuk do të thoshin: merrini ashtu siç kanë ardhur. Mos i merrni ashtu siç kanë ardhur sepse kuptimet e tyre nuk janë si kuptimi që ju kujtoni, por kanë kuptime të tjera të cilat ne nuk i dimë. A do të ishte e logjikshme që pastaj të mohonin formën dhe të thoshin: Mos i merrni siç kanë ardhur se ato nuk kanë kuptim, por pa pyetur për formën!! Duket qartë absurditeti i shumë kelamistëve, të cilët e pretendojnë arsyen, por që realisht janë shumë larg saj.

² Abdulaziz ibn Abdullah Maxheshoni. Imam i shquar. Prej dijetarëve dhe fukahave të njohur të Medines. Më pas u shpërngul në Irak. Vdiq në Bagdad në vitin 164h. dhe xhenazen ja fali kalifi abasit Mehdiu.

"E kuptova pyetjen që po bën rreth orvatjes së xhehmive për mohimin e përshkrimit të zotit të madh, madhëria e të cilit e ka tejkaluar çdo përshkrim dhe meditim. Gjuhët janë të paaftha për shpjegimin e cilësimit të tij. Mendja është dorëzuar përpara njohjes së fuqisë së tij. Madhështia e tij e mposhti mendjen, pa gjetur vend për të, prandaj mendja u kthye e mundur dhe e përbuzur.

Ata u urdhëruan të hulumtojnë dhe të mendojnë për atë që e ka krijuar me fuqinë e tij. Pyetja me "si" bëhet për atë që nuk ka ekzistuar dhe më pas ekzistoi. Ndërsa ai që nuk zhduket dhe nuk është zhdukur, ai i cili nuk ka shëmbull, askush tjetër përveç tij nuk e di se si është ai.

Si mund të njihet vlera e atij që nuk ka fillim dhe as nuk vdes dhe as nuk shkatërrohet?! Si mund të ketë përkufizim të plotë përshkrimi i diçkaje prej tij me të cilin njohësi dhe përshkruesi e përkufizon plotësisht atë?!

E megjithëkëtë ai është i vërteti dhe i qarti. Nuk ka ndonjë të vërtetë më të vërtetë se ai dhe asgjë më të qartë se ai.

Argument për paaftësinë e mendjeve për konceptimin e realitetit të cilësisë së Allahut, është paaftësia e mendimit për arritjen e konceptimit total qoftë edhe të krijesës më të vogël, të cilën mendja nuk e shikon dot për shkak të imtësisë së saj. Nuk e shikon as të ecë dhe as të lëvizë, as e dëgjon dhe as e shikon.¹ Ajo i vjen vërdallë dhe tallet me mendjen e tij. Ajo është më e vështirë dhe më e fshehtë për ty sesa dëgjimi dhe shikimi i saj.

*I lartë është Allahu ﷻ krijuesi më i përkryer. Krijuesi i tyre dhe zotëria i të gjithë zotërive dhe zoti i tyre, **﴿Asgjë nuk është si ai dhe ai është dëgjuesi shikuesi﴾** Esh shura, 11.*

Dije _Allahu të mëshiroftë_ se nuk ke përse e ngarkon veten me njohjen e asaj të cilën Allahu ﷻ nuk na e ka treguar për veten e tij; sepse ti je i paaftë ta njohësh atë që ai ta ka përshkruar. Nëse nuk arrin ta njohësh atë që ai ka përshkruar, përse e mundon veten për të ditur atë që nuk ta ka përshkruar?! A mos të bën dobi ajo në bindjen ndaj tij? Apo të ruan prej gjynaheve?

*Ai i cili e mohon përshkrimin me të cilin Allahu ﷻ ka përshkruar veten e tij, duke e munduar dhe ngarkuar veten, ai është si ai të cilin **﴿shejtanët e kanë mbërthyer dhe (ecën) në tokë i hutuar﴾** El enam, 71, dhe zuri të argumentohet _me pretendimin e tij_ për mohimin e asaj me të cilën Allahu ﷻ ka cilësuar dhe quajtur veten e tij, dhe tha: Nëse ai është kështu atëhere patjetër duhet të jetë ashtu.*

U verbua me të padukshmen prej të qartës dhe mohoi atë me të cilën Allahu ﷻ

¹ Sa herë që njeriu me mendjen dhe përpjekjet e tij arrin të njohë diçka, përpara tij dalin sfida dhe krijesa akoma më të vogla të cilat ai nuk mund ti konceptojë, para të cilave njeriu qëndron i paaftë dhe i hutuar.

quajti veten e tij, për shkak të asaj për të cilën Allahu ﷻ heshti dhe nuk përmendi prej saj asgjë.

Shejtani nuk e la rehat derisa mohoi fjalën e Allahut: **«disa fytyra në atë ditë do të jenë të shndritëshme. Te zoti i tyre ato shikojnë»** El kijame, 22-23. Tha: Askush nuk e shikon Allahun ﷻ në ditën e gjykimit. Kështu mohoi kerametin më të mirë me të cilin Allahu ﷻ do i nderojë evlijatë e tij në ditën e gjykimit, duke u lejuar shikimin në fytyrën e tij dhe ndriçimin e fytyrave të tyre, **«në një gradë të vërtetë, tek një sundues i fuqishëm»** El kamer, 55. Allahu ﷻ ka vendosur që ata nuk do të vdesin dhe për shkak të shikimit drejt tij, fytyrat do t'u ndriçohen".

Deri kur thotë:

"Ai e mohoi shikimin e Allahut ﷻ në ditën e gjykimit për ta përmbushur argumentin humbës dhe devijues. Dihet që Allahu ﷻ, kur t'u shfaqet në ditën e gjykimit, besimtarët do e shikojnë atë ashtu siç më parë e kanë besuar, ndërkohë që ky njeri e ka mohuar.

Muslimanët thanë: O i dërguar i Allahut! A do ta shohim zotin tonë në ditën e gjykimit? I dërguari i Allahut ﷺ u tha: **"A shtyheni me njëri-tjetrin për të parë diellin e pambuluar me re? I thanë: Jo. U tha: A shtyheni me njëri-tjetrin për të parë hënën në natën me hënë të plotë dhe të pambuluar me re? I thanë: Jo! U tha: Ju do e shikoni zotin tuaj atë ditë në të njëjtën mënyrë".¹**

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **"Nuk do të mbushet zjarri, derisa të vendosë Xhebari këmbën e tij në të dhe zjarri të thotë: Mjaft! Mjaft! Pastaj paloset me njëri-tjetrin".²**

I dërguari ﷺ i tha Thabit ibn Kajsit ؓ: **"Allahu ﷻ qeshi prej asaj që veprime mbrëmë me mikun tënd".³**

Dhe ka thënë _sipas asaj që na është përcjellur_ se: **"Allahu i lartë qesh prej ngushtimit dhe pesimizmit tuaj dhe afërsisë së përgjigjes (të duasë). Një bedevi i tha: A qeshka zoti ynë?! I tha: Po. I tha: Nuk do privohemi nga mirësia e një zoti që qesh".⁴** E shumë hadithe të tjerë që nuk mund të përmbliken këtu.

¹ **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu 6573 dhe Muslimi (1/299).

² **Hadith sahih.** E transmetojnë Buhariu 4848-4850 dhe Muslimi (51/35-38). Hadithi transmetohet me tekste të përafërta.

³ **Hadith sahih.** E transmetojnë Buhariu 3798 dhe Muslimi 2054, me dallimin se këto fjalë i janë thënë Ebu Talhas dhe jo Thabitit. Ibn Haxheri e ka sqaruar këtë pikë në "El feth" duke pohuar se transmetimi për Thabit ibn Kajsin është lapsus dhe gabim, dhe se transmetimi i saktë është për Ebu Talhan, siç përmendet në sahihun e Buhariut dhe Muslimit.

⁴ **Hadith daif.** Ky hadith transmetohet nga Ebu Rezini se i dërguari i Allahut ﷺ tha: **"Zoti ynë qesh prej pesimizmit të robërve dhe afrimit të ndërrimit (të gjëndjes). Thotë: I thashë: O i dërguar i Allahut! A qesh zoti? Tha: Po! I thashë: Nuk do të privohemi nga mirësia e një zoti që qesh".**

Allahu ﷻ thotë: **«Ai është dëgjuesi shikuesi»** Esh shura, 11. **«Bëj durim për gjykimin e zotit tënd sepse ti je nën sytë tanë»** Et tur 48. Dhe thotë: **«që të rritesh nën syrin tim»** Taha 39.

Dhe thotë: **«Çfarë të pengoi ty t'i biesh në sexhde asaj që e krijova me dy duart e mia»** Sad, 85.

Dhe thotë: **«E gjithë toka do jetë në mbërthimin e tij në ditën e ringjalljes ndërsa qiejt do të jenë të palosur në të djathtën e tij. I pastër dhe i lartë është ai prej asaj që po i bëjnë shok»** Ez zumer, 67.

Pasha Allahun! Për madhësitë e përshkrimit që ai i ka bërë vetes dhe mbërthimin e tyre në dorën e tij, nuk ka dëshmuar asgjë tjetër përveç vogëlsisë së vetë krijesave. Këtë njohuri Allahu ﷻ ua ka inspiruar krijesave në shpirt dhe ua ka krijuar në njohjen e zemrës.

Atë me të cilën Allahu ﷻ e përshkruan dhe e quan veten në gjuhën e të dërguarit ﷺ me atë e quajmë edhe ne, ashtu siç e ka quajtur veten. Nuk mundohemi të njohim cilësi të tjera, as këtë dhe as atë tjetrën. Nuk e mohojmë cilësimin e tij dhe nuk e ngarkojmë veten me njohjen e asaj që nuk e ka cilësuar.

Dije Allahu të mëshiroftë se mburoja në fe, është ndalja në fe aty ku ajo është ndalur. Mos e kalo kufirin që të është caktuar. Udhëzimi në fe është njohja e të mirës dhe mohimi i të keqes. Mos u frikëso prej përmendjes së asaj gjëje, njohuria e të cilës është sqaruar dhe zemrat në të janë qetësuar dhe baza e saj është përmendur në Kuran dhe në sunet, dhe dijen e të cilës umeti e ka trashëguar brez pas brezi. Mos u druaj prej përmendjes së cilësive me të cilat zoti yt e ka cilësuar veten, prej frikës së mangësisë. Mos e mendo veten për njohjen e madhësisë së tyre.

Atë që shpirti nuk ta panon dhe as nuk e ke gjetur në librin e zotit tënd ﷻ dhe as në hadithin e profetit tënd ﷺ për cilësimin e zotit tënd ﷻ, atëhere mos u përpiq ta njohësh me logjikën tënde dhe as mos e përshkruaj me gojën tënde. Hesht ndaj saj ashtu siç ka heshtur zoti ﷻ, sepse përpjekja për njohjen e asaj me të cilën nuk e ka cilësuar veten e tij është njësoj si mohimi i asaj me të cilën e ka përshkruar veten e tij.

Ashtu siç e ke kundërshtuar mohimin e mohuesve të cilësive po ashtu kundërshoje përshkrimin e atyre që e kanë përshkruar Allahun ﷻ me atë që nuk e ka përshkruar veten e tij.

E transmeton Ibn Maxheh, 181 në "kapitull rreth asaj që kanë mohuar xhehmitë", Imam Ahmed i në musnedin e tij 16187, Lalekai në "Sherhul usul" 722, Ibn Ebi Asim në "Es sunneh" 554, Axhuri në "Esh sheriah" 638, Taberani në "El muxhem el kebir" 469, Bejhaku në "El esma ues sifati" 987, etj. Të gjithë ata nga transmetimi i Hamad ibn Seleme, nga Jala ibn Ata, nga Veki ibn Hudusi, nga Ebu Rezini.

Hadithi është i dobët sepse gjëndja e Veki ibn Hudusit është e panjohur. Rreth emrit të tij ka shumë kundërshtime. Shejh Ahmed Shakiri dhe Albani e kanë konsideruar të dobët.

Pasha Allahun! Janë pakësuar muslimanët të cilët e njohin të vërtetën dhe me të cilët e vërteta njihet. Ata që e kundërshojnë devijimin dhe me kundërshtimin e tyre largohet. E dëgjojnë atë me të cilën Allahu ﷻ e ka përshkuar veten e tij në librin e tij dhe atë që u ka arritur prej profetit ﷺ, por as zemra e muslimanit nuk sëmuret nga përmendja e cilësive dhe as besimtari nuk përpiket ta njohë cilësinë e zotit nga tjetërkush.

*Ajo që ka përmendur profeti ﷺ prej cilësive të zotit ﷻ është njësoj si ajo që ka përmendur vetë zoti për veten e tij. Të palëkundurit në dije, ata që e përshkruajnë Allahun ﷻ ashtu siç e ka përshkuar veten, të cilët heshtin për atë që ai ka heshtur, ata nuk mohojnë asnjë cilësi me të cilën është përshkuar dhe as nuk përpiqen ta cilësojnë atë me atë që nuk e ka përmendur për t'u thelluar, sepse i vërteti subahnehu e ka lënë cilësimin me të. E ai që **«ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve do t'i japim atë që dëshiron dhe do ta fusim në xhehenem dhe ai është përfundimi më i keq»** En nisa 115. Allahu ﷻ na dhuroftë gjykim (të drejtë) dhe na bashkoftë me njerëzit e mirë".*

Kjo ishte e gjitha fjala e imam Maxheshonit. Meditoje atë dhe shiko se si i pohoi cilësitë dhe e mohoi njohjen e formës, duke u pajtuar me imamët e tjerë. Vështro se si e qortoi atë që mohon cilësitë me preteksin se po t'i pohojë rrjedh kështu dhe ashtu. Pikërisht kjo është fjala e xhehmive të cilët pretendojnë se pohimi i cilësive nënkupton që Allahu ﷻ është trup ose veti momentale dhe nga kjo rrjedh që ai është i krijuar.

Në librin e njohur në mesin e pasuesve të Ebu Hanifes "El fikhul ekber", të cilin e kanë transmetuar me sened prej Ebu Mutiut Hakem ibn Abdullah Belhiut, thotë: E kam pyetur Ebu Hanifen për fikhun më të madh dhe më tha:

"Mos i bëj tekfîr askujt për shkak të ndonjë gjynahu dhe mos e moho prej tij cilësimin me iman. Urdhëro për mirë dhe ndalo nga e keqja. Dije se ajo që të ka goditur nuk kishte si të të shmangej, ndërsa ajo që nuk të ka goditur nuk kishte si të të godiste. Mos u distanco prej askujt nga sahabët e të dërguarit të Allahut dhe mos përkrash ndokënd kundër dikujt tjetër dhe ktheje çështjen e Uthmanit dhe Aliut te Allahu.

Ebu Hanifja thotë: Fikhu më i madh në fe është më i mirë se fikhu në dije (dispozita), sepse të kuptojë njeriu se si ta adhurojë Allahun është më mirë se sa të grumbullojë dije të shumtë.

Ebu Mutiu thotë: I thashë: Më trego për fikhun më të dobishëm Tha: Të mësojë njeriu imanin, dispozitat, sunetet, masat ndëshkuese dhe kundërshtimin e dijetarëve.

Pastaj përmend çështjet e imanit, çështjet e kaderit, replikën ndaj kaderive me fjalë të goditura, të cilat nuk është vendi t'i përmendim. Pastaj thotë:

"I thashë: Çfarë mendon për atë që urdhëron për mirë dhe ndalon nga e keqja dhe mbledh rreth vetes pasues dhe i kundërvihet xhematit (të muslimanëve)? A e lejon këtë? Tha: Jo.

I thashë: Përse, kur dihet që Allahu dhe i dërguari kanë urdhëruar për urdhërimin për mirë dhe ndalimin nga e keqja, dhe kjo është farz i detyruar? Tha: Kjo është e vërtetë. Mirëpo ata prishin më shumë se sa ndreqin, duke derdhur gjak dhe duke cënuar të drejtat”.

Pastaj përmend citimet rreth luftimit të harixhive dhe rebelëve, derisa thotë:

“Ebu Hanife për atë që thotë: Nuk e di ku është zoti im, në qiell apo në tokë, ka thënë: Ai ka bërë kufër sepse Allahu ﷻ thotë: ﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾ Taha 5, dhe Arshi i tij është sipër shtatë qiejve.

I thashë: Po nëse thotë: Ai është lartësuar mbi Arsh, por thotë: nuk e di ku është Arshi, në qiell apo në tokë? Tha: Ai është qafir, sepse ka mohuar që ai të jetë në qiell, se Allahu është më i larti nga të lartit dhe ai lutet duke u drejtuar lart dhe jo poshtë.

Në një transmetim tjetër thuhet: "E pyeta Ebu Hanifen për atë që thotë: Nuk e di ku është zoti im, në qiell apo në tokë. Tha: Ka bërë kufër, sepse Allahu ﷻ thotë: ﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾ dhe Arshi i tij është sipër shtatë qiejve. Thotë: Po ai thotë se është i lartësuar mbi Arsh po nuk e di ku është Arshi, në tokë apo në qiell. Tha: Nëse e mohon se ai është në qiell ai ka bërë kufër".¹

¹ Transmetimi i Ebu Muti Belhiut, që Ibn Tejmije e quan këtu “El fikhul ekber”, njihet në mesin e hanefive të mëvonshëm dhe maturidive si “El fikhul ebset”, për ta dalluar nga transmetimi i Hamad ibn Ebi Hanifes i “El fikhul ekber”.

Versioni i Ebu Mutiut që ekziston në mesin e hanefive bashkohorë, është marrë prej dorëshkrimeve të Ebu Muin Nesefiut. Ky version nuk është i saktë dhe as i besueshëm. Jo për shkak se dorëshkrimet nuk na kanë arritur në mënyrë të besueshme, sepse pranimi i dorëshkrimeve dhe kopjeve të originalit ka të tjera baza dhe rregulla, por shkak janë vetë ata që kanë transmetuar këtë libër. Autori i këtij libri është vetë Ebu Muti Belhiu dhe librin duhet ta ketë shkruar pas vdekjes së Ebu Hanifes dhe transmetimi i tij prej Ebu Hanifes nuk mund të merret për bazë.

Dhehebiu në librin e tij "Mizanul itidal" thotë: "El Hakem ibn Abdullah, Ebu Muti' Belhiu, fakih, nxënës i Ebu Hanifes... Ibn Mubarek (dijetar gramatike dhe jo Abdullah ibn Mubarek i njohur) e ngrinte lart dhe e vlerësonte për shkak të fesë dhe dijes së tij. Ibn Maini ka thënë: Ai nuk konsiderohet asgjë. Një herë tjetër ka thënë: I dobët. Buhariu ka thënë: I dobët, veprues sipas rajit. Nesaiu ka thënë: I dobët”

Ibn Xheuziu në librin e tij "Ed duafo" ka thënë : "Ahmedi ka thënë: Nuk duhet të transmetohet prej tij asgjë. Ebu Daudi ka thënë: E kanë braktisur hadithin e tij sepse ishte xhehmi .

Ibn Adiji ka thënë: Dobësia e tij është shumë e qartë. Për të gjitha ato që i transmeton nuk pasohet . Ibn Hibani ka thënë: Ka qënë prej kokave të murxhiave, prej atyre që i urrejnë sunetet dhe pasuesit e tyre.

Ukejli ka thënë: Më ka njoftuar Abdullah ibn Ahmed (Ibn Hambeli): E pyeta babain për Ebu Muti' Belhiun dhe më tha: Nuk duhet të transmetohet prej tij. Na kanë treguar prej tij se ai thotë: Xheneti dhe zjarri janë krijuar dhe do të zhduken, e kjo është fjala e Xhehmiut".

Ibn Haxheri thotë: “Dhehebiu e ka pranuar në formë të prerë, se ai ka trilluar një hadith” Lisanul mizan, 3/346. Imam Ebu Hatem Raziu ka thënë: “Ka qënë murxhi dhe gënjeshtar”. E shumë fjalë të tjera që dëshmojnë për braktisjen e tij dhe mos pranimin e dijes prej tij.

Këtu duhet të largojmë edhe një dyshim të disa maturidive. Ata duke u argumentuar me fjalët e mësipërme të Ibn Tejmijes, të cilat mund të nënkuptojnë që Ibn Tejmije e ka pranuar të saktë librin në fjalë, përpiqen që t’u hedhin hi syve muslimanëve të thjeshtë, gjasme se versionin që Ibn Tejmije, Ibn

Në këtë fjalë të njohur të Ebu Hanifes te pasuesit e tij¹, ai i ka bërë tekfir atij që

Kajimi dhe Dhehebiu e kanë pranuar është i njëjtë me versionin e Ebu Muin Nesefiut prej Ebu Mutiut, apo versionet e tjera që maturiditë e sotëm qarkullojnë nëpër dorë.

Ibn Tejmije në vijim të Fetvasë së Hamasë thotë: ***“Këto fjalë i ka transmetuar me sened deri te ai, shejhul-islami Ebu Ismail Ensari Hereviu në librin “El faruk”.***

Të njëjtën gjë përmend edhe Dhehebiu. Kopja e transmetuar prej Ebu Ismail Hereviut, ajo ka qënë kopja prej të cilit kanë citur dijetarë si Dhehebiu, Ibn Tejmije apo Ibn Kajimi.

Dhehebiu në “El ulu’u” pasi përmend fjalën e Ebu Hanifes të transmetuar nga Ebu Mutiu, thotë: ***“E ka transmetuar autori i librit “El faruk” me isnad prej Ebu Bekr ibn Nasir ibn Jahjas nga Hakemi”.*** “El faruk” është libri i Ebu Ismail Ensariut ndërsa Hakemi është vetë Ebu Mutiu.

Për këtë version, shejhu i maturidive Muhamed Zahid Ketheriu thotë: ***“Ndërsa rivajeti i Ebu Ismail Ensariut Herviut i “El fikhul ekber” në librin e tij “El faruk”, ka shtesa dhe deformime të fjalës së imam azemit sipas epshit të hashevitëve dhe është në kundërshtim me rivajetin e të tjerëve”.*** El alim uel mutealim, rishikim dhe korigjim i Muhamed Zahid Keutheriut, botim i vitit 1367 h. Fq: 7.

Duket qartë që versionin që ka qarkulluar në duart e dijetarëve të hadithit, ka qënë i ndryshëm nga versioni i Ebu Muin Nesefiut, që qarkullon sot në duart e maturidive. Ajo që na intereson këtu është se versioni i Ebu Muin Nesefiut është i dobët dhe i paruahtur sepse transmetuesit e tij deri te Ebu Muti Belhiu nuk arrijnë gradën e hasenit, edhe sikur të bazoheshim në kriteret më liberale në shqyrtimin e fjalëve të dijetarëve dhe jo në kriteret e shqyrtimit të hadithit, megjithëse në këtë libër përmenden edhe hadithe.

Jo vetëm Ebu Mutiut nuk i pranohet fjala kur përcjell këto thënie të Ebu Hanifes, por edhe vetë zinxhiri i transmetuesve deri te Ebu Muti Belhiu nuk është i fortë. Sa për shëmbull në të gjëndet Ebu Abdullah Husejn ibn Ali Kashgeriu i cili është akuzuar për gënjeshtar, siç e përmend Dhehebiu në “mizanul itidal” dhe të tjerë. Madje edhe vetë Keutheriu e pranon që është përfolur.

Edhe transmetuesit e tjerë nuk janë kushedi se çfarë, sepse pothuajse nuk njihet gjëndja e tyre në mesin e muhadithëve. Nasir ibn Jahja që mbahet si profesori i Maturidiut nuk para përmendet përveçse në librat e hanefive maturidi dhe asnjë nga muhadithët nuk e përmend besueshmërinë e tij. Pra gjëndja e tij është e panjohur.

Pranimin e këtij libri nuk e refuzojnë vetëm selefistët. Atë e refuzojnë edhe shumë kelamistë të tjerë, sidomos prej esharive. Në kohën tonë mund të përmendim Abdulaziz Hadiriun, një prej profesorëve të njohur në ilmu-kelamit. Në librin e tij “Tenzihul hakkil mabud” në fq. 359, përmend refuzimin e këtij libri për shkak të senedit të tij.

Prej tyre Alevi Sekafi në shqyrtimin që i ka bërë librit të Ibn Xheuzit “Defu shubehit teshbih”. Pasi përmend pohimin e Ebu Hanifes se Allahu është mbi Arsh, thotë teksualisht: “Përgjigja jonë është: Kjo fjalë është gënjeshtër e trilluar ndaj Ebu Hanifes, sepse transmetuesi i tij është Ebu Muti Belhiu i cili ishte gënjeshtar dhe trillues”.

Pasi përmend transmetimet e dijetarëve si Dhehebiu dhe Ibn Haxheri thotë: “Trilluesi dhe gënjeshtari, për të cilin imam Ahmedi thotë se nuk duhet transmetuar prej tij asgjë, si atëhere të bazohemi te ajo që transmeton prej Ebu Hanifes?! Ai që trillon ndaj të dërguarit të Allahut e ka më të lehtë të trillojë ndaj atij që është poshtë tij, si puna e Ebu Hanifes. A nuk është kështu?”. Shiko librin e përmendur, fq: 69-70.

E shumë eshari të tjerë që nuk është vendi këtu për t’i përmendur. Nëse sqarohet se libri që Ebu Mutiu ka hartuar dhe ja ka mveshur Ebu Hanifes, nuk ka ndonjë vlerë shkencore, atëhere mbetet të sqarohet transmetimi i Hamad ibn Ebi Hanifes i “El fikhul ekber” i cili gjithashtu transmetohet nga tre transmetues të dobët njëri pas tjetrit. Mbase për këtë version mund të flasim më gjerësisht diku tjetër.

¹ Fakti që kjo fjalë është e njohur te hanefitë e mëvonshëm, nuk do të thotë që ajo është e saktë. Ibn Tejmije përpiket t’u sqarojë se edhe librat që ata vetë i transmetojnë ka në to dëshmi që kundërshtojnë

ndalet dhe thotë: Nuk e di se ku është zoti im, në qiell apo në tokë. Si qëndron puna atëhere me mohuesin i cili thotë: Nuk është në qiell, ose thotë: Nuk është as në qiell dhe as në tokë?! Ai u argumentua për kufrin e tij me ajetin: **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾** Taha 5, thotë: Arshi i tij është sipër shtatë qiejve. Ai sqaroi me këtë se fjala e Allahut **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾** Taha 5, dëshmon se Allahu është sipër qiejve dhe sipër Arshit, dhe se istivaja mbi Arsh dëshmon se vetë qenia e Allahut është mbi Arsh. Pastaj ai e plotësoi këtë me tekfirin e atij që thotë se Allahu është mbi Arsh, mirëpo u ndal në pikën nëse Arshi është në qiell apo në tokë. Këtë tekfir e arsyetoi me faktin se me këtë ndalje personi e mohoi që Allahu të jetë në qiell, sepse Allahu është më i larti i të lartëve, dhe se atij i drejtohet lutja lart dhe jo nga poshtë.

Ky është pohim i qartë prej Ebu Hanifes për tekfirin e atij që mohon se Allahu është në qiell. Ai u argumentua me faktin se Allahu është më i larti i të lartëve dhe se atij i drejtohet lutja lart dhe jo poshtë. Të dy këto argumente janë argumente të fitres dhe logjike. Vetë natyra e zemrës është krijuar e tillë që të pohojë se Allahu është lart dhe se atij i drejtohet lutja lart dhe jo poshtë. Transmetimi tjetër shprehet akoma më qartë, kur thotë: Nëse e mohon se ai është në qiell ai ka bërë kufër.

Këto fjalë i ka transmetuar me sened deri te ai, shejhul-islami Ebu Ismail Ensari Hereviu në librin "El faruk".

Ibn Ebi Hatim transmeton se Hisham ibn Ubejdilah Raziu _nxënësi i Muhamed ibn Hasenit¹_ kadiu i Rejit, burgosi një njeri me akuzën e pasimit të xhehmive. Ai u pendua dhe e sollën te Hishami që ta lironte. I tha: Hamdi i qoftë Allahut për pendimin tënd. Pastaj Hishami e morri në pyetje dhe i tha: *A dëshmon se Allahu është mbi Arsh i ndarë nga krijesat e tij? I tha: Dëshmoj se Allahu është mbi Arsh, po nuk e di çfarë është kjo "i ndarë nga krijesat e tij". Atëhere (Hishami) tha: Kthejeni në burg se nuk qënka penduar ende.*²

Gjithashtu (Ebu Ismail Ensariu) transmeton nga Jahja ibn Muadh Raziu se ai ka thënë: *"Allahu është mbi Arsh, i ndarë nga krijesat e tij. E ka përfshirë me dijen e tij çdo gjë dhe e ka përmbledhur me llogari çdo gjë. Për këtë fjalë dyshon vetëm një xhehmi i ulët, i humbur, i shkatërruar dhe dyshues. Ai (xhehmiu) pretendon se Allahu është i përzier me krijesat e tij. E përzien qënien (e Allahut) me pislëqet*

medhhebin e tyre. Megjithatë siç e thamë, versioni të i cili bazohet Ibn Tejmije është i ndryshëm nga ai i maturidive dhe nuk përmban deklaratat e tjera që përforcojnë medhhebin maturidi.

¹ Muhamed ibn Hasen Shejbaniu. Nga nxënësit e njohur të Ebu Hanifes. Ishte Kadi gjatë sundimit të Harun Rashidit, pas vdekjes së Ebu Jusufit. Vdiq në vitin 189h.

² Ibn Tejmije e përmend këtë transmetim me sendet të plotë në "Bejanu telbisil xhehmijeh" (1/440) thotë: "Shejhul islami gjithashtu transmeton etherin që e ka përmendur Ebu Muhamed Abdurrahman ibn Ebi Hatem në "Er reddu alesh xhehmijeh", na ka treguar Ali ibn Hasen Silmiu, kam dëgjuar babain tim të thotë: Hisham ibn Ubejdilah Hisham ibn Ubejdilah Raziu _nxënësi i Muhamed ibn Hasenit_ burgosi një burrë ...". Me shejhul islamit ka për qëllim Ebu Ismail Ensariun.

dhe ndyrësirat".¹

Gjithashtu transmeton se Ibn Medini² kur u pyet për mendimin e ehli-xhematit tha: *"Besojnë shikimin dhe fjalën dhe se Allahu është sipër qiejve, mbi Arsh i lartësuar"*. Pastaj u pyet për ajetin: *«Nuk ka ndonjë grup tre vetësh veçse Allahu është i katërti i tyre»*. Tha: *Lexo ajetin më përpara: «A nuk e vëren se Allahu e di çdo gjë që është në qiej dhe në tokë»"*.³

Transmeton prej Ebu Isa Tirmidhiut se ka thënë: *"Ai është mbi Arsh, ashtu siç thotë në librin e tij. Ndërsa dija, fuqija dhe sundimi i tij janë në çdo vend"*.⁴

¹ **Ether i dobët.** E përmend Dhehebiu në "El ulu", thotë: "Ebu Ismail Ensariu në "El faruk" citon me sened deri te Muhamed ibn Mahmudi, kam dëgjuar Jahja ibn Muadhin të thotë ...", etheri nr: 507. Albani thotë: "Nuk kam hasur ndonjë sened të tij".

Transmeton Ebu Nuejm Asfahaniu në "El hiljeh" (10/60) thotë: Më ka treguar Abdulvahid ibn Bekri, më ka treguar Ahmed ibn Muhamed ibn Ali Berdaiu, na ka treguar Tahir ibn Ismail Raziu, thotë: *"I thanë Jahja ibn Muadhit: Na trego çfarë është Allahu? U tha: Zot i vetëm. I tha: Si është ai? I tha: Sundues i fuqishëm. I tha: Ku është? I tha: Në pritë. I tha: Nuk po të pyes për këtë. Atëhere Jahja i tha: Atëhere ajo është cilësimi i të krijuarit, ndërsa cilësimi i krijuesit është ky që të tregova"*. E transmeton edhe Kushejriu me të njëjtin sened në "Er risaletul kushejrieh" (1/28), thotë: Më ka treguar Muhamed ibn Husejini, thotë: Kam dëgjuar Abdulvahid ibn Bekrin ..." e deri në fund me të njëjtin sened dhe teks.

Këtë thënie të Jahja ibn Muadhit, e dëgjojmë të përsëritet shumë shpesh në gojë e esharive të mëvonshëm, duke pretenduar se ai me këtë fjalë ka mohuar lartësimin e Allahut ﷻ mbi Arsh. Fjalët e Jahja ibn Muadhit nuk janë të qarta se ai e mohon lartësimin e Allahut ﷻ mbi arsh. Përkundrazi ato janë të goditura dhe në përputhje me akiden tonë. Në disa transmetime përmendet se ai i është përgjigjur me këto fjalë një ateisti, prandaj ia ktheu: Allahu ﷻ është në pritë, dhe e gjithë fjala e tij është e vërtetë.

Kjo thënie e tij nuk bie në kundërshtim me fjalën që e transmeton Ebu Ismail Hereviu dhe Ibn Ebi Hatim prej tij, rreth pohimit të lartësimit të Allahut ﷻ mbi Arsh. Kjo dëshmon se kuptimi i fjalës së Jahjas është ndryshe nga kuptimi që e kanë marrë esharitë.

Nëse thuhet: Etheri i Jahjas që e përmend Hereviu dhe Ibn Ebi Hatim është i dobët, u thuhet: Senedi i Kushejriut dhe Ebu Nuejmit për thënien e dytë gjithashtu është i dobët. Zinxhiri i tij është i mbushur me persona të panjohur, gjëndja e të cilëve nuk njihet.

Prandaj Ibn Tejmije në "El istikameh" (1/185) thotë: "Nuk dihet saktësia e kësaj thënie nga Jahja ibn Muadhi sepse në senedin e tij ka persona që nuk i njohim. Gjithashtu fjala e Jahja ibn Muadhit tek ata (sufistët) është nën nivelin e dijetarëve të mëdhenj prej dijetarëve të hakikatit në çështjet e veprave dhe në çështjet e tjera. Ai flet rreth shpresës me shprehje të cilat përngjasojnë me shprehjet e murxhive ekstrem, të cilat nuk përputhen me bazat e shehlerëve të mëdhenj, të cilët kanë qënë të kapur me sunetin. Ai pretendon rreth teuhidit një pozitë të caktuar e cila është caku përfundimtar. Atë e kanë kritikuar Ebu Jezidi dhe të tjerë. Fjalët e tij i ngjasojnë fjalëve të predikuesve ...".

² Ali ibn Medini. Dijetar i madh dhe imam në xherh dhe tadil. Dhehbiu e ka cilësuar si emiri i besimtarëve në hadith. Buhariu thotë: "Nuk e kam parë veten të vogël (në dije) përpara askujt përveç përpara Ali ibn Medinit". Vdiq në vitin 234h.

³ E transmeton Dhehebi në "El ulu" 473, me sened të plotë nga Ebu Ismail Ensariu. Në senedin e tij ka dy persona të panjohur.

⁴ **Ether sahih.** Të njëjtat fjalë, por me një renditje tjetër, i ka përmendur vetë imam Tirmidhiu në sunenin e tij, në temën rreth komentimit të sures El hadid.

Transmeton (Ebu Ismail Ensariu) se Ebu Zur'ah Raziu¹, kur u pyet për shpjegimin e ajetit: **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾** tha: *"Shpjegimi i tij është ashtu siç po e lexon. Ai është mbi Arsh dhe dija e tij është kudo. Mallkimi i Allahut qoftë mbi atë që thotë ndryshe".*²

Transmeton Hafidhi Ebu Kasim Lalekai, nxënësi i Ebu Hamid Isfirainit, në librin e tij të njohur "Usulus sunneh" me senedin e tij nga Muhamed ibn Haseni _nxënësi i Ebu Hanifes_ se ai ka thënë: *"Të gjithë fukahatë janë pajtuar nga lindja në perëndim rreth besimit të Kuranit dhe haditheve, të cilat i kanë transmetuar të besueshmit nga i dërguari i Allahut ﷺ rreth cilësimit të zotit, pa i shpjeguar, pa i përshkruar, pa i përngjasuar. Kush shpjegon diçka sot, atëhere ai ka dalur nga rruga në të cilën ka qënë profeti dhe është shkëputur nga xhemati. Ata as nuk kanë përshkruar dhe as nuk kanë shpjeguar, por janë përgjigjur me atë që gjëndet në Kuran dhe sunet dhe më pas kanë heshtur. Ndërsa kush thotë si fjala e Xhehmit, ai është shkëputur nga xhemati sepse ai e ka cilësuar Allahun me cilësinë e inekzistencës".*³

Muhamed ibn Haseni ka mësuar te Ebu Hanifja, Maliku dhe dijetarët e brezit të tyre. Ai përcolli pajtimin e dijetarëve dhe përmendi se xhehmitë e përshkruajnë zotin me cilësi mohuese përherë. Ndërsa fjala e tij "pa shpjegim" ka për qëllim shpjegimet e xhehmive mohues, të cilët shpikën shpjegime dhe komentime rreth cilësive në kundërshtim me metodën e sahabëve dhe tabinëve të besueshëm.

Bejhaku dhe të tjerë transmetojnë me sened sahih nga Ebu Ubejdi Kasim ibn Selami se ai ka thënë: *"Këto hadithe në të cilat thuhet: "Qesh zoti ynë prej pesimizmit të robërve të tij ndërkohë që ndryshimi është afër", "Xhehenemi nuk mbushet derisa të vendosë zoti yt këmbën e tij në të", "Kursia është vendi i dy këmbëve" dhe hadithet e shikimit, të gjitha ato janë të vërteta. Të besueshmit i kanë transmetuar brez pas brezi. Mirëpo nëse pyetemi për shpjegimin e tyre, nuk i shpjegojmë ato sepse nuk kemi arritur askënd që i shpjegonte ato".*⁴

¹ Ubejdullah ibn Abdulkërim Raziu, i njohur si Ebu Zur'a Raziu. Dijetar i xherhit dhe tadilit. Imam Ahmed i ka thënë: "Nuk e ka kaluar urën _e Bagdadit_ ndonjë person më i ditur sesa Is'hak ibn Rahavejhi dhe me memorizim më të fortë sesa Ebu Zura". Vdiq në vitin 264h.

² E transmeton Dhehebiu në "El ulu" me sened të plotë nga Ebu Ismail Ensariu, nr: 503.

³ E transmeton Lalekai në "Sherhul usul" 740,

⁴ **Ether sahih.** E transmeton Bejhaku në "El esmau ues sifāt" 760. Axhuri në "Esh sheriah" 177 me sened sahih. E transmeton edhe Lalekai në "sherhul usul" 928, nga Ahmed ibn Muhamed ibn Xherah Dirabi, nga Muhamed ibn Mehledi Duriu, nga Abas ibn Muhamed Duriu se ka dëgjuar Kasim ibn Selamin të thotë, pastaj përmendi fjalën e tij. Ky sened është sahih. Transmetuesit e tij janë hufadhë dhe thikatë (të besueshëm).

Ibn Abdulberri në "Et temhid" (7/150) thotë: "Abas Duriu thotë: Kam dëgjuar Jahaja ibn Mainin të thotë: Kam parë Zakarija ibn Adijin të pyesë Veki ibn Xherahun duke i thënë: *"O Ebu Suffjan! Këto hadithe si*

Ebu Ubejde është një nga katër imamët të cilët janë: Shafiu, Ahmedi, Is'haku dhe Ebu Ubejde. Njohuritë e tij në fikh, në gjuhë dhe në tefsir nuk kanë nevojë të përmenden, sepse janë të mirënjohura. Ai jetoi në kohën kur u përhapën fitnet dhe bidatet, prandaj dhe njoftoi se nuk kishte arritur ndonjë dijetar që t'i shpejgonte këto hadithe ashtu siç i shpejgonin xhehmitë.

Lalekai dhe Bejhakui transmetojnë me senede të tyre, se një burrë i tha Abdullah ibn Mubarekut: O Ebu Abdurrahman! Mua nuk më pëlqen që të cilësoj. Kishte për qëllim cilësimin e Allahut. Abdullah ibn Mubareku i tha: **"Unë e urrej këtë gjë më shumë se ti. Mirëpo nëse libri shprehet me diçka atëhere ne shprehemi me të. Nëse etheret (hadithet) vijnë me diçka ne i pasojmë ato"**¹ apo diçka të tillë.

Abdullah ibn Mubareku ka për qëllim se ne e urrejmë ta cilësojmë Allahun ﷻ nga vetja jonë. Nuk e shpikim cilësimin e tij nga vetja jonë por shikojmë nëse është përmendur në Kuran dhe në hadithe.

Abdullah ibn Ahmedi dhe të tjerë transmetojnë me senede sahihe prej Ibn Mubarekut se ai është pyetur: Si e njohim zotin tonë? Tha: **"Ai është sipër qiejve mbi Arshin e tij, i ndarë nga krijesat. Nuk themi ashtu siç kanë thënë xhehmitë: Ai është mu këtu në tokë"**.² Kështu ka thënë edhe imam Ahmedi dhe të tjerë.

"Kursia është vendi i dy këmbëve" e të tilla si këto? I tha (Vekiu): E kam arritur Ismail ibn Halidin dhe Suffjanin dhe Misarin të transmetonin këto hadithe dhe nuk shpejgonin prej tyre asgjë".

Thotë Abas Duriu: E kam dëgjuar Ebu Ubejden Kasim ibn Selamin kur i përmendën se një burrë prej ehli sunetit se thoshte: Këto hadithe që transmetohen për shikimin, kursia është vendi i dy këmbëve, qesh zoti yt nga pesimizmi i robërve të tij, dhe xhehnemi mbushet e të tjera hadithe si këto. I thanë: Ky filani thotë: Zemrat na thonë që këto hadithe janë të vërteta. Atëhere (Kasim ibn Selami) tha: **"Ma prishët mendimin që kisha për të. Këto hadithe janë të vërteta. Nuk ka dyshim në to. I transmetojnë ato të besueshmit brez pas brezi. Mirëpo nëse pyetemi për shpjegimin e këtyre haditheve nuk i shpjegojmë dhe nuk dimë askënd ti ketë shpjeguar ato"**.

Abas Duriu i cili është edhe transmetuesi i fjalës së Kasim ibn Selamit te Lalekai, ai është nga imamët dhe hufadhët e hadithit. Ndërsa fjala e Kasim ibn Selamit: "Ma prishët mendimin që kisha për të" sepse kjo formë e të shprehurit: "Zemrat na thonë se janë të vërteta" nënkupton që këto hadithe nuk janë shumë të sigurta, prandaj Kasim ibn Selami tha: "Nuk ka dyshim në to" edhe në aspektin e transmetimit dhe transmetuesve dhe jo vetëm me zemër.

E transmeton edhe Darakutni në "Es sifat" 57, se ai ka thënë: **"Këto hadithe janë sahihe. Dijetarët e hadithit dhe fukahatë i kanë transmetuar brez pas brezi. Ato tek ne janë të vërteta. Nuk dyshojmë rreth tyre. Mirëpo nëse thuhet: Si e ka vendosur këmbën e tij? Si ka qeshur? I themi: Kjo nuk shpjegohet dhe nuk kemi dëgjuar askënd që ta shpjegojë këtë"**.

Shejh Albani e ka konsideruar sahih këtë ether në "Muhtesarul ulu".

¹ E transmeton Bejhakui në "El esmau ues sifat" 726. Lalekai në "Sherhul usul" 737. Transmetimi i Bejhakiut është i dobët. Në të gjëndet Halef ibn Muhamed Buhariu, shejhu i Hakimit. Hakimi e ka dobësuar hadithin e tij dhe përmend që kanë shkruar shumë hadithe prej tij, por janë distancuar prej hadithit të tij, dhe i kanë shkruajtur ato vetëm që të nxirret prej tyre mësim.

² **Ether sahih.** E përmend Buahriu me talik në "Khalku efalil ibad", fq. 31, botimi i kontrolluar nga Abdurrahman Umejrah. Bejhakui në "El esmau ues sifat" 903. Uthman Darimiu në "Er redd alel

Transmetohet me sened sahih prej imamit, Sulejman ibn Harbit, thotë: Kam dëgjuar Hamad ibn Zejdin të përmendë xhehmitë dhe tha: **"Ata përpigën të thonë: Nuk ka në qiell asgjë".**¹

Ibn Ebi Hatim transmeton në librin e tij "Er reddu al el xhehmijeh" prej Said ibn Amir Dabiut, imami i Basrës në dije dhe në fe dhe profesor i imam Ahemdit, se xhehmitë u zunë në gojë te ai dhe tha: **"Fjala e tyre është më e keqe se e çifutëve dhe e të krishterëve. Çifutët, të krishterët dhe pasuesit e feve janë pajtuar së bashku me muslimanët se Allahu është mbi Arsh. Ndërsa ata thanë: Nuk ka mbi Arsh asgjë".**²

xhehmije" dhe në "En nakd". Ibn Kudame në "Ithbat sifetil ulu" nr: 83. Ibn Kajimi e përmend në "Ixhtimaul xhujush" dhe e konsideron sahih, ndërsa në fq: 213 thotë: Është saktësuar prej tij me saktësi që gati arrin gradën e tevaturit se ai është pyetur: Si e njohim zotin tonë? Tha: Ai është sipër qiejve të tij mbi Arshin e tij i ndarë nga krijesat". E përmend Bejhakui, e para tij Hakimi, e para tij Uthman Darimiu.

Atë e kanë saktësuar edhe Dhehebiu në "El ulu", Ibn Tejmije në "Mexhmulu fetaua", shejh Albani në "Mukhtesarul ulu" dhe të tjerë.

¹ **Ether sahih.** Dhehebiu e citon në "El ulu" nga libri "Er reddu al el xhehmije" nga Ibn Ebi Hatim, thotë: Më ka treguar babai, më ka treguar Sulejman ibn Harbi se ka dëgjuar Hamad ibn Zejdin të thotë: **"Ata po i sillen rrotull fjalës: Nuk ka në qiell asgjë".**

Ky sened është i vargëzuar me imamë të hadithit, nuk ka pikë dyshimi në saktësinë e tij. Më pas Dhehebiu thotë: **"Ka për qëllim xhehmitë. Them (Dhehebiu): Fjala e selefit dhe imamëve të sunetit, madje edhe e sahabëve, e Allahut, e të dërguarit dhe besimtarëve, është se Allahu është në qiell mbi Arsh sipër qiejve dhe se ai zbret për në qiellin më të afërt. Argumenti i tyre rreth kësaj janë tekset dhe hadithet.**

Fjala e xhehmive është se Allahu ndodhet në çdo vend. I lartë është Allahu prej fjalës së tyre. Përkundrazi ai është me ne kudo që jemi me dijen e tij.

Fjala e esharive të mëvonshëm është se Allahu nuk është në qiell dhe as mbi Arsh, as mbi qiej dhe as në tokë, as brenda botës dhe as jashtë botës, as nuk është i ndarë nga krijesat e tij dhe as nuk është i bashkuar me ta. Thonë: Të gjitha këto cilësi janë cilësi të trupave dhe Allahu nuk është trup.

Pasuesit e sunetit dhe etherit u janë përgjigjur: Ne nuk hyjmë në këtë çështje. Këtë që thamë, e thamë si pasim të tekseve edhe nëse pretendoni (se ato janë cilësi të trupave). Ne nuk e pranojmë fjalën tuaj sepse këto mohime që ju bëni janë vetëm përshkrim i asgjësë. I lartë është Allahu prej inekzistencës. Përkundrazi ai ekziston i dalluar prej krijesave, i cilësuar me atë që e ka cilësuar veten e tij se ai është sipër Arshit pa pyetur se si.

Pozita dhe dija e Hamad ibn Zejdit te banorët e Irakut është njësoj si pozita dhe dija e Malik ibn Enesit te banorët e Hixhazit". Mbaroi fjala e Dhehebiut.

E transmeton Abdullah ibn Ahmedi në "Es sunneh", 42 nga Ahmed ibn Ibrahim Deurekiu, nga Ali ibn Muslim Tusi, nga Sulejman ibn Harbi. Me të njëjtin sened e transmeton edhe Halali në "Es sunneh". Ebu Nuejmi e transmeton në "El hiljeh" prej Taberaniut prej Abdullah ibn Ahmed ibn Hambelit, me të njëjtin zinxhir transmetimi. Ibn Kudame Makdesiu në "Ithbatu sifetil ulu" nr: 86, nga Ethremi nga Sulejman ibn Harbi. Atë e ka saktësuar edhe shejh Shuajb Arnauti. Thotë në shqyrtimin e musnedit të imam Ahmedit (27578): "Ky ether është sahih prej Hamad ibn Zejdit. Transmetuesit e tij janë të besueshëm, prej transmetuesve të dy sahiheve, përveç Ali ibn Muslimit i cili është prej transmetuesve të Buhariut, dhe Abdullah ibn Ahmedit i cili është prej transmetuesve të Nesaiut. Të dy ata janë të besueshëm. Ky ether është prej shtesave të Abdullahit në munsned".

² Dhehebiu e citon nga i njëjti burim, në librin e tij "El ulu", por senedi i tij është i shkëputur (mursel) mes Ebi Hatimit dhe Said ibn Amirit. Ibn Tejmije përmend në "Ed der" se atë e transmeton edhe Abdullah ibn Ahmedi në "Es sunneh" (6/261). Buhariu në "Khalkul efal" fq. 31, me talik.

Muhamed ibn Is'hak ibn Huzejme, imami i imamëve, ka thënë: **"Kush nuk pohon se Allahu është sipër qiejve mbi Arshin e tij, i ndarë nga krijesat e tij, atëhere duhet t'i kërkohet pendim. Nëse pendohet mirë e në të kundërt i pritet qafa dhe hidhet në plera, që të mos mundohen pasuesit e kibles dhe as ehli-dhime prej kundërmimit të tij".**¹ E transmeton prej tij Hakimi me sened sahih.

Abdullah ibn Ahmedi, transmeton me sened të tij prej Abad ibn Avamit, imami i Vasitit, në brezin e profesorave të Shafiut dhe Ahmedit, thotë: **"Fola me Bishër Merisin dhe nxënësit e Bishrit dhe vërejtja se përfundimi i fjalës së tyre arrinte derisa thoshin: Nuk ka në qiell asgjë".**²

Imami i njohur, Abdurrahman ibn Mehdi ka thënë: **"Nuk ka në mesin e bidatçive njerëz më të këqinj se pasuesit e Xhehmit. Ata përpiqen të thonë: Nuk ka në qiell asgjë. Pasha Allahun! Unë mendoj që nuk duhen martuar dhe as trashëguar".**³

Ibn Ebi Hatim transmeton në librin e tij "Er reddu al el xhehmiye" se Abdurrahman ibn Mehdi ka thënë: **"Pasuesit e Xhehmiut përpiqen të thonë: Allahu nuk i ka folur Musës. Dëshirojnë të thonë: Në qiell nuk ka asgjë dhe Allahu nuk është mbi Arsh. Mendoj se duhet t'u kërkohet pendim. Nëse pendohen mirë, e në të kundërt vriten".**⁴

Nga Esmailu thotë: **"Erdhi grua e Xhehmiut dhe zbriti në Debagin".**⁵ Një

¹ Kjo fjalë e Ibn Huzejmes është e vërtetuar. E transmeton atë Hakimi në librin e tij "Marifet ul umil hadith", thotë: Kam dëgjuar Muahmed ibn Salihun të thotë: Kam dëgjuar Ibn Huzejmen të thotë: ..." dhe në fund shton: **"Pasuria e tij është plaçkë lufte, asnjë prej muslimanëve nuk e trashëgon, sepse muslimani nuk e trashëgon qafirin, siç ka thënë i dërguari".** E transmeton edhe nxënësi i Hakimit, imam Sabuni në "Akidet us selef", thotë: "Kam dëgjuar Hakimin ... e deri në fund të rivajetit".

² **Ether hasen.** E transmeton Darimiu në "En nakd", nga Zijad ibn Ejubi, nga Jahja ibn Ismaili, thotë kam dëgjuar Abad ibn Avamin të thotë Me të njëjtin sened e transmeton edhe Halali në "Es sunneh" (1753). Jahja ibn Ismaili është i pranueshëm (mekbul).

³ **Ether sahih.** E transmeton Abdullah ibn Ahmedi në "Es sunneh" (147). Ndërsa Ibn Bata e transmeton në "El Ibane" (327) thotë: "Na ka treguar Ebu Hafs (Umer ibn Muhamedi), thotë: na ka treguar Ebu Hafs (Muhamd ibn Daud Misisi), thotë: na ka treguar Ebu Bekr (Meruziu), thotë: na ka treguar Ebu Bekr ibn Haladi, thotë: Kam dëgjuar Abdurrahman ibn Mehdi të thotë, atëhere kur përmendej Xhehmiu dhe Bishër Merisiu: **"A e di se çfarë mendojnë? Mendojnë që nuk ka, pastaj bënte shenjë me dorën e tij nga qielli, pra nuk ka zot".** Senedi i tij është sahih.

⁴ **Ether sahih.** E transmeton Bejhakiu në "El esmau ues sifāt" (546) me sened sahih, nga Hakimi, nga Muhamed ibn Jakubi thotë: Më ka treguar Muhamde ibn Ali Ueraku (Hamdani), më ka treguar Amr ibn Abas (Ebu Uthman Bahiliu), thotë: Kam dëgjuar Abdurrahman ibn Mehdi ti thuhej: **"Xhehmitë thonë: Kurani është i krijuar. Tha: Xhehmitë nuk kanë këtë për qëllim. Ata dëshirojnë të mohojnë që Allahu është i lartësuar mbi Arsh dhe dëshirojnë të mohojnë që Allahu i ka folur Musës me fjalë. Allahu thotë: (Allahu i foli Musës me fjalë). Ata dëshirojnë të mohojnë që Kurani është fjalë e Allahut. Mendoj se atyre duhet t'u kërkohet pendim. Nëse pendohen mirë e në të kundërt u priten qafat".** Dhehebiu pasi e përmend në "El ulu" thotë: "E transmetojnë disa transmetues nga Abdurrahman ibn Mehdi me sened sahih".

⁵ Lagje e Bagdadit.

burrë në prezencën e saj tha: Allahu ﷻ është mbi Arshin e tij. Ajo i tha: I kufizuar mbi një të kufizuar?

Esmaiu tha: ***“Ajo ka bërë kufër për shkak të kësaj fjale”***.¹

Nga Asim ibn Ali ibn Asim _shejhu i Ahmedit, Buhariut dhe i brezit të tyre_ thotë: ***“Debatova me një xhehmi dhe m’u qartësua nga fjala e tij se ai nuk beson që në qiell ka zot”***.²

Transmeton imam Ahmed ibn Hanbeli thotë: Na ka treguar Surejxh ibn Numani, thotë: Kam dëgjuar Abdullah ibn Nafi Saigiu të thotë: Kam dëgjuar Malik ibn Enesin të thotë: ***“Allahu ﷻ është në qiell dhe dija e tij është kudo. Nuk i shpëton dijes së tij asnjë vend”***.³

Shafi u ka thënë: ***“Hilafeti i Ebu Bekr Sidikut ؓ është i vërtetë. Atë e ka vendosur Allahu ﷻ në qiell dhe i ka bashkuar zemrat e robërve të tij për të”***.⁴

Në hadithin sahih të Enes ibn Malikut thuhet: ***“Zejnebja u mburrej grave të profetit dhe u thoshte: Juve ju kanë martuar të afërmit tuaja ndërsa mua më ka martuar Allahu nga sipër shtatë qiejve”***.⁵ Kjo fjalë ka të njëjtin kuptim si fjala e Shafiut.

Historia e Ebu Jusufit _nxënësit të Ebu Hanifes_ për paraqitjen e Bishër Merisit për pendim është e njohur. Aq sa Bishri u arratis për të shpëtuar, sepse mohonte që

¹ E përmend Dhehebiu në “El ulu”.

² E përmend Dhehebiu në “El ulu” pa sened.

³ **Ether sahih.** Me të njëjtin sened nga imam Ahmed dhe me të njëjtin teks e transmeton Ebu Daudi në “Mesailul imami ahmed” nr: 1699. Surejxhi është i besueshëm, ndërsa Abdullah ibn Nafi megjithëse është i sigurt, mirëpo në memorien e tij nuk është shumë i fortë. Me të njëjtën rrugë nga imam Ahmed e transmetojnë edhe Ibn Kudame Makdesiu në “Ithbatu sifetil ulu” (76), Axhuri në “Esh sheriah” (652, 653) dhe shumë të tjerë. E transmeton edhe Ibn Abdulberri në “Et temhid” me sened të tij deri te Abdullah ibn Ahmed ibn Habeli, nga babai i tij, nga Surejxhi, nga Abdullah ibn Nafi, se Maliku ka thënë: ***“Allahu është në qiell dhe dija e tij është kudo. Nuk i shpëton dijes së tij asnjë vend”*** Et temhid (7/138).

⁴ **Ether i dobët.** Këtë fjalë të imam Shafiut e transmeton Ibn Kudame në “Ithbatu sifetil ulu” nga rruga e Ebu Hasen Hakariut. E përmend edhe Dhehebiu në “El ulu” dhe në “Es sijer” ku edhe e konsideron të dobët. Kjo fjalë është shkëputur nga porosia e imam Shafiut e cila transmetohet nga rruga e Ebu Hasen Hakariut. Hakariu ka qënë i dobët dhe nuk i merret fjala për bazë. Madje disa si puna e Ibn Nexharit e kanë akuzuar për shpikje hadithesh dhe montim të senedeve. Pa dyshim që ky transmetim nga imam Shafi është i dobët.

Në disa libra, si në “muhtesarul ulu”, thuhet: E transmetojnë atë Ibn Kudame dhe Ebu Hasen Hakariu me senedet e tyre. Realisht Ibn Kudame e transmeton nga Hakariu dhe rruga e tij e vetme është e Hakariut. Porosia e Shafiut që është përhapur në mesin e njerëze ka vetëm një rrugë transmetimi dhe kjo rrugë transmetimi është e dobët dhe papranueshme siç u përmend mësipër.

⁵ **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu (7420).

Allahu ﷻ të jetë sipër Arshit. Këtë histori e përmend Ibn Ebi Hatim dhe të tjerë.¹

Imami maliki i njohur, Ebu Abdullah Muhamed ibn Abdullah ibn Ebi Zemnini, në librin e tij “Usulus sunneh” ka thënë: “Kapitull rreth besimit të Arshit”.

Thotë: “Prej fjalës së ehlsunetit është se Allahu ﷻ e ka krijuar Arshin dhe e ka bërë atë krijesën më të lartë, sipër çdo krijese, pastaj u lartësua mbi të, ashtu siç dëshiroi, dhe ashtu siç njoftoi për veten e tij: **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾** Taha 5, dhe fjala e tij: **﴿pastaj u lartësua mbi Arsh. E di atë që hyn në tokë ...﴾** El hadid 4. I lartësuar qoftë ai që megjithëse është larg, por me dijen e tij është afër dhe dëgjon çdo bisedë”.

Pastaj përmend hadithin e Ebu Rezin Ukejlut: ***I thashë: O i dërguari i Allahut! Ku ishte zoti ynë para se të krijonte qiejtë dhe tokën? Tha: Në “ama”. Poshtë saj kishte “hava” dhe sipër saj kishte “hava”. Pastaj e krijoi Arshin mbi ujë.***²

Thotë Muhamed (Zemnini): “El amau” është reja e dëndur e palosur palë-palë. Kështu ka thënë Halili³”.

Pastaj përmend disa ethere të tjera dhe në vijim thotë: “Kapitull rreth besimit të Kursisë”.

Muhamed ibn Abdullahi thotë: “Prej fjalës së ehlsunetit është se Kursia ndodhet përpara Arshit dhe ajo është vendi i dy këmbëve”.

Pastaj përmend hadithin e Enesit ؓ ku përmendet shfaqja e Allahut ﷻ në ditën e xhuma në ahiret. Në këtë hadith thuhet: ***“Kur të jetë ditë e xhuma, zbret nga Iljini në Kursinë e tij. Pastaj Kursia rrethohet nga stola të artë të zbukuruar me xhevahire. Pastaj vijnë profetët dhe ulen në to.”***⁴

¹ **Ether i dobët.** E transmeton Abdurrahman ibn Ebi Hatim në librin “Er-red alel xhehmije”, siç e përmend Ibn Tejmije në “Bejanu telbisil xhehmije” (5/54), thotë: Transmeton Ibn Ebi Hatim, thotë: Na ka treguar Hasen ibn Ali Mehrani, na ka treguar Beshar ibn Musa Hafafi, thotë: **“Bishër ibn Velid Kindiu vajti te kadiu Ebu Jusuf dhe i tha: Më ndalon mua nga ilmul-kelami ndërkohë që Bishër Merisi dhe Ali Ahuali dhe filani flasin me ilmul-kelam?! I tha: Çfarë thonë? I tha: Thonë: Allahu është në çdo vend. Atëhere Ebu Jusufi u tha: Mi sillni këtu! Bishër (Merisi) u arratis, kështu që i sollën vetëm Ahualin dhe një burrë të shkuar në moshë. Ebu Jusufi vështroi nga i moshuari dhe i tha: Sikur të mos më ndalonte edukata do të fishkëlloja (me kamzhik). Pastaj urdhëroi që të futej në burg. Ndërsa Ahuelin e goditën dhe e demaskuan para njerëzve”.**

Në senedin e tij gjendet Beshar ibn Musa Hafafi, i cili është i dobët dhe gabon shumë në transmetime.

² **Hadith daif.** E transmetojnë Tirmidhiu 3109, Ibn Maxhe 182, imam Ahmedi 16188 dhe të tjerë. Të gjitha transmetimet e këtij hadithi kthehen te Veki ibn Hudusi, gjëndja e të cilit është e panjohur dhe hadithi është i dobët.

³ Halil ibn Ahmed Farahidi. Dijetari më i shquar i gjuhës arabe. Hartuesi i fjalorit të parë në botën arabe “El ajn”. Vendosi i rregullave të metrikës poetike (el arud). Vdiq në vitin 170 h.

⁴ Ky hadith është një pjesë e hadithit të njohur dhe të gjatë të Enesit ؓ, që bën fjalë për shikimin e Allahut ﷻ në xhenet çdo të xhuma. Transmetimet e tij nuk shpëtojnë nga dobësia, por janë me rrugë

Pastaj përmend atë që përmend Jahja ibn Selami, autori i tefsirit të njohur: Më ka treguar Muala ibn Hilali nga Amar Duheniu, nga Said ibn Xhubejri, nga Ibn Abasi ؓ, thotë: **"Kursia e cila ka përfshirë qiejtë dhe tokën është vendi i dy këmbëve. Ndërsa madhësinë e Arshit e di vetëm ai që e ka krijuar atë"**.¹

Pastaj përmend hadithin e Esed ibn Musës, na ka treguar Hamad ibn Seleme, nga Ziri, nga Ibn Mesudi ؓ, thotë: **"Mes qiellit më të afërt (dynjasë) dhe qiellit në vijim ka një distancë prej 500 vitesh. Mes çdo dy qiejve ka një distancë prej 500 vitesh. Mes qiellit të shtatë dhe Kursisë janë 500 vite. Mes Kursisë dhe ujit janë 500 vite. Arshi është sipër ujit dhe Allahu është sipër Arshit dhe ai e di gjëndjen tuaj"**.²

Ndërsa në kapitullin rreth besimit për perdet, thotë: **"Prej fjalës së ehlistunetit është se Allahu ؓ është i ndarë nga krijesat dhe mes tij dhe krijesave ka perde ndarëse pas të cilës fshihet. I lartë është Allahu ؓ nga ajo që thonë të zullumqarët. ﴿E rëndë është fjala që del nga gojët e tyre. Ata po thonë vetëm shpifje﴾ El kehf 5.**

Pastaj përmend disa ethere rreth perdeve penguese.

Ndërsa në kapitullin e besimit për zbritjen, thotë: Prej fjalës së ehlistunetit është se Allahu ؓ zbret për në qiellin e dynjasë. Ata e besojnë zbritjen, por pa e përshkruar atë. Pastaj përmend hadithin që e transmeton Malkiu dhe të tjerë.

transemtimi të shumta dhe arrijnë gradën e hadithit hasen. Ndërsa shtesa se Allahu zbret nga Arshi për në Kursi, apo zbret nga Arshi në një luginë të xhenetit, kjo shtesë transmetohet nga rivajeti i Uthman ibn Umejrit i cili është i dobët dhe nga Umr ibn Abdullah meula i Gafras, rreth të cilit dijetarët janë kundërshtuar dhe shumë prej tyre e kanë dobësuar. Dhe Allahu është më i ditur.

¹ **Ether sahih.** Është saktësuar vetëm si fjalë e Ibn Abasit por jo si fjalë e profetit. E transmeton Hakimi në "El mustedrek" (3116). Dhehebiu thotë: Sipas kushtit të Buhariut dhe Muslimit, Ibn Huzejme në "Et teuhid" (1/248) nga rruga e Sufjan Theuriut, nga Amar ibn Muavije Duheniu, nga Muslim ibn Umran Batini, nga Said ibn Xhubejri nga Ibn Abasi. Ky sened është sahih. Me të njëjtën rrugë transmetimi e transmetojnë edhe Bejhakui në "El esmau ues sifāt" (758), Daja Makdesiu në "El ehadithul muhtarāh" (331), Ebu Shejh Asfahani në "El adhemeḥ" (2/582), Taberani në "El muxhemul kebir". Abdullah ibn Ahmedi në "Es sunneh" (586), etj. Ibn Ebi Zemnini _siç e përmend Ibn Tejmi_ këtu _e transmeton nga rruga e Jahja ibn Selamit, nga Muala ibn Hilali, nga Amari, nga Saidi nga Ibn Abasi. Ibn Haxhr Askalani në "El fet'h" thotë: "E transmeton edhe Ibn Ebi Hatim nga një rrugë tjetër nga Ibn Abasi se Kursiu është vendi i dy këmbëve. E transmeton edhe Ibn Mundhiri me sened sahih prej Ebu Musa (Eshariut) me të njëjtin teks". Fetul bari, 8/199. Atë e ka saktësuar edhe shejh Ahmed Shakir në "Umdetul tefasir" 1/312.

² **Ether i saktë.** E transmeton Uthman ibn Saidi në "En nakd" nga Hamad ibn Seleme, nga Asim ibn Behdele, nga Zir ibn Hubejsh, nga Abdullah ibn Mesudi. Ky sened është sahih. Transmetuesit e tij janë transmetues në dy sahihet. Me të njëjtën rrugë transmetimi e transmeton edhe Taberani në "El kebir" (8987), Dhehebiu në "El ulu" (74), Bejhakui në "El esmau ues sifāt" (851), Ibn Huzejme në "Et teuhid" (1/242), Ebu Shejh Asfahani në "El adhemeḥ" (2/688), Lalekai në "Sherh usulil itikad" (659).

Ebu Shejh Asfahani e transmeton nga rruga e Mesudit nga Asimi, nga Ziri, nga Ibn Mesudi ؓ në librin e tij "El adhemeḥ" (2/565). Po kështu edhe Ibn Bata Ukburi në "El ibanetul kubra" (128). Bejhakui e transmeton edhe nga rruga e Asim ibn Behdele, nga Ebu Uail, nga Ibn Mesudi ؓ, në "El esmau ues sifāt" (852). E përmend Ibn Hajthemiu në "El mexhma" (352) dhe thotë: "E transmeton Taberani në "El kebir". Senedi i tij është sahih. Transmetuesit e tij janë transmetues të sahihut".

Derisa thotë: “Më ka njoftuar Vehbi nga Ibn Vedahi nga Zuhejr ibn Abadi¹, thotë: **"Kam arritur prej dijetarëve Malikun, Sufjanin, Fudejl ibn Ijadin, Isa ibn Mubarekun dhe Vekiun. Të gjitha ata thonin: Zbritja është e vërtetë".**²

Ibn Vedahu ka thënë: **"Kam pyetur Jusuf ibn Adijin për zbritjen dhe më tha: Po! E besoj atë, por nuk e përshkruaj atë me hollësira. Kam pyetur për të edhe Ibn Mainin dhe më tha: Po! E besoj atë, por nuk e përshkruaj atë me përshkrim".**³

Muhamedi⁴ thotë: Ky hadith sqaron se Allahu ﷻ është mbi Arsh, në qiell dhe jo në tokë. Kjo është e qartë, si në librin e Allahut ﷻ ashtu edhe në shumë hadithe të profetit ﷺ. Allahu ﷻ thotë: **﴿e drejton çështjen prej qiellit për në tokë e pastaj ngjitet tek ai﴾** Es sexhde 5. Dhe thotë: **﴿A mos vallë u siguruan prej atij që është në qiell se mos jua përmbys tokën dhe papritmas ajo fillon të lëkundet. Apo jeni siguruar prej atij që është në qiell se mos ju dërgon ndonjë rrebesh gurësh﴾** El mulk 16-17.

Dhe thotë: **﴿Te ai ngjitet fjala e mirë dhe punën e mirë e ngre﴾** Fatir 10. Dhe thotë: **﴿Ai është ngadhënjyesi sipër robërve të tij﴾** El enam 18. Dhe thotë: **﴿O Isa! Unë do të t'i marrë ndjenjat dhe do të të ngrejë tek unë﴾** Ali imran 55. Dhe thotë: **﴿Por Allahu e ngjiti te ai﴾** En nisa 158.

Pastaj përmend prej transmetimit të Malikut fjalën e profetit ﷺ drejtuar robërshës: **"Ku është Allahu? Tha: Në qiell. I tha: Kush jam unë? Tha: Ti je i dërguari i Allahut. Tha: Liroje atë".**⁵

Thotë: “Të tilla hadithe janë të shumtë. I madhëruar është ai, dija e të cilit për atë që është në qiell është njësoj si dija e tij për atë që është në tokë. Nuk ka ilah tjetër përveç tij dhe ai është më i larti dhe më i madhi”.

Para kësaj thotë: "Besimi i emrave dhe i cilësive të Allahut". Thotë: “Dije se dijetarët që e njohin Allahun ﷻ dhe atë me të cilën kanë ardhur profetët dhe të dërguarit e tij, e konsiderojnë mosnjohjen e asaj për të cilën Allahu nuk ka njoftuar për veten e tij, pikërisht ajo është dija. E konsiderojnë paafësinë e arritjes së asaj për të cilën nuk jemi thirrur, pikërisht ajo është imani. Në cilësimin e Allahut ﷻ me emra dhe cilësi ata ndalen aty ku është ndaluar libri i tij dhe profeti i tij ﷺ. Allahu ﷻ thotë, dhe ai është thënësi më i drejtë: **﴿Çdo gjë do të shkatërrohet përveç fytyrës së tij﴾** El kasas 88.

¹ Zuhejr ibn Abadi, prej dijetarëve të Kufes. Djali i xhaxhait të Veki ibn Xherahut. I besueshëm në transmetime. Vdiq në vitin 238 h.

² **Ether hasen.** Ibn Ebi Zemnini e transmeton këtë fjalë prej Vehb ibn Meserra Andalusi, nga Muhamed ibn Uedah Kurtubiu, i cili ka qënë saduk.

³ **Ether hasen.** Më sipër u përmend që Ibn Uedah ka qënë saduk dhe këto fjalë nuk janë transmetime hadithesh, prandaj dhe nuk shtrëngohemi në pranimin e tyre.

⁴ Ibn Ebi Zemnini.

⁵ **Hadith sahih.** E transmeton Muslimi dhe të tjerë. U përmend mëparë.

Dhe thotë: **«Thuaj: Cila gjë e ka dëshminë më të madhe? Thuaj: Allahu është dëshmitar mes meje dhe mes jush»** El enam 19. Dhe thotë: **«Dhe Allahu ju tërheq vërejtjen për veten e tij»** Ali imran 30. Dhe thotë: **«E kur ta formojë atë dhe të fryjë në të prej shpirtit tim»** Sad 72. Dhe thotë: **«Ti je në sytë tanë»** Et tur 48. Dhe thotë: **«E që të rritesh në sytë e mi»** Taha 39.

Dhe thotë: **«Çifutët thanë: Dora e Allahut është e shtrënguar. U shtrëngofshin duart e tyre dhe u mallkofshin për këtë që thanë. Përkundrazi! Dy duart e tij janë të shtrira me bujari»** El maideh 64. Dhe thotë: **«E gjithë toka do jetë në mbërthimin e tij në ditën e ringjalljes ...»** Ez zumer 67. Dhe thotë: **«Unë jam me ju, dëgjoj dhe shikoj»** Taha 46. Dhe thotë: **«Allahu i foli Musait me fjalë»** En nisa 164. Dhe thotë: **«Allahu është ndriçuesi i qiejve dhe i tokës»** En nur 35. Dhe thotë: **«Allahu është ai përveç të cilit nuk ka ndonjë ilah tjetër, i gjalli dhe mbikëqyrësi»** El bekare 255. Dhe thotë: **«Ai është i pari dhe i fundit, i larti dhe i afërti»** El hadid 3.

Të tilla ajete në Kuran ka shumë. Allahu i lartë është ndriçuesi i qiejve dhe i tokës ashtu siç ka njoftuar për veten e tij. Ai ka fytyrë dhe vetë dhe të tjera gjëra me të cilat e ka cilësuar veten e tij. Ai dëgjon, shikon dhe flet. Ai është i amshuari përpara të cilit nuk ka asgjë, i pafundi i cili ekziston pafundësisht. Ai është i larti sipër çdo gjëje, dhe i afërti me krijesat me dijen e tij. Allahu ﷻ thotë: **«Ai me çdo gjë është i ditur»** El bekare 29. Ai është mbikëqyrës, i gjallë. Nuk e kap atë as kotja dhe as gjumi”.

Pastaj përmend hadithet e cilësive dhe në vijim thotë: “Këto janë cilësitë e zotit tonë, me të cilat e ka cilësuar veten e tij në Kuran dhe e ka cilësuar profeti i tij ﷺ. Në asnjë prej këtyre (cilësive) nuk ka përshkrim hollësirash, përngjasim apo formëzim. **«Asgjë nuk është si ai dhe ai është dëgjuesi shikuesi»** Esh shura 11. Sytë nuk e kanë parë atë që ta përkufizojnë se si është. Mirëpo e kanë parë atë zemrat me vërtetësinë e besimit”.¹

Fjalët e imamëve në këtë çështje janë më të gjata dhe më të shumta. Kjo fetva nuk mund të përfshijë as një të dhjetën e tyre. Po kështu edhe fjala e cituesve të medhhebit të tyre. Si ajo që përmend Ebu Sulejman Hatabiu² në risalen e tij të njohur "El gunjetu anil kelami ue ehlihi", thotë:

"Përsa i takon pyetjes që po bën për cilësitë dhe çfarë përmendet prej tyre në Kuran dhe sunet, atëhere medhehbi i selefit është pohimi i tyre dhe kalimi i tyre në aparencën e tyre, bashkë me mohimin e formëzimit dhe përngjasimit të tyre. Disa i mohuan cilësitë duke mohuar kështu, atë që Allahu ﷻ e ka pohuar. Ndërsa disa të tjerë

¹ Përfundoi citimi i shkëputur prej librit “Usulus sunneh” të Muhamed ibn Ebi Zemnit.

² Ebu Sulejman Hatabiu, dijetar hanbeli i njohur. Dijetar i fikhut, hadithit dhe gjuhës arabe. Megjithëse ka shkruar për refuzimin e ilmul-kelamit, mirëpo faktikisht ka qënë ndikuar nga mendimet e disa esharive në kohën e tij. Vdiq në vitin 388h.

prej pohuesve, u thelluan aq thellë në pohimin e cilësive saqë përfunduan në një lloj përngjasimi dhe formëzimi. E vërteta është në ndjekjen e rrugës së drejtë e cila gjëndet mes këtyre të dyjave. Feja e Allahut ﷻ është në mes ekzagjeruesit në fe dhe neglizhuesit anashkalues.

Kjo çështje kthehet te rregulli se të folurit rreth cilësive është derivat i të folurit rreth qënies (së Allahut), prandaj ndiqet e njëjta metodë. Nëse dihet që pohimi i krijuesit të madhërishëm është pohim ekzistence dhe jo pohim forme, po ashtu edhe pohimi i cilësive të tij është pohim ekzistence dhe jo pohim përkufizimi detajor apo formëzim. Nëse themi: Dorë, dëgjon, shikon, e të tjera si këto, atëhere ato janë cilësi që vetë Allahu ﷻ i ka pohuar për veten. Mirëpo nuk themi: Kuptimi i dorës është fuqia apo mirësia. Nuk themi: Kuptimi i dëgjimit dhe i shikimit është dija. Nuk themi ato janë gjymtyrë. Nuk i përngjasojmë ato me duart, dëgjimet dhe shikimet të cilat janë me gjymtyrë dhe aparate veprimi.

Por themi: Pohimi i cilësive është detyrë sepse me të ka ardhur shpallja hyjnore. Edhe mohimi i përngjasimit është detyrë sepse asgjë nuk është si Allahu ﷻ. Këtë metodë kanë ndjekur selefi në hadithet e cilësive". Kjo ishte e gjithë fjala e Hatabiut.

Kështu thotë edhe Ebu Bekr Hatibi¹ në një nga letrat e tij ku shprehet se medhhebi i selefit është i tillë.

Me të njëjtat fjalë si të Hatabiut janë shprehur edhe dijetarë të tjerë të shumtë, të cilët nuk mund të përmbliiden për shkak të numrit të madh. Prej tyre Ebu Bekr Ismaili, imami Jahja ibn Amar Sixhziu, i cili është shejhu i shejhul-islam Ebu Ismail Hereviut dhe shejhul-islam Ebu Uthman Sabuni² dhe Ebu Umer ibn Abdulberr Nemriu imami i krahinave perendimore dhe të tjerë.

Ebu Nuejm Asfahaniu, autori i “El hiljeh”, në parathënien e një libri të tij në akide, thotë: “Rruga jonë është rruga e pasuesve të Kuranit, të sunetit dhe të konsensusit të umetit”.

Thotë: “Prej gjërave që kanë besuar është se hadithet e vërtetuara prej profetit ﷺ rreth Arshit dhe istivasë së Allahut ﷻ, ata i pranojnë dhe i pohojnë pa formëzim, pa shëmbëllim dhe pa përngjasim. Ata besojnë se Allahu ﷻ është i ndarë nga krijesat dhe krijesat janë të ndara nga Allahu ﷻ. Nuk hyn brenda tyre dhe as nuk përzihet me ta. Ai është i lartësuar mbi Arsh në qiell dhe jo në tokë dhe as me krijesat”.

¹ I njohur ndryshe si Hatib Bagdadiu (392-463 h.). Nga dijetarët e mëdhenj të hadithit. Imam në sunet dhe fakih shafi. Prej librave të tij “Tarihu Bagdad”, “Nderimi i pasuesve të hadithit”, “Fakihu dhe kërkuesi i fikhut” etj. Fjalën e Hatib Bagdadiut e citon Dhehebiu në librin “El ulu” të plotë.

² Ebu Uthman Sabuni, dijetar shafi, mufesir dhe muhadith i njohur. Është quajtur shejhislam. Autori i librit “Akidja e pasuesve të hadithit”. Bejhakui ka thënë për të: “Na ka treguar imami i muslimanëve pa ekzagjerim, shejhuislami padyshim, Ebu Uthman Sabuni ...” Vdiq në vitin 449 h.

Hafidh Ebu Nuejmi në librin e tij “Mehaxh-xhetul uathikine ue medrexhetul uamikin” thotë: “Ata janë pajtuar në një mendje se Allahu ﷻ është sipër qiejve, i lartësuar mbi Arsh. Nuk themi që (istivaja) është sundimi ashtu siç thonë xhehmitë, duke pretenduar se ai është kudo. Ata kanë kundërshtuar atë që është zbritur në Kuran: **﴿A jeni siguaruar prej atij që është në qiell﴾** El mulk 16, **﴿Te ai ngjitet fjala e mirë﴾** Fatir 10, **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh i lartësua﴾** Taha 5. I tiji është Arshi mbi të cilin është lartësuar dhe Kurisa e cila ka përfshirë qiejt dhe tokën, siç thuhet në fjalën e tij: **﴿Kursia e tij ka përfshirë qiejt dhe tokën﴾** El bekare 255. Kursia është trup dhe shtatë qiejt dhe tokat janë përpara saj, si një unazë e hedhur mes shkretëtirës. Kursia nuk është dija e tij ashtu siç pretendojnë xhehmitë. Përkundrazi, Kursia e tij do të vendoset në ditën e gjykimit kur të gjykohet mes krijesave, siç ka thënë profeti ﷺ se Allahu i lartë do të vijë në ditën e gjykimit për të gjykuar mes robërve të tij, ndërsa melekët do të jenë të rreshtuar rreshta rreshta, siç thotë: **﴿Dhe vjen zoti yt dhe melekët rreshta rreshta﴾** El fexhr 22. Allahu i lartësuar vjen në ditën e gjykimit për të gjykuar mes robërve dhe fal kë dëshiron prej njësuesve gjynahqarë dhe dënon kë dëshiron, ashtu siç thotë: **﴿Fal kë dëshiron dhe dënon kë dëshiron﴾** Ali imran 129”.

Imami Mamer ibn Ahmed Asfahaniu¹, shejhu i sufive në krahinën e tij në shek. IV, thotë: “Dëshiroj t’i porosis shokët e mi, me një porosi prej sunetit dhe një predikim prej urtësisë, për të cilën janë pajtuar pasuesit e hadithit dhe të etherit, pasuesit e dijes dhe të sufizmit, prej të parëve dhe të mëvonëshmeve”.

Në këtë porosi shprehet: “Allahu ﷻ është i lartësuar mbi Arsh, pa formë, pa përngjasim dhe pa tavil. Istivaja është e njohur ndërsa forma e panjohur. Ai është i lartësuar mbi Arsh, i ndarë prej krijesave dhe krijesat janë të ndara prej tij. Ai nuk përzihet, nuk hyn dhe nuk takohet me krijesat, sepse ai është një i vetëm, i ndarë nga krijesat dhe i panevojshëm për to.

Allahu ﷻ është dëgjues, shikues, i ditur, i mirëinformuar, flet, kënaqet, zemërohet, qesh, çuditet, u shfaqet robve të tij në ditën e gjykimit duke qeshur, zbret çdo natë për në qiellin e dynjasë ashtu siç dëshiron dhe thotë: “**A ka ndonjë lutës që t’i përgjigjem? A ka ndonjë që kërkon falje që ta fal? A ka ndonjë të penduar që t’ia pranoj pendimin? Derisa të agojë agimi**”.²

Zbritja e Allahut ﷻ për në qiell është pa formë, pa përngjasim dhe pa tavil. Kush e mohon zbritjen apo i bën tavil ai është bidatçi i humbur. Edhe dijetarët e

¹ Mamer ibn Ahmed Asfahaniu, shejh dhe asket i njohur i sufive në krahinën e Asfahanit. Vdiq në vitin 418h.

² **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu (1145) dhe Muslimi (1/521) dhe shumë transmetues të tjerë, nga sahabë të ndryshëm.

zgjedhur prej arifëve¹ ndjekin të njëjtën rrugë si ne”.

Shejhu dhe imami Ebu Bekr Ahmed ibn Muhamed ibn Harun Halali² në librin “Es sunneh” thotë: “Na ka treguar Ebu Bekr Ethremi, na ka treguar Ibrahim ibn Harith _ka për qëllim Abadin_ na ka treguar Lejth ibn Jahja, thotë: Kam dëgjuar Ibrahim Esh’athin _ai është kolegu i Fudejlit_ thotë: Kam dëgjuar Fudejl ibn Ijadin të thotë: **“Ne nuk na takon të përfytyrojmë se si është Allahu. Sepse Allahu e ka përshkruar veten e tij në mënyrë të përsosur kur tha: ﴿Thuaj: Ai është Allahu i vetëm. Allahu është zotëria. As nuk është lindur dhe as ka lindur kënd dhe askush nuk është i barabartë me të﴾. Nuk ka ndonjë cilësi më të përsosur sesa cilësimi që i ka bërë vetes së tij. Zbritja, qeshja, mburrja dhe vështrimi janë ashtu siç dëshiron të zbresë, ashtu siç dëshiron të mburret, ashtu siç dëshiron të qeshë, ashtu siç dëshiron të vështrijë. Ne nuk na lejohet të përfytyrojmë kështu apo ashtu. Nëse xhehmiu të thotë: Unë bëj kufër me një zot që zhvendoset prej vendit të tij, atëhere ti ktheja: Unë besoj me një zot që vepron çfarë të dojë”.**³

¹ Arif (عارف) është një term sufist që nënkupton njeriun e devotshëm i cili ka arritur një gradë shumë të lartë në njohjen e Allahut.

² Imam Ebu Bekr Halali (234-311h), shejhu i hanbelive në kohën e tij dhe dijetar i njohur i hadithit. Dhehebiu thotë për të: “Imami, dijetari, hafizi (i hadithit), fakihu, shejhu dhe dijetari i hanbelive, Ebu Bekr ibn Ahmed ibn Muhamed ibn Harun ibn Jezid Bagdadiu Halali. U lind në vitin 234h ose në vitin pasardhës. Mund edhe ta ketë parë imam Ahmedin. Mirëpo fikhun e ka marrë nga shumë nxënës të Ahmedit dhe ai vetë ka qënë nxënës i Ebu Bekr Meruziut ...

Udhëtoi në Persi, Sham dhe në gadishullin arabik për të kërkuar fikhun e imam Ahmedit, fetvatë dhe përgjigjet e tij. E shkruajti dijen prej të mëdhnjve dhe të vegjëlvë, aq sa e shkruante edhe prej nxënësve të tij. E mblodhi (dijen) dhe e përvetësoi. Pastaj shkroi librin “Përmbledhësi i fikhut” prej fjalëve të imam Ahmedit, në 20 vëllime. I gjithë libri është rivajete “na ka treguar” dhe “na ka njoftuar”. Hartoi librin “El ilel” (problemet e hadithit) të marra prej Ahmedit në tre vëllime. Hartoi edhe librin “Es sunneh” dhe fjalët e Ahmedit (rreth sunetit) dhe argumentet që forcojnë fjalën e tij prej haditheve, në tre vëllime.

Këto vepra dëshmojnë për imametin e tij dhe diapazonin e gjërë të dijes. Imam Ahmedi nuk ka pasur përpara Halalit një medhheb të veçantë, derisa ai i ndoqi fjalët e Ahmedit dhe i shkruajti dhe u argumentua për të, aty nga fillimi i shekullit të katërt. Allahu i lartësuar e mëshiroftë”. Sijeru alamin nubela, vëll. 11, fq: 184.

³ Ibrahim ibn Eshathi ka qënë shërbëtori i Fudejl ibn Ijadit. Ibn Hibani e përmend në librin e tij “Eth thikat” ka thënë për të: “Ka qënë mik i Fudejl ibn Ijadit. Transmeton prej Fudejlit predikimet e tij. Transmeton prej tij Abd ibn Hamid Kishiu. Transmeton thënie garibe, të veçuara, gabon dhe kundërshton”. Pra kundërshton ata që janë më të besueshëm se ai. “Eth thikat” 12276, (8/66)

Hakimi, në “Et tarih” thotë: “Kam lexuar prej shkrimit të Mustemliut: Na ka treguar Ali ibn Hasen Hilaliu, na ka treguar Ibrahim ibn Eshathi shërbëtori i Fudejlit, ai ka qënë i besueshëm (thikah). Kemi shkruar prej tij në Nejsabur”. Lisanul mizan 1/36, nr: 68. Ka transmetuar një hadith të kotë (batil) prandaj dhe e ka humbur vlerën e dijetarët, siç e përmend Ebu Hatim.

Darakutni ka thënë: “Ibrahim ibn Eshathi është i dobët. Transmeton prej të besueshmve gjëra që nuk kanë baza”. Talikat ed darakutni alal mexhruh, (1/95). Gjithashtu Lejth ibn Jahja nuk njihet kush është.

Këtë fjalë të Fudejlit nuk e transmeton kush përveç Halalit dhe senedi i tij nuk është i besueshëm. Pjesën e fundit “Nëse xhehmiu të thotë ...” e përmend imam Buhariu në “Khalku efalil ibad” por pa sened.

Këtë thënie të Fudejlit e kanë transmetuar disa dijetarë, prej tyre Buhariu në “Khalku efalil ibad”.¹

Këtë thënie të Fudejlit e transmeton edhe shejhul islami me senedin e tij në librin “El faruk” thotë: “Na ka treguar Jahja ibn Amari, na ka treguar babai im, na ka treguar Jusuf ibn Jakubi, Na ka treguar Haremi ibn Ali Buhariu dhe Hani ibn Nadri, nga Fudejli.”²

Amr ibn Uthman Mekiu³ në librin me titull “Et tearrufu bi Ahualil ibadi uel muteabbidin” thotë: “Kapitull rreth mashtrimeve të shejtanit për të penduarit”. Pastaj shpjegon se si shejtani, fillimisht i shtyn ata në pesimizëm, pastaj në vetëpëlqim dhe në shpresa të kota, derisa t’i mashtrojë në teuhid. Thotë: “Prej vesveseve më të mëdha të shejtanit në teuhid është hedhja e dyshimeve në cilësitë e zotit, ose me përngjasim dhe shëmbëllim, ose me mohim dhe **tatil**”.

Pas hadithit të vesveseve thotë: “Dije, Allahu të mëshiroftë, se çdo gjë që e përfytyron me zemër apo e imagjinon në mendje, çdo bukuri, hijeshi, vezullim apo rrezatim që e ndien me zemër, apo ndonjë vegim rrëmbimthi ose ndonjë person i mishëruar, dije me bindje të plotë se Allahu është ndryshe, sepse Allahu ﷻ është më i madhërishëm, më madhështor dhe më i madh. A nuk e ke dëgjuar fjalën e tij: **﴿Asgjë nuk është si ai﴾** Esh shura 11, dhe fjalën e tij: **﴿Askush nuk është i barabartë me të﴾** El ihlas 4. Pra ai nuk ka të përngjashëm, kopje, të barabartë apo shëmbëlltyrë.

Kur Allahu ﷻ iu shfaq malit, ai u shkërmoq copa-copa prej madhërisë së tij dhe prej madhështisë së sundimit të tij. Ashtu siç shkërmoqet çdo gjë që Allahu i shfaqet, po ashtu shkatërrohet çdokush që përpiket ta përfytyrojë atë. Që t’i shmangesh kësaj, duhet të bazohesh në sqarimin që Allahu ka bërë në librin e tij, për mohimin e përngjasimit, shëmbëllimit, kopjes dhe barazimit.

Nëse edhe këtu i bën ballë shejtanit, atëhere ai të orvatet nga porta e mohimit të cilësive të zotit, të përmendura në Kuran dhe në sunetin e profetit Muhamed ﷺ, dhe të thotë: Nëse cilësohet me këtë gjë, apo cilësimi i tij nënkupton përngjasim, atëhere mohojë. Sepse ky lanet dëshiron që të shkasësh dhe të humbasësh, dëshiron që të futesh në turmën e të devijuarve dhe të mohuesve të cilësive të zotit.

Dije, Allahu të mëshiroftë, se Allahu i lartë është një, jo si gjërat e tjera. Ai është i vetëmi dhe zotëria. Prej askujt nuk është lindur, askënd nuk ka lindur dhe askush nuk

¹ Buhariu e përmend vetëm pjesën e fundit “Nëse xhehmio të thotë: Unë nuk besoj në një zot që zhvendoset atëhere ti thuaj: Unë besoj në një zot që vepron çfarë të dëshirojë” pa sened, por në formë aprovimi. Aprovimi i imam Buhariut për këtë fjalë dëshmon që kjo fjalë si kuptim është e vërtetë dhe se vetë Buhari mendon kështu.

² Në zinxhirin e transmetimit janë dy persona të panjohur.

³ Ebu Abdullah Mekiu, dijetar sufi dhe usulist. Nxënës i Xhunejdut. Jetoj në Bagdad dhe ka qënë i njohur për kundërshtimet e tij kundër Halaxhit. Vdiq në vitin 297 h.

është i barabartë me të".

Deri kur thotë: "Emrat e tij të ndritur janë të përkryer. Ato kanë ekzistuar realisht që në amëshim. Allahut tebareke ue teala nuk i është shpikur ndonjë cilësi të cilën nuk e ka pas poseduar, apo ndonjë emër me të cilin nuk ka qënë emërtuar. Ai ka qënë udhëzues që do të udhëzonte dhe krijues që do të krijonte, furnizues që do të furnizonte, falës që do të falte, veprues që do të vepronte. Nuk i është shpikur atij "istivaja" veçse ai ka qënë i cilësuar se do e vepronte këtë vepër (istivanë) dhe do të cilësohej me të në tërësinë e veprave të tij.

Allahu i lartë thotë: **﴿Dhe vjen zoti ytë me melekët rreshta rreshta﴾** El fexhr 22. Kuptimi i ajetit është se ai do të vijë në të ardhmen. Atij nuk i është shpikur cilësia për shkak të ardhjes dhe vonimit të veprimit deri në çastin e ardhjes, sepse ai është ardhës që do të vijë. Atëhere ardhja është reale dhe cilësi e tij, e cila nuk përshkruhet me "si" dhe as nuk përngjasohet, sepse ai është veprim i zotit. Logjika mbetet çalë dhe fryma të zihet, atëhere kur dëshiron të arrish formën e të adhuruarit.

Prandaj mos ano nga asnjë prej këtyre dy anëve. Mos ji as mohues dhe as përngjasues. Kënaqu me atë që është kënaqur Allahu ﷻ për veten e tij. Ndalo te fjala e tij për veten e tij, duke e pohuar me dorëzim dhe vërtetim, pa bërë dallim dhe pa gërmuar për hulumtim".

Deri kur thotë: "Allahu ai është thënësi **﴿Unë jam Allahu﴾** El kasas 30, dhe jo pema, prandaj ai është i ardhuri përpara se të vijë, dhe jo urdhëri i tij. Vetë ai do t'ua shfaqet evlijave të tij në ditën e ringjalljes dhe do t'ua zbardhë fytyrat, ndërsa mohuesve do t'ua shpalosë argumentet pa mëdyshje. Ai është i lartësuar mbi Arsh me madhërinë e madhështisë së tij, sipër çdo vendi. Ai i ka folur Musës ﷺ me fjalë dhe i demostroi prej ajeteve të tij. Musai ﷺ e dëgjoi fjalën e Allahut ﷻ sepse Allahu ﷻ e afroi atë te vetja për bisedim. I madhëruar është ai prej fjalës "i krijuar" apo "i zotëruar". Ai është trashëguesi i krijesave të tij brez pas brezi. Ai i dëgjon zërat e tyre, i shikon trupat e tyre me sytë e tij. Dy duart e tij janë bujare. Me dy duart e tij nuk nënkuptohet mirësia. E krijoi Ademin ﷺ dhe e fryu në trupin e tij shpirtin e tij. Shpirti i tij këtu është urdhëri i tij¹. I pastër dhe i lartë është ai prej mishërimit në trupa, apo përzierjes me trupa, apo përputhjes me ta. I lartë është Allahu prej kësaj.

Ai është dëshiruesi i cilësuar me dëshirë, i dituri i cilësuar me dije. Ai i shtrin duart e tij për të dhuruar mëshirë. Ai zbret çdo natë për në qiellin e dynjasë, që krijesat t'i afrohen me adhurim dhe atij t'i drejtohen për hallet dhe kërkesat. Ai është i afërti i

¹ Urdhëri i tij "bëhu". Shpirti të cilin Allahu e ka fryrë në trupin e Ademit është i krijuar, njësoj si shpirtat e pasardhësve të tij. Ndërsa artiubimi i shpirtit ndaj Allahut si "Shpirti i Allahut" apo "Shpirt prej Allahut" është artiubim krijimi dhe posedimi, jo atribim cilësimi, njësoj siç thuhet për Qaben "Shtëpia e Allahut" apo "Haremi i Allahut".

cili është më afër damarit të qafës, i largëti në lartësinë e tij mbi çdo vend të largët dhe nuk përngjasohet me njerëzit”.

Deri kur thotë: “**﴿Te ai ngjitet fjala e mirë dhe punën e devotëshme e ngre﴾** Fatir 10, dhe thotë: **﴿A u siguruat prej atij që është në qiell se mos jua përmbys tokën dhe papritmas ajo fillon të lëkundet. Apo u siguruat prej atij që është në qiell se mos ju dërgon ndonjë rrebesht gurësh﴾** El mulk 16-17. I lartë dhe i pastër është ai prej qënies në tokë ashtu siç është mbi qiell. I madhërishëm është ai prej kësaj”.

Imami Ebu Abdullah Harith ibn Ismail ibn Esed Muhasibiu¹ në librin me titull “Fehmul kuran” gjatë trajtimit të çështjes së “abrogimit” thotë: “Abrogimi nuk mund të ndodhë në lajme”².

Thotë: “Nuk i lejohet askujt të besojë se lavdërimi i Allahut, apo emrat dhe cilësitë e tij mund të abroget diçka prej tyre”.

Deri kur thotë: “Pasi të na tregojë se cilësitë e tij janë të bukura dhe të larta, nuk është e mundur të na tregojë se ato janë të shëmtuara dhe të ulta. Kështu Allahu e paska cilësuar veten e tij me mosnjohjen e gajbit, pasi na pati njoftuar se ai është njohës i gajbit.

Ai nuk mund të na njoftojë se nuk shikon atë që ka qënë, dhe as i dëgjon zërat, dhe as nuk ka fuqi, as nuk flet, dhe as nuk ka folur ndonjë fjalë, apo se ai është nën tokë dhe jo mbi Arsh. I madhërishëm dhe i lartë është Allahu prej kësaj.

Nëse e kupton dhe bindesh për këtë, do e kuptosh se çfarë lejohet të abroget

¹ Harith Muhasibiu (170-243h). Dijetar i njohur i Bagdatit. I shquar në fikh dhe në tasevuf. Nxënës i Ibn Kulabit dhe hartues i disa librave në akide. Imam Ahmedi pati urdhëruar që të braktisej një farë kohe, sepse pati zgjedhur mendimin e Ibn Kulabit, i cili e mohon ndodhjen e veprimeve që lidhen me dëshirën, në vetë qënien e Allahut. Thuhet se Muhasibiu është kthyer nga ky mendim. Hatib Bagdadiu ka thënë: “Ka përpiluar shumë libra rreth zuhdit, akides dhe replikave me mutezilitë dhe rafidat”.

Dhehebiu thotë: “Pozita e Muhasibit është e lartë. E ka futur veten në disa çështje të ilmul-kelamit prandaj dhe është refuzuar. Transmetohet që Ahmedi e ka lavdëruar nga një aspekt dhe ka tërhequr vërejtje ndaj tij në një aspekt tjetër”.

Ibn Tejmije e përmend fjalën e Muhasibit këtu, sepse pozita e Muhasibit të esharitë nuk është e vogël. Ai dëshiron t’u thotë esharive të kohës së tij: Shikoni çfarë thonë të parët tuaj. Shikoni ku janë ata e ku jeni ju në bazat e akides.

² Kjo është një çështje e njohur në usul-fikh. Abrogimi, në kumtesën fetare dhe në sheriat, ndodh vetëm në urdhërat dhe ndalesat që lidhen me veprat e njerëzve (fjalitë nxitëse). Si rasti kur profeti ﷺ ka ndaluar prej vizitës së varrezave dhe më pas ka urdhëruar që të vizitohen.

Ndërsa fjalitë dëftore në sheriat, të cilat kumtojnë fakte të realitetit, nuk mund të abroghen, sepse abrogimi i tyre nënkupton që njëri prej fakteve është i rremë dhe tjetri i vërtetë. Pra kumtuesi ose ka gënjer ose ka qënë i paditur dhe pastaj e ka njohur realitetin.

P.sh. nëse thuhet: Në varr do të ketë dënim për pabesimtarët, dhe më vonë thuhet: Në varr nuk do të ketë dënim për pabesimtarët, ky është një abrogim. Pohimi i këtij lloji abrogimi për Allahun, të çon deri në kufër, sepse është akuzim i Allahut me gënjeshtëri dhe mashtrim ose me padije.

dhe çfarë nuk lejohet. Nëse lexon ndonjë ajet, që në pamje të parë të duket sikur po abrogon disa lajme, si fjala e tij për faraonin: **﴿E kur e zuri mbytja tha: Besova ...﴾** Junus 90, dhe ajeti: **﴿Kemi për t'ju sprovuar derisa t'i njohim muxhahidët prej jush dhe durimtarët﴾** Muhamed 31.

Pastaj thotë: “Disa i keqinterpretuan këto ajete, duke kujtuar se Allahu ﷻ ka pasur për qëllim që do ta shpëtojë me trupin e tij prej zjarrit sepse ai besoi atëhere kur u mbyt. Ata pretendojnë se Allahu ﷻ na ka njoftuar që në zjarr do të hyjë populli i faraonit dhe jo vetë faraoni¹, kur thotë: **﴿I hodhi ata në zjarr﴾** Hud 98. Dhe thotë: **﴿Dhe i goditi përkrahësit e faraonit dënimi i keq﴾** Gafir 45.

Ky është tamam trillim ndaj Allahut, sepse Allahu ﷻ thotë: **﴿Allahu e rrëmben atë me dënim për shkak të herës së parë dhe të dytë﴾** En naziat 25.

Po kështu edhe ajeti **﴿ka për t'i njohuar Allahu ata që ishin të singertë﴾** Muhamed 31. Ai e komentoi këtë ajet se dija e Allahut është e shpikur. I madh dhe i madhërishtëm është ai prej shpikjes së dijes së diçkaje. Sepse ai që nuk ka dije për atë që dëshiron ta veprojë, atëhere ai nuk është i aftë për ta vepruar. Kjo është një apriori. Allahu ﷻ thotë: **﴿A nuk e di çfarë ka krijuar dhe ai është i dituri me detaje dhe i mirëinformuari﴾** El mulk 14.

Kuptimi i ajetit: **﴿derisa t'i njohim muxhahidët﴾** Muhamed 31, derisa dijen tonë shikojmë të vërtetuar në ekzistencë. Nuk është e mundur që ai ta njohë të njëjtën gjë si inekzistence përpara se ajo të ekzistojë, dhe ta njohë atë për ekzistente që ka ekzistuar. Nuk mund ta konsiderojë në një çast të vetëm se ajo është edhe ekzistente edhe inekzistente. Kjo është një diçka e pamundur”.

Pastaj përmend disa fjalë rreth cilësisë së dëshirës, deri kur thotë: **﴿Ne sëbashku me ju po dëgjojmë﴾** Esh shuara 15. Kuptimi i ajetit nuk është se atij i është krijuar dëgjimi, apo është munduar për të dëgjuar fjalët e tyre.

Disa njerëz prej ehlisunetit mendojnë se Allahu ka dëgjim që ndodh në vetveten e tij². Ata menduan se ajo që haset te krijesat është ndodhja e dëgjimit për fjalën e

¹ Muhasibiu replikon në këtë çështje me disa xehmi. Xehmitë në çështjen e imanit kanë qënë murxhi ekstrem. Ata besonin se kushdo që beson me zemër njëshmërinë e Allahut, ai është besimtar. Ndërkohë që faraoni jo vetëm që besoi me zemër por edhe e shprehu besimin me gojë pak përpara vdekjes, kështu që sipas medhhebit të tyre i bie të ketë vdekur si besimtar zullumqar.

Nëse do e mohojnë që ka qënë besimtar, atëhere kanë hedhur poshtë medhhebin e tyre. E nëse do e pohojnë që ka qënë besimtar, duhet patjetër të gjejnë ndonjë ajet që dëshmon për këtë. Prandaj gjetën ajetin që flet për shpëtimin e trupit të faraonit dhe pretenduan se trupi i tij do të shpëtojë prej zjarrit sepse ai ka qënë besimtar, duke deformuar kështu kuptimin e ajetit. Ajeti bën fjalë për nxjerrjen e trupit të faraonit në breg, që ta shikonin izraelitët, sepse faraoni pretendonte se ishte zot dhe disa izraelitë kishin akoma mëdyshje, prandaj Allahu e nxorri trupin e tij në breg, të pa jetë, që të largohej çdo dyshim.

² Ky është mendimi i Ibn Tejmijes dhe i shumë dijetarëve të tjerë. Ndërkohë që Muhasibiu në këtë pikë ndjek medhhebin e Ibn Kulabit, siç u përmend. Sido që të jetë Muhasibiu përmend që ky mendim është

thënë, sepse krijesa kur e dëgjon diçka, atëhere i ndodh edhe kuptimi i zërit që e ka perceptuar veshi i tij. Po kështu edhe ajeti: **﴿Thuaj: Punoni! Allahu dhe i dërguari i tij do ta shikojnë punën tuaj﴾** Et teubeh 105. Nuk i ndodh ndonjë shikim në vetveten e tij, por ndodh vetë gjëja (e shikuar) të cilën Allahu e shikon të ndodhur, megjithëse e ka pas ditur me dijen e tij para se të ndodhë”.

Deri kur thotë: “Po kështu fjala e Allahut: **﴿Ai është ngadhnjimtari sipër robërve të tij﴾** El enam 18. Dhe fjala e tij: **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾** Taha 5. Dhe fjala e tij: **﴿A mos vallë u siguruat prej atij që është në qiell﴾** El mulk 15.

Dhe thotë: **﴿Te ai ngjitet fjala e mirë dhe punën e mirë e ngre﴾** Fatir 10. Dhe thotë: **﴿e drejton çështjen prej qiellit për në tokë e pastaj ngjitet tek ai﴾** Es sexhde 5. Dhe thotë: **﴿Melaiket dhe shpirti ngjiten për tek ai﴾** El mearixh, 4. **﴿Unë do të t’i marrë ndjenjat dhe do të të ngrej tek unë ...﴾** Ali Imran, 55. Dhe thotë: **﴿Por Allahu e ka ngritur tek ai﴾** En nisa, 158. Dhe thotë: **﴿Ata që janë tek zoti i tyre nuk tregohen kryeneç për adhurimin e tij﴾** El araf 206.

Përmendi edhe perënditë, të cilat nëse me të vërtetë do të ishin perëndi atëhere do të përpiqeshin të gjenin rrugë për te poseduesi i Arshit, kur thotë: **﴿Thuaj: Nëse do të ekzistonin sëbashku me të perëndi (ilahë) ashtu siç pretendojnë, atëhere do të synonin të gjenin për te pronari i Arshit rrugë﴾** El isra 42. Dhe thotë: **﴿Madhëroje emrin e zotit tënd më të lartë﴾** El ala 1”.

Ebu Abdullahi thotë: “Këto ajete kurrësesi nuk mund të abrogohen.

Po kështu edhe fjala e tij: **﴿Ai është i cili është i adhuruar në qiell dhe i adhuruar në tokë﴾** Ez zuhruf 84. Dhe thotë: **﴿Ne jemi më pranë tij sesa damari i qafës﴾** Kaf 16. Dhe thotë: **﴿Ai është Allahu në qiell dhe në tokë. Ai e di fshetësinë tuaj dhe atë që e shfaqni﴾** El enam 3. **﴿Nuk ka ndonjë grup tre vetësh veçse Allahu është i katërti i tyre﴾** El muxhadeleh 7.

Këto ajete nuk i abrogojnë ajetet e mëparshme dhe as që janë në kontradiktë me njëra-tjetrën. Dije se Allahu ﷻ nuk ka pasur për qëllim në këto ajete, se ai me vetë veten e tij është poshtë apo me gjërat e poshtme, apo lëviz në mesin e tyre, apo përpjestohet në to sipas përmasave të tyre dhe largohet prej tyre atëhere kur ato të zhduken. I madhërishëm dhe i lartë është ai prej kësaj.

Me këtë janë mashtruar disa të humbur dhe kanë pretenduar se Allahu është kudo me vetveten e tij, njësoj siç është mbi Arsh. Nuk ka dallim mes tyre sipas atyre.¹

brenda suazave të ehli sunetit, në dallim nga esharitë e sotëm të cilët i konsiderojnë përfaqësuesit e këtij mendimi _përfshi këtu edhe Ibn Tejmijen_ si të humbur dhe të devijuar.

¹ Pra nuk ka dallim mes qënies së Allahut mbi Arsh dhe qënies së Allahut kudo.

Mirëpo ata thanë diçka të pamundur megjithë mohimin e tyre¹ pas pohimit të asaj që e konsideruan të mundëshme për Allahun ﷻ. Kushdo që e pohon domethënien e diçkaje por pastaj mohon fjalët e tij (rrjedhimin e saj), atëhere mohimi me gojë i këtij rrjedhimi nuk i pi ujë.² Ata u argumentuan me këto ajete se Allahu ﷻ është në çdo send me veten e tij, por e mohuan kuptimin (rrjedhojën) e asaj që e pohuan kur thanë: Jo si një send brenda një sendi tjetër.

Thotë Ebu Abdullahi: "Ajetet: **﴿derisa t'i njohim﴾** **﴿Allahu do e shikojë﴾** **﴿ne jemi me ju duke dëgjuar﴾**, kuptimin e kanë derisa të ekzistojnë ajo gjë dhe Allahu ﷻ ta dijë që ajo ekzistoi, apo ta dëgjojë atë kur të ekzistojë si e dëgjuar, ato ta shikojë atë kur të ekzistojë, po jo se dija, dëgjimi apo shikimi i tij janë të krijuar.

Ndërsa ajeti: **﴿E kur të dëshirojmë﴾**, ka për qëllim kur të vijë koha e gjësë së dëshiruar.

Ndërsa fjala e tij: **﴿mbi Arsh u lartësua﴾**, **﴿ai është ngadhnjimtari sipër robërve të tij﴾**, **﴿a mos vallë u siguaruat prej atij që është në qiell﴾**, **﴿atëhere kishin për të synuar për te pronari i Arshit ndonjë rrugë﴾**, këto ajete dhe ajete të tjera si këto, si: **﴿melekët dhe shpirti ngjiten për te ai﴾**, **﴿te ai ngjitet fjala e mirë﴾**, këto ajete janë të ndara³, dhe detyrimisht dëshmojnë që Allahu ﷻ është sipër Arshit dhe sipër të gjitha gjërave. Ai është i pastër prej hyrjes brenda krijesave të tij. Atij nuk i shpëton asgjë prej të fshehtave.

¹ Ka për qëllim mohimin e xehmive se Allahu nuk është gjë si gjërat.

² Kuptimi i fjalës së Muhasibiut është se kushdo që e pohon diçka dhe nga kjo gjë rrjedh një kuptim domosdoshmërisht i gabuar, atëhere ky kuptim i gabuar është rrjedhojë e pandashme e pohimit të tyre edhe nëse ata e përgënjeshtrojnë këtë rrjedhojë me gojën e tyre.

Më konkretisht xehmitë pohuan që Allahu është kudo dhe në çdo vend e në çdo send. Nga kjo rrjedh që Allahu është send sepse ai është i përzier me sendet dhe ka zënë vendin e tyre. Kjo është një rrjedhojë e pashmangëshme. Mirëpo këtë rrjedhojë xehmitë e përgënjeshtrojnë dhe thonë: Allahu është në çdo send, por jo siç janë sendet brenda disa sendeve të tjera, sepse Allahu nuk është send.

Ky përgënjeshttrim i kësaj rrjedhoje është i pavlerë dhe nuk u pi ujë sepse pohimi që Allahu është kudo, nënkupton që ai është brenda sendeve. Nga kjo rrjedh që ai është send dhe kjo është përngjasim i Allahut me krijesat. Kështu, ata pa e kuptuar e pohuan përngjasimin të cilit deshën t'i shmangeshin dhe për shkak të të cilit e mohuan që Allahu të jetë mbi Arsh.

³ Që të kuptohet kjo fjalë dhe fjalët në vijim të Muhasibiut, është e nevojshme në parathënie gjuhësore. Fjalja është një strukturë fjalësh të lidhura me njëra-tjetrën. Lidhjet në fjali mund të jenë të ndryshme, si lidhja kallzuesore, lidhja e veçimit, e bashkrenditjes, e përfshirjes, etj. P.sh. fjala jonë: Allahu është në qiell, fjala në qiell është një kallzuesor emror (haber) që lidhet me kryefjalën (el muhtede) që në rastin konkret është emri "Allah". Nëse kallzuesi emëror ndahet dhe fshihet atëhere kryefjala nuk ka kuptim. Kjo dëshmon që ato fjalë janë të lidhura me njëra-tjetrën me një lidhje kallzuesore.

Muhasibiu dëshiron të thotë që ajetet që dëshmojnë për lartësimin e Allahut mbi krijesat e tij, janë të ndara, pra nuk lidhen me pjesën në vazhdim të ajetit apo me ajetin në vijim, sepse fjalja ka marrë formë të plotë dhe ka mbaruar. Ndërsa ajeti në vazhdim është i një forme nistore që flet për diçka tjetër të ndarë nga tema e fjalisë së mëparëshme.

Allahu ﷻ është shprehur qartë në këto ajete se ai me vetveten e tij është sipër robve të tij, sepse ai thotë: **«a mos vallë u siguaruat prej atij që është në qiell»**, pra sipër Arshit dhe Arshi është sipër qiellit. Sepse ai që është sipër çdo gjëje dhe mbi qiell, ai është në qiell. Allahu ﷻ thotë të njëjtën gjë në fjalën e tij: **«lëvizni në tokë»** Et teube 2, pra mbi tokë.¹ Ai nuk ka për qëllim hyrjen në brendësinë e saj. Po kështu edhe ajeti: **«hallakaten në tokë»** pra mbi tokë. Nuk ka për qëllim hyrjen në brendësinë e saj.

Po kështu edhe ajeti: **«Do t'ju kryqëzoj në trungjet e pemëve»** Taha 71, pra mbi to. Dhe thotë: **«A mos vallë u siguaruat prej atij që është në qiell»** pastaj e ndau² atë nga fjala e tij **«se mos jua trondit tokën»** dhe nuk e lidhi me fjalën **«atij që është në qiell»** por nisi një kërcënim të ri me tronditjen e tokës, mirëpo ai është sipër qiellit.

Allahu thotë: **«e drejton çështjen prej qiellit për në tokë e pastaj ngjitet tek ai»** Es sexhde 5. Dhe thotë: **«Melekët dhe shpirti ngjiten për tek ai»** El mearixh 4. E sqaroi ngjitjen e çështjes dhe ngjitjen e melekëve, pastaj e përshkroi kohën e ngjitjes së tyre në lartësi, si ngjitje drejt tij, kur thotë: **«Në një ditë, gjatësia e të cilës është një mijë vjet»** El mearixh 4. Thotë: "Ngjitja e tyre" duke e ndarë nga parafjala "për tek ai" është njësoj si fjala e dikujt: Ngjitu te filani në një natë ose në një ditë. Kjo sepse ai është në lartësi, dhe ti ngjitesh tek ai për një ditë. E kur melekët të ngjiten drejt Arshit atëhere ato janë ngjitur për tek Allahu ﷻ, megjithëse nuk e kanë parë atë, apo nuk janë barazuar me të në lartësinë e tij. Mirëpo ato janë ngjitur duke bartur çështjet, nga toka drejt lartësisë.

Allahu ﷻ thotë: **«Por Allahu e ka ngritur për tek ai»** dhe nuk thotë "tek ai". Faraoni tha: **«O Haman! Më ndërto një kullë se mbase i arrij rrugët; rrugët e qiellit dhe ngjitem te ilahu i Musës»**, pastaj filloi një fjali nistore të re: **«Me të vërtetë unë mendoj se ai është gënjeshhtar»** Gafir, 36-37. Pra besoj se më ka gënjyer në pretendimin se zoti i tij është sipër qiejve. Allahu ﷻ sqaroi që faraoni kujtoi se Musai عليه السلام po e

¹ Kuptimi i parafjalës (fi-في) në gjuhën arabe është ekuivalent me kuptimin e parafjalës "në" në gjuhën shqipe. Parafjala "në" si në shqip ashtu edhe në arabisht, mund të tregojë vendin në brendësi të të cilit gjëndet diçka, si në fjalën: Uji është në enë. Ose si në hadithin e profetit: "Në trup gjëndet një organ i cili po të rregullohet rregullohet i gjithë trupi ...". Pra brenda enës dhe brenda trupit.

Por ajo mund të marrë edhe kuptimin e parafjalës "mbi", si në fjalën: E vendosa librin në tavolinë, pra mbi tavolinë. Apo si në ajetin: (lëvizni në tokë) pra mbi tokë. Po kështu e ka kuptimin ajeti (prej atij që është në qiell) pra mbi qiell, sepse Allahu nuk është brenda qiellit por mbi të.

² Ka për qëllim që togfjalëshi "në qiell" është i ndarë nga ana kuptimore nga togfjalëshi në vazhdim "se mos jua trondit", sepse togfjalëshi "në qiell" është i lidhur nga ana kuptimore me fjalën "atij" ndërsa togfjalëshi "se mos jua trondit tokën" është i lidhur nga ana gramatikore me foljen "u siguaruat" dhe në arabisht ai zë vendin e një kundrinori (me'ul bi) sepse është një "masdar mueuuel".

Përderisa togfjalëshi "në qiell" është i ndarë nga ana gramatikore nga pjesa tjetër e ajetit, atëhere ai është kuptimplotë dhe nënkupton që është në qiell. Kjo në dallim kur togfjalëshi mund të jetë i varur nga kuptime të tjera, si dija apo adhurimi, ku ai merr kuptim në varësi të gjymtyrës me të cilin është lidhur gramatikisht dhe kuptimisht, siç do të sqarohet.

mashtrohte për atë që thoshte, prandaj kërkoi një kërkesë të tillë (prej Hamanit) duke kujtuar se Musai ؑ kishte mashtruar. E sikur Musai ؑ ti thoshte se Allahu ؑ është kudo, atëhere faraoni do ta kërkonte atë kudo, në shtëpinë e tij, në trupin e tij apo në nevojto. I pastër është Allahu ؑ prej kësaj. Kështu nuk kishte pse ta mundonte veten për të ndërtuar kullën".

*Thotë Ebu Abdullahi: "Ndërsa ajetet që me të cilat (xhehmitë) u argumentuan, ato Allahu ؑ i ka lidhur dhe nuk i ka ndarë ashtu siç e shkëputi fjalën me të cilën pati për qëllim se ai është mbi Arsh, dhe tha: **﴿A nuk e shikon se Allahu e di atë që është në qiell dhe në tokë﴾** El muxhadelah 7. Ai na njoftoi për dijen e tij, dhe se ai është prezent me çdo biesdies, pastaj e mbylli ajetin me dijen kur thotë: **﴿Allahu për çdo gjë është i ditur﴾**.¹ Pra e nisi me dijen dhe e përfundoi me dijen, për të sqaruar se ai i di ata kudo që janë dhe se nuk i fshihen dot dhe as biseda e tyre nuk i fshihet dot Allahut ؑ. E sikur njerëzit të ishin në vendin më të ulët dhe ai i vështron ata nga vendi më i lartë, dhe u thotë: Unë vazhdoj t'ju vështrojë dhe e di se çfarë po bisedoni, atëhere fjala e tij do të ishte e vërtetë. E Allahut i takon shëmbulli më i lartë sepse ai nuk i përngjan krijesave.*

Nëse xhehmitë refuzojnë çdo koment përveç kuptimit sipërfaqësor të ajetit dhe thonë: Ky është vetëm një pretendim i juaji. Atëhere u thuhet: Ju vetë i jeni larguar kuptimit parësor të ajetit, sepse ai që është sëbashku me dy ose më shumë veta, ai është me ta dhe jo brenda tyre. Ai që është me diçka, nuk është brenda trupit të tij dhe kjo bie ndesh me fjalën e tyre.²

*Po kështu fjala e Allahut ؑ: **﴿Ne jemi më pranë tij sesa damari i qafës﴾** Kaf 16, sepse ajo që afrohet te diçka nuk është brenda asaj gjëje. Edhe sipas pretendimit të tyre për kuptimin parësor të ajetit, atëhere kuptimi parësor dëshmon që ai nuk është brenda damarit të qafës.³*

*Po kështu fjala e tij: **﴿Ai është në qiell ilah dhe në tokë ilah﴾** Ez zuhruf 84, nuk ka thënë "në qiell" dhe pastaj e ka ndarë⁴, ashtu siç tha në ajetin **﴿A mos vallë u***

¹ Ajeti i plotë në suren "El muxhadeleh": **﴿A nuk e shikon se Allahu e di atë që është në qiell dhe në tokë . Nuk ka ndonjë grup tre vetësh veçse Allahu është i katërti i tyre dhe as një grup pesë vetësh veçse ai është i gjashti i tyre dhe as më pak se kaq apo më shumë, veçse ai është me ta kudo që të jenë. Pastaj do i njoftojë ata për atë që vepronin në ditën e gjykimit, sepse Allahu për çdo gjë është i ditur﴾** El muxhadeleh 7.

² Emri "mea-مع" që mund të përkthehet në shqip "sëbashku" ose mund të përkthehet me parafjalën "me", në gjuhën arabe ka shumë kuptime. Zakonisht nënkupton shoqërim. Nëse them: Ne po ecim sëbashku, apo unë jam duke ecur me ty, apo ne jemi bashkë, atëhere kjo nuk nënkupton që ne jemi brenda njëri-tjetrit, por nënkupton që veprimi po kryhet në shoqërimin e njëri-tjetrit.

³ Sepse ajo që kuptohet nga ndajfolja "afër" është ndarja. Nëse dy gjëra janë të përziera me njëra-tjetrën atëhere nuk thuhet që ato janë afër, por të përziera ose brenda njëra-tjetrës. Pra edhe kuptimi aparent i ajetit nuk dëshmon për medhhebin e xhehmive.

⁴ Që ta kuptojmë këtë fjalë të Muhasibiut duhet të dimë disa gjëra:

siguruar prej atij që është në qiell» dhe e ndau nga fjala *«se mos jua trondit tokën»*. Fjala e tij: *«Ai është në qiell ilah (i adhuruar)»* pra i adhuruari i banorëve të qiellit dhe të tokës.

Kjo përputhet edhe me përdorimin gjuhësor, sepse mund të thuash: Filani është sundimtar në Horasan, sundimtar në Belh dhe sundimtar në Samerkand, megjithëse ai ekziston në një vend të vetëm dhe nuk di gjë për atë që ndodh jashtë vendit ku qëndron. E çfarë mund të thuhet për të lartin i cili është sipër gjërave, të cilit nuk i shpëton asgjë, i cili e komandon çdo gjë. Ai është i adhuruari (ilahu) në tokë dhe në qiell sepse ai është komanduesi i tyre, mirëpo ai është mbi Arsh dhe sipër çdo gjëje. I lartë është ai prej përngjasimit dhe shëmbëllimit".

Imami Ebu Abdullah Muhamed ibn Hafifi¹ në librin me titull "Itikadut teuhid bi ithbatil esmai ues sifat", në fund të parathënies së librit thotë:

"Fjalët e muhaxhirëve dhe ensarëve për teuhidin dhe njohjen e emrave të Allahut ﷻ, cilësive dhe caktimit të tij, kanë qënë në konsensus të plotë dhe të qarta fetarisht. Ata na i përcollën prej të dërguarit të Allahut ﷺ këto fjalë, aq sa profeti ﷺ pati thënë: "Kapuni pas sunetit tim ..."»² E përmendi këtë hadith të plotë dhe më pas

1- Fjala "ilah" në gjuhën arabe nënkupton zotin dhe perëndinë. Ajo është fjalë e prejardhur nga tema "elihe" që do të thotë "me adhuru". Fjala ilah është fjalë e prejardhur me kuptimin e të vepruarit, pra "i adhuruari". Dhe fjalët e prejardhura në gjuhën arabe luajnë rolin e foljes nga e cila kanë prejardhjen. Kjo pikë ka konsensus në mesin e gramaticienëve arab.

2- Xhehmitë shkëputën nga ajeti togfjalëshin "në tokë" dhe thanë që Allahu është në tokë ashtu siç është në qiell sepse ai është kudo.

Pretendimi i tyre është i kotë, sepse togfjalëshat "në qiell" dhe "në tokë" janë të lidhura kuptimisht me emrin e prejardhur "ilah – i adhuruar", i cili luan rolin e foljes, pra "ai i cili adhurohet në qiell dhe adhurohet në tokë". Lidhja e togfjalëshit "në tokë" me emrin "i adhuruar" është njësoj si lidhja e foljes me rrethanorin e vendit. Togfjalëshi "në tokë" shpreh vendin ku vepohet veprimi i adhurimit dhe jo që qenia e Allahu është në tokë. Prandaj edhe Muhasibiu _Allahu e mëshiroftë_ e komenton kuptimin e ajetit që Allahu është i adhuruar në qiell nga banorët e qiellit dhe i adhuruar në tokë nga banorët e tokës.

¹ Muhamed ibn Hafif Shiraziu (268-371h). Dijetar sufi. Nxënës i Ebu Hasen Eshariut dhe autor i shumë veprave. Ebu Abas Feseviu thotë për të: "Shejhu jonë Ibn Hafifi shkroi aq vepra sa askush nuk kishte shkruar përpara tij. Të shumtë ishin ata që patën dobi prej tyre aq sa u bënë imamë të pasuar. Allahu i dhuroi jetë të gjatë dhe dobia e tij u përhap në shumë vende".

Dhehebiu thotë për të: "Ky shejh ishte dijetar që punonte me dijen e tij. E transmetonte hadithin me senez të lartë. Ishte i kapur me sunetin dhe iu dhuroi jetë të gjatë të cilën e mbushi me adhurim".

² **Hadith sahih.** Kuptimi i fjalës së Muhamed ibn Hafifit është se i dërguari i Allahut na urdhëroi që të kapemi me rrugën e kalifeve të udhëzuar, sepse pikërisht sahabët janë ata të cilët e kanë bartur sunetin e profetit ﷺ. Kapja pas sunetit të profetit nuk arrihet ndryshe përveçse me ndjekjen e sahabëve. Për këtë dëshmon pjesa e mebetur e hadithit të Irbad ibn Sarijes ﷺ se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **"Kapuni pas sunetit tim dhe sunetit të kalifeve të urtë dhe të udhëzuar. Shtrëngojeni atë me dhëmballë"**, pra kapuni pas tij aq fort njësoj dhe mos e lëshoni ashtu siç nuk lëshohet gjëja e cila shtrëngohet me dhëmballë.

Ky është hadithi i plotë i Irbad ibn Sarijes, thotë: **"I dërguari i Allahut na predikoi me një predikim prej të cilit u tronditën zemrat dhe lotuan sytë. I thamë: O i dërguar i Allahut! A thua se ky është predikimi**

hadithin: *“Allahu e ka mallkuar atë që vepron ndonjë krim apo strehon ndonjë kriminel”*.¹

Thotë: *“Fjala e sahabëve ﷺ ishte unanime dhe e papërçarë. Ne jemi urdhëruar të marrim prej sahabëve ﷺ, sepse ata, falë mirësisë së Allahut ﷻ, nuk janë kundërshtuar në çështjet e teuhidit dhe në bazat e fesë si puna e emrave dhe cilësive, por janë kundërshtuar në çështjet e fikhut. Nëse ata do të ishin kundërshtuar në çështjet e teuhidit, atëhere kundërshtimi i tyre do të na përcillej ashtu siç na u përcollën kundërshtimet e tyre në çështjet e tjera.”*²

Besimi i tyre i saktë (për emrat dhe cilësitë) ishte rrënjësor thellë si te dijetarët

i lamtumirës prandaj na porosit! Tha: Ju porosis të dëgjoni dhe të bindeni edhe nëse bëhet emir i juaji një rob etiopian. Sepse ai që do të jetojë pas meje do të hasë kundërshtime të shumta. Prandaj kapuni pas sunetit tim dhe sunetit të kalifeve të urtë dhe të udhëzuar. Shtrëngojeni atë me dhëmballë. Ruajuni prej gjërave të shpikura sepse çdo çdo bidat është humbje”.

Këtë hadith e transmeton imam Ahmedi në musnedin e tij (17144), Ebu Daudi (4607), Tirmidhiu (2676), Ibn Maxheh (42), Tahaviu në “Sherhu mushkilil athar” shkurtimisht (1186), Darimiu në sunenin e tij (96), Ibn Ebi Asim në “Es sunneh” (54), Bezari në musnedin e tij (4201), Meruziu në “Es sunneh” (69), Ibn Hibani në sahihun e tij (5), Axhuri në “Esh sheriah”, Taberaniu në “El kebir” (622), Bejhakui në “Es sunenul kubra” (20338), Hakimi në “El mustedrek” (329) dhe e ka saktësuar duke thënë: Ky hadith është i saktë dhe nuk ka asnjë problem. Me saktësimin e tij është pajtuar edhe Dhehebiu. E përmend edhe Ibn Abdulberri në “Xhamiul ilm” (1758) dhe thotë: “Është transmetuar nga profeti me sened sahih: **“Kapuni pas sunetit tim ...”**”.

Tirmidhiu thotë: Ky është hadith hasen sahih. Begeviu në “Sherus sunneh” thotë: Hadith hasen.

Këtë hadith e kanë saktësuar shumë dijetarë dhe muhaddithë të tjerë. Shejh Shuajb Arnauti e shqyrton atë gjërësisht në musnedin e imam Ahmedit dhe e vlerëson si sahih. Po ashtu edhe shejh Albani dhe shejhu jonë Abdurrezak Mehdiu, Abdulkadir Arnauti në sahihun e Ibn Hibanit dhe shumë të tjerë.

U zgjata pak në saktësimin e këtij hadithi për shkak të rëndësisë së tij dhe për shkak të pretendimeve të kota të disa njerëzve për dobësinë e tij.

¹ **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu (1870) nga hadithi i Aliut ﷺ, nga profeti ﷺ: **“Medineja është harem nga Airi e deri kështu. Mbi atë që vepron në të ndonjë krim apo strehon ndonjë kriminel, qoftë mallkimi i Allahut dhe i melekëve dhe i të gjithë njerëzve ...”**.

Në një rivajet tjetër thuhet: **“Medineja është harem nga Airi deri në Theur”** të cilat janë dy vende të njohura në Medine. E transmeton edhe Muslimi (15/467).

Fjala “Muhdith” në gjuhën arabe përdoret me shumë kuptime. Ajo përdoret me kuptimin e atij që bën një precedent penal dhe krim. Ky është kuptimi që kuptohet nga hadithi të cilin e kanë përmenduar dijetarët si puna e Neveviut, Ibn Haxherit, Sujutit dhe shumë të tjerë.

Por fjala “muhdith” në terminologjinë e mëvonshme ka marrë edhe kuptimin e bidatçut, sepse ajo rrjedh nga folja “ehdethe”, ndër kuptimet e të cilës është edhe bërja e diçkaje nga fillimi, ose të re ose shpikja e diçkaje. Prandaj disa njerëz e kanë përkthyer atë “Allahu e mallkoi atë që bën një bidat apo strehon një bidatçi”. Mirëpo kuptimi i saktë i hadithit është ai që përmendëm.

² Kundërshtimet e tyre në çështjet e fikhut na janë përcjellur me detaje shumë të hollësishme. Nëse ata do të kundërshtoheshin në çështje madhore si në temën e emrave dhe cilësive të Allahut apo në komentimin e tyre, atëhere duhej të na transmetohej ky kundërshtim akoma më hollësisht, për shkak të rëndësisë së këtyre çështjeve. Padyshim që çështjet bazë të akides janë më të rëndësishme se ato të fikhut dhe kundërshtimi për to ka më shumë interes për t’u përcjellur.

ashtu edhe te masat e gjëra të sahabëve ﷺ, derisa e përcollën këtë besim te pasardhësit e tyre me mirësi (tabinët). Edhe te dijetarët e njohur të tabinëve ky besim ishte rrënjësor thellë. Pastaj ata e përcollën këtë besim brez pas brezi. Sepse mospajtimet në çështjet bazë ata i kanë pasë konsideruar kufër dhe mirësia është prej Allahut ﷻ.

Në vijim, i mbështetur te Allahu ﷻ po ju them: Atëhere kur ndodhën mospajtime për teuhidin dhe për pohimin e emrave dhe të cilësive, në kundërshtim me metodën e të parëve tanë prej sahabëve ﷺ dhe tabinëve, dhe ndërhyjnë në këto çështje ata që nuk i njihnin dhe nuk i kuptonin thëniet e të parëve rreth haditheve të transmetuara, të cilët u bazuan te epshet e tyre me qëllim të mirë, që në realitet janë rrjedhojë e mendimit të keq për Allahun¹, duke kundërshtuar sunetin dhe duke u kapur me disa ajete të cilat kur nuk u shkuan përshatat epshit të tyre i deformuan, në mënyrë që të përputheshin me medhhehin e tyre; kur kjo ndodhi, më doli si përgjegjësi ta sqaroj realitetin e brezave të kaluar, burimin e besimtarëve dhe metodologjinë e të parëve, për shkak të frikës prej rrëshkitjes në mendimet e kelamistëve, prej të cilave i dërguari i Allahut ﷻ i ka tërhequr vërejte umetit dhe përkrahësve të tyre”.

Në vijim Ebu Abdullahi përmend hadithin kur profeti ﷺ i gjeti sahabët të polemizonin për kaderin² dhe u zemërua, dhe hadithin: **“Të mos e gjej ndonjërin prej jush ...”**³, dhe hadithin: **“Do të përçahet umeti im në shtatëdhjetë e tre grupe ...”**⁴, i

¹ Sepse ata supozuan që emrat dhe cilësitë e përmenduar në Kuran dhe sunet në aparençë dëshmojnë për përngjasim. Pikërisht ky ishte mendimi i tyre i keq.

² **Hadith sahih.** I dërguari i Allahut ﷻ doli te shokët e tij dhe i gjeti duke polemizuar për kaderin. Faqja iu skuq prej zemërimit, a thua se i kishin shtryllur një shëgë në faqe dhe u tha: **“A mos vallë me këtë jeni urdhëruar! Apo vallë për këtë jeni krijuar! E rrëzoni Kuranin me njëri-tjetrin! Popujt para jush, pikërisht për këtë janë shkatërruar”**. E transmeton Ibn Maxheh, 85. Në transmetimin e Tirmidhiut thuhet: **“Vallë me këtë jeni urdhëruar apo unë për këtë jam dërguar!”**. Suneni i Tirmidhiut 2133.

E transmeton edhe imam Ahmed në musnedin e tij, nr: 6845. Ibn Ebi Asim në “Es sunneh” 406. Ebu Jala Meusiliu në musnedin e tij, Axhuri në “Esh sheria” 111, Lalekai në “Sherhul usul” 180, Taberani në “El kebir” 5442, dhe të tjerë. Shejh Shuajb Arnauti e ka konsideruar sahih. Ndërsa shejh Albani e ka konsideruar hasen.

³ **Hadith sahih.** Nga Ubejdilah ibn Rafi, nga babai i tij, se i dërguari i Allahut ka thënë: **“Të mos e gjej ndonjërin prej jush të ulur në karriken e tij. I vjen urdhëri im me të cilin kam urdhëruar apo kam ndaluar dhe ai thotë: Nuk dimë gjë! Çfarë gjejmë në librin e Allahut do ta pasojmë”**. E transmeton Ebu Daudi (4605), Tirmidhiu (2663) dhe thotë: Hadith hasen sahih. Ibn Maxheh 13. Shafiu në “Er risale”, Ahmed në musnedin e tij (23876), etj. Shejh Shuajb Arnauti thotë: “Hadith sahih. Transmetuesit e tij janë thikate (të besueshëm) prej transmetuesve të dy sahiheve”. Hakimi ka thënë: “Sahih sipas kushteve të dy shejhave, mirëpo ata nuk e kanë përmendur”.

⁴ **Hadith sahih.** Nga Ebu Hurejra se i dërguari i Allahut ka thënë: **“Çifutët u përçanë në 71 ose në 72 fraksione. Të krishterët u përçanë në 71 ose 72 fraksione, Ndërsa umeti im në 73 fraksione”**. E transmeton Ebu Daudi (4956), Tirmidhiu (2640), Ibn Maxheh (3991), Ahmed në musnedin e tij (8396). Tirmidhiu ka thënë: “Hasen sahih”. Hakimi thotë: “Hadith sahih sipas kushteve të Muslimit”. Me të është pajtuar edhe Dhehebiu. Shejh Albani e ka konsideruar “hasen sahih”. Kurse Sh. Arnauti e konsideron hasen ndërsa në hadithin nr: 12208 e konsideron sahih për shkak të dëshmimeve të shumta.

shpëtuari do të jetë grupi në të cilin ka qënë profeti ﷺ dhe shokët e tij.

Pastaj thotë: “I gjithë ymeti e ka për detyrë të njohë se çfarë kanë besuar sahabët ﷺ. Kjo njohje mund të arrihet vetëm nëpërmjet pasuesve të tyre me mirësi (tabinët) të njohur për transmetimin e haditheve dhe refuzues të medhhebeve të shpikura. Kështu ajo përcillet brez pas brezi, prej atyre që janë njohur për drejtësi dhe besnikëri. Ata të cilët kanë ruajtur për umetin detyrat dhe të drejtat e tyre prej sunetit të saktë”.

Deri kur thotë: “Fillimisht do të fillojmë me atë për të cilën e kemi hapur këtë çështje, pra me emrat e Allahut ﷻ të përmendura në Kuran dhe cilësitë që i ka përmendur i dërguari ﷺ në sunetin e tij, me të cilat Allahu ﷻ ka përshkruar veten e tij. Do të përmendim edhe fjalët e pohuesve të tyre, të cilat nuk ka lejohet ti refuzojmë për shkak të logjikës sonë, e cila kërkon njohjen e formës, për të cilën jemi urdhëruar të dorëzohemi”.

Deri kur thotë: “Allahu ﷻ na e ka bërë të njohur veten e tij _pasi e vërtetoi njeshmërinë dhe uluhijen e tij_ duke përmendur në librin e tij emrat dhe cilësitë e tij, të cilat i vërtetoi edhe i dërguari i tij ﷺ. Ata i pranuan këto cilësi ashtu siç i pranuan argumentet e teuhidit dhe kuptimin aparent të fjalës “la ilahe il-lallah”.

Deri kur thotë: “... me pohimin e vetes së tij. Kur i tha Musës ﷺ: **﴿të kam zgjedhur ty për veten time﴾** Taha 41, dhe thotë: **﴿Dhe Allahu ju tërheq vërejtjen që të keni kujdes prej vetes së tij﴾** Ali imran 30. Sepse kjo është e vërtetë edhe Isai ﷺ është lutur kështu kur thotë: **﴿E di atë që është në veten time, por unë nuk e di atë që është në veten tënde﴾** El maideh 116. Allahu i madhëruar thotë: **﴿Zoti yt ia ka obliguar vetes së tij mëshirën﴾**.

Pohimin e "vetes" e ka përforcuar edhe profeti ﷺ kur thotë: **"Allahu azze ue xhelle thotë: Kush më përmend mua në veten e tij unë do ta përmend në veten time".¹**

Dhe thotë: **"Allahu ka shkruar një libër me dorën e tij: Mëshira ime ia ka kaluar zemërimin tim".²**

Në musnedin e imam Ahemdit (16937) në një rivajet tjetër shtohet: **"Të gjitha ato janë në zjarr përveç njërit. Ai është xhemati"**. A. Shakir thotë për këtë hadith: Senedi i tij është hasen.

¹ **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu (7405) dhe Muslimi (2675). Hadithi i plotë te Buhariu ka ardhur me këtë tekst: **"Allahu teala thotë: Unë jam sipas mendimit që rob i ka për mua. Unë jam me të nëse ai më përmend mua. Nëse më përmend në veten e tij, unë e përmend atë në veten time. Nëse më përmend në mesin e një grupi, unë do ta përmend atë në një grup më të mirë ..."**.

² **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu 7404 dhe Muslimi 2751, me pak dallime në fjalët e teksit dhe pa shtesën "me dorën e tij". Kjo shtesë transmetohet te Tirmidhiu (3543), Ibn Maxheh (189), Ibn Ebi Shejbe në "El musannaf" (34199), Ahmedi në "El musned" (9597), Shejh Sh. Arnauti e konsideron xhejid (gradë mes hadithit hasen dhe hadithit sahih), ndërsa Shejh A. Shakir e konsideron sahih. Ibn Ebi Asim në "Es sunneh" dhe shejh Albani e konsideron sahih, Bejhakiu në "El esmau ues sifet" (623), Bezari në musnedin e tij (8371) dhe Ibn Hibani në sahihun e tij. Shuajb Arnauti thotë: Hasen.

Dhe thotë: "I pastër është Allahu aq sa kënaqësitë e vetes së tij".¹

Në debatin e zhvilluar mes Ademit ؑ dhe Musës ؑ thuhet: "Ty të ka zgjedhur Allahu dhe të ka përgatitur për veten e tij".²

Allahu ؑ është shprehur qartë që ai ka "vete", të cilin e ka pohuar edhe i dërguari ؑ. Kush e beson Allahun ؑ dhe të dërguarin ؑ, duhet të besojë për atë që na ka njoftuar për veten e tij, bazuar edhe në kuptimin aparent të ajetit: ﴿Nuk ka si ai asgjë﴾ Esh shura 11.

Besimtarët, dijetarët apo njerëzit e thjeshtë, duhet të pranojnë çdo gjë që është përcjellur prej profetit ؑ, i drejtë pas të drejti, derisa të arrijë te profeti ؑ. Prej gjërave që Allahu ؑ na ka njoftuar në librin e tij duke e cilësuar me të veten e tij dhe është saktësuar edhe në sunet, është fjala e Allahut ؑ: ﴿Allahu është nuri i qiellit dhe tokës﴾, ndërsa në fund të ajetit thotë: ﴿nur përmbi nur﴾ En nur 35.

Me këtë e ka lutur edhe i dërguari ؑ kur thotë: "Ti je nuri i qiejve dhe i tokës".³

Pastaj përmend hadithin e Ebu Musës ؑ: "Perdja e tij është dritë. Nëse e heq atë, kishin për të djegur subuhatët e fytyrës së tij deri aty ku arrin shikimi i tij prej krijesave të tij".⁴

Thotë (Muhamed ibn Hafifi): "Subuhatet e fytyrës së tij janë drita e tij dhe madhështia e tij. Kjo është përcjellur prej Halilit dhe Ebu Ubejdit".

Më pas vijon: Abdullah ibn Mesudi ؑ ka thënë: "Nuri i qiejve është nga nuri i

Të gjitha këto transmetime nga rruga e Muhamed ibn Axhlanit nga babai i tij Axhlan Medeniu nga Ebu Hurejra. Muhamed ibn Axhlani është thikah (i besueshëm) mirëpo gabon. Ai është nga transmetuesit e Muslimit, por vetëm në sheuahid. Ndërsa babai i tij është prej transmetuesve të Muslimit. Prandaj kjo shtesë nuk zbrit nga grada e hadithit hasen.

¹ **Hadith sahih.** E transmeton Muslimi (48/79).

² **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu (4736, 6614) dhe Muslimi (46/13), nga hadithi i Ebu Hurejrës, se profeti ka thënë: "Ademi debatoi me Musën. Musa i tha: O Adem! Ti je babai jonë. Na humbe dhe na nxorre nga xheneti. Ademi i tha: O Musa! Allahu të zgjodhi për fjalën e tij dhe të shkruajti (Teuratin) me dorën e tij. A po më qorton për diçka të cilën Allahu ma kishte caktuar dyzet vjet përpara se të më krijonte?! Kështu Ademi e mundi Musën në debat. Kështu Ademi e mundi Musën në debat, tre herë".

³ **Hadith sahih.** E transmetojnë Buhariu (1120) dhe Muslimi (5/199) nga hadithi i gjatë i Ibn Abasit, për duanë që profeti ؑ bënte në namazin e natës.

⁴ **Hadith sahih.** E transmeton Muslimi (1/237). Dijetarët e hadithit dhe të gjuhës kanë thënë që "subuhatet e fytyrës së tij" janë drita dhe nuri dhe bukuria e fytyrës së tij.

Nga Ebu Musa, thotë: I dërguari i Allahut ؑ doli para nesh dhe na tha pesë fjalë: "Allahu azze ue xhelle nuk fle dhe nuk i takon të flejë. E ngre peshoren dhe e ul. Tek ai ngrihet puna e natës para punës së ditës dhe puna e ditës para punës së natës. Perdja e tij është dritë (nur). Nëse do ta hiqte, kishin për të djegur subuhatet e fytyrës së tij deri aty ku arrin shikimi i tij prej krijesave të tij".

fytyrës së tij”.¹

Argumentet dëshmojnë edhe se ai është i gjallë, si fjala e Allahut ﷻ: ﴿Allahu është ai i cili nuk ka ilah tjetër përveç tij. Ai është i gjalli dhe përkujdesësi﴾ El bekare 255.

Në hadith thuhet: “O i gjallë! O përkujdesës! Me mëshirën tënde kërkoj ndihmë!”.²

Thotë: “Prej gjërave me të cilat Allahu ﷻ e ka cilësuar veten është edhe fytyra e tij, e cila është plot me madhësi dhe bujari. Ai e ka pohuar fytyrën për veten e tij”.

Pastaj përmend ajetet që dëshmojnë për këtë dhe përmend hadithin e mësipërm të Ebu Musës ؓ dhe thotë: “Në këtë hadith përmendet cilësia e mosfjetjes. Kjo përputhet edhe me kuptimin aparent të Kuranit: ﴿Nuk e kap atë kotja dhe as gjumi﴾ El bekareh 255, dhe se ai ka fytyrë të cilësuar me dritë. Ai cilësohet me shikim ashtu siç e kemi mësuar prej librit të tij se ai është dëgjuesi dhe shikuesi”.

Pastaj përmend hadithet dhe ajetet që pohojnë fytyrën, dëgjimin dhe shikimin. Pastaj thotë: “Allahu e ka cilësuar veten e tij para besimtarëve me dy duar të cilat i ka shtrirë me mëshirën e tij”.

Pastaj përmend hadithet që dëshmojnë për këtë dhe poezinë e Umeje ibn Saltit. Pastaj përmendi hadithin: “*Hidhen në zjarr dhe (zjarri) thotë: A ka më? Derisa i plotfuqishmi të vendosë këmbën e tij ...*”.³ Kështu është rivajeti i Buhariut. Në një rivajet tjetër thuhet “kademehu”.⁴

Pastaj përmend transmetimin e Muslim Batinit nga Ibn Abasi ؓ se: “*Kursia është vendi i dy këmbëve. Ndërsa madhësinë e arshit e di vetëm Allahu*”.⁵

¹ **Ether i dobët.** E transmeton Taberaniu në “El kebir” 8886, Ebu Daudi në “Ez zuhd” 158, Bejhakui në “El esmau ues sifāt” (674) dhe thotë: Transmetuesi i tij është i panjohur.

Ky ether transmetohet nga Zubejr Ebu Abduselamit nga Ejub ibn Abdullah ibn Mikrezi nga Abdullah ibn Mesudi. Zubejri është i panjohur.

² **Hadith hasen.** E transmeton Tirmidhiu (3524) nga hadithi i Enes ibn Malikut. E transmeton edhe Hakimi në mustedrekun e tij (2000) dhe thotë: “Ky hadith është sahih sipas kushteve të dy shejhave, por nuk e kanë transmetuar (në dy sahihet e tyre)”, Bezari në musnedin e tij (6368) dhe Nesaiu në “Es sunenul kubra” (10330), Bejhakui në “El esmau ues sifāt” dhe të tjerë. Dijaudin Makdesiu në “El ehadithul muhtarrah” thotë: “Senedi i tij është hasen” (2320). Hejthemiu thotë (10/117): “E transmeton Bezari dhe transmetuesit janë transmetues të hadithit sahih, përveç Uthman ibn Meuhibit i cili gjithashtu është thikah (i besueshëm)”. Hadithin e përmend shejh Albani në silsilenë e haditheve sahihe nr: 227 dhe e vlerëson si hadith hasen.

³ **Hadith sahih.** E transmetojnë Buhariu dhe Muslimi. U përmend më parë.

⁴ Fjala (kadem – قدم) dhe fjala (rixhl – رجل) e përmendur në transmetimin e Buhariut, në arabisht kanë të njëjtin kuptim, që është këmba.

⁵ **Ether sahih.** U përmend më parë. Është saktësuar si fjalë e Ibn Abasit por jo si fjalë e profetit.

Pastaj përmend fjalën e vetë Muslim ibn Batinit¹, fjalën e Sudijut², fjalën e Vehb ibn Munebihit³, dhe të Ebu Malikut⁴. Disa thonë: “vendi i dy këmbëve”, ndërsa disa të tjerë: “I ka vendosur dy këmbët”.

Në vijim thotë: *“Këto rivajete që janë transmetuar nga të parët e këtij umeti, janë në përputhje të plotë me fjalët e profetit ﷺ. Fjalët e të parëve tanë janë të përhapura dhe të ruajtura. As dijetarët e mëvonshëm dhe as bashkohësit e tyre nuk i kanë mohuar. Këto transmetime i kanë përcjellur dijetarët dhe muslimanët e thjeshtë dhe janë përpiluar në librat e tyre; derisa u shfaqën në këtë umet një grush njerëzish prej të cilëve i dërguari i Allahut ﷺ na pati tërhequr vërejtjen për mos u ulur dhe për të mos biseduar me ta. Na pati urdhëruar të mos i vizitojmë të sëmuret e tyre dhe të mos i përcjellim xhenazet e tyre për në varreza. Këta njerëz iu kundërvunë këtyre rivajeteve dhe i akuzuan ato me përngjasim. Prandaj i refuzuan këto ethere bazuar në krahasime logjike dhe i shpallën qafirë të parët e umetit duke iu kundërvënë sahabëve ﷺ dhe tabinëve. Ata i refuzuan imamët e udhëzuar, prandaj devijuan prej rrugës së drejtë dhe i devijuan të tjerët”.*

Pastaj përmend etherin e Ibn Abasit ؓ dhe përgjigjen e tij ndaj Nexhde Haruriut. Pastaj përmend hadithin e pamjes duke thënë se ai ka hartuar një libër të veçantë për këtë çështje dhe kundërshtimin e njerëzve rreth interpretimit të saj.

Pastaj thotë: *“Do të përmendim bazat e sunetit dhe mospajtimet rreth tyre, sipas asaj që ne besojmë, aty ku na kanë kundërshtuar të devijuarit dhe aty ku janë pajtuar me ne pasuesit e hadithit prej pohuesve, me lejen e Allahut”.*

Pastaj përmed mospajtimet rreth “imametit” duke përmendur argumentat dhe pajtimin e muhaxhirëve dhe ensarëve për vlerësimin e Ebu Bekrit ؓ si më të mirin e umetit. Pastaj thotë: *“Pastaj ndodhi kundërshtimi rreth krijimit të veprave nëse janë apo*

¹ Muslim ibn Umran ibn Batin, nxënës i Muxhahidit dhe Said ibn Xhubejrit. Jahja ibn Maini dhe Ebu Hatimi e kanë konsideruar të besueshëm (thikah) në transmetim.

² Ismail ibn Abdurrahman Sudiju. Dijetar i njohur i tefsirit. Shumicën e tefsirit të tij e bazon te transmetimet e Enes ibn Malikut dhe i Ibn Abasit. Axhliu thotë për të: I besueshëm dhe dijetar në tefsir. Ndërsa Dhehbiu e ka quajtur imam në tefsir. Vdiq në vitin 127 h.

Fjalën e Sudijut e transmeton imam Ibn Xherir Taberiu në tefsirin e tij (5970) thotë: Më ka treguar Musa ibn Harun (Hamedani) Amr (ibn Hamad ibn Talha) nga Esbat (ibn Nasr Hamedani), nga Sudiji: **“(Kursija e tij e ka përfshirë qiellin dhe tokën). Qiejtë dhe toka janë brenda Kursisë ndërsa kursia është përpara Arshit dhe ajo është vendi i dy këmbëve”.**

Këto lloj senedi e saktëson shpesh herë Hakimi në mustedrekun e tij dhe me të pajtohet edhe Dhehbiu. Ky është senedi më shumë i përmendur në tefsirin e Taberiu. Shejh A. Shakir e ka shpjeguar me detaje këtë sened të Taberiu në tefsirin e tij në komentimin e sures “El fatiha” vëll. 1, fq. 156.

³ Vehbi ibn Munebih (34-110). Tabin i njohur dhe i shquar për adhurimin dhe dijen e tij dhe urtësinë e tij.

⁴ E transmeton Abdullah ibn Ahmed ibn Hanbeli në “Es sunneh” 589 me sened të dobët. Në të gjëndet një transmetues i panjohur.

nuk janë të caktuara me kader? Mendimi jonë rreth tyre është se veprat e robërve janë të caktuara dhe të njohura”.

Pastaj foli rreth pohimit të kaderit. Pastaj përmendi mospajtimet rreth vepruesit të gjynaheve të mëdha dhe çështjen e “elesamu uel ahkam”¹ dhe më pas tha: “Mendimi jonë është se ata janë besimtarë përgjithësisht (pa përcaktim) dhe se çështja e tyre kthehet te Allahu ﷻ; nëse dëshiron i dënon, e nëse dëshiron i fal”.

Thotë: “Burimi i imanit është një dhunti, prej të cilës rrjedhin veprat e robërve. Pra imani në origjinë është vërtetim, pohim dhe vepra”. Pastaj përmend kundërshtimet rreth shtimit dhe pakësimit të imanit, duke shtuar se: “Mendimi jonë është se ai shtohet dhe pakësohet”.

Pastaj thotë: “Pastaj ndodhën kundërshtimet rreth Kuranit, nëse është i krijuar apo jo. Mendimi jonë dhe mendimi i imamëve tanë është se Kurani është fjalë e Allahut ﷻ dhe nuk është i krijuar, sepse ai është cilësi e Allahut ﷻ, prej tij ka filluar si fjalë dhe te ai kthehet si dispozitë”.

Më pas përmend kundërshtimet rreth shikimit të Allahut ﷻ dhe thotë: “Mendimi jonë dhe i imamëve të udhëzuar, sipas asaj që besojmë, është se Allahu ﷻ do të shikohet në ditën e gjykimit”. Pastaj përmendi argumentet përkatëse.

Pastaj thotë: “Dije, Allahu të mëshiroftë, se unë i rendita kundërshtimet sipas rradhës që i kanë renditur muhadithët sipas periudhave të tyre. Ndërsa tani po filloj me përmendjen e gjërave që ne besojmë, duke thënë:

Besojmë se Allahu ﷻ ka një Arsh, mbi të cilin është lartësuar, sipër shtatë qiejve, me emrat dhe cilësitë e tij. Allahu ﷻ thotë: ﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾ Taha 5, ﴿E drejton çështjen nga qielli për në tokë e pastaj ngjitet sërish tek ai﴾ Es sexhde 5. Nuk themi ai është në tokë ashtu siç është në qiell mbi Arsh, sepse ai është i ditur për atë që veprojnë robërit e tij”.

Deri kur thotë: “Besojmë se Allahu ﷻ e ka krijuar xhenetin dhe zjarrin. Ato janë krijuar për përjetësi dhe nuk do të zhduken”. Deri kur thotë: “Besojmë se profeti ﷺ u ngjit si person deri te “sidretul munteha”. Pastaj thotë: “Besojmë se Allahu ﷻ ka kapur dy grushta dhe ka thënë: “Ata janë për xhenetin, ndërsa këta për zjarrin”.² Besojmë se

¹ Nga temat e mutezilëve ku flasin rreth temës së imanit dhe dispozitave të tij.

² **Hadith sahih.** E transmeton Maliku në “El muata” (3337), Ebu Daudi (4703), Tirmidhiu (3075), Ahmedi (311) dhe të tjerë. Ibn Abdulberri e konsideron të dobët në “Et temhid” po ashtu edhe shejh Albani.

E transmeton edhe Hakimi në “El mustedrek” (84) nga rruga e Rashid ibn Sadi, nga Abdurrahman ibn Katade Sulemiu, i cili është nga sahabët e profetit, thotë: E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: “Allahu e krijoi Ademin dhe pastaj i krijoi njerëzit prej shpinës së tij pastaj tha: Këta janë të xhenetit dhe nuk më intereson, ndërsa këta janë të zjarrit dhe nuk më intereson. I thanë: O i dërguari i Allahut! Përse të punojmë? U tha: Në përputhje me kaderin”. Hakimi thotë: “Ky është hadith sahih. Buhariu dhe

profeti ﷺ do të ketë hauzin e tij. Besojmë se ai është i pari ndërmjetësues dhe i pari që do i jepet leja për të ndërmjetësuar".

Pastaj përmendi rrugën e siratit, peshoren, vdekjen, dhe se i vrari është vararë sipas exhelit që i është caktuar dhe se riskun e ka përfutur të plotë, e deri kur thotë: *"Besojmë se Allahu ﷻ zbrit çdo natë për në qiellin e dynjasë në një të tretën e fundit të natës. E shtrin dorën e tij dhe thotë: "A ka ndonjë që lutet?". Ai zbrit edhe në natën e mesmuajit të shabanit dhe në muzgun e Arafatit", pastaj përmend hadithet përkatëse.¹*

Thotë: *"Besojmë se Allahu ﷻ i ka folur Musës ﷺ me fjalë. E ka marrë Ibrahimin ﷺ për halil dhe se grada e "el huleh" është e ndryshme nga ajo e nevojtarisë dhe jo ashtu siç pretendojnë bidatçinjtë. Besojmë se Allahu ﷻ e ka veçuar profetin tonë ﷺ me shikimin e tij. Ai e ka marrë profetin tonë ﷺ halil ashtu siç e ka marrë Ibrahimin ﷺ halil. Besojmë se pesë çelsat e gajbit i di vetëm Allahu ﷻ: ﴿Te Allahu është dija e kiametit ...﴾ Lukman 34.*

Besojmë se dhënia mest mbi këpucë është e lejuar, tre ditë për udhëtarin dhe një ditë e një natë për vendaliun.

Besojmë se duhet bërë sabër ndaj sulltanit kureshi kur vepron me drejtësi apo me padrejtësi, përderisa e fal namazin, xhumanë dhe bajramin. Xhihadi me ta është i lejuar deri në ditën e gjykimit.

Muslimi janë pajtuar për argumentimin me transmetuesit e tij deri te sahabët. Abdurrahman ibn Katade është prej fisit Seleme, prej sahabëve". Me saktësimin e tij është pajtuar edhe Dhehebiu.

E transmeton edhe Bejhakiu në "El esmau ues sifāt" (712), nga Rashid ibn Sadi, nga Abdurrahman ibn Katade nga Hisham ibn Hakemi nga profeti. Prandaj disa dijetarë e kanë konsideruar këtë hadith të paqëndrueshëm (muterib).

Shejh Albani megjithëse në "Es silsiletu ed daifeh" e ka konsideruar të dobët, mirëpo më vonë është kthyer nga ky mendim dhe e ka saktësuar atë bazuar në transmetime të tjerë, ku prej tyre transmetimi i Hakimit që u përmend mësipërm. Shejhu përjashton fërkimin e kurrizit të Ademit prej Allahut, shtesë e cila nuk është e saktë. Shiko fusontat e shejh Albanit për akiden e Tahaviut, botimi i nëntë.

Shënim: Në këto rivajete nuk përmendet kapja e dy grushtave prej Allahut, por vetëm krijimi i njerëzve nga kurrizi i Ademit.

¹ **Hadith sahih.** Hadithi i natës së mesmuajit të shabanit transmetohet nga shumë sahabë. Shejh Albani i ka përmbledhur rrugët e këtij hadithi në silsilën e haditheve sahihe, hadithi nr 1144, duke përmendur plot 8 sahabë të ndryshëm dhe në fund thotë (3/138): "Shkurtimisht ky hadith me të gjitha rrugët e tij është sahih, pa pikë dyshimi. Saktësia e hadithit vërtetohet edhe me një numër më të vogël përderisa transmetimet nuk janë shumë të dobta, siç është rasti me këtë hadith".

Ky hadith transmetohet me tekste të ndryshme, prej tyre hadithi i Aishes: *"Allahu zbrit natën e mesmuajit të shabanit për në qiellin e dynjasë dhe fal (prej njerëzve) më shumë se numri i qimeve të bagëtisë së Kelbit".* Kelbi është një fis arab i shquar për rritjen e bagëtive.

Ndërsa hadithin e Arafatit e transmeton Muslimi (1348) prej hadithit të Aishes se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *"Nuk ka ndonjë ditë që Allahu liron më shumë njerëz prej zjarrit sesa dita e Arafatit. Ai afrohet (atë ditë) dhe u mburret melekëve me robërit e tij dhe thotë: Çfarë dëshirojnë ata?".* Pra çfarëdo që të dëshirojnë le të më lusin se unë do t'ua plotësojë.

Namazi me xhemat është vaxhip kudo që të thirret, nëse nuk ekziston ndonjë arsye ose pengesë. Taravitë janë sunet. Dëshmojmë se kush e le namazin me qëllim ai është qafir. Dëshmia (me xhenet apo zjarr) dhe distancimi (prej gjynahqarëve) janë bidate. Namazi për atë që vdes prej pasuesve të kibles është prej rrugës profetike. Nuk gjykojmë për askënd me zjarr dhe me xhenet derisa Allahu ﷻ të gjykojë për ta. Polemikë dhe debatet në fe janë bidate. Besojmë se ato që ndodhën mes shokëve të profetit duhen kthyer te Allahu ﷻ. Bëjmë rrahmet dhe teradi për Aishen. Të folurit rreth shqiptimit dhe të shqiptuarit, apo rreth emrit dhe të emërtuarit, apo nëse imani është apo nuk është i krijuar, është bidat.

Dije se unë përmenda besimin e ehlisunetit përgjithësisht pa detaje, ashtu siç është transmetuar prej sahabëve dhe tabinëve. Kjo sepse fjalët e dijetarëve tanë (sufistët) të njohur prej imamëve të kapur me fenë u përmendën më parë. Mirëpo unë dëshiroj të përkujtoj besimin e kolegëve tanë sufi, për t'u ruajtur nga ajo që e ka shpikur një grup i cili u është atribuar sufive. Realisht ata kanë trilluar disa mendime, prej të cilave Allahu ﷻ e ka ruajtur medhhebin dhe pasuesit tanë".

Deri kur thotë: "Kam lexuar prej Muhamed ibn Xherir Taberit në librin me titull "Et tebsir", të cilin e ka shkruar për banorët e Taberistanit, për një kundërshtim që kishte ndodhur mes tyre. Ata i kërkuar t'u përpilonte një libër rreth asaj që besonte dhe mendonte. Në këtë libër, ai përmend kundërshtimin rreth shikimit të Allahut ﷻ, duke përmendur prej një grupi pohimin e shikimit si në dynja ashtu edhe në ahiret. Ai ua atriboi këtë mendim sufistëve përgjithësisht pa veçuar ndonjë grup të tyre.

Duket qartë se ai nuk i ka njohur fjalët e dijetarëve sufist eminent. Pas akuzimit që u bëri sufive, këtë mendim ia atriboi edhe djalit të motrës së Abdulvahid ibn Zejdit. Allahu e di më mirë se çfarë pozite ka pasur Abdulvahid ibn Zejdi, e si mund të jetë puna me djalin e motrës së tij?!¹

Jo çdo mendim që një i devijuar shpik në medhhebin e tij, ai mendim duhet t'i mvishet të gjithë medhhebit. Kështu qëndron puna edhe me fukahatë dhe muhadithët. Jo çdo mendim që e shpik dikush në fikh, për të cilin nuk ka hadith të përshtatshëm, lejohet që ky mendim t'u mvishet të gjithë fukahave dhe muhadithëve.

Dije se termat dhe njohuritë e sufive përdoren me kuptime të ndryshme. Ata përdorin disa terma në disa tema që lidhen me ta, apo në disa botkuptime dhe simbolizime të cilat i përdorin në mesin e tyre. Ai që nuk jeton në mesin e tyre për të njohur realitetin e tyre dhe kundërshton atë që ata e thonë, ka për t'u kthyer prej sufive i humbur dhe i dërmuar".

¹ Ka për qëllim se Abdulvahid ibn Zejdi nuk është prej dijetarëve sufi të njohur dhe as mendimet e tij nuk janë të pranuar. Shumë sufistë e kanë refuzuar atë me gjithë mendimet e tij. Prandaj nuk mund të merret mendimi i tij për të përfaqësuar sufistët.

Pastaj përmendi botkuptimin e termit "shikim" në mesin e tyre. Thotë: "Shumë herë sufistët thonë: E kam parë Allahun". Thotë: "Transmetohet se Xhafer ibn Muhamedi kur u pyet: A e ke parë Allahun atëhere kur e adhurove? Tha: E pashë Allahun ﷺ dhe pastaj e adhurova. Pyetësi i tha: Si e pe atë? I tha: Nuk e pa atë shikimi me perceptimin e syrit, por shikimi i zemrave me plotësimin e bindjes".

Pastaj thotë: "Allahu ﷻ shikohet në ahiret ashtu siç na ka njoftuar në librin e tij dhe na ka njoftuar i dërguari i tij ﷺ. Ky është mendimi jonë dhe mendimi i imamëve tanë, po të përjashtojmë injorantët budallenj në mesin tonë".

Besojmë se Allahu ﷻ ua ka bërë haram besimtarëve jetët, pasuritë dhe nderet e njëri-tjetrit. Këtë e ka përmendur në haxhin e lamtumirës. Kush pretendon se ka arritur te Allahu një gradë, aq sa Allahu ﷻ i lejon atij ato gjëra që ua ka bërë haram besimtarëve _përveç të detyruarit për t'i shpëtuar vdekjes_, sado pozitiv të ketë në dije dhe në adhurim, atëhere ai ka bërë kufër me Allahun ﷻ. Kush pretendon një mendim të tillë, ai është "ibahi" dhe ibahitë¹ janë të dalur prej fesë.

Prej gjërave që besojmë është edhe mopërdorimi i fjalës "ishk" për Allahun".

Pastaj përmendi arsyen e moslejimit, për shkak të prejardhjes së kësaj fjale dhe sepse ajo nuk është trasmetuar në sheriat. Thotë: "E pakta që mund të thuhet për të është se ajo është bidat dhe humbje. Përdorimi i fjalës "dashuri" të përdorur në Kuran është i mjaftueshëm.

Besojmë gjithashtu se Allahu nuk hyn brenda sendeve të shikuara. Ai është i vetëm me emrat dhe cilësitë e përsosura, i ndarë nga krijesat, i lartësuar mbi Arsh.

Besojmë se Kurani është fjalë e tij dhe i pakrijuar, kudo që të lexohet, studiohet dhe mësohet.

Besojmë se Allahu ﷻ e ka marrë Ibrahimin عليه السلام dhe profetin tonë Muhamed ﷺ për halil dhe të dashur. Kuptimi i "El hul-lah" është ndryshe nga fjala e mutezilive se ajo është nevoja dhe varësia.

Deri kur thotë: "El huleh" dhe dashuria janë dy cilësi të Allahut ﷻ me të cilat cilësohet. Mirëpo cilësitë e tij nuk shpjegohen me detaje (modalitete) dhe as nuk përngjasohen. Cilësia e dashurisë dhe miqësisë (el hul-leh) të krijesat mund të shpjegohet me modalitete, ndërsa cilësitë e Allahut njihen në dije dhe ekzistojnë në njohuri por nuk përngjasohen. Besimi i tyre është i detyruar dhe forma e tyre është e mohuar.

Besojmë që Allahu ﷻ i ka lejuar fitimet, tregëtinë dhe zanatet, por ka bërë haram mashtrimin dhe padrejtësinë. Kush pretendon ndalimin e këtyre fitimeve ai është i devijuar, i humbur dhe bidatçi. Sepse fesadi, padrejtësia dhe mashtrimi nuk

¹ Ibahi quhet çdo person i cili i rrëzon kufijtë e hallallit dhe haramit dhe nuk konsideron asgjë tabu në fe.

konsiderohen tregëti dhe zanat. Allahu ﷻ dhe i dërguari i tij ﷺ kanë ndaluar çrregullimin por jo fitimin dhe tregëtinë. Ato janë të lejuara me Kuran dhe sunet deri në ditën e gjykimit.

Prej asaj që besojmë është se Allahu ﷻ nuk urdhëron për ngrënien e hallallit e nga ana tjetër e bën të pamundur arritjen të hallalli nga çdo aspekt. Sepse ajo me të cilën i ka ngarkuar do të ekzistojë deri në ditën e gjykimit. Besimi se toka do të zbrazet prej hallallit dhe njerëzit do ta pranojnë haramin është besim i humbur dhe i shpikur. Hallalli pakësohet diku dhe shtohet diku tjetër, mirëpo nuk zhduket nga toka plotësisht.

Besojmë se nëse e shikojmë një njeri që në aparençë është punëmirë, atëhere nuk e akuzojmë atë në fitimin, pasurinë dhe ushqimin e tij. Lejohet të hahet ushqimi i tij dhe të bëhet tregëti me të dhe nuk na lejohet të gjurmojmë për atë që ai thotë. Nëse dikush pyet për t'u siguruar atëhere lejohet. Ndërsa ai që përzihet me të padrejtët dhe pasurinë hallall e ka përzier me pasuri të përvetësuar padrejtësisht, atëhere duhet pyetur për t'u ruajtur, ashtu siç pyeti Ebu Bekr Sidiku ؓ shërbëtorin e tij. Nëse ai ka pasuri të tjera hallall të cilat janë përzier me pasurinë haram, atëhere kjo pasuri nuk quhet as hallall dhe as haram, por quhet e dyshimtë. Ai që pyet i ka larguar dyshimet për hirë të fesë, ashtu siç vepri Ebu Bekr Sidiku ؓ. Ibn Mesudi ؓ dhe Selman (Farisiu) ؓ e kanë lejuar ngrënien prej saj dhe gjynahu rëndon mbi pronarin. Njerëzit janë me grada dhe feja është hanifija e pastër.

Besojmë se robi përderisa akoma vazhdon të jetojë në dynja, atëhere nuk duhet të zhvishet nga frika dhe nga shpresa. Kushdo që e pretendon sigurinë ai është i paditur për Allahun ﷻ dhe fjalën e tij: **﴿Askush përveç popullit të humbur nuk sigurohet prej kurdisjes së Allahut﴾** El araf 99. Për refuzimin e kësaj lajthitje kam shkruar një libër të veçantë.

Besojmë se konsiderimi i vetes "rob i Allahut" nuk rrëzohet në asnjë mënyrë përderisa njeriu logjikon dhe di ta shquaj hallallin prej haramit, por trajtohet sipas mundësisë dhe fuqisë që ka (për kryerjen e detyrave fetare). Allahu ﷻ nuk i ka liruar (nga dispozitat fetare) as profetët, as sidikinët, as shehidat, as të devotëshmit. Ai që pretendon se ka dalë jashtë rrethit të "robërimit ndaj Allahut", për në hapësirën e lirisë së pakufishme, duke e rrëzuar "robërinë" dhe duke u përkushtuar me dispozitat e bashkimit të nismëtarit¹ dhe dispozitat e ahiretit, atëhere ai është qafir pa pikë dyshimi. Këtu bën përjashtim vetëm ai të cilin e kaplon sëmundja dhe kalon në lajthitje, apo çmendet, apo e godet ndonjë sëmundje në kokë, e cila ia trazon logjikën, apo i humbet logjika dhe i humbet fuqija e dallimit dhe njohjes. Kush pretendon diçka të tillë (kur është i shëndoshë nga mendja) atëhere ai është i dalur prej umetit islam dhe i

¹ Në termat e sufistëve të devijuar (el ehadije – bashkimi) është shkrirja e robit me Allahun në një të vetëm. Ndërsa (El mubdiije – nisma ose nismëtar) është prej termave që ata i përdorin për Allahun e marrë nga emri i Allahut "El mubdiu".

distancuar nga sheriati.

Kush pretendon drejtimin e krijesave apo njohjen e gjëndjes dhe të sasisë së tyre të Allahut, pa ndonjë fjalë që i është shpallur profetit, atëhere ai është i dalur prej fesë islame. Ai që pretendon se e njeh përfundimin e krijesave dhe atë që do të ndodhë me to, apo si do të vdesin, apo me çfarë do t'u mbyllën veprat e tyre, pa u bazuar në shpalljen prej ajeteve dhe haditheve, atëhere ai e ka merituar zemërimin e Allahut.

Parandjenja (el firase) është e vërtetë, sipas bazave që përmendëm dhe ajo nuk ka lidhje me fjalët që u thanë mësipërm.

Kush pretendon se cilësitë e Allahut ﷻ ekzistojnë në cilësitë e tij, pa pasur për qëllim fuqinë, mbrojtjen, udhëzimin dhe drejtimin, por ka për qëllim vetë cilësitë e amëshuara të Allahut ﷻ, atëhere ai është "hululi" që pretendon uluhijen dhe mishërimin, dhe kjo padyshim është kufër.¹

Besojmë se të gjithë shpirtrat janë të krijuar. Ai që pretendon se ato nuk janë të krijuar, u ka përngjasuar besimit të të krishterëve nestorian² rreth natyrës së mesihut. Kjo është kufër me Allahun e madh.

Kush thotë se disa cilësi të Allahut ﷻ kanë hyrë te rob, ose thotë se Allahu përpjestohet në pjesë, ai ka bërë kufër.

Kurani është fjalë e Allahut ﷻ dhe i pakrijuar dhe nuk ka hyrë brenda krijesave. Kudo që të lexohet, të recitohet apo të mësohet përmendësh ai është cilësi e Allahut. Të mësuarit nuk është njësoj si i mësuarit dhe të lexuarit nuk është njësoj si i lexuari, sepse Allahu ﷻ me gjithë emrat dhe cilësitë e tij nuk është i krijuar. Kush thotë diçka tjetër ai është qafir.

Besojmë se leximi i Kuranit me melodi është bidat dhe humbje. "Kasidet" janë bidat. Ato janë dy llojëshe. E mira prej tyre që përmend mirësitë dhe begatitë e Allahut dhe përmend vlerat e njerëzve të mirë dhe përshkrimin e të devotshëmve, ajo është e lejuar. Por lënia e tyre dhe preukopimi me përmendjen e Allahut, Kuranin dhe dijen është më parësore. Ndërsa kasidet që përngjasojnë Allahun me krijesat dhe me gjërat prezente janë kufër.

¹ Hululi është personi që beson se Allahu është mishëruar te krijesat ose ka hyrë te krijesat. Njësoj si besimi i të krishterëve që besojnë se natyra hyjnore ka hyrë në trupin njerëzor të mesiut. I pastër është Allahu prej asaj që thotë të padrejtët.

² Sekti i krishterë origjina e të cilit kthehet te Nestori i cili ka qënë patriaku i Kostantinopojës në 428–431 e.s. Në kohën e profetit ﷺ kanë qënë të përhapur në Gadishullin Arabik dhe në Irak. Delegacionet e krishtera që kanë vizituar profetin ﷺ në Medine kanë qënë pikërisht nga ky sekt.

Ata besojnë se krishti ka pasur dy natyra. Natyra hyjnore dhe natyra njerëzore. Krishti ka qënë njeri i krijuar, mirëpo në të ka hyrë shpirti dhe fjala e zotit e cila është hyjnore dhe e pakrijuar.

Prandaj shejhu këtu thotë se kush pretendon që shpirtërat janë të pakrijuar, ai ka pretenduar se ato kanë natyrë hyjnore dhe ka përngjasuar me nestorianët.

Dëgjimi i muzikës dhe rubairave për adhurim është kufër. Vallëzimi me muzikë dhe lavdërimi i fesë së valltarëve është fisk, ndërsa vallëzimi për kënaqësi dhe melodi është lojë dhe humbje kohe.

*Dëgjimi i rubairave dhe kasideve me melodi që ndodh në mesin e “ehli etbait”¹ për përkujtimin e Allahut është haram. Përveçse nëse ka dije rreth teuhidit dhe njohjes së emrave dhe cilësive të Allahut dhe çfarë lejohet dhe çfarë nuk lejohet t’i atribuhet Allahut, atëhere dëgjimi i tyre është si fjala e Allahut: **﴿Ata që e dëgjojnë fjalën dhe pasojnë më të mirën e saj﴾** Ez zumer 18.*

Kushdo që nuk i njeh (dispozitat e teuhidit) dhe dëshiron t’i dëgjojë ato për Allahun ﷻ pa pasur parasysh dallimin e përmendur më parë, atëhere kjo është kufër pa diskutim. Nuk lejohet askujt të shkruajë dhe të dëgjojë kasiden ku i atribuhet Allahut ﷻ diçka, përveç atij që e di atë që të përmenda më parë; si kasidet me përkujtimin e Allahut ﷻ dhe mirësive të tij, apo si kasidet që e përshkruajnë Allahun me cilësitë e tij e jo me cilësitë e krijesave. E megjithatë lënia e tyre është më parësore sepse origjina në to është se ato janë të shpikura dhe nuk janë të sigurta prej fitnes së dëgjimit të muzikës.

Mexhliset e dëgjimit të muzikës dhe vallëzimit sipas rubairave, janë bidat. Ato i kanë kundërshtuar Metlebiu², Maliku, Theuriu, Jezid ibn Haruni, Ahmed ibn Hambeli dhe Is'haku. Pasimi i tyre është më parësor se pasimi i atyre që nuk dinë në fe dhe as nuk janë nga të parët e sinqertë.

Më është përcjellur se Bishër ibn Harithit i thanë: Shokët e tu kanë shpikur një diçka që e quajnë "kaside". Tha: Si është ajo? I tha: Si fjala e tij: Duro o shpirt derisa të banosh në botën tjetër. Tha: Mirë. Ku janë ata që e dëgjojnë këtë? I tha: Në Bagdat. Tha: Kanë gënjuar, pasha atë përveç të cilit nuk ka ilah tjetër. Nuk banon në Bagdat ai që dëgjon të tilla gjëra.³

*Thotë Ebu Abdullahi: Mendojmë dhe kjo është edhe mendimi i imamëve tanë se i varfëri nevojtar i cili bën durim dhe nuk lyp (njerëzit), derisa ta furnizojë Allahu, ai e ka gradën më të lartë. Ndërsa (i varfëri) që nuk duron dot është më mirë që të kërkojë, bazuar në fjalën e profetit: **"Nëse dikush prej jush merr litarin e tij ..."**.⁴*

Mendojmë se braktisja e fitimit nëpërmjet punës nuk është e lejuar, përveçse me kushtin e mospasjes nevojë dhe mosshtrirjen e dorës te njerëzia. Kush e merr lypjen për

¹ Ndoshta është prej termave sufist. Nuk e di se çfarë ka pasur për qëllim me të autori.

² Imam Shafiu, Allahu e mëshiroftë.

³ Ka për qëllim se Bagdati në atë kohë ka qënë i prishur në krahasim me vendet e tjera islame. Shumë prej zahidëve dhe njerëzve të devotshëm nuk e kanë preferuar jetesën në Bagdat për shkak të fiskut dhe prishjes, që nuk ekzistonte në vende të tjera.

⁴ Hadithi i plotë sipas Buhariut (1470): **"Pasha atë përveç të cilit nuk ka ilah tjetër! Nëse dikush prej jush merr një litar dhe ngarkon dru në shpinën e tij, është më mirë për të se të lypë nga një person, i cili nuk dihet i jep apo nuk i jep"**.

zanat, megjithëse është i shëndoshë, ai është i përbuzur dhe jashtë realitetit (të devotshmërisë).

Mendojmë se dëgjuesi i muzikës dhe ahengeve është ashtu siç e ka cilësuar profeti: **"Muzika e mbin nifakun në zemër".**¹ Edhe pse nuk bën kufër, mirëpo ai padyshim që është fasik.

Zgjedhim si mendim fjalën e imamëve tanë për braktisjen e polemikës në fe dhe të folurit se a është imani i krijuar apo i pakrijuar. Kush pretendon se i dërguari ﷺ është ndërmjetës që përcjell ndërsa i dërguari tek ata është më i mirë se ai, atëhere ai ka bërë kufër me Allahun.² Gjithashtu ai që mohon çdo lloj ndërmjetësimi ai është qafir³. Mbaroi fjala e tij.

Prej sufistëve të mëvonshëm është edhe shejhu dhe imami Ebu Muhamed Abdulkadir ibn Ebi Salih Xhejlaniu⁴. Në librin "El gun'jeh" thotë: "Përshkrimi shkurtimisht i njohjes së krijuesit me ajete dhe dëshmi, është: Të njohë me bindje të plotë se Allahu ﷻ është një dhe i vetëm".

Deri kur thotë: "Ai është në drejtimin e lartësisë, i lartësuar mbi Arshin e tij, mbizotërues në sundim, gjithpërfshirës i gjërave me dijen e tij: **﴿Tek ai ngjitet fjala e mirë dhe punën e mirë e ngre atë﴾** Fatir 10. **﴿E drejton çështjen nga qielli për në tokë e pastaj ngjitet sërish tek ai në një ditë gjatësia e të cilës është njëmijë vjet si ajo që numëroni﴾** Es sexhde 5.

Nuk lejohet të thuhet që është kudo, por thuhet: ai është në qiell sipër Arshit, ashtu siç ka thënë: **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾** Taha 5."

Pastaj përmend ajete dhe hadithe të tjera derisa thotë: "Cilësia e istivasë duhet pohuar pa i bërë tavil. Ai është lartësuar mbi Arsh me vetëveten e tij".

¹ Më e sakta është që ky hadith është prej fjalës së Ibn Mesudit. Transmetimi prej fjalës së profetit nuk është sahih. Si fjalë të Abdullah ibn Mesudit e transmeton Meruziu në "Tadhimu kadrish salah" (680), nga rruga e Hamad ibn Ebi Sulejmanit, nga Ibrahim Nehaiu nga Abdullah ibn Mesudi. Me të njëjtën rrugë e transmeton edhe Bejhakui (21006) në "Es sunenul kubra", Halali në "Es sunneh" (1647) dhe të tjerë. Senedi i tij është i saktë siç e përmend shejh Albani në "silseletu el ehadithi ed daifeh" (2430). Ibn Kajimi në "Igathetuh lehfan" thotë: "Kjo fjalë është saktësuar nga Ibn Mesudi dhe transmetohet edhe prej profetit".

² Qëllimi i Muhamed ibn Hafifit është për disa grupe të humbura të sufive që besojnë se veliu është më i mirë se profeti, sepse profeti është një hallkë e mesme në përcjelljen e fesë, ndërsa veliu është më i mirë.

³ Sepse kështu ka mohuar që profeti ﷺ është ndërmjetës mes Allahut dhe krijesave përse i takon përcjelljes së fesë dhe dispozitave të saj.

⁴ Abdulkadir Xhejlaniu (471-561h). Dijetar sufist i njohur dhe shejhu i tarikatit kaderi. Ka qënë i njohur për dijen, ibadetin dhe zuhdin e tij. Hante vetëm prej fitimit që e nxirte me punën e tij. Medhhebi i tij në fikh ka qënë hanbeli. I janë mveshur shumë fjalë dhe shprehje të paqëna. Ashtu si edhe tarikatit i pasuesve të tij është katandisur në një tarikat të ndryshëm nga rruga e shejhut të tyre. Për dijen dhe pozitën e tij dëshmojnë vetë librat e tij. Prej tyre libri "El gun'jeh" i cili është botuar me botime të ndryshme.

Dhe thotë: *"Lartësimi i tij mbi Arsh është përmendur në çdo libër që është zbritur për çdo profet të dërguar, pa shpjegim modaliteti"*.

Pastaj zgjerohet më gjatë por vendi nuk na lejon ta citojmë të plotë, dhe pastaj përmend cilësitë e tjera. E sikur të përmendja çdo gjë që kanë thënë dijetarët ky libër do të zgjerohej shumë.

Ibn Abdulberri ka thënë: *"Kemi transmetuar prej Malik ibn Enesit, Sufjan Theuriut, Sufjan ibn Ujejnes, Euzaiut dhe Muamer ibn Rashid se ata të gjithë kanë thënë për hadithet e cilësive: "Kalojini ato ashtu siç kanë ardhur"*.

Ebu Umeri thotë: *Ajo që është transmetuar prej profetit ﷺ nëpërmjet të besueshmëve apo është transmetuar prej sahabëve, ajo është dije e cila merret për fe. Ndërsa ajo që është shpikur pas tyre dhe nuk ka bazë të fjalët e tyre, ajo është bidat dhe humbje"*.

Në komentimin e Muvatas, kur flet për hadithin e zbritjes thotë: *"Ky hadith është i vërtetuar në transmetim, sahih në aspektin e senedit. Asnjë prej muhadithëve nuk kundërshton rreth kësaj. Ai është transmetuar me rrugë të tjera përveç kësaj, prej transmetimeve të të drejtëve prej profetit"*.

Në këtë hadith ka argument se Allahu ﷻ është në qiell, i lartësuar mbi Arsh, sipër shtatë qiejve, ashtu siç ka thënë xhemati. Hadithi është argument kundër mutezilive për mendimin e tyre se Allahu ﷻ është kudo me vetveten e tij.

Thotë: *"Argument për saktësinë e asaj që kanë thënë pasuesit e të vërtetës, është fjala e Allahut ... pastaj përmendi disa ajete deri kur thotë: "Kjo është aq e njohur dhe e ditur në mesin e dijetarëve dhe muslimanëve të thjeshtë, saqë nuk ka nevojë të zgjatemi por mjafton vetëm përmendja e saj, sepse ajo është dije apriori. Askush nuk u ka kërkuar shpjegime rreth tyre dhe asnjë musliman nuk i ka kundërshtuar"*.

Ebu Umer ibn Abdulberri gjithashtu thotë: *"Të gjithë ulematë e sahabëve dhe të tabinëve prej të cilëve është mbartur interpretimi i Kurait, janë pajtuar për interpretimin e fjalës së Allahut: **﴿Nuk ka ndonjë grup tre vetësh veçse Allahu është i katërti i tyre﴾** El muxhadeleh 7, se ai është mbi Arsh dhe dija e tij është kudo. Askush prej atyre që u peshon fjala, nuk i ka kundërshtuar ata në këtë çështje"*.

Gjithashtu Ebu Umeri thotë: *"Ehli suneti janë pajtuar me ixhma rreth pohimit të cilësive të përmendura në Kuran dhe sunet dhe besimin e tyre dhe komentimin e tyre sipas kuptimit real dhe jo kuptimit metaforik. Mirëpo ata nuk japin detaje për formën e tyre dhe nuk e përshkruajnë me hollësi modale"*.

Ndërsa bidatçitë si xhehmitë, mutezilitë, harixhitë, të gjithë ata i mohojnë dhe nuk i komentojnë ato sipas realitetit. Ata besojnë se kush i pohon këto cilësi, ai është përngjasues. Ndërsa sipas pohuesve të cilësive ata në realitet janë mohues të zotit. E

vërteta i takon atyre që janë shprehur me atë që është shprehur Kurani dhe suneti i profetit dhe ata janë imamët e xhemitit". Kjo ishte fjala e Ibn Abdulberrit, imamit të krahinave perëndimore.

Në kohën e Ibn Abulberrit ka jetuar edhe hafidh Ebu Bekr Bejhakui¹. Megjithëse ai i pati përkrahur kelamistët nga pasuesit e Ebu Hasen Eshariut dhe i pati mbështetur. Në librin "El esamu ues sifati" thotë:

"Kapitull rreth argumenteve të pohimit të dy duarve si dy cilësi, jo si gjymtyrë, bazuar në hadithin e të sinqertit (profeti ynë) që i pohon ato.

Allahu ﷻ thotë: **﴿O Iblis! Çfarë të pengoi t'i biesh në sexhde asaj që e krijova me dy duart e mia﴾** Sad 75. Dhe thotë: **﴿Por dy duart e tij janë të shtrira me bujari﴾** El maideh 64.

Pastaj përmend hadithet sahihe në këtë çështje, si fjala e profetit ﷺ në më shumë se një hadith rreth shefatit: **"O Adem! Ti je babai i njerëzimit. Ty të krijoi Allahu me dorën e tij".²**

Apo si fjala e profetit ﷺ në hadithin mutefek alejhi: **"Ti je Musa. Allahu të ka zgjedhur ty për fjalën e tij dhe t'i ka shkruar pllakat me dorën e tij".³** Në një transmetim tjetër thuhet: **"Ta ka shkruar Teuratin me dorën e tij".**

Apo si ajo që transmetohet në sahihun e Muslimit se: **"Allahu e ka mbjellur me dorën e tij xhenetin e Adnit si mikëpritje për evlijatë e tij".⁴**

¹ Ebu Bekr Bejhakui (384-458). Muhadithi i kohës së tij dhe fakihu shafi i nderuar. Nxënësi i Hakimit. E mbrojti fikhun e imam Shafiut me argumenta dhe hadithe, aq sa thuhet: Të gjithë janë borxhli ndaj Shafiut, përveç Ebu Bekr Bejhakiut, të cilit Shafiu i është borxhli.

Përfaqësues i brezave të mesëm në shkollën esharite, në rangun e Ebu Sulejman Hatabiut, Halimit dhe Ebu Is'hak Isfirajinit. Autor i shumë librave, prej tyre "Es sunenul kubra", "El esmau ues sifati", "Shuabul imani", etj.

² **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu (7516) dhe Muslimi (193). Kjo është vetëm një pjesë e një hadithi të gjatë rreth ngjarjeve të ditës së gjykimit. Në transmetimin e Buhariut thuhet: **"Do të grumbullohen besimtarët në ditën e gjykimit dhe thonë: Sikur të ndërmjetësonim te zoti ynë, që të na lirojë prej vendit ku ndodhemi. Atëhere shkojnë te Ademi dhe i thonë: Ti je Ademi, babai i njerëzimit. Ty të ka krijuar Allahu me dy duart e tij. ..."**

³ **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu dhe Muslimi. U përmend më parë.

⁴ **Hadith sahih.** E transmeton Muslimi (1/312). Hadithi i plotë: **"Musai pyeti zotin: Kush është njeriu me gradën më të ulët në xhenet? I tha: Një njeri që vjen pasi t'i fusë banorët e xhenetit në xhenet dhe i thuhet: Hy në xhenet. Thotë: O zot! Si të hyjë kur të gjithë njerëzit kanë hyrë në shtëpitë e tyre dhe kanë marrë pjesët e tyre?!"**

I thuhet: A je i kënaqur nëse të jepet sa pushteti i një mbreti prej mbretërve të dynjasë? Thotë: U kënaqa o zot! I thotë: Do të jap këtë dhe aq sa kjo dhe aq sa kjo dhe aq sa kjo dhe aq sa kjo. Në herën e pestë tha: U kënaqa o zot. I thotë: Kaq dhe dhjetë fishin e saj. Ty të takon ajo që ta ka ënda dhe kënaqasia e syrit. Thotë: U kënaqa o zot.

Apo si fjala e profetit ﷺ: "Toka në ditën e gjykimit do të jetë si një bukë e vetme. Xhebari e përgatit atë me dorën e tij ashtu siç e përgatit ndokush prej jush bukën e tij në udhëtim. E gjitha kjo si mikëpritje për banorët e xhenetit".¹

Pastaj përmendi hadithe si fjala e profetit ﷺ: "Në dorën e tij është çështja".² "Mirësia është në dy duart e tua"³, "Pasha atë në dorë të të cilit është shpirti im"⁴, "Allahu e shtrin dorën e tij natën që të pendohet keqpunuesi i ditës dhe e shtrin dorën e tij ditën që të pendohet keqpunuesi i natës".⁵

Apo fjala e profetit ﷺ: "Të drejtët do të jenë te Allahu, ulur në stola të ndriçuar, në të djathtën e të mëshirëshmit dhe të dyja duart e tij janë "jemin".⁶

Dhe fjala e tij: "Allahu i palos qiejt ditën e gjykimit, pastaj i merr ato me dorën e tij të djathtë, pastaj thotë: Unë jam sundimtari! Ku janë tiranët? Ku janë kryeneçët? Pastaj i palos tokat me të majtën e tij dhe thotë: Unë jam sundimtari!

Thotë (Musai): Po më i larti në pozitë? I tha: Për këta që po pyet, unë kam mbjellur me dorën time si mikëpritje për ta dhe e kam vulosur. Asnjë sy s'e ka parë dhe asnjë vesh s'e ka dëgjuar dhe askujt s'i ka shkuar në mendje". Pra Allahu e ka mbyllur këtë xhenet dhe atë s'e kanë parë as melekët dhe askush, derisa evlijatë e tij të hyjnë në të dhe të gjejnë atë që askush s'ka parë dhe s'ka dëgjuar.

¹ **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu (6520) dhe Muslimi (2792).

² **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu (7491), nga Ebu Hurejra se i dërguari i Allahut ka thënë: "Allahu ka thënë: Më ofendoi i biri i Ademit. Ai e shan kohën ndërkohë që unë jam koha, në dorën time është çështja, e këmbë natën dhe ditën".

³ **Hadith sahih.** E transmetojnë Buhariu (3348) dhe Muslimi (1/379) nga Said Hudriu, nga profeti thotë: "Allahu Teala thotë: O Adem! I përgjigjet: Të përgjigjem dhe të bindem dhe e gjithë mirësia është në dy duart e tua. I thotë: Nxirre dërgesën e zjarrit! I tha: Çfarë është dërgesa e zjarrit? Prej çdo njëmijë (vetëve) nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë. Atëhere thinjet i vogli dhe çdo grua me barrë e dështon barrën e saj dhe i shikon njerëzit të dehur, por ata nuk janë të dehur, porse dënimi i Allahut është i ashpër.

I thanë: O i dërguar i Allahut! Cili prej nesh është ai personi i vetëm? U tha: Përgëzohuni! Prej jush do të jetë një person dhe prej jaxhuxhëve dhe maxhuxhëve njëmijë. Pastaj tha: Pasha atë në dorën e të cilit është shpirti im! Shpresoj që të jeni çereku i banorëve të xhenetit. Atëhere ne bëme tekbir. Pastaj tha: Shpresoj të jeni një e treta e banorëve të xhenetit".

Dallimi i selefit të këtij umeti me të mëvonëshmit është si dallimi i hënës së plotë me yjet e tjera. A nuk e shikon se ata jetonin me xhenetin dhe për xhenetin dhe e gjithë jeta e tyre ishte ndërtuar për të hyrë në xhenet. Prandaj edhe pyetja që ata i drejtuan profetit ﷺ ishte për atë personin e vetëm që do të futej në xhenet.

Ndërsa halefi (të mëvonëshmit) gjëja e parë që u shkon ndërmend kur dëgjojnë këtë hadith, a ka në botën tjetër barrë? Nëse ka barrë si ka mundësi që të ketë barrë para se të futen në xhenet? Nëse nuk ka barrë çfarë ka pasur për qëllim profeti dhe Allahu me dështimin e barrës? Allahu na dhëntë dije dhe sinqeritet.

⁴ Ky fragment është transmetuar në shumë hadithe të sakta.

⁵ **Hadith sahih.** E transmeton Muslimi (49/31).

⁶ **Hadith sahih.** E transmeton Muslimi (33/18). Fjala "jemin" në arabisht ka shumë kuptime. Prej tyre e djathta që është e kundërta e të majtës. "Jemin" përdoret edhe për bereqetin dhe begatinë, dhe kjo kihet për qëllim në këtë hadith, pra të dy duart e tij janë të bereqetëshme dhe me begati.

Ku janë tiranët? Ku janë kryeneçët?"¹

Dhe fjala e tij: "E djathta e Allahut është e mbushur plot. Nuk e pakëson atë shpenzimi përgjatë ditës dhe natës. A nuk e shikoni se sa ka dhuruar që kur ka krijuar qiejt dhe tokën. Asgjë nuk i ka pakësuar prej asaj që është në të djathtën e tij. E Arshi i tij është mbi ujë. Ndërsa në dorën tjetër ka peshoren të cilin e ul dhe e ngre".²

Të gjithë këto hadithe kanë ardhur me transmetime sahihe. Ai përmend edhe fjalën e profetit ﷺ: "**Kur Allahu e krijoj Ademin, ndërkohë që duart i kishte të mbyllura, i tha: Zgjidh prej tyre kë të duash. Tha: Zgjodha të djathtën e zotit tim. E të dyja duart e zotit tim janë "jemin" dhe të begata**".³

Apo si hadithin: "**Kur Allahu e krijoj Ademin, e fërkoi me dorën e tij në kurriz ...**".⁴ E shumë hadithe të tjerë të këtij lloji.

Më pas Bejhakui thotë: "*Të herëshmit e këtij umeti nuk i kanë komentuar këto ajete dhe hadithe që i përmendëm në këtë kapitull*".

Të njëjtën gjë thotë edhe për istivanë mbi Arsh dhe për cilësitë e tjera haberije. Megjithatë ai përmend edhe fjalën e disa të mëvonshëmve.

Ndërsa kadiu Ebu Jala në librin "Ibtalul tavi" thotë: "*Nuk lejohet refuzimi i këtyre haditheve dhe as humbja e kohës për tavinin e tyre. Ne e kemi obligim t'i kuptojmë ato në kuptimin parësor të tyre, se ato janë cilësi të Allahut. Ato nuk u përngjasojnë cilësive përkatëse të krijesave. Nuk e besojmë përngjasimin, por besojmë atë që përmendet prej imam Ahmedit dhe imamëve të tjerë ...*".⁵

Pastaj përmendi fjalët që lidhen me këtë çështje nga Zuhriu, Mekhuli, Maliku,

¹ **Hadith sahih** E transmeton Muslimi (50/24).

² **Hadith sahih.** E transmetojnë Buhariu (7411) dhe Muslimi (10/37).

³ **Hadith sahih.** E transmeton Tirmidhiu (3368) Bejhakui në "El esmau ues sifāt" (708), Ibn Ebi Asim në "El sunneh" (206), Bezari në "El musned" (8478), Ebu Jala Meusuliu në "El musned" (6580), Ibn Huzejme në "Et teuhid" (1/160), Hakimi në "El mustedrek" (214) dhe thotë: "Sahih sipas kushteve të Muslimit" dhe me të është pajtuar edhe Dhehebiu. Sh. Arnauti në shqyrtimin që i ka bërë sahihut të Ibn Hibanit pas përmendjes së këtij hadithi (6167) thotë: "Senedi i tij është i fortë sipas kushteve të Muslimit". Atë e ka saktësuar edhe shejh Albani.

⁴ **Ky fragment është i dobët.** Ky fragment hadithi transmetohet si pjesë e hadithit "*Allahu e krijoj Ademin dhe pastaj i krijoj njerëzit prej shpinës së tij pastaj tha: Këta janë të xhenetit dhe nuk më intereson, ndërsa këta janë të zjarrit dhe nuk më intereson. I thanë: O i dërguari i Allahut! Përse të punojmë? U tha: Në përputhje me kaderin*". Ky hadith u përmend më parë. Kjo shtesë është transmetuar vetëm në rrugën e Muslim ibn Sejarit, nga Umeri, por Muslimi nuk e ka takuar Umerin, prandaj dhe senedi i tij është i shkëputur. Këtë fragment hadithi e ka dobësuar edhe shejh Albani.

⁵ Vazhdimi i fjalës në "ibtalul tavi": "... dhe imamëve të tjerë prej pasuesve të hadithit, të cilët kanë thënë për këto hadithe: "**Kalojini ato ashtu siç kanë ardhur**". Ata i shpjeguan ato ashtu siç kanë ardhur në pamjen e jashtme dhe se ato janë cilësi të Allahut".

Theuriu, Euzaiu, Lejthi, Hamad ibn Zejdi, Hamad ibn Seleme, Sufjan ibn Ujejne, Fudejl ibn Ijadi, Uekiu, Abdurrahman ibn Mehdi, Esved ibn Salimi, Is'hak ibn Rahavejhi, Ebu Ubejde, Muhamed ibn Xherir Taberiu e të tjerë. Ai u zgjerua shumë në përcjelljen e fjalëve të tyre, derisa tha: *"Për kotësinë e tavilit dëshmon edhe fakti se sahabët dhe tabinët pas tyre, i kanë komentuar ato sipas kuptimit primar, dhe nuk u janë kundërvënë atyre me tavil dhe as i kanë komentuar kuptimet e tyre ndryshe nga kuptimi parësor. Nëse tavili do të ishte i lejuar, atëhere ata kishin për të na paraprirë, sepse në këtë rast tavili do të ishte i nevojshëm për shmangien e përngjasimit dhe largimin e dyshimeve".*

Ebu Haseni, Ali ibn Ismail Eshariu, kelamisti dhe themeluesi i shkollës së njohur në *ilmul-kelam*, e cila edhe i është atribuar, në librin e hartuar për kundërshimet e namazlive dhe mendimet e muslimanëve, pasi përmend rafidat, havarixhët, murxhitë, mutezilitë, dhe të tjerët, thotë:

"Fjala e ehli sunetit dhe pasuesve të hadithit. Fjalët e pasuesve të hadithit dhe ehli sunetit janë: Pohimi i Allahut, i melekëve, i librave, i të dërguarve dhe pohimi i çfarëdo gjëje që ka ardhur prej Allahut dhe çfarëdo gjëje që është përcjellur prej transmetuesve të besueshëm prej të dërguarit të Allahut ﷺ. Ata nuk refuzojnë asgjë prej tyre.

*Allahu është një, i vetëm, i pashok, zotëria. Nuk ka ilah tjetër përveç tij. Nuk ka grua dhe as fëmijë. Muhamedi është rob dhe i dërguar i tij. Xheneti është i vërtetë dhe zjarri është i vërtetë. Koha e kiametit do të vijë padyshim. Allahu do i ringjallë ata që janë në varre. Allahu ﷻ është mbi Arshin e tij, ashtu siç ka thënë: **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾** Taha 5.*

*Ai ka dy duar, pa folur për formën e tyre, siç thotë: **﴿e krijova me dy duart e mia﴾** Sad 75. Dhe thotë: **﴿Por dy duart e tij janë të shtrira me bujari﴾** El maideh 64.*

*Ai ka dy sy pa folur për formën e tyre, siç thotë: **﴿lundron nën sytë tanë﴾** El kamer 14.*

*Ai ka fytyrë, ashtu siç thotë: **﴿dhe do të mbetet fytyra e zotit tënd me madhështi dhe me bujari﴾** Er rahman 27.*

Nuk thuhet për emrat e Allahut se ato janë tjetërkush prej Allahut ﷻ, ashtu siç thonë mutezilitë dhe havarixhët.

*(Ehli suneti) pohojnë se Allahu ﷻ ka dije, siç thotë: **﴿E ka zbritur atë me dijen e tij﴾** En nisa 166. Dhe thotë: **﴿Asnjë femër nuk mbarset dhe as nuk lind, përveçëse me dijen e tij﴾** El fatir, 11.*

*E pohojnë për Allahun ﷻ dëgjimin dhe shikimin dhe nuk e mohojnë, ashtu siç e mohojnë mutezilitë. E pohojnë për Allahun ﷻ fuqinë, siç thotë: **﴿a nuk e vërejnë që Allahu i cili i ka krijuar, ai është shumë më i fortë se ata﴾** Fusilet 15".*

Pastaj përmend medhhebin e pasuesve të hadithit rreth kaderit, deri ku thotë:

"Dhe thonë: Kurani është fjalë e Allahut dhe i pakrijuar. Ata që njihen me çështjen e "shqiptimit" apo të "qëndrimit", sipas pasuesve të hadithit janë bidatçinj. Nuk thuhet "lafdh i Kuranit"¹ është i krijuar apo i pakrijuar.

*E pohojnë që Allahu do të shikohet me shikime në ditën e gjykimit, ashtu siç shikohet hëna në natën me hënë të plotë. Vetëm besimtarët do e shikojnë dhe jo pabesimtarët, sepse ata prej zotit të tyre janë të penguar. Allahu ﷻ thotë: **﴿Kurrresi! Në atë ditë ata prej zotit të tyre do të jenë të penguar﴾** El mutaffifun 15".*

Në vijim përmend fjalën e pasuesve të hadithit rreth islamit dhe imanit, rreth hauzit dhe shefatit dhe gjëra të tjera, e më pas thotë: *"Pohojnë që imani është fjalë dhe vepër, shtohet dhe pakësohet. Nuk prononcohen nëse imani është i krijuar. Nuk deklarojnë për ndonjë veprues të gjynaheve të mëdha se ai është në zjarr".*

Deri ku thotë: *"E kritikojnë polemikën dhe debatimin në fe ashtu siç debatojnë polemizuesit dhe zihen rreth fesë së tyre.*

I pranojnë rivajetet e sakta ashtu siç kanë ardhur etheret e sakta të cilat i kanë transmetuar të besueshmit, transmetues pas transmetuesi të drejtë, derisa të arrijë te i dërguari i Allahut ﷻ. Nuk flasin rreth formës dhe as nuk pyesin "përse", sepse ky është bidat sipas tyre".

Deri kur thotë: *"Pohojnë se Allahu ﷻ do të vijë në ditën e gjykimit, ashtu siç thotë: **﴿dhe erdhi zoti yt me melekët rreshta rreshta﴾** El fexhr, 22. Allahu ﷻ afrohet te krijesat e tij si dëshiron, siç thotë: **﴿Ne jemi më pranë tij sesa damari i qafës﴾** Kaf 16".*

Deri kur thotë: *"Thërresin për braktisjen e çdo thirrësi në bidat. Nxisin për leximin e Kuranit, për hartimin dhe leximin e haditheve, për mësimin e fikhut me përrulje, për moralin e mirë, për bujarinë, për mosveprimin e të keqes, për braktisjen e gibeitit, thashethemit, ankimit dhe dhënies pas ngrënies dhe pirjes".*

Thotë: *"Kjo është ajo çka ata urdhërojnë, e pranojnë dhe e besojnë. Të gjitha fjalët e tyre që i përmendëm, ne i pranojmë dhe i besojmë dhe udhëzimi është vetëm prej Allahut ﷻ dhe vetëm prej tij kërkohet ndihma".*

Ndërsa në kapitullin rreth mospajtimit të pasuesve të kiblës rreth Arshit thotë:

¹ Fjala "lafdh" në këtë rast mund të marrë dy kuptime. Ajo mund të marrë kuptimin e fjalës së shqiptuar dhe Kurani si fjalë është fjalë e Allahut i pakrijuar. Por mund të marrë edhe kuptimin e emrit foljor (masdar) që nënkupton veprimin e shqiptimit. Veprimi i shqiptimit është një veprim njerëzor dhe ai është i krijuar. Për këtë kuptim të dytë, imam Buhariu ka përpiluar librin e tij të njohur "Krijimi i veprave të njerëzve", atëhere kur e akuzuan se ai thoshte që Kurani është i krijuar.

Përderisa kjo fjalë mbart dy kuptime dhe meqë shumë xhehmi nuk i shprehnin dot haptazi mendimet e tyre dhe përpiqeshin të fshiheshin pas fjalëve me shumë kuptime, atëhere imam Ahmedi pati ndaluar prej përdorimit të kësaj shprehje.

"Ehli suneti dhe pasuesit e hadithit kanë thënë: Allahu nuk është trup. Ai nuk u përngjan gjërave. Ai është lartësuar mbi Arsh, ashtu siç ka thënë: **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾** Taha 5. Nuk flasim për diçka që nuk ka folur Allahu ﷻ, por themi: Është ngritur pa e ditur si.

Ai ka fytyrë, siç thotë: **﴿Do të mbetet fytyra e zotit tënd me madhësi dhe me bujari﴾** Er rahman, 27.

Ai ka dy duar, siç thotë: **﴿E krijova me dy duart e mia﴾** Sad 75. Ai ka dy sy siç thotë: **﴿Lundron nën sytë tanë﴾** El kamer 14.

Ai do të vijë në ditën e gjykimit me gjithë melekët, siç thotë: **﴿dhe erdhi zoti yt me melekët rreshta rreshta﴾** El fexhr, 22.

Ai zbret për në qiellin e dynjasë, siç transmetohet në hadith. Pasuesit e hadithit pohojnë vetëm atë që është transmetuar në Kuran apo në transmetimet nga i dërguari i Allahut ﷻ.

Ndërsa mutezilitë mendojnë se Allahu ﷻ ka bërë istiva mbi Arsh, me kuptimin e "istilasë" (mbizotrimin)". E më pas përmend edhe mendime të tjera.

Ndërsa në librin me titull "El ibanetu fi usulid dijaneh", për të cilin pasuesit e tij përmendin se është libri i fundit që ai ka shkruar, dhe te ai bazohen për mbrojtjen e tij kundër akuzuesve të tij¹, në këtë libër Ebu Hasen Eshariu thotë:

"Kapitull për sqarimin e mendimit të pasuesve të së vërtetës dhe sunetit.

Nëse dikush thotë: I hodhët poshtë mendimet e mutezilive, kaderive, xhehmive, harurive², rafidive dhe murxhive. Atëhere na njoftoni për mendimin tuaj të cilin e pasoni dhe fenë të cilën e besoni. I themi:

Mendimi që ne pasojmë dhe feja që ne besojmë është të kapurit fort me fjalën e zotit dhe sunetin e profetit ﷺ dhe me atë që është transmetuar prej sahabëve, tabinëve dhe imamëve të hadithit. Me këtë kapemi fort dhe atë që mendonte Ebu Abdullah Ahmed ibn Hanbeli _e lus Allahun t'ia ndritë fytyrën, t'ia ngrejë gradat dhe t'ia shtojë shpërblimet_ e pranojmë, ndërsa atë që kundërshton fjalën e tij e kundërshtojmë. Sepse ai është imami i viryeteve dhe kryetari i plotë. Me të Allahu ﷻ e sqaroi të vërtetën, e zhdukuri të kotën dhe e qartësoi rrugën. I dërrmoi bidatet e bidatçive dhe devijimin e të devijuarve dhe dyshimin e dyshuesve. Allahu e mëshiroftë sepse me të vërtetë ka qënë një imam i madh dhe i ngritur.

Mendimi jonë i përmbledhur është: E pohojmë Allahun, melekët, librat e tij, të

¹ Ka për qëllim hafidh Ibn Asakirin në librin që ka shkruar për të të mbrojtur Ebu Hasen Eshariun me titull "Sqarimi i gënjeshtërs së trilluesit".

² Haruritë janë grupi i harixhive të cilët u ndanë nga Aliu _Allahu qoftë i kënaqur me të_ dhe u rebeluan kundër tij. U quajtën Harurije sepse fillimi i rebelimit të tyre ndodhi në një fshat të quajtur Harura.

dërguarit dhe atë që e kanë përcjellur prej Allahut dhe atë që e kanë transmetuar të besueshimit prej të dërguarit të Allahut ﷺ dhe nuk mohojmë prej tyre asgjë.

Pohojmë që Allahu ﷻ është një dhe i vetëm. Nuk ka ilah tjetër përveç tij. Ai është i vetëm dhe zotria. Nuk ka grua dhe as fëmijë.

Dëshmojmë që Muhamedi është rob dhe i dërguari i Allahut. E ka dërguar me udhëzimin dhe fenë e vërtetë që ta lartësojë atë mbi çdo fe.

Xheneti dhe zjarri janë të vërtetë. Kiameti do të ndodhë dhe Allahu ﷻ do të ringjallë banorët e varreve.

Allahu ﷻ është i lartësuar mbi Arsh, siç thotë: **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾** Taha 5. Ai ka fytyrë siç thotë: **﴿Do të mbetet fytyra e zotit tënd me madhësi dhe bujari﴾** Er rahman 27.

Ai ka dy duar pa formë, siç thotë: **﴿E krijova me dy duart e mia﴾** Sad 75 dhe thotë: **﴿Por dy duart e tij janë të shtrira me bujari, furnizon si të dëshirojë﴾** El maideh, 64.

Ai ka dy sy pa formë, siç thotë: **﴿Lundron nën sytë tanë﴾** El kamer 14.

Kush pretendon se emrat e Allahut janë tjetërkush, ai është i humbur”.

Pastaj përmend fjalë të përafërta me fjalët e përmendura në librin e hartuar për grupacionet, e më pas vijoi: “Themi: Islami është më i gjërë se imani. Jo çdo islam konsiderohet iman. Besojmë që Allahu ﷻ i kthen zemrat e robërve mes dy gishtërinjve prej gishtërinjve të tij¹. Besojmë se Allahu ﷻ do t’i vendosë qiejtë në një gisht dhe tokat në një gisht, ashtu siç transmetohet rivajeti i saktë prej të dërguarit të Allahut ﷺ”.

Deri kur thotë: “Imani është fjalë dhe vepër, shtohet dhe pakësohet. I pranojmë transmetimet sahihe nga i dërguari i Allahut ﷺ, të cilat i kanë transmetuar të besuarit, i drejti nga i drejti, derisa të përfundojnë te i dërguari i Allahut ﷺ”.

Deri ku thotë: “I besojmë të gjitha rivajetet të cilat i kanë pohuar pasuesit e hadithit, si zbritja për në qiellin e dynjasë dhe se zoti thotë: “A ka ndonjë lypës? A ka ndonjë kërkues falje?”. E besojmë edhe çdo gjë tjetër që e kanë transmetuar dhe pohuar, në kundërshtim me atë që thonë të humburit e devijuar.

Ndërsa për atë që jemi kundërshtuar, i kthehemi librit të zotit tonë dhe sunetit të profetit ﷺ dhe ixhmasë së muslimanëve, apo ajo që e zëvendëson atë. Nuk shpikim në fenë e Allahut ﷻ atë që nuk na e ka lejuar, dhe nuk themi për Allahun ﷻ atë që nuk e dimë.

¹ **Hadith sahih.** E transmeton Muslimi (46/17). Nga Abdullah ibn Amr ibn Asi thotë se ka dëgjuar të dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: **“Të gjitha zemrat e bijve të Ademit janë mes dy gishtave prej gishtave të mëshiruesit, njësoj si një zemër e vetme, e kthen atë si të dëshirojë. Pastaj i dërguari i Allahut ﷺ tha: O Allah! O kthyes i zemrave! Ktheji zemrat tona për nga bindja jote”.**

Themi: Allahu ﷻ vjen në ditën e gjykimit siç thotë: **«Dhe erdhi zoti yt me melekët rreshta rreshta»** El fexhr 22 . Allahu ﷻ afrohet te robërit e tij siç dëshiron. Thotë: **«Ne jemi më pranë tij sesa damari i qafës»** Kaf 16, dhe thotë: **«pastaj u afrua me afrim dhe ishte afër tij sa dy kause¹ ose më afër»** En nexhm 8-9”.

Deri kur thotë: “Do të argumentohemi për të gjitha këtë që përmendëm dhe ato që nuk i përmendëm, në kapitujt përkatës”.

Pastaj foli rreth shikimit të Allahut ﷻ dhe u argumentua dhe foli për moskrijimin e Kuranit dhe u argumentua. Pastaj replikoi me ata që ndalojnë dhe nuk pohojnë që Kurani është i krijuar apo i pakrijuar. Pastaj thotë:

“Kapitull për istivanë mbi Arsh.

Nëse dikush thotë: Çfarë thoni rreth istivasë? I thuhet: Themi që Allahu ﷻ është i lartësuar mbi Arshin e tij, siç thotë: **«I mëshirëshmi mbi arsh u lartësua»** Taha 5. Dhe thotë: **«te ai ngjitet fjala e mirë, ndërsa punën e mirë e ngre»** Fatir 10. Dhe thotë: **«Por Allahu e ngjiti te ai»** En nisa 158. Dhe thotë: **«e drejton çështjen nga qielli për në tokë pastaj ajo ngjitet te ai»** Es sexhde 5.

Thotë kur përmend fjalën e faraonit: **«O Haman! Më ndërto një kullë! Mbase i arrij udhët; udhët e qiellit dhe ngjitem te ilahu i Musës, sepse unë mendoj se ai është gënjeshtar»** Gafir 36-37. E përgënjeshtroi Musën ﷺ në fjalën e tij se Allahu ﷻ është sipër qiejve.

Allahu ﷻ thotë: **«A u siguruat prej atij që është në qiell, se mos jua trondit tokën»** El mulk 16.

Arshi ndodhet sipër qiejve. E përderisa arshi ndodhet sipër qiejve, Allahu ﷻ tha: **«A u siguruat prej atij që është në qiell»** El mulk 16, sepse ai është i lartësuar sipër arshit dhe arshi është sipër qiejve. Çdo gjë që është sipër quhet sema (qiell). Atëhere arshi është qielli më i lartë. Ajeti **«A u siguruat prej atij që është në qiell»** nuk ka për qëllim të gjithë qiejt, por ka për qëllim arshin i cili është qielli më i lartë. A nuk e shikon që Allahu ﷻ kur i përmendi qiejt (në numrin shumës) **«E bëri hënën në to si dritë»** nuk kishte për qëllim që hëna është në të gjithë qiejt apo i mbush të gjitha qiejt.

Ne i kemi parë të gjithë muslimanët të ngrejnë duart e tyre në drejtim të qiellit sepse Allahu ﷻ është sipër Arshit dhe Arshi është sipër qiejve. Sikur Allahu ﷻ të mos ishte sipër Arshit atëhere nuk do i ngrinin duart e tyre në drejtim të Arshit, ashtu siç nuk i drejtojnë duart e tyre drejt tokës atëhere kur luten.

Kapitull:

Mutezilitë, xhehmitë, haruritë kanë thënë: Kuptimi i ajetit: **«I mëshirëshmi mbi arsh u lartësua»** Taha 5, është istilaja me fuqi dhe sundim dhe se Allahu është kudo. E

¹ Kausi në gjuhën arabe është harku, por përdoret edhe si njësi matëse për të shprehur largësinë.

mohuan lartësimin e Allahut mbi arsh, ashtu siç thonë pasuesit e të vërtetës. Ata e komentuan istivanë mbi arsh si fuqi.

Nëse pretendimi i tyre do të ishte i vëretetë atëhere nuk do të kishte dallim mes Arshit dhe tokës së shtatë, sepse Allahu ka fuqi për çdo gjë. Allahu ka fuqi mbi tokën dhe nevojtoret dhe mbi çdo gjë që është në botë. Nëse kuptimi i istivasë mbi Arsh do të ishte istilaja (mbizotërimi) _dhe realisht Allahu ﷻ është mbizotërues mbi çdo gjë_ atëhere istivaja e tij do të ishte mbi Arsh, mbi tokë, mbi qiej, mbi nevojtores dhe mbi vendet e pista, sepse ai është i fuqishëm për të gjitha këto gjëra dhe mbizotrues i tyre.

Megjithëse Allahu ﷻ është i fuqishëm mbi të gjitha këto gjëra, mirëpo nuk thuhet dot se ai ka bërë istiva mbi banjot dhe nevojtoret. Nga kjo kuptohet që istivaja mbi Arsh nuk mund të ketë kuptimin e istilasë, sepse istilaja është e përgjithëshme për çdo gjë. Atëhere patjetër kuptimi i istivasë duhet të jetë i veçantë për Arshin dhe nuk i përfshin gjërat e tjera”.

Pastaj përmendi argumente nga Kurani, hadithi, ixhmaja dhe logjika, pastaj tha: “Kaptull rreth fytyrës, dy syve, shikimit dhe dy duarve”, pastaj përmedi ajetet përkatëse dhe replikoi me ata që u bëjnë tavil këtyre cilësive me fjalë të gjatë, e cila nuk mund të përmendet e gjitha. Si puna e fjalës së tij:

*“Nëse pyetemi: A i pohoni dy duart për Allahun? U thuhet: E pohojmë këtë, sepse për këtë ka dëshmuar fjala e Allahut ﷻ **﴿dora e Allahut është sipër duarve të tyre﴾** dhe fjala e Allahut ﷻ **﴿të cilin e krijova me dy duart e mia﴾**.*

Është transmetuar se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Allahu e mëshoi kurrizin e Ademit me dorën e tij dhe nxorri prej tij pasardhësit e tij”.¹ Në hadithin e profetit ﷺ thuhet: “Allahu e krijoi Ademin me dorën e tij. E krijoi xhenetin e Adenit me dorën e tij. E shkroi Teuratin me dorën e tij. E mbolli pemën Tuba me dorën e tij”.²

As në gjuhën arabe dhe as në të folurit e njerëve nuk shkon që dikush të thotë: E veprova këtë me dorën time dhe të ketë për qëllim mirësinë. Allahu ﷻ u ka folur

¹ U përmend më parë se kjo shtesë nuk është saktësuar prej profetit.

² **Hadith daif.** Nuk transmetohet me këtë teks, por me një teks të përafërt. E transmeton Bejhakui në “El esmau ues sifāt” (692) nga profeti thotë: “Allahu krijoi tre gjëra me dorën e tij. E krijoi Ademin me dorën e tij. E Shkroi Teuratin me dorën e tij. E mbodhi Firdeusin me dorën e tij. Pastaj tha: Pasha krenarinë time. Nuk do banojë në të as pijaneci dhe as dejuthi. I thanë: O i dërguar i Allahut! Pijanecin e kuptuam, mirëpo çfarë është dejuthi? Tha: Ai i cili ja lehtëson familjes së tij veprën e turpshme”. Bejhakui thotë: Ky hadith është mursel (i shkëputur).

Mirëpo kuptimi i një pjese të hadithit të cilin e përmendi Ebu Hasen Eshariu këtu është i saktë, sepse:

1- Krijimi i Ademit me dorën e Allahut është vërtetuar me Kuran, në ajetin: **(Çfarë të pengoi ti bëje sexhde atij që e krijova me dy duart e mia).**

2- Shkrimi i Teuratis me dorën e Allahut është saktësuar në hadithin që e transmeton Muslimi (46/13) ku Ademi i thotë Musës: “Allahu ta shkroi Teuratin me dorën e tij”. E transmeton edhe Ebu Daudi (4701), Ibn Maxheh (80) dhe të tjerë.

arabëve me gjuhën e tyre dhe me atë që është e kuptueshme dhe e logjikëshme në gjuhën e tyre. Është e njohur në shkencën e oratorisë se askush nuk mund të thotë: E veprova këtë me dorën time dhe të ketë për qëllim mirësinë. Nëse kjo është kështu atëhere bie poshtë pretendimi që fjala **﴿me dorën time﴾** të ketë për qëllim mirësinë”. Pastaj u zgjat shumë për pohimin e kësaj çështje.

Kadiu kelamist Ebu Bekr Muhamed ibn Tajib Bakilaniu¹, i cili është kelamisti më i shquar i esharive dhe askush nuk krahasohet me të, as nga të herëshmit dhe as nga të mëvonëshmit, thotë në librin e tij “El ibaneh”:

Nëse dikush thotë: Cili është argumenti që pohon fytyrën dhe dorën e Allahut? I thuhet: Fjala e Allahut ﷻ: **﴿do të mbetet fytyra e zotit tënd me madhësi dhe bujari﴾** Er rahman 27, dhe fjala e tij: **﴿çfarë të pengoi ti bëje sexhde atij që e krijova me dorën time﴾** Sad 75. Allahu ﷻ e pohoi fytyrën dhe dorën për veten e tij.

Nëse thotë: Përse e mohoni që fytyra dhe dora të jenë gjymtyrë, sepse ju s’mund ta konceptoni dorën dhe syrin ndryshe? I themi: Kjo nuk është kusht, ashtu siç nuk është kusht që meqë ne e perceptojmë të gjallin dhe të diturin vetëm si trup, të dëshmojmë ne apo ju që Allahu ﷻ është trup.

Ashtu siç jo çdo gjë që ekziston e pavarur, është kusht që të jetë xheuher (substancë), megjithëse si ne ashtu edhe ju nuk kemi parë ndonjë gjë në botën e dukëshme që të ekzistojë e pavarur e të mos jetë xheuher (substancë).

Nëse pretendojnë që dija, jeta, fjala, dëgjimi, shikimi dhe cilësitë e tjera të qënies, detyrimisht janë arad (veti) duke u argumentuar me ekzistencën, atëhere mund t’u përgjigjemi në të njëjtën mënyrë”.

Thotë: “Nëse thotë: A thoni që ai është në çdo vend? I thuhet: Mos e dhëntë Allahu. Ai është sipër Arshit të tij ashtu siç na ka njoftuar në librin e tij: **﴿I mëshirëshmi mbi Arsh u lartësua﴾** Taha 5. Allahu ﷻ thotë: **﴿Te ai ngjitet fjala e mirë﴾** Fatir 10, dhe thotë: **﴿A mos vallë u siguruat prej atij që është në qiell se nuk do t’ua çajë tokën dhe ajo do të lëkundet!﴾** El mulk 16”.

E sikur të ishte në çdo vend, atëhere do të ishte në barkun e njeriut, në gojën e tij, në nevojtores, dhe në vendet e padëshirueshme. Kjo do të çonte në zgjerimin e tij me zgjerimin e vendeve, nëse ai krijon vende të reja, apo me tkurrjen e tij nëse do të reduktonte (krijesat).

¹ Ebu Bekr Bakelaniu. Nxënësi i Ebu Hasen Eshariut. Kadi maliki me origjinë nga Basra dhe më pas u vendos në Bagdad. U shqua në shumë fusha, sidomos në çështjet e akides. Shkroi shumë libra kundër rafidave, harixhive, mutezilive dhe keramive. Prej librave të tij “Et temhid”, “El insaf”, “Ixhazul Kuran” etj. Ndërsa libri “El ibane” prej të cilit citon Ibn Tejmije fjalët e tij, ka humbur. Megjithatë këto fjalë që Ibn Tejmije i citon prej Bakelanit, janë në përputhje të plotë me librat e ruajtur dhe të botuar. Vdiq në vitin 403h.

Gjithashtu do të ishte e saktë që të luteshim në drejtim të tokës, apo nga mbrapa, apo majtas dhe djathtas. Të gjithë muslimanët janë pajtuar për kundërshtimin e kësaj rrjedhoje dhe gabimin e pretenduesit të saj”.

Po në të njëjtin libër thotë:

“Cilësitë e qënies, me të cilat ka qënë dhe vazhdon të jetë i cilësuar, janë: jeta, dija, fuqija, dëgjimi, shikimi, fjala, dëshira, vashdueshmëria, fytyra, dy sytë, dy duart, zemërimi dhe kënaqësia”.

Në librin “Et temhid” është zgjeruar në shpjegime më shumë, mirëpo kopjen e këtij libri tani për tani nuk e posedoj. Fjalët e Bakilanit dhe të kelamistëve të tjerë në këtë çështje janë të shumta, për ata që i kërkojnë ato. Megjithëse Kurani, suneti dhe transmetimet e selefit janë të mjaftueshme në këtë pikë.

Që njeriu ta përvetësojë këtë çështje duhet që Allahu ﷻ t’i dhurojë urtësi dhe iman dhe të posedojë logjikë dhe të jetë i kapur me fenë, që të arrijë të kuptojë. Pas kësaj drita e Kuranit dhe sunetit i mjafton. Shumë njerëz kanë pasuar disa kelamistë, nisur nga mendimi i mirë që kanë pasur për ta, duke kujtuar se ata kanë shqyrtuar në këtë çështje më mirë se kushdo tjetër. E sikur t’i silllet çdo ajet ai nuk e pason derisa t’i silllet diçka prej dijes së kelamit.

Pas gjithë kësaj ata edhe vetë të parët e tyre i kanë kundërshtuar dhe nuk i kanë pasuar. Nëse do ta pranonin udhëzimin që gjëndet në tekset e të parëve të tyre, dhe do të ishin të sinqeritetë në kërkimin e të vërtetës, do të shpresohej për ta shtimi i këtij udhëzimi.

Ai që të vërtetën e pranon vetëm nga një grup i caktuar dhe pastaj edhe të vërtetën që gjëndet në këtë grup nuk e pason, atëherë ai përngjason me çifutët, për të cilët Allahu thotë: **﴿E nëse u thuhet atyre: besojeni atë që e ka zbritur Allahu! Thonë: Besojmë atë që na ka zbritur ne, dhe e mohojnë çdo gjë tjetër megjithëse ajo është e vërteta e cila vërteton atë që kanë në dorë (Teuratin). Thuaj: Përse dikur i vrisnit profetët e Allahut, kur qënkeni besimtarë?﴾** El bekare 91.

Çifutët thanë: Ne besojmë vetëm atë që na është zbritur ne. Atëherë Allahu ﷻ iu drejtua: **﴿Përse dikur i vrisnit profetët e Allahut, kur qënkeni besimtarë?﴾**, pra nëse vërtetë e besoni atë që ju është zbritur. Allahu ﷻ u thotë: As atë që jua sollën profetët tuaj nuk e ndoqët dhe as atë me të cilën erdhën profetët e tjerë nuk e pasuat, por pasuat epshet tuaj. Ky është realiteti i atij që nuk e pranon të vërtetën as prej grupit të tij dhe as prej tjetërkujt, pa folur për fanatizmin që shfaq për grupin e tij pa argument prej Allahut dhe pa qartësim.

Ebu Meali Xhuvajni¹ në librin e tij “Er risaletu nidhamijeh” thotë:

“Dijetarët kanë ndjekur rrugë të ndryshme rreth kuptimeve aparente². Disa anuan nga “tavili” duke e praktikuar atë në ajetet dhe hadithet e sakta. Ndërsa imamët e të parëve të umetit (selefit) anuan nga mospraktikimi i “tavilit” dhe kalimi i kuptimeve aparente ashtu siç kanë ardhur dhe kthimi i kuptimeve të tyre te zoti.

Thotë: “Mendimi që e preferojmë dhe me të e besojmë Allahun në akiden tonë, është pasimi i selefit të këtij umeti. Argumenti i prerë sheriatik rreth kësaj është fakti se konsensusi (ixhmaja) i umetit është argument i pranuar dhe bazë e shumicës së sheriatit.

Sahabët nuk janë orvatur t’i shpjegojnë kuptimet e argumenteve (të cilësive) dhe nuk janë orvatur për perceptimin e tyre. Ata janë ajka e këtij umeti të cilët kanë bartur barrën më të rëndësishme të sheriatit. Ata kanë qënë kurdoherë të përkushtuar për përvetësimin e bazave të fesë dhe ruajtjen e tyre dhe ua mësonin njerëzve ato dije që u nevojiteshin prej bazave të fesë. Nëse “tavili” i këtyre kuptimeve të jashtëme do të ishte i lejuar ose i sigurtë, atëherë në këtë një farë mënyre ne po i akuzojmë ata se kanë barazuar mes bazave të fesë (akides) dhe dispozitave sheriatike.

Nëse koha e sahabëve dhe tabinëve ka kaluar pa u përzier me “tavile” atëherë ky është drejtimi që duhet pasuar. Çdo njeri me fe duhet të besojë që Allahu ﷻ është i pastër nga përshkrimi me cilësitë e krijesave dhe nuk duhet të futet në “tavinin” e argumenteve të paqarta, por ta kthejë kuptimin e tyre te zoti.

*Le ta marrë (në pamjen e jashtëme) ajetin e istivasë dhe ajetin e ardhjes apo ajete si **﴿atij që e kam krijuar me dy duart e mia﴾** Sad 75, **﴿dhe mbetet fytyra e zotit tënd me madhësi dhe krenari﴾** Er rahman 27, **﴿lundron nën sytë tanë﴾** El kamer 14, apo hadithe e sakta profetike, si hadithi i zbritjes apo hadithe të tjera. Le të sillet me ato ashtu siç e përmendëm më parë”.*

¹ Ebu Meali Xhuvajni (419-478). Dijetar i njohur eshəri dhe shafi, i cilësuar si imami i dy Haremeve. U bë i njohur pas fitnes së njohur (disa e quajnë fitnia e Kushejriut) që u ndodhi esharive, prandaj u vendos dhe jetoi një farë kohë në dy Haremet, Haremin e Mekës dhe Haremin e Medines. Dha leksione në shkollën “En nidhamije” e cila ishte shkolla më e njohur e kohës së tij. Hartoi libra të shumtë në usul-fikh, në akide dhe në fusha të ndryshme.

Dhehebiu dhe dijetarë të tjerë, përmendin se Xhuvajni është kthyer nga mendimet e tij të mëparëshme dhe se në mënyrë të përgjithshme ka pranuar medhhebin e selefit.

Libri “En nidhamije” është libri i fundit që ai ka përpiluar në çështjet e akides, dëshmon për kthimin e tij nga shumë çështje. A është kthyer në medhhebin e selefit apo në medhhebin që ai ka kujtuar se selefi kanë pasur por që në realitet është medhhebi i tefvidit të kuptimeve, kjo mbetet një çështje e diskutueshme. Mirëpo pendimi i tij prej angazhimit me dijen e kelamit është i njohur. Atë e kanë përcjellur vetë nxënësit e tij në fundin e jetës së tij.

² Ka për qëllim kuptimet aparente të ajeteve dhe haditheve që lidhen me çështjen e cilësive të Allahut.

Them (Ibn Tejmija): Pyetësi duhet të dijë që kjo përgjigjeje ka si synim citimin e fjalëve të disa dijetarëve të cilët e kanë përcjellur medhhebin e selefit në këtë çështje. Nuk është kusht që çdo kelamist apo të tjerë, fjalët e të cilëve i cituam, të pajtohet me ne në çdo gjë që themi në këtë çështje apo në çështje të tjera. Mirëpo e vërteta pranohet prej kujtdo që shprehet me të.

Muadh ibn Xhebeli رضي الله عنه, në shprehjen e tij të njohur, të cilën e transmeton Ebu Daudi në sunenin e tij, thotë: ***“Pranojeni të vërtetën prej kujtdo që e sjell atë edhe nëse është qafir _apo tha: edhe nëse është i prishur_ dhe ruajuni prej rrëshkitjes së të urtit. I thanë: Si ta dallojmë kur qafiri thotë të vërtetën? U tha: E vërteta ka dritë”***.¹ Apo ka thënë një fjalë të përafërt me të.

Kjo fetva nuk na lë më shumë hapësirë për përvetësimin e kësaj çështje me argumente dhe për flakjen e dyshimeve që paraqiten dhe për qartësimin e çështjes aq sa zemra të flejë e qetë duke paraqitur shprehjet e të gjithë njerëzve nga viset e ndryshme.

Herët kam pas shkruar diçka rreth kësaj për disa njerëz që prezantojnë në kuvendet tona dhe mbase do të shkruaj _me lejen e Allahut_ rreth kësaj çështje që të përmbushet objektivi i synuar.

Askush të mos kujtojë se argumentet rreth cilësive mospërputhen me njëri-tjetrin. Sikurse të pretendojë se kuptimet aparente të Kuranit dhe sunetit që dëshmojnë që Allahu ﷻ është mbi Arsh, janë në mospajtim me kuptimin aparent të ajetit: ***﴿Ai është me ju kudo që të jeni﴾*** El hadid 4, dhe me hadithin: ***“Nëse dikush prej jush fillon të falet atëhere Allahu është karshi fytyrës së tij”***.² Ky pretendim është i gabuar.

¹ **Ether sahih.** Ibn Tejmije e përmend përafërsisht dhe jo teksualisht, duke i ruajtur kontekstin kuptimor. Teksti i tij i plotë siç transmetohet në sunenin e Ebu Daudit (4611) se Jezidi ibn Umejra _nga shokët e Muadh ibn Xhebelit_ ka thënë: Sa herë që ulej në ndonjë kuvend thoshte: Allahu është gjykues i drejtë dhe dyshuesit janë shkatërruar”. Njëherë Muadh ibn Xhebeli رضي الله عنه tha: ***“Pas jush do të ketë sprovë. Shtohet gjatë tyre pasuria dhe Kurani do të përhapet aq sa do ta mësojë edhe besimtari edhe munafiku, edhe burri edhe grua, edhe i madhi edhe i vogli, edhe skllavi edhe i liri.***

Është afëruar koha kur dikush të thotë: Përse nuk po më pasojnë njerëzit, ndërkohë që unë e kam mësuar Kuranin? Ata nuk do më ndjekin mua derisa t’u shpik atyre diçka tjetër.

Kini kujdes prej asaj që shpiket sepse çdo gjë që shpiket është humbje. Ju tërheq vërejtjen prej rrëshkitjes së të urtit sepse shejtani mund ta shpreh fjalën e humbur në gojën e të urtit. Ndërsa munafiku mund të shprehet me të vërtetën.

Thotë (Jezidi): I thashë Muadhit رضي الله عنه: Allahu të mëshiroftë! Si ta kuptoj unë që i urti mund të thotë shprehje të humbura ndërsa munafiku mund të thotë shprehje të vërteta?

Më tha: Patjetër (do e kuptosh). Shmangu fjalës së të urtit në çështjet e dyshimta për të cilat thuhet: Çfarë janë këto? Por kjo mos të të largojë ty prej tij sepse ai mbase kthehet. Ndërsa të vërtetën pranoje nëse e dëgjon sepse e vërteta ka dritë”. Pra pranoje edhe nëse të vjen nga munafiku, sepse konteksti i hadithit e nënkupton këtë.

² **Hadith sahih.** E transmetojnë Buhariu (753), Muslimi (53/18), Maliku (663) dhe të tjerë. Teksti i plotë te Buhari, se i dërguari i Allahut ka thënë: ***“Kur dikush prej jush ngrihet për në namaz atëhere Allahu është karshi fytyrës së tij, prandaj askush të mos pëshytyjë përpara fytyrës së tij gjatë namazit”***.

Kjo sepse Allahu është me ne realisht dhe ai është sipër Arshit realisht. Allahu ﷻ i ka mbledhur bashkë këto dy kuptime në fjalën e tij: **«Ai është ai i cili i krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë dhe pastaj u lartësua mbi Arsh. E di atë që hyn në tokë dhe atë që del prej saj. (E di) atë që zbret prej qiellit dhe atë që ngjitet në të dhe ai është me ju kudo që jeni. Allahu është shikues i asaj që veproni»** El hadid 4.

Allahu tregoi që ai është sipër Arshit dhe se e di çdo gjë dhe se ai është me ne kudo që jemi, ashtu siç ka thënë profeti në hadithin e “uealë-vë”: **“Allahu është sipër Arshit dhe ai e di gjëndjen tuaj”**.¹

Fjala “mea”² në gjuhën arabe, në kuptimin e pakufizuar të saj nënkupton vetëm shoqërim, pa nënkuptuar përzierje apo se ajo gjë është përkrah teje, majtas apo djathtas.

E nëse kufizohet me kuptime të tjera atëhere nënkupton kuptimin sipas fjalës me të cilën është kufizuar.

Thuhet: Vazhdojmë të udhëtojmë dhe hëna është me ne apo ylli është me ne. Apo thuhet: Ky mall është me mua. Kjo për shkak se ti je në shoqërimin e hënës megjithëse ajo është sipër kokës tënde.

Allahu ﷻ është me krijesat e tij realisht dhe është sipër Arshit realisht.

Kuptimi i fjalës “mea - me” varion në varësi të kontekstit. Atëhere kur Allahu ﷻ tha: **«E di atë që hyn në tokë dhe atë që del prej saj. (E di) atë që zbret prej qiellit dhe atë që ngjitet në të dhe ai është me ju kudo që jeni»** kuptimi aparent i kësaj kumtese dëshmon se fjala “me” këtu nënkupton që ai ju shikon, ju vrojton, ju ka nën kontroll dhe e di se çfarë veproni. Ky është kuptimi i fjalës së selefit: **“Ai është me ju me dijen e tij”**. Ky është kuptimi parësor i kësaj kumtese.

Me të njëjtin kuptim vjen edhe fjala e Allahut ﷻ: **(Nuk ka ndonjë grup tre vetësh veçse Allahu është i katërti i tyre dhe asnjë grup pesë vetësh veçse ai është i gjashti i tyre dhe as më pak se kaq apo më shumë, veçse ai është me ta kudo që të jenë)** El muxhadeleh 7.

Kur profeti ﷺ i tha shokut të tij në shpellë: **«Mos u dëshpëro! Allahu është me ne»** Et teube 40, ky ajet mbart një kuptim aparent. Rrethanat dëshmojnë që qënia e Allahut me ta nënkupton vështirimin e tyre dhe gjithashtu mbrojtjen dhe përkrahjen e tyre.

Edhe fjala e Allahut ﷻ: **«Allahu është me ata të cilët janë ruajtur dhe me ata të cilët janë bamirësa»** En nahl 128 dhe fjala e Allahut ﷻ drejtuar Musës ﷺ dhe Harunit ﷺ: **«Unë jam me ju, dëgjoj dhe shikoj»** Taha 46. Ky shoqërim është në kuptimin e tij aparent dhe kuptimi që merr këtu është mbrojtja dhe përkrahja.

¹ **Hadith i dobët.** U përmend më parë.

² Që përketshet sëbashku ose me.

Mund të ndodhë që një fëmijë të frikësohet dhe të qajë dhe babai i tij nga sipër çatisë t'i thotë: Mos u frikëso! Unë jam me ty. Ose unë jam këtu. Apo shprehje të tilla. E orienton atë për shoqërimin, i cili në këto rrethana nënkupton edhe largimin e problemit.

Ka dallim mes kuptimit të fjalës “mea-me ose sëbashku” dhe rrjedhjavë kuptimore të saj. Sepse një rrjedhim kuptimor mund të shndërrohet në kuptimin e kësaj fjale dhe kjo varion sipas situatave.

Fjala “mea” është përdorur në Kuran dhe sunet në situata të ndryshme, ku në secilën situatë nënkupton një rrjedhje kuptimore (derivat kuptimor) e cila nuk nënkuptohet në një situatë tjetër. Ose përmbajtja e saj kuptimore ndryshon në varësi të situatave ose fjala “mea - me” nënkupton një kuptim motivues (të përbashkët) që haset në të gjitha situatat¹ megjithëse në çdo situatë mund të marrë një kuptim shtesë. Sipas të dyja analizave, prapëseprapë fjala “mea-me” nuk nënkupton që qenia e Allahut është e përzier me krijesat, dhe nuk ka arsye të pretendojmë që kemi bërë “tavi” që ta nxjerrim këtë fjalë nga kuptimi aparent.

Si ilustrim për këtë mund të sjellim fjalët “rububije” dhe “ubudije”. Megjithëse të gjitha krijesat përfshihen në konceptin e rububijes dhe të ubudijes, mirëpo atëhere kur tha: **﴿... me zotin e aleminëve, zotin e Musës dhe të Harunit﴾** El araf 121-122, u kuptua që “rububija” që i është bashkangjitur Musës dhe Harunit, merr një kuptim më të veçantë dhe shtesë ndaj kuptimit të përgjithshëm të rububijes që lidhet me të gjithë krijesat. Kjo sepse atij që Allahu ﷻ i ka dhuruar përsosje më shumë se krijesat e tjera, atëhere ai i ka dhuruar edhe përkujdesje, sepse rububija rrjedh nga folja “rabba-jurabbi” që nënkupton përkujdesje dhe përkujdesja dhe zotrimi i Allahut ndaj Harunit dhe Musës ka qënë më e plotë se përkujdesja ndaj të tjerëve.²

Gjithashtu edhe fjala e Allahut ﷻ: **﴿një burim prej të cilit pijnë robërit e Allahut﴾** El insan 6 dhe fjala e tij: **﴿I patëmeta është ai që e soditi robin e tij natën﴾** El isra 1. Fjala “abd-rob” nganjëherë nënkupton të nënshtuarin dhe kjo është e

¹ Ky kuptim i përgjithshëm dhe i përbashkët i fjalës “mea” është shoqërimi i diçkaje. Këtë kuptim të përgjithshëm fjala “mea” e mbart në të gjitha situatat, mirëpo këtij kuptimi të përgjithshëm mund t'i shtohen kuptime rrethore të cilat varen nga situatat e ndryshme, si mbrojtja, kërcënimi, përzierja etj.

² Ky ishte shëmbulli për fjalën rububije. Fjala rububije rrjedh nga fjala “rabb” që do të thotë zot dhe pronar i diçkaje dhe ai që përkujdeset për diçka, sepse të dyja këto fjalë kthehen te folja “rabba” që nënkupton përkujdesjen për atë që e posedon.

Fjala “rabb – zot” që i është bashkangjitur Musës dhe Harunit në ajetin **﴿zotin e Musës dhe të Harunit﴾** merr një kuptim më të veçantë se fjala “rabb-zot” që i është bashkangjitur aleminëve (njerëzve dhe xhindëve) në ajetin e parë **﴿me zotin e botrave﴾**. Megjithëse ato e kanë një kuptim të përbashkët që është zotërimi që Allahu ﷻ ka ndaj tyre si krijesa dhe përkujdesja ndaj tyre, mirëpo zotërimi dhe përkujdesja ndaj Musës dhe Harunit merr kuptim më të gjërë, sepse ajo përfshin edhe kuptimin e përkrahjes, mbrojtjes, udhëzimit, drejtimit, dashurisë etj. Ndërkohë që jo të gjithë njerëzit dhe xhindët Allahu i udhëzon, i mbron, i përkrah apo i do. Këto kuptime shtesë përfitohen prej situatës dhe kontekstit ku është përdorur fjala “rabb-zot”.

përgjithëshme për të gjithë robtë, si në fjalën e Allahut ﷻ: **﴿Çdokush që është në qiej dhe në tokë veçse do vijë te i mëshirëshmi si rob﴾** Merjem 93.

Mirëpo ndonjohere merr një kuptim më të veçantë. Nënshtrimi i atij që është i nënshtuar me dije dhe adhurim është më i plotë, prandaj bashkangjitja e këtij emri (ndaj Allahut) merr një kuptim më të plotë. Megjithëse nënshtrimi si nënshtrim është real në të gjitha këto raste.¹

Disa i klasifikojnë fjalë të tilla si **mushekike**² sepse dëgjuesi lëkundet në to. A hyjnë këto fjalë në kategorinë e **polisemive** apo në atë të **homonimeve**? Studiuesit e thelluar janë të bindur që ata nuk dalin nga nocioni i përgjithshëm i polisemisë, sepse vendosësi i gjuhës e ka përcaktuar përdorimin e një fjale karshi një kuptimi të përbashkët dhe nëse kihet për qëllim një lloj i veçantë i polisemisë atëhere nuk ka problem nëse veçohet me përdorimin e një fjale tjetër.

Kush bindet që fjalë si “mea-me” i bashkangjiten çdo kategorie të krijesave, ashtu siç i bashkangjitet fjala “zot” të gjitha krijesave, dhe se istivaja është e veçantë për Arshin dhe se Allahu ﷻ përshkruhet me lartësimin dhe qënien sipër realisht dhe nuk përshkruhet me qënien nën diçka dhe poshtësinë, as realisht dhe as në formë alegorie, ka për ta kuptuar që Kurani duhet kuptuar ashtu siç ka zbritur dhe pa u deformuar.

Nëse dikush imagjinon se Allahu ﷻ është në qiell me kuptimin që qielli e përfshin dhe e rrethon atë, ai është gënjeshtar nëse këtë fjalë ia atribon dikujt dhe është

¹ Ky është shëmbulli me fjalën “ubudije-nënshtrimi”. Në origjinë fjala “abd” nënkupton robin e nënshtuar dhe përfshin besimtarin dhe pabesimtarin, të bindurin dhe kryeneçin, adhuruesin dhe joadhuruesin, etj. Nënshtrimi është kuptimi dhe motivi i përbashkët i kësaj fjale. Prandaj, në ajetin e sures Merjem **﴿do vijë te i mëshirëshmi si rob﴾** nënkupton të mirin dhe të keqin, të bindurin dhe të pabindurin. Këtij kuptimi të përgjithshëm i shtohen kuptime të reja në ajetin **﴿robin e tij﴾**. Bashkangjitja e kësaj fjale përkrah përemrit pronor që kthehet te Allahut, i jep kësaj fjale një diapazon më të gjërë nga ana kuptimore dhe më specifik nga ana e personave. Merr një kuptim më të gjërë sepse nënkupton nënshtrimin me dije dhe adhurim prej të cilit është përfituar nderimi i këtij robi. Dhe është më specifik sepse ky kuptim përfshin shumë pak veta, vetëm profetët të cilën kanë arritur tek Allahu këtë gradë të lartë.

Këto kuptime shtesë përfitohen në një situatë dhe kontekst të caktuar në të cilën vendoset fjala, duke e ruajtur kuptimin e saj parësor që është nënshtrimi.

Ibn Tejmije dëshiron të thotë se fjala “mea- me ose sëbashku” në disa raste mund të marrë kuptimin e përzierjes, mirëpo kuptimi i përzierjes është një kuptim dytësor që përfitohet nga vendosja e fjalës në situata dhe kontekste të caktuara. Ndërsa kuptimi parësor i saj është shoqërimi. Ky kuptim parësor do të haset _përgjithësisht_ në të gjitha përdorimet e kësaj fjale.

Kështuqë kuptimi i ajetit që dëshmon se Allahu është me ne, është i qartë dhe në kuptimin e tij aparent nuk dëshmon që Allahu është i përzier me krijesat. Dhe falenderimi i takon Allahut.

Këto dukuri që përmend shejhul islami këtu, në terminologjinë bashkohore quhet **polisemi**. Kemi polisemi kur një fjalë e vetme përfshim shumë kuptime të cilat ruajnë midis tyre një lidhje kuptimore motivuese.

² Ky term përdoret për përdorimin e një fjale për më shumë se një kategori sendesh. P.sh. fjala dritë, mund të përdoret për dritën e diellit, dritën e kandilit, dritën e llampës, dritën e hënës, etj.

i humbur nëse beson kështu për zotin e tij.

Nuk kemi parë askënd ta ketë kuptuar këtë kuptim prej kësaj fjale. As nuk kemi hasur ndokënd që ta ketë përcjellur këtë kuptim prej të tjerëve. Nëse muslimanët e thjeshtë do t'u drejtohej kjo pyetje: A kuptoni prej fjalës së Allahut ﷻ dhe të profetit ﷺ se Allahu ﷻ është në qiell, që qielli e përfshin atë? Kushdo do të përgjigjej: Nuk na ka shkuar ndërmend një diçka e tillë.

Si të vërtetohet kjo, atëhere është shumë absurde që fjalës t'i mvishet një kuptim i pamundur të cilën njerëzit nuk e kuptojnë dhe pastaj të pretendojë që ky kuptim ka nevojë për “tavil”.

Shprehje si “Allahu është në qiell” apo “Allahu është mbi Arsh” janë ekuivalente. Sepse fjala “qiell” nënkupton lartësinë dhe kuptimi është që Allahu ﷻ është në lartësi dhe jo poshtë. Muslimanët e dinë që Kursija e Allahut ka përfshirë qiejt dhe tokën dhe se Kursija në krahasim me Arshin është njësoj si një unazë e hedhur në mesin e shkretëtirës. Ata janë të bindur që Arshi është krijesë prej krijesave të Allahut ﷻ dhe nuk është me kuptimin e fuqisë dhe madhësisë së Allahut. Pas kësaj që përmendëm, si mund të supozohet që një krijesë (si puna e qiellit) ta përfshijë dhe ta rrethojë Allahun?

Allahu ﷻ thotë: **﴿Do u kryqëzoj në trungjet e pemëve﴾** Taha 71, dhe thotë: **﴿udhëtoni në tokë﴾** Ali imran 137, ku parafjala “në” vjen me kuptimin “mbi”. Apo si në shumë ajete të ngjashme. Kjo është gjuhë arabe me kuptim real dhe jo alegorik. Këto domethënie i kupton ai i cili i njeh kuptimet reale të parafjalëve dhe se ato në shumicën e rasteve janë **polisemi** dhe jo **homonime**.

Po kështu fjala e profetit ﷺ: **“Kur dikush prej jush të ngrihet për t'u falur, Allahun e ka karshi fytyrës së tij, prandaj të mos pështyjë përpara fytyrës së tij”**¹ është e vërtetë dhe në kuptimin e saj aparent. Allahu ﷻ është sipër Arshit dhe ai është karshi fytyrës së tij. Madje ky përshtet lejohej të përdoret edhe për krijesën. Nëse dikush i lutet qiellit, Diellit dhe Hënës, atëhere qielli, Dielli dhe Hëna janë sipër tij dhe janë karshi fytyrës së tij.

I dërguari i Allahut ﷺ solli një ilustrim për këtë dhe Allahut ﷻ i takon shëmbulli më i përkryer dhe me ilustrimin nuk ka pasur për qëllim përngjasimin e krijesit me krijesën, thotë: **“Kushdo prej jush do ta shikojë zotin e tij të veçuar me të”. Ebu Rezin Ukejlju i tha: Si do e shikojmë o i dërguar i Allahut, kur ai është një dhe ne jemi shumë? Atëhere profeti i tha: Do të të sjell një shëmbull prej mirësive të Allahut. Këtë hënë, të gjithë ju e shikoni të veçuar dhe ajo është mrekulli prej mrekullive të Allahut dhe Allahu është më i madh”**² apo siç ka thënë profeti ﷺ.

¹ **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu dhe Muslimi. U përmend më parë.

² **Hadith daif.** E transmeton Ebu Daudi (4731), Ibn Maxheh (180), Ahmedi në “El musned” 16186, Abdullah ibn Ahmedi në “Es sunneh” (447) etj. Hadithin e Ebu Rezinit e transmeton Jala ibn Ata nga

Dhe thotë: ***“Ju do ta shikoni zotin tuaj ashtu siç e shikoni Diellin dhe Hënën”***¹
E krahasoi shikimin me shikimin megjithëse i shikuari nuk është i përngjashëm me të shikuarin.

Pra besimtarët do ta shikojnë zotin e tyre në ditën e gjykimit dhe do të bisedojnë me të. Kushdo prej tyre do e shikojë atë sipër tij dhe karshi fytyrës së tij, ashtu siç shikohet Dielli dhe Hëna dhe mes tyre nuk ka mospërputhje.

Pohimi i Kuranit dhe sunetit prej atij që posedon njohje të thellë dhe dije të sigurtë, është më i plotë se pohimi i tjetërkujt.

Dije që disa të mëvonshëm janë shprehur se medhhebi i selefit është pranimi i këtyre tekseve ashtu siç kanë ardhur, me besimin se kuptimi aparent i tyre nuk është pasur për qëllim. Kjo shprehje është e përgjithshme. Nëse ka pasur për qëllim me kuptimin aparent, tiparet e gjallesave dhe cilësitë e krijesave, atëherë padyshim që kjo nuk kihet për qëllim. Si p.sh. nëse me fjalën “karshi fytyrës së tij” të kihet për qëllim që Allahu ﷻ ekziston në vetë murin që është karshi namazliut², apo me fjalën “Allahu është me ne” të kihet për qëllim që Allahu ﷻ është anash nesh.

Kush thotë: “Sipas medhhebit të selefit kjo nuk është pasur për qëllim”, ai ka thënë një kuptim të vërtetë. Mirëpo ka gabuar në aspektin se ka pretenduar që ky është kuptimi aparent i ajeteve dhe haditheve. Këto kuptime të pamundura nuk janë kuptimet aparente siç e kemi sqaruar në libra të tjerë.

Vetëm nëse kanë për qëllim që ky kuptim i pamundur, zuri të bëhej aparent në një grup i caktuar njerëzish. Thënësi i kësaj shprehje³, i parë nga ky prizëm, ka thënë të vërtetën dhe justifikohet për përgjithësimin e saj.

Kuptimi aparent apo i fshehtë, mund të ndryshojë në varësi të njerëzve dhe ai është diçka e variueshme. Por më e udhës do të ishte që atij që besonte se kuptimi

Veki ibn Hudusi ose Udusi, gjëndja e të cilit nuk është e njohur. Shejh Albani e ka konsideruar hasen, sepse transmetohet edhe nga rrugë të tjera të ndryshme nga ajo e Veki ibn Hudusit!! Shejh Abdulkadir Arnauti në “Xhamiul usul” dhe Shuajb Arnauti në “El musned” dhe në “Sherh et tahavijeh” e kanë konsideruar të dobët. Kjo përsa i takon senedit të këtij hadithi. Mirëpo ana kuptimore e këtij hadithi është saktësuar në shumë e shumë hadithe të tjera të sakta përveç hadithit të Ebu Rezinit.

¹ Hadithet që dëshmojnë për shikimin e Allahut në ditën e gjykimit, ashtu siç shikohet Hëna e plotë dhe në disa rivajete të tjera siç shikohet Dielli i pambuluar me re, kanë arritur gradën e hadithit mutevatir. Ato transmetohen nga gati 30 sahabi të ndryshëm dhe nga secili sahabi me rrugë transmetimi të ndryshme dhe të sakta.

² Siç është mendimi i shumë xhehmive të cilët besojnë se Allahu ekziston kudo, megjithëse nuk besojnë në panteizëm, pra se Allahu është i mishëruar me krijesat. Ata besojnë se Allahu është kudo por i dalluar nga krijesat. Kjo akide më vonë ka degraduar te disa sufista si Ibn Faridi, Ibn Tilmisani, apo Ibn Arabiu deri në akiden e mishërimit të Allahut në çdo gjë dhe në çdo send.

³ Shprehjes që “medhhebi i selefit është pranimi i këtyre tekseve ashtu siç kanë ardhur, me besimin se kuptimi aparent i tyre nuk është pasur për qëllim”.

aparent është i tillë, t'i sqarohej që ky nuk është kuptimi aparent, në mënyrë që t'i jepet fjalës së Allahut dhe fjalës së profetit ﷺ haku i saj, si në aspektin leksikor ashtu edhe në atë kuptimor.¹

Nëse cituesi i fjalës së selefit² me fjalën e tij “Kuptimi aparent nuk kihet për qëllim”, ka dashur të thotë që kuptimet aparente të ajeteve dhe haditheve të cilat i përshtaten madhësisë dhe madhërisë së Allahut ﷻ, të cilat nuk janë si cilësitë e krijesave, por janë të vërtetuara, ose të paktën logjika i lejon dhe në njëmendësi janë të lejuara, nëse ka dashur të thotë që këto kuptime aparente nuk kihen për qëllim, atëherë ai ose ka gabuar në citimin e këtyre fjalëve prej selefit ose ka gënjyer. Askush nuk mund të sjellë prej selefit qoftë edhe një fjalë të vetme me kuptim të prerë dhe as ndonjë fjalë që në dukje e mohon që Allahu të jetë sipër Arshit, apo që Allahu në njëmendësi nuk ka dëgjim, shikim apo dorë.

Këtë domethënie e kam hasur qartaz në librat e një personi që ia atribon këtë fjalë selefit dhe pretendon se metoda e selefit në realitet ka qënë tavili. Ai ka pasur për qëllim që të dy grupet³ janë pajtuar që këto ajete dhe hadithe nuk dëshmojnë për cilësitë e Allahut, mirëpo selefi nuk u futën në çështjet e tavilit, ndërsa të mëvonëshmit vunë re që përdorimi i tavilit është më i dobishëm për shkak të nevojës që u paraqit me kalimin e kohës. Dallimi mes tyre është që halefi e përcaktojnë me tavil kuptimin që është pasur për qëllim, ndërsa selefi nuk e përcaktojnë kuptimin e tyre sepse mund të kihet për qëllim diçka tjetër.⁴

¹ Pra t'i sqarohet atij që kujton se fjala “Allahu është me ju” e ka kuptimin aparent që Allahu është kudo. Më mirë do të ishte që këtij personi të mos i thuhej që medhhebi i selefit është mohimi i kuptimeve aparente, por t'i thuhej: Ky kuptim aparent që pretendove nuk është kuptimi aparent, por është një kuptim ireal dhe i pavërtetë që nuk kuptohet as në aparencë.

Sepse në rastin e parë, ti je pajtuar me këtë person që kuptimi aparent i ajetit **﴿Ai është me ju kudo që të jeni﴾** është qenia e Allahut kudo, megjithëse e ke mohuar duke pretenduar që ky ajet ka nevojë për tavil. Në këtë rast nuk i ke dhënë Kuranit hakun e tij, sepse ke pranuar parimisht si një kuptim aparent, një kuptim të cilin Allahu nuk e ka pasur për qëllim dhe aparenca e fjalës së Allahut dëshmon të kundërtën. Përgjigja më e saktë në një rast të tillë është saktësimi i këtij keqkuptimi dhe t'i thuhet: Kuptimi aparent i ajetit nuk është ashtu siç e imagjinove ti, por është kështu dhe ashtu.

² Kjo fjalë lidhet me fjalën e mëparëshme të Ibn Tejmijes: “Dije që disa të mëvonshëm janë shprehur se medhhebi i selefit, është pranimi i këtyre tekseve ashtu siç kanë ardhur, me besimin se kuptimi aparent i tyre nuk është pasur për qëllim. Kjo shprehje është e përgjithshme ...”.

³ Në njërën anë selefi që janë tre brezat e parë dhe në anën tjetër halefi të cilët kanë ardhur pas tre brezave të parë. Kjo fjalë që përmend Ibn Tejmije këtu mund të jetë e Fehrudin Raziut.

⁴ Esharitë në përgjithësi e pranojnë që selefi nuk kanë angazhuar me përdorimin e tavilit në çështjen e cilësive dhe pretendojnë që medhhebi i tyre ka qënë tefvidi, mirëpo tefvidi sipas tyre është tefvidi i cili e mohon kuptimin aparent prej të cilit përfitohet pohimi i një cilësie që i përshtatet Allahut.

Një pakicë e esharive kanë vajtur më larg dhe kanë thënë që përderisa selefi kanë besuar që kuptimet aparente nuk kanë qënë për qëllim në ajetet dhe hadithet e cilësive, atëherë në realitet ky është kuptimi i medhhebit të tavilit. Mirëpo dallimi i selefit me halefin është se halefi e kanë përcaktuar kuptimin e tavilit

Kjo fjalë e pakufizuar, është një gënjeshtër e pastër ndaj selefit. Për disa cilësi si puna e lartësimit mbi Arsh ajo është gënjeshtër me siguri të plotë. Kushdo që i hulumton fjalët e transmetuara nga selefi, prej të cilave në këtë fetva nuk kemi përmenduar as një të dhjetën e tyre, ka për të ditur me bindje të plotë se selefi janë shprehur haptazi që Allahu është sipër Arshit realisht dhe se ata nuk kanë pasë besuar të kundërtën e kësaj. Shumë selefë të tjerë janë shprehur qartazi edhe për pohimin e shumë cilësive të tjera.

Allahu ﷻ e di se si pas një kërkimi dhe shqyrtimi të plotë, nuk munda të gjejë prej fjalëve të selefit asnjë fjalë të prerë apo me kuptim të dukshëm apo me kuptimim tërthor, që të mohojë cilësitë haberije për shkak se janë cilësi haberije. Përkundrazi ajo që kam hasur është se një pjesë e mirë e shprehjeve të tyre dëshmojnë për pohimin e kategorisë së këtyre cilësive, ose prerazi ose në mënyrë të dukshme. Nuk them se transmetohet prej secilit prej tyre pohimi i çdo cilësie, por ajo që kam hasur është pohimi i kategorisë së cilësive haberije në mënyrë të përgjithëshme.

Nuk kam hasur askënd prej tyre të mohojë këtë kategori cilësish, por mohojnë përngjasimin dhe kritikojnë përngjasuesit, të cilët përngjasojnë Allahun ﷻ me krijesat e tij dhe kritikojnë ata që mohojnë cilësitë. Si puna e thënies së profesorit të Buhariut, Nuejm ibn Hamad Huzaiut¹: ***“Kush e përngjason Allahun me krijesat e tij ka bërë kufër. Kush e mohon atë me të cilën Allahu ka cilësuar veten e tij ka bërë kufër. Ajo me të cilën Allahu dhe i dërguari i tij e kanë përshkruar Allahun nuk është përngjasim”***.²

me një kuptim të caktuar, psh kanë thënë që me fjalën dorë mund të kihet për qëllim fuqija, mirësia, bujaria etj. Dhe tavili i fjalës dorë është kuptimi i fuqisë.

Ndërsa selefi nuk e kanë përcaktuar tavilin e saj në një kuptim të veçantë, dhe nuk kanë thënë që me fjalën dorë mund të kihet për qëllim fuqija, nga frika se me të mund të kihet për qëllim bujaria dhe mirësia, dhe gabimi në tavil nënkupton të folurit për Allahun padije.

Megjithëse edhe selefi edhe halefi ata janë pajtuar që me fjalën dorë nuk kihet për qëllim “cilësia e dorës”. Nga ky aspekt selefi e kanë pranuar tavilin e fjalëve prej të cilave mund të kuptohen cilësi të zotit. Ky ishte shkurtimisht pretendimi i disa esharive. Megjithëse mendimi më i përhapur në mesin e tyre është mendim i parë se selefi kanë qënë cilësuar me tefvid dhe jo me tavil.

Dallimi i grupit të parë nga i dyti është se tefvidi i selefit, sipas esharive nënkupton që ata nuk i kanë ditur kuptimet që kanë dashur të thuhet me fjalë si “dora, syri apo fytyra”. Ndërsa grupi i dytë që pretendon tavilin, mendojnë që selefi i kanë ditur kuptimet e këtyre fjalëve, mirëpo përderisa kuptimet e tyre kanë qënë të shumta, ata nuk kanë zgjedhur një kuptim të caktuar ashtu siç kanë vepruar të mëvonëshmit.

¹ Nuejm ibn Hamad Huzaiu, profesori i imam Buhariut. Thuhet se ka thënë: “Kam qënë xhehmi prandaj dhe i njoha thëniet e tyre. Kur fillova të kërkoja hadithin e kuptova që çështja e tyre të çonin në mohim”. Imam Ahmedi e ka lavdëruar së tepërmi për qëndrimet e tij ndaj xhehmive. U sprovua shumë gjatë fitnes të krijimit të Kuranit, aq sa vdiq i burgosur në vitin 228h. dhe si amanet la që të varrosej me pranga në duar, si argument kundër xhehmive në ditën e gjykimit.

² **Ether sahih.** E transmeton Lalekai në “Sherhul usul” 963. E transmeton edhe Dhehbiu në “El ulu” (464) dhe në “El arsh” (209) me sened të plotë. Në librin e tij pasi përmend këtë thënie dhe një thënie tjetër të Nuejm ibn Hamadit thotë: “Të dyja këto fjalë janë të sakta”. Atë e ka saktësuar edhe shejh Albani në “Muhtesarul ulu”.

Kur e shikonin ndonjë person të ekzagjeronte në mohimin e përngjasimit por pa u shprehur për pohimin e cilësive, e cilësonin atë si xhehmi mohues. Kjo haset shpesh në thëniet e tyre. Xhehmitë dhe mutezilitë edhe në kohën e sotme, vazhdojnë t'i quajnë

Ibn Kethiri në komentimin e ajetit **﴿Pastaj u lartësua mbi Arsh﴾** thotë: “Në këtë çështje njerëzit kanë thënë thënie të shumta por vendi nuk na lejon t'i përmendim. Ne ndjekim në këtë çështje medhebin e selefit të udhëzuar, i cili është pranimi i tyre ashtu siç kanë ardhur pa dhënie forme, pa përngjasim dhe pa **tatili**”. Aparenca e cila u shkon në mendje përngjasuesve është e mohuar prej Allahut, sepse Allahu ﷻ nuk i përngjason asnjë krijese, **﴿Askush nuk është si ai dhe ai është dëgjuesi shikuesi﴾**.

Kjo çështje është ashtu siç ka thënë profesori i Buhariut Nuejm ibn Hamad Huzaiu: **“Kush e përngjason Allahun me krijesat e tij ka bërë kufër. Kush e mohon atë me të cilën Allahu ka cilësuar veten e tij ka bërë kufër. Ajo me të cilën Allahu dhe i dërguari i tij e kanë përshkruar Allahun nuk është përngjasim”**. Kush e pohon për Allahun ﷻ atë që është përcjellur në ajetet e qarta dhe hadithet e sakta, ashtu siç i shkon përshtat madhërisë së Allahut ﷻ, dhe i mohon prej Allahut ﷻ mangësitë, atëhere ai ka ndjekur rrugën e udhëzimit”. Mbaroi fjala e Ibn Kethirit.

Disa kelamistë spekulantë u munduan ta shfrytëzonin këtë fjalë të Ibn Kethirit për të treguar që ai nuk është në medhebin e Ibn Tejmijes! Çudia më e madhe është se Ibn Kethiri këto fjalë të tija, i ka marrë pikërisht nga profesori i tij shejhul-islam Ibn Tejmije.

Ibn Kethiri nuk e mohon kuptimin aparent të ajeteve të cilësie, por mohon kuptimin që përngjasuesit kujtojnë se është kuptimi aparent i këtyre ajeteve. A nuk e vëren përputhjen e plotë mes fjalëve të Ibn Tejmijes këtu në “El-hameviye” me fjalën e Ibn Kethirit në tefsirin e tij.

Si mund të ketë parasysh Ibn Kethiri "tefvidin" që pretendojnë esharitë dhe maturiditë, ndërkohë që ai thotë: “(medhebi i tyre) është pranimi i tyre ashtu siç kanë ardhur pa dhënie forme, pa përngjasim dhe pa **tatili**”. Fjala **“tatili”** në gjuhën arabe është zbrazja e diçkaje, si në fjalën e Allahut **﴿dhe sa puse të zbrazur ...﴾** të cilën vetë Ibn Kethiri në tefsirin e tij e shpjegon si pus i zbrazur ose i braktisur nga njerëzit.

Tatili është pikërisht zbrazja e ajeteve nga domethëniet e tyre. Është pikërisht ky **tefvidi** i kuptimeve që e pretendojnë esharitë dhe maturiditë. **Tatili** nuk është mohimi i ajetit si ajet, por është zbrazja e fjalëve të ajetit nga përmbajtja e tyre kuptimore.

Mohimin e ajeteve si ajet nuk e ka pretenduar askush, me përjashtim të disa shiave ekstrem. Nuk njihet në historinë islame që xhehmitë, mutezilitë apo rryma të tjera kelamiste, të kenë mohur ndonjë ajet si ajet dhe të kenë thënë që ky ajet nuk është prej Kuranit! Mohimi i ajeteve prej tyre ka qënë pikërisht zbrazja e këtyre ajeteve prej përmbajtjes kuptimore të tyre.

Esharitë me termin **“tefvid i kuptimeve”** nënkuptojnë ato fjalë ajetesh që dëshmojnë për cilësi të Allahut ﷻ të cilat ata i konsiderojnë të pamundëshme logjikisht, si puna e dorës, syrit, istivasë mbi Arsh, etj. Rrjedhimisht thonë që këto fjalë nuk kanë kuptimin e dorës dhe as të syrit, ne i pranojmë si fjalë të Kuranit po jo si kuptime, sepse kuptimin e tyre e di vetëm Allahu.

Si fjalë Kurani ato i kanë pranuar edhe xhehmitë edhe mutezilitë ndërsa kuptimet e tyre i kanë mohuar.

Si ka mundësi që imam Ibn Kethiri qënka me medhebin e “tefvidit” të kuptimeve, ndërkohë që ai pohon se ajetet e cilësive duhen pranuar pa **tatili** dhe **tatili**-i është pikërisht zbrazja e fjalëve të ajeteve të cilësive nga kuptimet e tyre. **Tefvidi** dhe **tatili** nuk mund të bashkohen sëbashku sepse ato janë dy kahe të kundërta.

Aq më shumë kur Ibn Kethiri e përforcon mendimin e tij në pohimin e istivasë edhe me fjalën e Nuejm ibn Hamadit: **“Ajo me të cilën Allahu dhe i dërguari i tij e kanë përshkruar Allahun nuk është përngjasim”**, për të treguar që në kuptimet aparente të Kuranit nuk ka përngjasim, prandaj ato pohohen dhe nuk mohohen, por ajo që mohohet është kuptimi aparent që përngjasuesit e kujtojnë të tillë, të cilin Allahu ﷻ kurrësi nuk e ka pasur për qëllim.

Vëreje, Allahu të mëshiroftë, mprehtësinë dhe dijen e thellë të dijetarëve tanë në këtë çështje!

përngjasues ata që pohojnë diçka prej cilësive dhe kjo është një trillim dhe shpifje.

Madje ndonjë prej tyre e ekzagjeroi aq shumë sa kaloi deri në akuza ndaj profetëve, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi ta. Aq sa një prej kokave të xhehmive, Thumame ibn Eshresi¹ ka thënë: ***“Tre profetë kanë qënë përngjasues. Musai atëhere kur tha: ﴿Ajo është vetëm fitneja jote﴾ El araf 155, Isai kur tha: ﴿E di atë që është në veten time dhe nuk e di atë që është në veten tënde﴾ El maide 116, dhe Muhamedi kur thotë: “Zoti jonë zbrit”.***

Shumica e mutezilive i fusin në varganin e përngjasuesve imamë si puna e Malik ibn Enesit dhe nxënësit e tij, Theuriun dhe nxënësit e tij, Euzaïun dhe nxënësit e tij, Shafiun dhe nxënësit e tij, Ahmedin dhe nxënësit e tij, Is’hak ibn Rahavejhun, Ebu Ubejden dhe të tjerë.

Dijetari shafi, Ebu Is’hak Ibrahim ibn Uthman ibn Dirbasi ka hartuar një broshurë me titull “Pastrimi i sheriatit prej epiteteve të ulta”. Aty cek thëniet e selefit dhe të dijetarëve të tjerë dhe përmend kuptimet e këtyre epiteteve. Më pas përmend se çdo grup bidatçi e epiteton ehli-sunetin me epitete që vetë i kanë shpikur, duke pretenduar se këto epitete janë të vërteta bazuar në mendimet e tyre të devijuara. Ashtu siç mushrikët e epitetuan profetin ﷺ me epitete të rreme.

Pasuesit e sunetit; prej rafidive epitetohen si nasibi, prej kaderive epitetohen si xhebri, prej murxhive epitetohen si dyshues, prej xhehmive epitetohen si përngjasues, prej kelamistëve epitetohen si hashevi, çiliminj, llum i përzier, tufë injorantësh etj. Ashtu siç kurejshët e quanin profetin ﷺ të çmendur, poet, fallxhor dhe mashtrues.

Pasuesit e selefit kanë thënë: Kjo është shenjë e trashgimisë së saktë dhe pasimit të vërtetë. Suneti është ajo gjë në të cilën ka qënë i dërguari ﷺ, në akide dhe në metodë, në fjalë dhe në vepra. Ashtu si kundërshtuesit e quajnë profetin ﷺ me lloj-lloj epitetesh të rreme dhe të ulta, duke i supozuar të vërteta për shkak të akides së tyre të devijuar, po ashtu edhe pasuesit me dije të profetit ﷺ (do të marrin pjesën e tyre prej këtyre epiteteve), sepse ata janë njerëzit që më shumë e meritojnë ti bashkangjiten profetit ﷺ, në këtë jetë dhe pas vdekjes, në veprat e dukshme dhe në fshehtësitë e zemrave.

Ndërsa ata që e kanë pasuar profetin ﷺ në brendësitë e tyre dhe nuk kanë mundur ta pasojnë atë në pamjen e dukshme, apo janë pajtuar me të në pamjen e jashtme por nuk kanë pasur mundësi ta pranojnë me brendësitë e tyre, apo ata që e kanë pasur profetin ﷺ në pamje të jashtme dhe të brendëshme aq sa kanë pasur mundësi, patjetër që të devijuarit nga suneti patjetër do gjejnë te ta shkasë që ti nënçmojnë dhe ti quajnë me etiketime të rreme, të cilat i kujtojnë për të vërteta.

¹ Ibn Haxheri ka thënë për të: “Thumame ibn Eshresi është nga kokat e mutezilive dhe prej prijësve të humbjes ...”. Vdiq në vitin 213h.

Si thënia e rafidiut: Kush nuk e urren Ebu Bekrin dhe Umerin ai e ka urryer Aliun, sepse vilajeti i Aliut arrihet vetçse me distancimin prej tyre. Pastaj e konsideron nasibi¹ atë që e do Ebu Bekrin dhe Umerin, bazuar në këtë kusht të pavlerë të cilin e supozuan të vërtetë apo u shtirën se është i vërtetë si në të shumtën e rasteve.

Apo si fjala e kaderiut: Kush beson që Allahu ﷻ i ka dëshiruar gjërat ekzistente dhe i ka krijuar veprat e robëve atëhere ai e ka mohuar aftësinë dhe lirinë e zgjedhjes te njerëzit dhe i ka konsideruar njerëzit të imponuar njësoj si gjërat e ngurta të cilat as nuk kanë vullnet dhe as nuk kanë aftësi për të vepruar.

Apo si fjala e xhehmive dhe mutezilive: Kush pohon që Allahu ﷻ ka dije dhe aftësi (kudret-fuqi) ai ka pretenduar se Allahu ﷻ është trup i formuar, prandaj ai është përngjasues. Sepse këto cilësi janë veti dhe vetia (aradi) ekziston vetëm në një substancë (xheuher) që ka vëllim dhe çdo gjë që ka vëllim ajo është ose trup i ndërtuar ose substancë elementare². E kush pretendon diçka të tillë ai është përngjasues sepse të gjithë trupat përngjasojnë me njëri-tjetrin.

Kush citon thëniet e njerëzve dhe i quan ata me epitete të rreme, bazuar në kundërshtimin akaidor me ta, atëhere shpërblimin do e gjejë te zoti i tij dhe Allahu ﷻ ndaj tyre është në pritë dhe kurthet e thurura godasin vetëm njerëzit e këqinj.

Baza në çështjen e ajeteve dhe të haditheve të cilësive kthehet në gjashtë grupe. Në secilin grup gjëndet disa prej pasuesve të kibles.

Dy grupe thonë se ato kuptohen në pamjen aparente.

Dy grupe të tjera thonë që ato kuptohen ndryshe nga aparenca e tyre.

Dy grupet e fundit thonë se duhet heshtur.

¹ Nasibi në terminologjinë akaidore është ai që urren ehlibejtin.

² Substanca elementare (xheuher ferd) është term i marrë nga greqishtja, nga fjala *atom*. Atomi është grimca më e vogël e pandashme e cila ruan cilësinë e lëndës. Bashkimi i disa atomeve formon trupin. Filozofët dhe kelamistët janë kundërshtuar se sa është numri më i pakët i atomeve që formojnë një trup. Disa kanë thënë tre bazuar në tre dimensionet e hapsirës e disa më shumë .

Madje ata janë kundërshtuar edhe në vetë ekzistencën e atomit ose substancës elementare të pandashme. Shkenca e sotme i ka hedhur poshtë të gjitha iluzionet primitive dhe thëniet e supozuara nga kelamistët duke e futur këtë çështje në sfera shkencore të përparuara.

Trajtimi i gabimit të kelamistëve rreth përfytyrimit të ekzistimit dhe formimit të lëndës dhe materies në natyrë dhe në njëmendësi, ka nevojë për një kërkim serioz dhe të gjatë, për të cilin e lus Allahun të ma lehtësojë dhe të ma mundësojë.

Por ajo që dua të theksoj këtu, të cilën e kanë theksuar dijetarë të mëdhenj para meje, dhe unë thjesht po bart mendimet e tyre; ajo që dua të theksoj këtu është fakti se nëse kelamistët kanë qënë të paafte të përfytyrojnë materien e dukshme e cila i rrethon kudo, si mund të pretendojnë njohjen e pakontenstueshme të natyrës hyjnore dhe të cilësive hyjnore, të cilat as nuk i shikojnë dhe as nuk mund t'i përfytyrojnë?! Aq më shumë që shumica e konkluzioneve të tyre janë pjellë e fantazisë së tyre në krahasimin logjik mes materies dhe hyjnores, mes krijesës dhe krijuesit.

1) Dy të parat ndahen në dy grupe:

Grupi i parë janë ata që i pranojnë me kuptimin aparent por pretendojnë që kuptimi i jashtëm është në një kategori me cilësitë e krijesave. Këta janë përngjasuesit. Medhhebi i tyre është i kotë. Atë e ka mohuar selefi dhe kundër tij janë drejtuar kritika të drejta.

Grupi i dytë janë ata që i pranojnë ato me kuptimin aparent i cili i shkon për shtat madhështisë së Allahut, njësoj siç i kuptojnë në aparencë emrat e Allahut si i dituri, i afti, zoti, ekzistuesi apo me atë që kuptojnë me qënien e Allahut.

Kuptimi aparent i këtyre cilësive të krijesat është ose substancë e krijuar ose veti që ekziston në këto substanca. Dija, fuqija, fjala, vullneti, mëshira, kënaqësia, zemërimi dhe cilësi të tjera si këto, të robë janë në formë vetishë.¹ Po ashtu edhe fytyra, dora dhe syri, të krijesat janë trupa.

¹ Esharitë i pranojnë shumicën e këtyre cilësive si cilësi kuptimore reale të cilat janë shtesë ndaj qënies së Allahut. Gjithashtu e pranojnë me konsensus të plotë që këto cilësi të krijesat janë veti. Ndërkohë që ata i mohojnë cilësi si dora dhe syri me argumentin se ato janë veti apo trupa.

Mirëpo kur i pyesim: Përse nuk i mohoni edhe cilësitë si dëgjimi dhe shikimi sepse ato të krijesat janë veti. Përgjigja e esharive është: Ne nuk i pohojmë ato si veti momentale por si cilësi të amëshuara. Përngjasimi mes këtyre emrave është vetëm gjuhësor sepse faktikisht realiteti i dëgjimit dhe shikimit të Allahut është i ndryshëm nga realiteti i dëgjimit dhe shikimit të krijesave. I pari është cilësi e amëshuar që i shkon për shtat krijesit ndërsa i dyti është veti momentale e krijuar që i shkon për shtat krijesës.

U thuhet: Fare mirë mund të thuhet që dora dhe syri janë dy cilësi të amëshuara të cilat i shkojnë për shtat Allahut dhe janë komplet ndryshe nga kuptimi dhe realiteti i tyre të krijesat.

Thonë: Cilësitë që ne pohojmë si dëgjimi dhe shikimi, janë nocione kuptimore dhe nocionet kuptimore mund të logjikohen si të paformëzuara. Ndërsa fjalë si “dorë” dhe “sy” kanë kuptimin e organeve trupore dhe nuk mund të kuptohen ndryshe përveçse si forma dhe konture, prandaj Allahu nuk mund të cilësohet me to.

U themi: Kuptimi i tyre vetëm si organe trupore, sidomos nëse me fjalën trup kuptohen trupa si të krijesave, nuk është kuptim aparent i këtyre fjalëve. Nuk është kusht që ato të kuptohen vetëm si organe trupore ashtu siç gjenden të krijesat. Fare mirë mund të pohohet cilësia e dorës pa e pohuar që ajo është cilësi gjymtyre trupore.

Kundërpërgjigja ndaj tyre në këtë pikë ka nevojë për shtjellime të gjata, sepse pretendimi i tyre nuk është shumë preciz dhe pranimi i një forme të paditur dhe momentalizimi i veprave është një rrjedhojë e pashmangëshme edhe në medhhebin e tyre, përveç nëse ata pohojnë se cilësitë janë gjëndje (ahuale) të cilat janë koncepte abstrakte dhe nuk ekzistojnë në njëmendësi (në botën reale) dhe kështu cilësitë e Allahut janë thjesht koncepte abstrakte ashtu siç pretendojnë shumë mutezili dhe disa eshari që janë pajtuar me ta, si puna e Ebu Meali Xhujnit i cili më pas e ka braktisur këtë mendim.

Shumica e esharive të hershëm i kanë pranuar cilësitë haberije si dora, syri, istivaja dhe zbritja, si cilësi kuptimore. Prej tyre Bejhakui dhe brezi i tyre. Mendimi i tyre nuk është larg mendimit të Ibn Tejmiyes megjithëse është i ndryshëm në disa aspekte me mendimin e tij dhe me mendimin e shumë prej pasuesve të hadithit. Sido që të jetë Bejhaku dhe brezi i tij, janë shumë herë më pranë të vërtetës sesa esharitë e mëvonshëm, apo maturiditë e hershëm dhe të mëvonshëm, të cilët bënë çmos që në një mënyrë apo në një tjetër t'i mohojnë të gjitha cilësitë haberije, duke mohuar kështu kuptimet e ajeteve kuranore dhe të haditheve profetike të sakta.

Nëse Allahu sipas pohuesve të cilësive, ka dije, aftësi, fjalë dhe vullnet të cilat te Allahu nuk janë veti momentale (arade) ashtu siç janë te krijesat, atëhere është e pranueshme që fytyra dhe duart e Allahut të mos jenë trupa të cilat kanë tiparet e trupave të krijesave.

Ky është medhhebi të cilin e ka përmendur Hatabiu dhe dijetarë të tjerë prej selefit. Fjala e shumicës së tyre dëshmon për këtë dhe fjala e dijetarëve të tjerë nuk e kundërshton këtë. Kjo çështje është shumë e qartë, sepse çështja e cilësive është si çështja e qënies. Ashtu siç qënia e Allahut është reale por pa u kategorizuar në kategorinë e qënieve të krijesave, po kështu edhe cilësitë e tij janë reale por pa u kategorizuar në kategorinë e cilësive të krijesave.

Ai të thotë: Unë dijen dhe dorën e konceptoj vetëm si dija dhe dora që unë shkojë përreth. I thuhet: Si e koncepton “qënien” e zotit e cila është e ndryshme nga kategoria e qënieve të krijuara? Dihet shumë mirë që cilësitë e të cilësuarit përshtaten me qënien e tij në mënyrë reale. Ai që prej cilësive të zotit _të cilit askush nuk i përngjan_ kupton vetëm cilësi që i përshtaten krijesës, ai është i çoroditur në fenë dhe në logjikën e tij.

Prej thënieve më të bukura që kam dëgjuar është: Kur xhehmiu të pyesë: Si është lartësuar? Si zbrit për në qiellin e dynjasë? Si janë dy duart e tij? Ose pyetje të tilla. Atëhere thuaj: Si është ai në veten e tij?

Nëse të thotë: Askush përveç tij nuk e di si është ai dhe njohja formës së krijesit nuk është në mundësinë e krijesës.

Atëhere thuaj: Dija për njohjen e formës së cilësisë është derivat i njohjes së formës së të cilësuarit. Si mund ta njohim formën e cilësisë së të cilësuarit kur ti nuk e njeh formën e të cilësuarit?! Ti e njeh qënien dhe cilësitë e Allahut vetëm përgjithësisht.

Për gjërat e krijuara në xhenet, është vërtetuar që Ibn Abasi ؓ ka thënë: ***“Nuk ngjason ajo që është në xhenet me atë që ekziston në dynja përveçse në emra”.***¹

Allahu ﷻ na ka njoftuar se askush nuk e di se çfarë kënaqësish i janë fshehurar atij në xhenet. Po kështu i dërguari i Allahut ﷺ na ka njoftuar: ***“Në xhenet ka gjëra që as syri nuk i ka parë dhe as veshi nuk i ka dëgjuar dhe askujt nuk i kanë shkuar në mendje”.***²

¹ **Ether sahih.** E transmeton imam Ibn Hazm Andalusi në librin e tij “El fisel” nga rruga e Veki ibn Xherahut nga Ameshi, nga Dhabjani, nga Ibn Abasi se ai ka thënë: ***“Nuk ngjason ajo që është në xhenet me atë që ekziston në dynja përveçse në emra”.*** Ibn Hazmi thotë: “Ky sened është shumë i saktë dhe ai është hadithi i parë që transmetohet në broshurën e njohur të Vekiut”. El fisel, 2/86. E transmeton edhe Ebu Bekr Bejhakui në “El bathu uen nushur” 332, Ebu Nuejm Asfahaniu në “Sifetul xhenneh” (124), Ibn Asakir në “El muxhem” (1194), Ibn Xherir Taberiu në tefsirin e tij (534) nga rruga e Sufjan Theuriut, nga Ameshi nga Ebi Dhabjani nga Ibn Abasi dhe Ibn Ebi Hatimi në tefsirin e tij (260).

² **Hadith sahih.** E transmeton Buhariu (3244) dhe Muslimi (51/5).

Kur puna qëndron kështu me kënaqësitë e xhenetit të cilat janë krijesa prej krijesave të Allahut ﷻ, atëhere çfarë mendoni për Allahun ﷻ?!

Apo si puna e shpirtit që është brenda njeriut. Njeriu me logjikë është i vetëdijshëm për mospajtimet e njerëzve rreth shpirtit. Tekset sheriatike kanë heshtur për formën e tij¹. Përse nuk nxjerr mësim njeriu i logjikshëm dhe të heshtë rreth formës së cilësive të Allahut ﷻ. Megjithëse ne e dimë me siguri të plotë që shpirti është brenda trupave tanë dhe që ai del prej trupit dhe ngjitet në qiell. Shpirti nxirret nga trupi në agoninë e vdekjes ashtu siç kanë dëshmuar argumentet e sakta.

Nuk e ekzagjerojmë në zhveshjen e shpirtit prej cilësive të tij, ashtu siç e kanë ekzagjeruar filozofët dhe ata që janë pajtuar me ta, aq sa mohuan që ai ngjitet dhe zbret, hyn në trup dhe del. Ata u çorditën në këtë pikë sepse e panë që shpirti nuk klasifikohet në kategorinë e trupit njerëzor dhe cilësive të tij. Mospërngjasimi i shpirtit me trupin, nuk bie në kontradiktë me pohimin e cilësive të shpirtit në një formë që i përshtaten natyrës së shpirtit.

Ose fjalën e filozofëve do t'u duhet ta interpretojnë me interpretime të tjera, në mënyrë që të pajtohet me tekset e sheriatit dhe gabimi në këtë rast të jetë thjesht një gabim verbal, por kjo është e pamundur të arrihet.

2) Ndërsa me dy grupet që mohojnë kuptimin aparent, kam për qëllim ata që mendojnë se përmbajtja kuptimore e tekseve të sheriatit nuk dëshmon për asnjë cilësi të Allahut ﷻ dhe Allahu nuk cilësohet me cilësi të pohuara, por cilësitë e tij janë ose të mohuara ose të bashkangjitura, ose të formuara nga këto dy nocione.

Ose ata që pohojnë shtatë, tetë apo pesëmbëdhjetë cilësi, apo pohojnë gjëndjet (ahualet) dhe jo cilësitë, siç janë medhhebet e kelamistëve.

Ata ndahen në dy grupe. Një grup u bën tavil cilësive dhe e përzgjedhin kuptimin që është dashur me të. Si puna e atij që thotë se kuptimi i istivasë është *istilaja* (sundimi), lartësia në pozitë, fuqija, demonstrimi i dritës së tij ndaj Arshit, apo me kuptimin e mbarimit të krijimit të Arshi, apo si shumë kuptime të tjera të pakuptimta.

Ndërsa grupi tjetër thonë: Allahu ﷻ e di se çfarë ka pasur për qëllim me këto fjalë. Mirëpo ne jemi të sigurtë që ai nuk ka pasur për qëllim ndonjë cilësi tjetër përveç atyre cilësive që ne i kemi pohuar.

3) Ndërsa grupi i parë nga dy grupet e rezervuara, mendojnë se me këto fjalë mund të kihet për qëllim kuptimi aparent që i shkon për shtat madhësisë së Allahut ﷻ por mund edhe të mos kihet për qëllim cilësimi i Allahut ﷻ. Kjo metodë është metoda e shumë fukahave dhe dijetarëve të tjerë.

¹ Ka për qëllim ajetin e sures El isra: **«Të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: Shpirti është çështje e zotit tim dhe ju shumë pak dije ju është dhënë për të»**.

Ndërsa grupi i dytë rezervohen nga e gjithë kjo dhe vetëm lexojnë Kuranin dhe hadithin duke u larguar plotësisht nga këto mundësi kuptimore me zemra dhe me gjuhë.

Këto janë gjashtë grupe prej të cilëve nuk del askush.

Metoda e saktë në shumë ajete dhe hadithe të cilësive është pohimi me siguri të plotë i metodës së dytë. Si puna e ajeteve dhe haditheve që dëshmojnë se Allahu ﷻ është sipër Arshit. Metoda e saktë në të tilla ajete dhe hadithe kuptohet me dëshminë e vetë Kuranit, sunetit dhe konsensusin e dijetarëve, pa asnjë pikë dyshimi në pasaktësinë e të kundërtës së tyre.

Ndërsa në disa argumente të tjera anohet më shumë nga pohimi i cilësisë megjithëse edhe e kundërta mund të jetë e vërtetë. Luhatja e besimtarit në këtë çështje varet nga grada e dijes dhe imanit që ai ka. Atij që Allahu ﷻ s'i ka dhuruar dritë ai s'ka ku të gjejë dritë.

Nëse dikujt i pështjellohen këto çështje, atëhere le të lutet me atë që e transmeton Muslimi në sahihun e tij, nga Aishja thotë: I dërguari i Allahut ﷺ kur falte namazin e natës thoshte: ***“O Allah! O zot i Xhibril, Mikailit dhe Israfil! O krijues i qiejve dhe i tokës! O i dituri i të dukëshmes dhe të padukëshmes! Ti do të gjykosh mes robërve të tu rreth asaj për të cilën janë kundërshtuar. Më udhëzo për atë ku është kundërshtuar e vërteta me lejen tënde sepse ti udhëzon kë dëshiron në rrugë të drejtë”***.

Në një transmetim të Ebu Daudi thuhet: Bënte tekbirin e namazit dhe pastaj e thoshte këtë.

Nëse robi kthehet te Allahu ﷻ dhe i lutet atij dhe vazhdimisht hulumton në fjalën e Allahut ﷻ dhe në fjalën e të dërguarit të tij ﷺ, në thëniet e sahabëve, të tabinëve dhe të imamëve të muslimanëve, atëhere atij do t'i çelen portat e udhëzimit.

Ai që e ka medituar katandisjen e filozofëve dhe të kelamistëve në këtë çështje dhe e ka kuptuar që shumica e atyre që ata i quajnë argumente, por që në realitet janë thjesht mëdyshje, ka për t'u bindur që shumica e asaj që ata e përzgjedhin nuk është më shumë se një pretendim joreal ose një dyshim i ndërtuar në një krahasim të gabuar. Ose është ndonjë gjykim i përgjithshëm i cili është i vlefshëm vetëm për gjërat e veçanta në kategorinë e tij. Ose mund të jetë ndonjë pretendim konsensusi i pavërtetë. Ose është një bazim në rryma dhe argumente të shprehura me fjalë shumëkuptimëse.

Pastaj argumentimet e tyre, nëse formulohen me formula të shumta, të gjata dhe të vështira, për atë që nuk e njeh terminologjinë e tyre, kanë për ta mashtruar të paditurin, ashtu siç e mashtron mirazhi të eturin.

Kush bindet për këtë realitet të kelamistëve, ka për t'ju shtuar besimi te Kurani dhe suneti, si në dije ashtu edhe në vepra, sepse mirësinë e të mirës, e nxjerr në pah

vetëm njohja e të kundërtës. Kushdo që të kotën e njeh më mirë, ai për të vërtetën është më i ditur dhe pozitivisht e saj e vlerëson më shumë.

Ndërsa kelamistët e mesëm janë në rrezik më të madh se ata që nuk janë futur në këto çështje, madje në rrezik më të madh edhe se ata që kanë arritur në *ilmul-kelam*, kulmin e tij. Ai që nuk ka hyrë në *ilmul-kelam* është i pasprovuar. Ndërsa ai që ka arritur majat e tij, e ka kuptuar cakun e kësaj dije dhe nuk ka pse të frikësohet për ndonjë humbje tjetër. Prandaj ai e pranon të vërtetën atëhere kur qartësohet dhe është i etur për të. Ndërsa kelamisti i mesëm jeton me iluzionet e thënieve, të cilat shumicën e tyre i ka imituar.

Thuhet: Askush nuk e dëmton njerëzimin më shumë se një gjysëm kelamist, një gjysëm fakih, një gjysëm mjek dhe një gjysëm gramaticien. I pari shkatërron fenë, i dyti shkatërron vendin, i treti trupin dhe i katërti gjuhën.

Njeriu i logjikshëm dhe i zgjuar i cili është bindur që kelamistët filozofë dhe kelamistët e tjerë, në shumicën e rasteve janë **«në gjithfarë kontradiktash. Prej tij (Kuranit) do të shmanget ai që do të shmanget»** Edh dharijat, 8-9, ka për ta ditur që kelamisti për atë që thotë nuk posedon ndonjë dije të sigurtë dhe se argumenti i tij nuk është i qartë, por argumentet e tyra janë njësoj si ato që poeti thotë:

Argumente që rrëzohen një nga një si shishet e xhamit

I merr për të vërteta por çdo thyes një herë do të thyhet

Nga njëra ana ata e meritojnë atë që ka thënë Shafi'u: **“Gjykimi im për pasuesit e *ilmul-kelamit* është që të goditen me shapka dhe thupra, pastaj të demaskohen te fiset dhe familjet e ndryshme dhe të thuhet: Ky është dënimi i atij që e braktis Kuranin dhe sunetin dhe merret me dijen e kelamit”.**¹

Nga ana tjetër nëse i vështrojmë ata me syrin e kaderit, do i gjejmë të hutuar dhe nga shejtani të mashtruar dhe kanë për t'u dhimbsur. U është dhuruar zgjuarsia por jo pastërti, u është dhuruar mprehtësi por jo dituri. Iu dhurua dëgjimi, shikimi dhe zemra mirëpo: **«Nuk u bëri dobi asgjë as dëgjimi i tyre, dhe as shikimet e tyre dhe as zemrat e tyre sepse ata i mohojnë ajetet e Allahut dhe i goditi ata ajo me të cilën po talleshin»** El ahkaf 26.

Kush është i ditur për këto çështje, ka për t'ju qartësuar atij mjeshtëria, dija dhe

¹ **Ether sahih.** E transmeton Ibn Abdulberri në “Xhamiul bejanil ilm” (1794), Ebu Nuejm Asfahani në “El hiljeh” (9/116), Hatib Bagdadi në “Sherefu ashabil hadith” (1/78). Ebu Ismail Hereviu në “Dhemmul kelam” (708) transmeton prej Shafiut se ai ka thënë: **“Gjykimi im për kelamistët është njësoj si gjykimi i Umerit për Sebigun”.**

eksperienca e selefit, të cilët ndaluan prej *ilmul-kelamit* duke e përbuzur atë dhe pasuesit e tij. Ai ka për ta kuptuar që kush e kërkon udhëzimin diku tjetër përveç Kuranit dhe sunetit, ka për t'u larguar më shumë nga udhëzimi.

E lusim Allahun e madh, të na udhëzojë në rrugën e drejtë, në rrugën e atyre të cilët i ka begatuar dhe jo në rrugën e atyre mbi të cilët ka rënë zemërimi dhe as në rrugën e të humburve.

Përmbajtja

Parathënie	3
Jetëshkrim i shkurtër i shejhulislam Ibn Tejmijes	6
Paraqitje e shkurtër e fetvasë së Hamasë.	14
Pyetja që i është parashtruar Ibn Tejmijes	20
Vlera dhe përparësia e selefit në fe dhe në dije	21
Turbullimi i halefit dhe lëkundja e tyre në dijet fetare	23
Ajete dhe hadithe që dëshmojnë për lartësinë e Allahut mbi krijesat e tij	25
Realiteti i thirrjes së kelamistëve	29
Burimi i mendimeve të kelamistëve	33
Librat dhe literatura që dijetarët kanë hartuar si replikë ndaj kelamisëve	35
Kapitull rreth bazës përmbledhëse në besimin e emrave dhe të cilësive sipas pasuesve të hadithit	37
Medhhebi i selefit është mes temthilit dhe tatilit	38
Rrymat e të devijuarve në çështjen e emrave dhe të cilësive	43
1- pasuesit e iluzionit	43
2- pasuesit e tavilit	44
3- pasuesit e injorimit	45
Kuptimet e fjalës “tavi”	45
Fjala e Abdulaziz ibn Abdullah Maxheshonit	53
Fjalët e Ebu Hanifes në “El fikhul ekber”	57
Transmetime të ndryshme nga disa dijetarë të hershëm rreth pohimit të lartësimit mbi Arsh	60
Fjala e imamit të malikive Muhamed ibn Abdullah ibn Ebi Zemnit	67
Fjala e shejhut të sufive Mamer ibn Ahmed Asfahaniut	72
Fjala e Ebu Bekr Halalit	73
Fjala e nxënësit të Xhunejdut Amr ibn Uthman Mekiut	74
Fjala e Harith Muhasebiut	76

Fjala e shejhut të sufive dhe nxënësit të Ebu Hasen Eshariut Ebu Abdullah Muhamed ibn Hafifit	82
Fjala e imamit të Andaluzisë Ebu Umer Ibn Abdulberrit	97
Disa transmetime të përmendura nga Ebu Bekr Bejhakiu në librin e tij rreth cilësive që dëshmojnë për medhhebin e selefit	98
Fjala e Kadi Ebu Jala Hambeliut	100
Fjala e Ebu Hasen Eshariut	101
Fjala e Ebu Bekër Bakelaniut	107
Bazat e udhëzimit janë urtësia, imani dhe logjika	108
Fjala e Ebu Meali Xhuvėjniut	109
Synimi i Ibn Tejmijes në këtë përgjigje	110
Mes argumentave të cilësive nuk ka mospërputhje	110
Gjashtë grupet në çështjet e emrave dhe të cilësive	120
Lutja që duhet të bëjë muslimani në rast pështjellimi rreth këtyre çështjeve	124
Përmbajtja	127